Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XLI   nr. 94 / 2010

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XLI   nr. 94 - 2010

Botues:
Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës
Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84
Tel & fax: 038 / 224-024
e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:
Mr. Qemajl Morina
qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:
Akad. Pajazit Nushi, Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahimi, Hajrullah Hoxha dhe Dr. Xhabir Hamiti.

Sekretar i redaksisë:
Hajrullah Hoxha

Lektor:
Bislim Berisha

Korrektor:
Skender Rashiti

Realizimi: **Shtëpia Botuese**

Redaktor teknik &
Operator kompjuterik:
Nuhi Simnica

Shtyp: KOHA - Prishtinë

Tirazhi: 1000

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLI nr. 94 / 2010

Prishtinë
2010

EDITORIALI

Qemajl Morina

MEHMET ALI PASHA BURRËSHTETI

Nuk ka dyshim se Mehmet Ali Pasha, vali i Egjiptit (1805-1849), lindur në Kavallë, të vilajetit të Janinës, është ndër personalitet më të njohura jo vetëm të kombit shqiptar, por edhe më gjerë. Pyetja e cila shtrohet në mesin e historianëve egjiptian është se: A është meritë e Egjiptit që e bëri Mehmet Ali Pashën një personaliet aq të madh, apo ishte meritë e Mehmet Ali Pashës që e bëri Egjiptin një vend të njohur dhe të përparuar?! Historianët poashtu flasin për besnikërinë e Mehmet Ali Pashës ndaj identitetit të tij osman, duke e përfshirë edhe atë shqiptar, ndërkohë që i biri i tij Ibrahimi kishte një simpati ndaj identitetit të atdheut të ri Egjiptit, i cili i kishte ofruar çdo mundësi.

Këto të dhëna dhe shumë tjera për biografinë e Mehmet Ali Pashës, na ofron studiuesja nga Egjipti, Afaf Lutfi Sejid Marso, në libri e saj "Egjipti në kohën e Mehmet Aliut", por kësaj radhe do të bëjmë fjalë për letrat që themeluesi i Egjiptit modern u kishte dërguar bijve të tij, të cilat janë përplot urtësi, dashuri dhe këshilla prindore, por ato përmbajnë edhe këshilla të një burrështetasi i një tirazi të veçantë, siç ishte Mehmet Ali Pasha.

Për shkak të ekspeditave luftarake, për zgjerimin e kufijve të shtetit, bijtë e tij edhepse në moshë shumë të re, ishin të shpërndarë në ve-

nde të ndryshme të Gadishullit Arabik dhe në Afrikë. Ismail Qamili, biri i tretë i Mehmet Aliut (1775-1822), në moshën 25 vjeçare e kishte dërguar në krye të një ekspedite luftarake në Sudan. Në kulmin e fitoreve pas disa betejave, në shenj ngadhënjimi i dërgoi babait të tij treqind palë "veshë" të prerë. Ky gjest i birit të tij e kishte irrituar pa masë, për çka i kishte shkruar: "A nuk ke dëgjuar si duhet të jetë sjellja e njerëzve gjatë luftërave? A nuk ke dëgjuar sa të drejtë ishin francezët në Egjipt? A nuk ke dëgjuar për drejtësinë dhe butësinë që treguan anglezët në Egjipt në një periudhë nuk është shumë e largët?" Pastaj i dërgoi një letër tjetër ku i shpjegoi se : "Misioni i komandantit të përgjithshëm është të jetë i afërt me oficerët e tij dhe të udhëheq me urtësi, mençuri dhe dashuri". I tërhoqi vërejtjen nga pasojat e pushtetit absolut dhe i shkroi me zemërim: "Nëse zgjedh ta duash vetveten më shumë se ushtarët tu, dije se unë nuk do të dua ty!" Rezultat o mospërfilljes së Ismailit këshillat e babait të tij për mëshirë e butësi ishte ajo që e çoi atë në shkatërrimin e tij. Ai pati sjellja tejet të vrazhda ndaj sudanezëve, u nënçmoi tej mase parinë e tyre. Sjelljet jo njerëzore të Ismailit ndaj parisë e shtyn njërin prej tyre t'ia vejë zjarrin kasolles së Ismailit duke e kallë atë të gjallë. Kur Mehmet Ali Pasha mori vesh për vdekjen tragjike të birit të tij u pikëllua pa masë.

Seidi, i biri i katërt i Mehmet Aliut, u lind më 17 mars 1822, Mehmet Aliu, i cili ishte analfabet deri në moshën dyzet e shtatë vjeçare, dëshironte t'u siguronte fëmijëve të tij arsimimin më të mirë, për këtë qëllim ai ia adresoi Seidit dhe të gjithë fëmijëve të familjes mbretërore të njëjtën letër: "Mësoni! Mësoni!" Kur Seidi arriti në moshën njëmbëdhjetë vjeçare, kishte mësuar turqishten, arabishten dhe persishten. Seidi poashtu kishte zotëruar frëngjishten dhe anglishten. Por, meqenëse ishte i marrueshëm, ndoshta për shkak të trashësisë së tij të tepruar, nuk kishte guxim të fliste në ato dy gjuhë. Kur e kuptoi këtë Mehmet Ali Pasha e urdhëroi të birin e tij t'i vizitojë për çdo ditë konsujt e shteteve evropiane dhe të flasë me ata në gjuhët franceze dhe angleze derisa i zotëroi mirë të dy gjuhët.

Mehmet Ali Pasha, princave të rinj u kishte caktuar një mbikëqyrje tejet të ashpër, të cilët i kishte obliguar me një studim akademik

rigoroz të gjatë, siç ishte rasti me Seidin dhe Abasin. Por, ata kishin marrë edhe nga një bursë shtesë, siç ishte dërgimi i Ahmet Rifatit dhe Ismailit, bijt Ibrahimit dhe Abdul Halimin dhe Husejnin, bijtë e Mehmet Ali Pashës për të studiuar në Francë. Kështu në një letër që valiu i Egjiptit, Mehmet Aliu ia dërgonte të birit të tij Halimit shkruante: “Dije se ti je nxënës, sikur të gjithë të tjerët. Dëgjoj të gjitha ata që sipas hierarkisë janë përgjegjës për ty. Sillu me çdo individ mirë. Përpiqu që për çdo mëngjes e mbrëmje të jesh modest dhe i sjellshëm. Me këtë ti do të fitosh reputacion të mirë si dhe do të fitosh kënaqësinë dhe miratimin tim. Do të fitosh respektin e të gjithë njerëzve.”

Mehmet Aliu i kishte shkrua të birit të tij Ibrahimit, në kohën kur ky ishte në një ekspeditë ushtarake në Sudan, me vëllain e tij Ismailin. Në ndërkohë që i biri i tij Tusuni kishte vdekur. “Biri im, unë të dua ty dhe vëllain tënd Ismailin. Ju jeni shpirti i trupit tim dhe dritë e syve të mi. Megjithatë, unë u dërgova në atë tokë të varfër dhe u ngarkova me një barrë të rëndë që të realizoni për ne dhe familjen tonë famë dhe krenari”.

Të gjitha letrat e Mehmet Ali Pashës, që u janë dërguar edhe fëmijëve tjerë përmbajnë shprehjet e dashurisë si: shpirti im, zemra ime etj.

Mehmet Ali Pasha, të njëjtën dashuri dhe respekt tregoi edhe ndaj vajzave të tij, në atë kohë kur vajzave të shtresës aristokrate nuk i kushtohej kurrfarë kujdesi për arsimimin e tyre. Në atë kohë, Mehmet Ali Pasha kishte caktuar mësues të veçantë për arsimimin dhe edukimin e vajzave të tij.

Edhepse Mehmet Aliu, nuk dinte shkrim-leximin deri kah mesi i jetës së tij, ai dëgjonte këshillat e njerëzve të dijshëm. Kjo cilësi e tij më së miri shihet në letrën e tij që ua dërgoi bijve të tij, në veçanti atë që ia dërgoi të birit të tij Ismailit, i cili ishte i pamatur, i vrullshëm, të cilit i shkroi:”Ti duhet të pyesësh dhe të kuptosh derisa të mësosh se cila rrugë të çon në fitore”. Kurse në një letër tjetër e këshillon: “Të kërkosh ndihmë dhe këshillë prej atyre që janë me grada më të larta deri tek ata më të ulëta”. Për fat të keq Ismaili nuk veproi me këshillat a babait të tij dhe si rezultat i saj përfundoi shumë keq. Kurse vëllai i

tij Ibrahimi veproi sipas tyre jetoi dhe u bë njëri prej komandantëve dhe strategëve më të njohur të ushtrisë së Egjiptit i të gjitha kohërave. Përmendoret e tij gjenden nëpër të gjitha sheshet më të njohura të qyteteve të Egjiptit.

Abasi (1812-1854), i biri i Tusunit, i biri i Mehmet Ali Pashës sundoi Egjiptin gjatë viteve (1848-1854), sepse ai ishte mashkulli më i vjetër i familjes mbretërore pas vdekjes së xhaxhait të tij Ibrahimit. Abasi ishte tejet i vrazhdë, zemër gur, përdorte metodat më të vrazhda, për këto sjellje Tusunin shumë herë e kishte qortuar gjyshi i tij.

Ibrahimi, djali më i madh i Mehmet Ali Pashës (1789-1848) ishte kopje e babait të tij dhe antipod i tij në të njëjtën kohë. Ai ishte komandant i një tirazi të veçantë. Edhepse ai ishte i vrazhdë, por ai nuk ishte më i vrazhdë se komandantët tjerë të asaj kohe, qofshin ata osmanë apo evropianë. Është e vërtetë se Ibrahimi e fshiu nga faqja e dheut, qytetin “Ed-derije”, duke e zbatuar urdhrin e babait të tij, ai shkatërroi mbretërinë e parë të vehabinjve.

Në të kundërtën e babait të tij, Ibrahimi ishte njeri i arsimuar, posedonte bibliotekën më të pasur në vend. Tregonte interesim të madh për veglat e bujqësisë. Plantazhi i tij ishte i pari që kishte përdorur fuqinë e avullit për ujitjen e tokës. Gjatë një vizite që kishte bërë në Evropë ai kishte treguar interesim të madh për të vizituar fabrikat, ishte informuar mirë për të gjitha të arriturat bashkëkohore në të gjitha lëmenjtë e shkencës dhe teknologjisë..Edhepse Ibrahimi Pasha ishte i vrazhdë, ai besonte në drejtësi. Nubari, përcjellësi i tij tregon se gjatë vizitës në Londër, Ibrahim Pasha pa policinë duke e dërguar një të dehur në arrest, ai u kthye kah ai i tha: “Këtu qëndron madhështia e Britanisë e jo vetëm në fabrikat e saj”, kishte për qëllim respektimin e ligjit.

Gjatë vizitës në Francë, Ibrahim Pasha kishte qar kur kishte parë përparimin fshatrave të Francës dhe prapambeturin e fshatrave të Egjiptit. Atëherë i kishte thënë Bubarit: “Do ta ndryshojë tërë atë, nëse Zoti më jep jetë gjatë”!

Në kohën kur Mehmet Ali Pasha e theksonte identitetin e tij osman dhe mohimin e tij e konsideronte mohim të rrënjëve të tij. Ibra-

him Pasha nuk vuante nga problemi i identitetit. Ai i jepte përparësi Egjiptit, i cili i dha shansin për të shprehur aftësitë dhe talentin e tij.

Reformat e Mehmet Ali Pashës në Egjipt

Konsulli britanik Bowring, në një raport dërguar Forin Ofisit në Londër, shkruan se në një takim që kishte pasur me valiun e Egjiptit, Mehmet Ali Pasha i kishte thënë: “Ju anglezët keni pasur fillimin tuaj ashtu siç kam unë sot fillimin tim. Fillimi i juaj ishte i kushtueshëm ashtu siç është fillimi im. Unë nuk besoj se në fillim do të korri shumë suksese, por besoj se ato do të vijnë me kalimin e kohës”.

Në realitet suksesi i Mehmet Aliut në aspektin e industrializimit të Egjiptit ishte një hap i madh, në kohën kur industria automatike dhe ajo e avullit nuk ishte e njohur në masë të gjerë as në Evropë, përveç në Britani dhe në Francë. Ndërkohë që industrializimi u vonua deri në fund të shekullit nëntëmbëdhjetë në pjesët tjera të Evropës.

Shumë fabrika të Mehmet Ali Pashës ishin të një niveli më të lartë se të atyre në Evropë. Shumë vëzhgues evropianë e shikonin me habi përparimin e madh të industrisë automatike të Egjiptit që kishte themeluar Mehmet Ali Pasha. Egjipti kishte shënuar një përparim të madh të industrive bashkëkohore, automatike dhe mekanike, ushtarake dhe civile. Zhvillimi i industrisë ishte mbështetur në fuqinë e avullit si dhe në burime tjera. Industria nuk ishte përqendruar vetëm në dy qytetet kryesore, Kajro dhe Aleksandri, por ajo ishte përhapur në të gjitha provincat.

Afaf Lutfi Sejid Marso, autorja librit “Egjipti në kohën e Mehmet Aliut”, thotë se Mehmet Aliu me industrializimin Egjiptit, zhvillimin sistemit të ujitjes, zgjerimin prodhimeve për eksport, me egjiptianizimin e administratës i vendosi bazat themelore të shtetit bashkëkohor në Egjipt. Fabrikat e reja, të cilat i përmend kronisti i kohës së Mehmet Ali Pashës, Al-Xhiberti në vitin 1816, paraqesin përpjekjet e para të aktivitetit të biznesit të një segmenti të gjerë. Themelimi i industrisë moderne kishte për qëllim sigurimin e prodhimeve vendore në vend të atyre që vinin nga importi si dhe sigurimi i prodhimeve të reja nga lëndë të para vendore, të cilat mund të gjendeshin në tregun e vendit. Sigurimi i plasmanit të prodhimeve të vendit, nëse nuk mund të sigurohej në vendet evropiane, ato mund të plasoheshin në vendet e Perandorisë Osmane për të krijuar bilanc pozitiv në tregtinë me jashtë.

Zgjerimi më i madh u bë në industrinë e tekstilit të pambukut, në të njëjtën periudhë kohore kur një zgjerim i tillë u bë në Angli, ku edhe u bë revoluciono industrial duke u mbështetur në këto prodhime. Për këto zhvillime, ekspertët dhe tregtarët e huaj në Egjipt u shqetësuan për shkak të konkurrencës të prodhimeve egjiptiane atyre evropiane. Kështu shohim se Rossel, haptazi e pranon se Mehmet Ali Pasha me ndërtimin e fabrikave në vendin e tij kishte për qëllim që një ditë vendi i tij të mos kishte nevojë të importonte prodhime nga jashtë. Kështu, vetëm brenda disa viteve fabrikat e ndërtuara në Egjipt për prodhimin e mëndafshit i dhanë grusht vdekje prurës fabrikave të mëndafshit në Itali, por edhe tek ne.

Konsulli francez, Droveti, këtij projekti i qaset me përbuzje, të cilin e quan të “pakuptimtë”. Ai thotë si mund të ketë sukses një projekt në fushën e industrisë në një vend ku e tërë popullata merret me bujqësi. Ai mendonte se Mehmet Ali Pasha, nuk mund të ketë sukses në prodhimet e tekstilit, sepse lënda e parë dhe prodhimi do t’i kushtojë më shumë se sa ai t’i importojë prodhimet e gatshme nga vendet evropiane.

Droveti, kishte harruar se Franca dhe Britania filluan prodhimet e tyre të para në mënyrë modeste duke u mbështetur në prodhimet e popujve të mëhershëm. Këtë të vërtetë e patën parasysh bashkëpunëtorët e Mehmet Ali Pashës, të cilët hynë në një konkurrencë të fuqishme. Për dallim nga Britania e Madhe, e cila nuk kishte lëndë të parë, kjo për Egjiptin nuk ishte problem. Egjipti kishte nevojë për përvojë të ekspertëve, e cila u siguria nga vendet evropiane.

Në fund, konsulli britanik në Kajro, Bowring, pranoi se prodhimet e tekstilit të pambukut të Egjiptit dëmtuan shumë prodhimet britanike. Në ndërkohë që konsulli, tjetër britanik, Kampel pohon se Mehmet Ali do të fitojë shumë nëse i shkatërron fabrikat e tekstilit dhe importon prodhimet e gatshme prej vendeve evropiane.. Në vitin 1830 ai i

shkruante Ministrit të Jashtëm britanik: “Eksporti i Egjiptit sot është katër herë më i madh se sa importi.

Në kohën kur vendet evropiane nuk deshën t’i shesin Egjiptit anije dhe armatim, Mehmet Aliu stimuloi miqtë dhe shokët e tij të investojnë në armatim dhe në ndërtimin e anijeve në llogari të tij. Për një kohë të shkurtër, pushkët dhe topa të kalibrave të ndryshëm, të cilët importoheshin më parë importoheshin, filluan të prodhohen në fabrikat e vendit.

Sipas fjalëve të Drovetit, ishte dëshirë e Mehmet Aliut, që Egjipti të kishte fare pak nevojë për import, por të eksportonte sa më shumë prodhime jashtë vendit dhe të ishte në gjendje t’i furnizonte fqinjët e tij me të gjitha llojet e prodhimeve.

Bowring tregon, se në një bisedë që ai kishte zhvilluar me Mehmet Ali Pashën, ai e kishte informuar atë, se ndërtimi i fabrikave kishte për qëllim që njerëzit të adaptoheshin në industri, më tepër se sa ato t’i sillnin vendit përfitime të drejtpërdrejta. Konsulli britanik, përmendi se disa fabrika të Mehmet Ali Pashës i sollën dëme të konsiderueshme industrisë së prodhimeve të pambukut të Anglisë.

Qemajl Morina

MEHMET ALI PASHA – THE STATESMAN

(Summary)

There is no doubt that Mehmet Ali Pasha, the wali of Egypt (1805-1849), who was born in Kavala, the vilayet of Janina, is one of the most distinguished personalities of the Albanian nation and further. The question that arises among historians is whether it was Egypt that made him such a big personality or whether it was him that made Egypt famous and highly developed?! Historians also stress the loyalty of Mehmet Ali Pasha towards his Ottoman identity, as well as his Albanian identity. On the other hand his son Ibrahim was loyal to his new fatherland, Egypt, which had provided him with endless opportunities.

كمال مورينا

محمد على باشا رجل دولة

(خلاصة البحث)

لا شك بان محمد على باشا والى مصر (1805-1849) من مواليد قولة فى ولاية يانينا يعد من اشهر الثخصيات ليس فقط بين الشعب الالبانى بل على نطاق اوسع . و السوءال الذى يطرح بين المؤرخين المصريين هو: هل مصر هى التى جعلت محمد عليا شخصية عظيمة ام ان الفضل يرجع الى محمد على باشا الذى جعل مصر بلدا عظيما و مشهورا ؟!

المؤرخون يتحدثون ايضا عن هويته العثمانية بما فى ذلك الالبانية فى الوقت الذى نرى ابنه ابراهيم الذى يميل الى هوية وطنه الجديد مصر الذى قدم له كل التسهيلات الممكنة .

FILOZOFI ISLAME

Nexhat Ibrahimi

IBN RUSHDI (AVERROESI), GJENIU MYSLIMAN NGA ANDALUZIA

1. HYRJE

Shekulli VII hixhrij gregorian karakterizohet me rrethana të paqëndrueshme politike, ekonomike e shoqërore në gadishullin iberik dhe në Afrikën Veriore. Edhe pse dinastitë ndërroheshin shpesh, dinastia e el-murabitunëve (më 541 h. e humbi sundimin nga el-muvehidunët) në këtë kohë ishte më e njohura.[1] Përkundër këtij fakti, deri atëherë Kordoba pati përjetuar periudhën më të shkëlqyer andaluziane. Kordoba përmendej krahas qyteteve të njohura botërore si Athina, Aleksandria, Roma dhe Bagdadi. Në këtë kohë në këtë qytet shquheshin dy familje kryesore: Benu Hamidin dhe Benu Rushd, e para që kryesisht merrej me politikë, kurse e dyta kryesisht merrej me jurisprudencë dhe shkencë, më larg politikës.[2]

[1] Ahmed Fuad El-Ehwani, Ibn Rusd, në: M. M. Sharif, Historija islamike filozofije, I, August Cesarec, Zagreb, 1988, fq. 539. (Më tej: M. M. Sharif).

[2] Numan Jusuf Aruç, Ibën Rushdi dhe filozofia e tij e arsimit, Logos-A, Shkup, 2006, fq. 22. (Më tej: Numan Aruç).

2. JETA

Në këtë kohë, më saktë më 520 h./1126, në Kordobë, Spanjë, u lind Ebū'l-Velid Muhammad ibn Ahmed ibn Rushdi, në botën myslimane më i njohur si *Ibn Rushd*, kurse në Perëndim më i njohur si *Averroes*.[3] Mbante prejardhje nga një familje e njohur juristësh. Gjyshi i tij kishte kryer detyrën e juristit dhe gjykatësit suprem në Kordobë. Dallohej si njohës i mirë i usuli-fikhut dhe i divergjencave të shkollave të mëdha legale (ihtilafeve).[4] I gjyshi vdiq në vitin kur lindi Ibn Rushdi. Edhe babai i Ibn Rushdit, Ebu'l-Kasimi, nga viti 532 h./ 1139, kishte punuar si gjykatës në Kordobë. Ai mbante mësim në një kënd të xhamisë së Kordobës. Mirëpo, pas një kohe e braktisi detyrën e gjykatësit dhe iu përkushtua studimit të lirë. Shkroi disa vepra, sidomos nga shkenca e fikhut, hadithit, Kur'anit. Vdiq në vitin 563 h..

Në këtë ambient familjar u lind edhe Ibn Rushdi dhe nuk do të duket e habitshme, por e natyrshme që edhe Ibn Rushdi të orientohet në profesionin e juristit. Si shumica e fëmijëve të kohës mësimet e para i mori në familje, por edhe nga mësues të veçantë. Ibn Rushdi fillimisht e mësoi Kur'anin përmendsh dhe më vonë e studioi Kur'anin dhe tefsirin, pastaj hadithin, fikhun (jurisprudencën, sidomos divergjencat (el-ihtilafat), që i mësoi te babai i tij, pastaj kelamin (teologjinë islame), gjuhën, retorikën, poezinë, mjekësinë, matematikën, astronominë, fizikën, logjikën dhe filozofinë.[5] Nga veprat fetare e ka specializuar sidomos El-Muvattaun e Imam Malikut dhe apologjetikën e Imam El-Esh'ariut.[6]

Por, më i zëshëm ai do të jetë si mjek, madje disa e krahasojnë me Galenin. Thuhet se këtë shkencë e mësoi nga Ibn Dhuhri, eksperti i kohës së tij.[7]

[3] Rreth nofkës së tij "Averroes" shih: Numan Aruç, po aty, fq. 21.

[4] Dominique Urvoy, Ibn Rushd, në: S. H. Nasr and O. Leaman, History of Islamic Philosopohy, Part I, Tehran, (-), fq. 330 (Më tej: Nasr – Leaman).

[5] M. M. Sharif, po aty, fq. 539.

[6] Hana El-Fahuri & Halil El-Xherr, Tarih'ul-felsefet'il-arabijjeti, pjesa 2, botimi 3, Bejrut, 1993, fq. 381; krhs.: Numan Aruç, po aty, fq. 24.

[7] Ernest Renan, Averroes & Averroisme, Paris (arab.), sipas: http://www.muslimphilosophy.com/books/renan.pdf.

Foto nga interneti

Ibn Rushdi filozof është më i dalluari. Ky preokupim me filozofinë e ka zanafillën e vet interesante. Së pari, halifi muvehhidin Abdulmu'mini e zgjodhi si anëtar të komisionit për themelimin dhe zhvillimin e plan-programit mësimor. Ajo që e afroi edhe më shumë me strukturat shtetërore ishte rasti kur guvernatori i Kordobës, Ebu Jakub Jusufi, e ftoi Ibn Tufejlin, gjithashtu filozof i madh, që t'ia shkruajë shpjegimet e veprave të Aristotelit, sepse sunduesi shpesh haste në paqartësi në veprat e Aristotelit, për shkak të stilit të lartë të Aristotelit. Mirëpo, Ibn Tufejli e refuzoi këtë ofertë, duke u arsyetuar se është i zënë, po ashtu, është në moshë dhe këtë punë nuk e bënë dot. Mirëpo, Ibn Tufejli i rekomandoi sunduesit që këtë punë ta bëjë një dijetar i ri, me emrin Ibn Rushdi. Kështu Ibn Tufejli i thotë Ibn Rushdit: *"Nëse ti ke forcë për ta bërë këtë punë, bëje! Them se do ta pranosh, sepse unë e di që ti ke kapacitet të madh intelektual dhe shkencor."*[8]

Ibn Rushdi e bën përshkrimin e hollësishëm të takimit të tij me guvernatorin dhe me Ibn Tufejlin. Ja si vijon:

"Më njoftoi Ebu Bekr Bendud Ibn Jahja, nxënësi i Ibn Rushdit: E dëgjova Ebu Velidin disa herë se si përsërit: "Hyra te emir'ul-mu'minin, Ebu Ja'kubi dhe e gjeta me Ebu Bekr Ibn Tufejlin. Ishin të vetëm. Kur iu bashkëngjita atyre, Ebu Bekr filloi të më lavdërojë, ta përkujtojë shtëpinë time dhe të parët e mi. Kësaj i shtoi edhe shumë gjera të tjera për të cilat nuk isha i denjë, që nuk i meritoja. Pasi më prezantoi, e theksoi emrin e babait dhe emrin e familjes, më pyeti për atë se çka mendojnë filozofët për qiejt, a janë ata të krijuar apo të amshueshëm. Në këtë pyetje më kaploi turpi dhe fillova ta qortoj dhe mohoj punën e preokupimit tim me filozofi. Derisa i flisja këto, nuk dija ç'kanë diskutuar ata për këtë. Pasi që halifi vërejti se jam shqetësuar dhe më kishte kapluar turpi, Ibn Tufejli m'u drejtua mua dhe filloi të diskutojë mbi çështjen që m'u shtrua. Citoi çdo gjë që kanë pohuar Platoni, Aristoteli dhe të gjithë filozofët, dhe citoi akuzat e filozofëve myslimanë të drejtuara atyre. Atëherë pashë mbamendje të vëllimshme që nuk kam menduar se e posedon dikush…".[9]

Pas bisedës që ishte bërë në këtë audiencë, sunduesi e kishte pëlqyer Ibn Rushdin, i kishte dhënë dhurata dhe më vonë, në vitin 565 h./1169, e kishte caktuar si gjykatës në Sevilje[10], kurse më 1182 edhe si gjykatës suprem në Kordobë dhe mjek kryesor në pallatin e halifit Ebu Jakub Jusuf në Marakesh të Marokut të sotëm, si kryeqendër e dinastisë el-muvehhidunëve.[11]

Mirëpo, pak nga smira profesionale, e pak nga konceptet puritane të juristëve dhe të ulemasë së kohës, për shkak të intrigave kundër tij për arsye të konceptit të Ibn Rushdit pro-arsyes, pro-filozofisë, menjëherë pas fitores së myslimanëve kundër të krishterëve në Betejën e Alarcosit më 1195, Ibn Rushdi u akuzua për jolojalitet ndaj sunduesit dhe madje për herezi, kurse librat e tij janë djegur.[12] Për t'iu shmangur

8 Numan Aruç, po aty, fq. 25.

9 Ahmed Fuad El-Ehwani, Filozofia islame, Zëri Islam, 2002, Prizren, fq. 91. (Më tej: El-Ehwani).

10 Numan Aruç, po aty, fq. 26-27.

11 Hana El-Fahuri & Halil El-Xherr, po aty, fq. 383 e tutje.

12 Versioni më i besueshëm i ndarjes së sunduesit dhe Ibn Rushdit mendohet se është sëmurja e sunduesit në vitin 585 h. Në këtë kohë, i vëllai i tij, Ebu Jahja shfaqi pretendime për pozitën e sunduesit, kurse Ibn Rushdi ishte në anën e këtij të fundit. Pasi që sunduesi nuk vdiq, pasoi hakmarrja, e cila nuk zgjati shumë kohë. Sipas: Numan Aruç, po aty, fq. 27.

më të keqes Ibn Rushdi u përndoq në Lucenë (ku mbahej nën mbikëqyrje). Mirëpo, nën ndikimin e njerëzve autoritarë të Seviljes te halifi, ai u kthye në funksionet e mëhershme në Marakesh. Aty, pas një kohe, në vitin 595 h./1198 vdiq, kurse trupi i tij pas tre muajve u zhvarros dhe u përcoll në vendlindje në Kordobë.[13] Këtë rast e përshkroi bukur edhe teologu e sufiu i madh Ibn Arebiu në veprën e tij të famshme *“Futuhat’ul-mekkijjeh”*, i cili ishte i pranishëm me rastin e varrimit të dytë.[14] Mirëpo, vlen të theksohet edhe fakti se Perëndimi mysliman, Magrebi dhe Andaluzia, është pjesa më konservative e botës myslimane dhe shumë e përkushtuar ta ruajë traditën. Kjo ka bërë që edhe shkolla malikite ta trashëgojë këtë karakteristikë në pikëpamjet e tyre fikhore.[15] Në një mjedis të tillë, çdo ide e re, vështrohej me thjerrëz të veçantë dhe pak duhej që një dijetar të pësojë, siç ndodhi edhe me Ibn Rushdin, por edhe me shumë dijetarë të tjerë.

Përkundër baticave e zbaticave, Ibn Rushdi numërohet një ndër njerëzit më me famë në kohën kur jetoi por edhe deri në ditët tona. Për kohën kur jetoi dhe autoritetin që e gëzonte e kemi një përshkrim të bukur dhe real nga Ibn Abbari:

“Në Endelus nuk është rritur askush që, në kohën e tij, ishte i barabartë me të sipas përgatitjes, origjinalitetit dhe zellit. Madhështinë e tij njerëzit e çmonin shumë dhe i tregonin kujdes të madh: ishte i interesuar për shkencë prej fëmijërisë deri në pleqëri. Tregohet se nuk e braktisi leximin dhe meditimin kurrë në jetën e vet pos asaj dite kur i vdiq babai. Shkroi, shënoi, revidoi dhe hartoi rreth dhjetë mijë faqe. Ndiente simpati ndaj diturive natyrore ashtu që nuk kishte të denjë në kohën e tij. Pikëpamjet e veta juridike i ka argumentuar me formën e bukur e letrare të shprehjes.”[16]

[13] Henry Corbin, Historia e filozofisë islame, Logos-a, Shkup, I-II, 1997, fq. 254-255 (Më tej: H. Corbin).
[14] Averroës, Nesuvislost nesuvislosti, Zagreb, Naprijed, 1988, fq. XII. (Më tej: Averroës, Nesuvislost); Krhs.: Sa’d Abdulaziz, felasifet’ul-islami, Kajro, 1977, fq. 48.
[15] Cyril Glasse, Enciklopedija Islama, Libris, Sarajevë, 2006, fq. 239.
[16] Sipas: El-Ehwani, po aty, fq. 90-91. Krhs.: Numan Aruç, po aty, fq. 28.

3. VEPRA

Vepra e Ibn Rushdit (Averroesit) është e vëllimshme dhe prek shumë fusha. Ai është shënuar në analet e historisë si mendimtar që vepra e tij nuk vdes me vdekjen e tij. Veprat e tij nuk e obliguan vetëm botën myslimane por edhe atë botërore. Ekspertët e veprës së Ibn Rushdit mendojnë se veprat e tij kanë hapur horizonte të reja në fushën e mendimit dhe shkencës.

Disa dijetarë veprat e Ibn Rushdit i ndajnë në disa tematika kryesore: filozofi, teologji, metafizikë, etikë, jurisprudencë, astronomi, logjikë, filologji, politikë, zoologji, mjekësi etj., mirëpo, ata nuk kanë mendim të prerë rreth numrit të veprave të tij. Ibn Ebu Usajbiu numëron 47 vepra burimore, kurse në veprën *Bernamixh’ul-fakih ibn Rushd* numërohen 78 vepra, bibliografi kjo e përgatitur nga Renan dhe Kanavat.[17]

Mirëpo, meqë nuk i posedojmë të gjitha veprat e tij dhe meqë vetëm theksimi i të dhënave më elementare të veprave të tij do të kërkonte faqe të tëra, ne do të ndalemi vetëm në veprat kryesore.

Fikhu dhe Usuli-fikhu:

Nga fusha e fikhut (të drejtës) Ibn Rushdi ka shkruar veprën e njohur *Bidajet’ul-muxhtehid we nihajet’ul-muktesid*, e cila sipas një shënimi të vetë autorit është shkruar më 563 h./1168. Vepra edhe pse është brenda drejtimit malikit, megjithatë ka specifikat e saj origjinale. Madje, disa thonë se Ibn Rushdi ka qenë drejtim-shkollë në vete, që me kalimin e kohës është zbehur e lënë anash. Vepra është përkthyer në disa gjuhë botërore. Në këtë vepër Ibn Rushdi ka shkruar edhe një vepër nga usuli-fikhu me titull *Kitab fi usul’il-fikh*. Por, kjo vepër deri sot nuk është gjetur.[18]

[17] Gjerësisht për këtë çështje: Numan Aruç, po aty, fq. 29-33.
[18] Nasr – Leaman, po aty, fq. 334 e tutje.

Mjekësia:

Nga fusha e mjekësisë Ibn Rushdi e shkroi veprën *El-Kul-lijjatu fi't-tibb*, që krahasohet më atë të Ibn Sinait me titull *Kanun fi't-tibb.* Një kohë të gjatë kjo vepër ka qenë burim kryesor (bashkë me Kanunin e Ibn Sinait) i mjekësisë myslimane dhe evropiane. Kopje të kësaj vepre gjenden në biblioteka evropiane.[19]

Filozofia:

Ai ka shkruar edhe nga fusha e filozofisë: *Fasl'ul-mekal fi ma bejne'sh'sheriati ve'l-hikmeti min'el-ittisal*. Vepra paraqet një hyrje në metodologjinë e refleksionit filozofik dhe religjioz dhe angazhohet të merret me pajtimin e shpalljes dhe arsyes dhe të fesë dhe filozofisë. Kjo vepër është përkthyer edhe në gjuhën shqipe, por në mungesë të të dhënave nuk mund të flasim për autenticitetin e veprës.[20] Kjo vepër, *Damima li mes'elet'il-ilm'il-kadim el-leti dhekereha Ebu'l-Velid fi Fasl'il-mekal*, është e bashkangjitur me veprën Fasl'ul-mekal.

Keshfu an menahixh'il-edil-leh fi akaid'il-mil-leh, është vepra vijuese, që gjendet në shumë biblioteka dhe i kushtohet në përgjithësi arsimit.

Në fushën e filozofisë vepra kryesore e Ibn Rushdit është *Tefafut'ut-tehafut* (Vetëshkatërrimi i vetëshkatërrimit). Kjo vepër është përgjigje filozofike në veprën e madhe të Imam El-Gazaliut *Tehafut'ul-felasifeh* (Vetëshkatërrimi i filozofëve). Kjo vepër ende nuk është përkthyer në gjuhën shqipe, por ekziston në shumë gjuhë botërore. Në këtë vepër Ibn Rushdi pasazh pas pasazhi e analizon veprën e El-Gazaliut dhe i përgjigjet atij.[21] Vepra është përkthyer në hebraisht, pastaj në latinisht. Më vonë është përkthyer edhe në anglisht, spanjisht, turqisht, persisht, boshnjakisht, gjermanisht etj.

Shkroi edhe veprën Mekale fi ittisal'il-akli bi'l-insan etj.

Ai shkroi edhe vepra të tjera, si ato që i shkroi me kërkesë të halifit të kohës së tij, Ebu Ja'kub Jusufit: *Komenti i vogël (xhami'), Komenti i mesëm (telhis) dhe Komenti i madh (tefsir apo sherh)*. Këto komente aktualisht nuk kanë ndonjë vlerë të madhe, pos vlerës historike, sepse ndër të tjera ka ndikuar që Evropa të njihet me Aristotelin dhe vlerat e tjera greke.[22]

[19] Nasr – Leaman, po aty, fq. 336-337.

[20] Ibn Rushd, Pajtimi ndërmjet sheriatit dhe filozofisë, në: Revista Edukata Islame, nr. 81/2006, Prishtinë, fq. 45-83. (Më tej: Ibn Rushd, Pajtimi)

[21] Personalisht e kam përdorë përkthimin në gjuhën kroate nga orientalisti Daniel Bučan: Averroës, Nesuvislost nesuvislosti, Zagreb, Naprijed, 1988.

Lëvizjet e Ibn Rushdit kanë ecur përafërsisht në këtë drejtim

[22] Ahmed Fuad El-Ehwani, po aty, fq. 92-93. Numan Aruç, po aty, fq. 29-33

Për shkak të klimës jo të favorshme për Ibn Rushdin, për shkak të intrigave dhe syrgjynosjes së tij, shumë vepra të tij janë djegur apo zhdukur. Por, numri më i madh i tyre është ruajtur nga përkthimet në gjuhën hebraishte, kurse disa vepra po këta autorë i kanë përshkruar në gjuhën arabe me alfabet hebraik. Kemi edhe përkthimet latine, sidomos ato nga Michael Scot (1228) në kohën e Friedrich II Hohenstaufenit.[23]

4. VENDI I IBN RUSHDIT NË FILOZOFINË ISLAME DHE ATË BOTËRORE

Përkundër disa zërave kundërshtues, respektivisht kontestues rreth figurës dhe kontributit të tij, Ibn Rushdi paraqet kulmin e filozofisë islame. Pas tij filozofia nuk do të jetë filozofi, por vetëm një kopje e zbehtë e filozofisë. Ky pohim, sipas mendimit të filozofëve, konsiston në rezultatin përfundimtar të plejadës së filozofëve të frymëzuar helenistë kurse në këtë me rëndësi të madhe ka qenë përcaktimi i Ibn Rushdit për Aristotelin si autoritet i vetëm filozofik, *par excellence*, sepse ka menduar se të tjerët duke e studiuar Aristotelin, ideve të tij i kanë mveshur edhe gjëra që nuk përkojnë me Aristotelin. Kjo e shtyri Ibn Rushdin që të shkruajë shumë vepra- komente për veprat e Aristotelit. Origjinaliteti i tij në filozofinë islame, po ashtu, konsiston edhe në qëndrimin e tij kritik ndaj Ibn Sinait, sidomos në shkëputjen e vetëdijshme nga sinteza neoplatoniste e El-Farabiut, e ngritur në sistemin madhështor të Ibn Sinait etj.[24]

Po ashtu, nëse filozofinë mesjetare do ta perceptojmë si mendim filozofik i lidhur me religjionin, të bazuar në parimet e shpalljes dhe monoteizmit, atëherë Ibn Rushdi paraqet apogjenë e filozofisë mesjetare islame dhe manifestimin më të plotë të kësaj filozofie.

Mirëpo, mozaiku do të ishte i mangët sikur emri i Ibn Rushdit të mos kishte ndikim edhe në Perëndim. Madje, ky ndikim është më i shprehur në Perëndim sesa në botën islame. Kësaj klime ndoshta i

[23] Për veprat e Ibn Rushdit shih: Numan Aruç, po aty, fq. 28-55. H. Corbin, po aty, fq. 256.

[24] Shih: Daniel Bučan në: Averroës, Nesuvislost nesuvislosti, po aty, fq. XVI-XVII.

ndihmoi edhe fryma antifilozofi në kohën kur jetoi ai por edhe rrënimi i perandorisë islame në Spanjë që pasoi menjëherë pas vdekjes së Ibn Rushdit. Sipas mendimit të Daniell Buçan, *“Evropa vetëm duke iu falënderuar kontaktit me filozofinë islame dhe shkencën, dhe në rend të parë duke iu falënderuar ndërmjetësimit të Aristotelit, në ç’gjë Ibn Rushdi kishte rolin kryesor, do të përjetojë atë zgjerim dhe formësim të horizonteve të saj, e cila do t’i mundësojë zhvillimin që e ka sendërtuar.”*[25] Ky ndikim vërehet edhe në atë që në Evropë kemi një shkollë të tërë që quhet *“averroizmi latin”*, shkollë e cila gjithnjë nuk është kuptuar drejt.

Vlerën dhe ndikimin e Ibn Rushdit në Evropë e konfirmon edhe Roger Bacon në veprën e tij *“Opus Maius”*, sepse ndër të tjera ky dhe Ibn Sinai kanë meritën kryesore që shkencën e Aristotelit *“sërish e nxorën të plotë në dritë.”*[26] Madje, orientalisti Salomon Munk pohon se *“nuk ka dyshim se Ibn Rushdi ka qenë prej njerëzve më të ditur të botës myslimane dhe prej komentuesve më të thellë të veprave të Aristotelit...”.*[27]

5. MENDIMI FILOZOFIK

Temat filozofike që ndërlidhen për Ibn Rushdin janë të shumta. Në pamundësi t’i shqyrtojmë të gjitha këto tema do ta trajtojmë në mënyrë të thukët problemin e raporteve filozofi-religjion.

5. 1. Raporti ndërmjet filozofisë dhe religjionit

Pikëpamja e Ibn Rushdit për raportin e filozofisë dhe religjionit, respektivisht për raportin ndërmjet arsyes dhe besimit, është e hetueshme në të gjitha veprat e tij origjinale, sepse edhe të gjitha temat e tjera kontekstuale individuale vendosen në këtë kontekst të përgjithshëm.[28]

[25] Sipas: Daniel Bučan në: Averroës, po aty, fq. XIX.

[26] Sipas: Čedomil Veljačić, Razmedja azijskih filozofija, pjesa 2, Zagreb, 1978, fq. 318.

[27] Salomon Munk, Mélanges de philosophie jive et Arabe, sipas: Hana El-Fahuri & Halil El-Xherr, po aty, 388.

[28] Hana El-Fahuri & Halil El-Xherr, po aty, fq. 304 e tutje.

Për shkak të paragjykimeve dhe keqkuptimeve rreth Ibn Rushdit në Andaluzinë e Ibn Rushdit por edhe në Perëndim, qe formuar një botëkuptim për Ibn Rushdin heretik, jobesimtar. Mirëpo, studimet e reja, më të thella, të bazuara në veprat e tij origjinale, rrënuan mitin për Ibn Rushdin jobesimtar. Përkundrazi, Ibn Rushdi ka qenë njeri besimtar, madje një ndër juristët (kadinjtë) e famshëm myslimanë, kurse angazhimi i tij ka ecur drejt marrëdhënieve filozofi-religjion. Ibn Rushdi është racionalist, por jo në kuptimin evropian, që mohon Shpalljen hyjnore dhe tërë atë që quhet e mbinatyrshme. Këtë konstatim lidhur me Ibn Rushdin e mohon edhe filozofi mysliman A. Bedevi, duke përfunduar se *"çdo përfundim për racionalizmin është jolegjitim."*[29] Vetë Ibn Rushdi në veprën e tij *Fasl'ul-mekal* lidhur me raportin filozofi-religjion thotë: *"Të përsiaturit e bazuar në dëshmi nuk shpie në kundërthënie (të shkencave) që i sjell ligji i Zotit. Sepse, e vërteta nuk mund të jetë e kundërt me të vërtetën: ajo me këtë pajtohet dhe dëshmon asaj në dobi."*[30] Ibn Rushdi së pari tregon se Ligji i Zotit thërret në studimin racional dhe të thelluar të botës dhe në njohjen racionale të shpalljes (që shihet qartë nga Kur'ani[31]). Pastaj Ibn Rushdi rekomandon studimet logjike si mjet për arritjen e njohjes. Meqë sipas tij, ekzistojnë tri lloje shpirtrash, ekzistojnë edhe tri mënyra që njerëzit të arrijnë të vërtetën: 1) Me anë të dëshmimit demonstrativ silogjist, 2) Nëpërmjet bindjes, d.m.th. nëpërmjet argumentimit retorik dhe 3) Argumentimit dialektik. Kjo i përgjigjet tre llojeve të njerëzve: filozofit argumentimi logjik, njeriut nga masa e popullit metoda retorike dhe teologut metoda dialektike. Ligji fetar arrin konsensusin e përgjithshëm duke i thirrur të gjithë njerëzit në njohje, secili nëpërmjet rrugës së vet. Ibn Rushdi thotë: *"Nëse vjen deri te mospajtimi (ndërmjet perceptimit logjik, filozofik dhe atij të fjalëpërfjalshëm), atëherë kjo kërkon komentim. Komentimi nënkupton të përcillet kuptimi i ndonjë shprehjeje nga kuptimi i fjalëpërfjalshëm në kuptim figurativ..."*.[32]

[29] Gjerësisht: Daniel Bučan në: Averroës, Nesuvislost nesuvislosti, po aty, fq. XXIV.
[30] Sipas: Daniel Bučan, Averroës, po aty, fq. XXV.
[31] Shih: Kur'āni III, 190-191; VII, 185.
[32] Sipas: Daniell Buçan, po aty, fq. XXV.

Në këtë frymë do të duhej kuptuar edhe disa probleme kyçe në filozofinë e Ibn Rushdit: Amshueshmëria e botës, Njohja e universaleve nga Zoti dhe Ringjallja vetëm shpirtërore.

5.2. Rruga drejt Zotit

Ibn Rushdi nuk ndjek rrugën e paraprijësve të tij filozofë, por ndjek rrugën vetjake në dëshmimin e ekzistimit të Zotit, rrugë kjo me premisa peripatetike, në masën që nuk e dëmton besimin Islam. Edhe Ibn Rushdi mendon se Zoti është Lëvizësi i Palëvizshëm, Përfundimtar, pas të cilit nuk ka lëvizës tjetër dhe se ekskluzivisht vetëm Zoti është Krijuesi. Rruga e tij filozofike konsideron se bota dhe ekzistentët janë shqisorë, ndijorë, substanca ndijore, kurse rruga e tij fetare konsideron se bota është e krijuar, të përshtatura njeriut. Këto dy dëshmi Ibn Rushdi i ka emërtuar si *dëshmi e krijimit* dhe *dëshmi e providencës*. Sipas tij, Zoti është Ekzistuesi në kuptim se ekziston jashtë shpirtit tonë dhe se posedon realitetin e vet. Të konceptuarit tonë të Tij në mendje përputhet me këtë realitet.[33]

5.3. Rruga drejt shkencës

Njeriu gjendet në shoqërinë e cila koekziston ndërmjet shkencës, religjionit dhe filozofisë. Ai duhet ta gjejë mënyrën e harmonisë ndërmjet këtyre tre aspekteve të ndryshme, që njeriu të mos dezintegrohet. *Shkenca* është e domosdoshme për mirëqenien e të gjithë njerëzve në shoqërinë e qytetëruar. *Religjioni* është edhe më i rëndësishëm për njeriun. Këtë e pohon edhe ekzistencialisti H. Bergson, i cili thotë: "Ne gjejmë në të kaluarën, e mund të gjejmë edhe sot shoqëri njerëzore pa shkencë dhe pa filozofi, por jo edhe pa religjion."[34] *Filozofia* është kërkim i Të Vërtetës. Këta tre faktorë te filozofët kanë gjetur vendin meritor. Ata e preferonin shkencën, por nuk e devalvonin religjionin. Ibn Rushdi i ka integruar këto tri fusha të ndryshme dhe me

[33] El-Ehwani, po aty, fq. 113-114.
[34] Bergson, The Two Sources of Morality and religion, New York, 1954, fq. 102, sipas: M. M. Sharif, po aty, fq. 515.

komentimin racional të Kur’anit e ka ndihmuar pajtimin e religjionit dhe filozofisë.[35]

6. TRE PROBLEMET KYÇE

6. 1. Amshueshmëria e universit

Amshueshmëria e universit (jokrijimi i botës) është një ndër temat për të cilat Farabiu, Ibn Sinai dhe Ibn Rushdi nga kundërshtarët e tyre janë klasifikuar për jobesimtarë. El-Gazaliu, më rigorozi ndër ta, i kritikoi rreptë filozofët e parë të cilët, sipas tij, ishin të ndikuar nga filozofia heleniste dhe për bindjet e tyre jashtëtradicionale i shpalli për jobesimtarë. Nga ana tjetër, Ibn Rushdi nuk mendon se bota është krijuar në mënyrë të përnjëhershme *ex nihilo*, por krijimi është i vazhdueshëm, me ç’gjë bota mbahet dhe ndryshohet.[36] Respektivisht, fuqia krijuese e Zotit vazhdimisht ndikon në botë, e mban dhe e lëviz atë. Bota është e amshueshme, por si pasojë e shkakut krijues dhe lëvizës; në anën tjetër, Zoti është i amshueshëm dhe pa shkaqe.[37]

Shkencëtarët kompetentë për idenë e Ibn Rushdit pohojnë se mosperceptimi i drejtë i mendimit të tij lidhur me amshueshmërinë e botës çoi në të kuptuarit e gabueshëm. Sipas tyre, gabimi konsiston në atë që përsiatjet e Ibn Rushdit lidhur me krijimin e Zotit janë përpjekja e tij ta ruajë të panjollosur rëndësinë e gjithmbarshme transhedente si të vetë Zotit ashtu edhe të veprimit të Tij krijues. Ibn Rushdi mendon se bota është e amshueshme në kuptim të veprimit të Zotit, i cili është domosdoshmërish i amshueshëm, pa fillim dhe pa mbarim. Por, kjo nuk do të thotë që bota përbëhet prej gjerave të amshueshme, por vetëm ajo e cila gjithnjë krijohet. Sipas Ibn Rushdit, Qenia e cila nuk është në kohë, d.m.th. Zoti, posedon edhe krijimin i cili nuk është në kohë dhe se, në pajtim me këtë, krijimi i Zotit është krejtësisht i natyrës transhedente dhe assesi i krahasueshëm me krijimin në botën empirike. Sipas tij, Zoti nuk krijon diç të ngjashëm me veten siç bën babai kur e krijon të birin. Siç vërehet qartë, dallimi është i theksuar mes Ibn Rushdit dhe shkollës plotiniane të emanacionit dhe atyre që janë ndikuar nga kjo shkollë.[38]

6. 2. Njohja e universalive (jo edhe e partikularive)

Ibn Rushdi është më shumë elastik krahasuar me disa filozofë të tjerë lidhur me njohjen e Zotit vetëm të universalive (kul-lijjateve, të përgjithshmeve) por jo edhe të partikularive (xhuz’ijjateve, hollësive). Ai e pranon se Zoti në qenien e Tij vetjake i njeh të gjitha gjerat e botës. Megjithatë, njohja e Tij nuk mund të quhet as e përgjithshme as e veçantë dhe, së këndejmi, nuk është identike me njohjen njerëzore, për më tepër, është e llojit më të lartë, për të cilën ne nuk kemi njohuri. Dija e Zotit nuk mund të jetë e njëjtë sikur dija e njeriut, sepse atëherë Zoti do të kishte “rival” në dijen e Tij, dhe së këndejmi Ai nuk do të ishte më Zoti i Vetëm. Përveç kësaj, dija e Zotit nuk buron, sikur dija e njeriut, nga gjërat dhe as që është shkaktuar nga ajo; ajo është, e kundërta, vetëm themel i të gjitha gjerave.[39] Dija e Zotit i takon joempirikes, kurse ajo njerëzore empirikes, që janë ndryshime radikale.[40]

Duke iu përgjigjur lidhur me këtë çështje Imam El-Gazaliut, Ibn Rushdi thotë: “*...shohim se Ebu Hamidi veç ka gabuar në qëndrimin e tij ndaj peripatetikëve për shkak të supozimeve të tyre se Ai nuk i di në realitet parcialet. Ata* (peripatetikët - NI) *mendojnë se i di, me dituri që nuk i ngjan asaj sonës, sepse njohja formohet me objektin e njohur, krijohet me krijimin e tij dhe ndryshon me ndryshueshmërinë e tij.*”[41]

[35] Myslimanët në masë nuk ndoqën Ibn Rushdin, shkencën, por ndoqën El-Gazaliun, rrugën sufiste, dhe dalëngadalë shpërfillën studimin e shkencës dhe kjo frymë çoi në zbehjen dhe stagnimin e shkencës te myslimanët. Lindja islame e ndoqi intuitën (El-Gazaliun) dhe ngeci kurse Perëndimi ndoqi shkencën (Ibn Rushdin) dhe avancoi. Shih: M. M. Sharif, po aty, fq. 551-552.

[36] Ibn Rushd, Pajtimi ndërmjet sheriatit dhe filozofisë, në: Edukata Islame, nr. 81/2006, Prishtinë, fq. 53 e tutje. (Më tej: Ibn Rushd, Fasl’ul-mekal shqip).

[37] Nerkez Smailagic, Leksikon Islama, Sarajevë, 1990, fq. 258.

[38] Averroës, Nesuvislost, po aty, fq. XXVII.

[39] Averroës, Nesuvislost, po aty, fq. XXIX dhe 269. N. Smailagic, Leksikon, po aty, fq. 259.

[40] Averroës, Nesuvislost, po aty, fq. XXIX.

[41] Ibnu Rushdi, Traktati mbi konfirmimin e relacionit mes filozofisë dhe sheriatit, Tetovë, 1993, fq. 25. (Më tej: Ibnu Rushdi, Traktati).

6. 3. Ringjallja shpirtërore

Filozofët besojnë në ringjallje, por nuk pajtohen në mënyrën e ndodhjes së saj, kurse tekstet për ringjalljen fizike, kënaqësinë dhe vuajtjen në xhenet dhe xhehenem e shikojnë si prezantime figurative të të vërtetave shpirtërore, me synim të përvetësimit apo largimit të masave.[42] Në këtë mënyrë është qortuar edhe Ibn Rushdi, se nuk e beson ringjalljen fizike në Botën Tjetër. Trupi në Botën Matanë nuk do të jetë ky i kësaj bote, sepse ky ka qenë dhe ka përfunduar; ai do jetë ndryshe dhe më i lartë se ky i kësaj bote. Po ashtu, Ibn Rushdi nuk ka dëshirë të thurë përfytyrime dhe mite për Botën Tjetër.[43]

Ibn Rushdi e mohon se filozofët e përfolur e mohojnë ringjalljen duke e elaboruar gjerësisht këtë çështje. Madje, ai thotë se kjo doktrinë është me rëndësi parësore. Mirëpo, paraqitjen e Botës Përtej me anë të mjeteve materiale, sikur ajeti: ***“Atyre që frikësohen (nga Allllahu) u është premtuar aso parajse me fryte dhe hije të përhershme, ku do të rrjedhin edhe lumenj. Ai është shpërblim i atyre që frikësohen, ndërsa përfundim i mosbesimtarëve është zjarri.”*** (Er-Rra’d, 35),
dhe hadithi: *“Në të është ajo që asnjë sy nuk e ka parë, as ndonjë veshë e ka dëgjuar, as ndonjë mendje e ka imagjinuar”*

nuk e sheh identike me gjërat e kësaj bote. Sepse, ajo botë është gjendje tjetër, më e lartësuar. Përshkrimet e asaj bote janë vetëm emërtime të ngjashme me ato që i përkasin kësaj bote, kurse përmbajtjet për të cilat kanë të bëjnë ato emërtime janë të pakrahasueshme me përmbajtjet e kësaj bote. Kjo në kuptim të thënies së Ibn Abbasit: *“Në atë botë nga kjo botë do të jenë vetëm emërtimet”.*[44]

[42] John L. Esposito, Oksfordska historija islama, Zivinice, 2005/ 1428, fq. 266 etj.
[43] N. Smailagic, Leksikon, po aty, fq. 259.
Shih qëndrimin e Ibn Sinait për këtë temë: Nexhat Ibrahimi, Vepra, vëllimi 8, Logos-A, Shkup, 2009, fq. 438-447.
[44] Parafrazimi i hadithit dhe domethënia e ajetit sipas Ibn Abbasit jepet sipas: Averroës, Nesuvislost, po aty, fq. 469. Shih edhe: Ibn Rushd, Pajtimi, po aty, fq. 79 e tutje.

7. KONCEPTI POLITIK I FILOZOFISË

Edhe pse Ibn Rushdi nuk është angazhuar drejtpërdrejt në politikë, ai megjithatë ka qenë i përfshirë në cilësi të këshilltarit politikë apo të mjekut të pallatit të halifit. Ky angazhim zë vend të rëndësishëm në traditën islame filozofike. Ibn Rushdi është ndër njerëzit që çështjes së sunduesit (halifit) i ka vendosur themele, edhe pse si elemente i hasim qysh në kohën e paraqitjes së shi’izmit, harixhizmit etj.

Edhe pse Ibn Rushdi në njëfarë mase i përkiste konstruksionit ideor në formimin e një gjendjeje të re, megjithatë fryma e tij kritike e afron me Ibn Haldunin, që do të vijë më vonë. Ibn Rushdi e konsideron se Ligji është themel dhe bazë e shtetit, ndërkaq motivin e hulumtimit e nxjerr nga kërkesat që burojnë nga Ligji fetar. Ibn Rushdi konsideron se domosdoshmëria e shoqërorizimit konsiston në faktin se njeriu përsosmërinë e tij morale dhe kognitive e realizon në shtetin e përsosur. Kjo do të thotë se Ibn Rushdi shkaqet e shoqërorizimit i kërkon në faktet jashtëshoqërore, nga ana tjetër, realizimin e shoqërorizimit e sheh vetëm në shtet.

Koncepti i Ibn Rushdit është i frymës së filozofëve, ndërmjet doktrinave teologjik-juridike dhe historike-realiste. Ibn Rushdi synon, thënë kushtimisht, monarkinë si nomokraci[45], kurse shtet ideal e konsideron atë islam vetëm gjatë katër halifëve të parë.[46] Ibn Rushdi edhe pse realist, edhe pse me frymë kritike, megjithatë, pak i ka vërejtur faktorët shoqërorë si *asabijetin*[47], *rijasetin* etj.

[45] *Monarkia* d.m.th. formë e sundimit në të cilën në krye të shtetit gjithnjë qëndron një person (monarku), kurse *Nomokracia* d.m.th. sundimi i ligjit, rendi shtetëror në të cilin sundojnë ligjet. Sipas: Milan Vujaklija, Leksikon stranih reci i izraza, Beograd, 1980, fq. 579 (monarhija) dhe 613 (nomokracija).
[46] Hasan Susic, Dva konceta politike filozofije (Ibn Rusd i Ibn Haldun), në: Simpozij o arapsko-islamskoj kulturi, 18-19, 05, 1973, Prilozi za orijentalnu filozogiju, Sarajevë, 1974, fq. 134 e tutje.
[47] *Asabijeti* - Solidariteti fisnor, klanor, grupor. Dukuri themelore dhe qenësore që i karakterizon lidhjet dhe raportet ndërmjet fiseve. Formë e lidhjes shoqërore me solidaritet dhe joshje të bashkësisë. Sipas: Nexhat Ibrahimi, Vepra 9, Logos-a, Shkup, fq. 38.

8. NDIKIMI I IBN RUSHDIT NË MENDIMIN ISLAM DHE ATË BOTËROR

Ibn Rushdi bashkë me Ibn Sinain mund të konsiderohen kulmi i filozofisë islame, e sidomos brenda drejtimit të ashtuquajtur *filozofë të frymëzuar helenistë*.[48] Ka shkruar shumë dhe pothuaj në të gjitha fushat, prandaj edhe ndikimi i tij shtrihet në shumë fusha. Megjithatë, ndikimi i tij më i theksuar është në mjekësi dhe filozofi. Meqenëse ndikimi në mjekësi me këtë rast nuk është trajtuar, do të themi se ndikimi i tij në filozofinë islame është i madh, por në filozofinë evropiane edhe më i theksuar. Duke e përzgjedhur si autoritet studimi Aristotelin, të cilin e shpjegon nga shumë aspekte, ai u përpoq ta rikonstruktojë mendimin e tij në mënyrë sistematike dhe kritike. Ky angazhim i tij intelektual rezultoi me një varg komentesh të veprave të Aristotelit, që në Perëndim ia siguroi nofkën *Komentues i veprave të Aristotelit*.[49] Madje edhe Dante e përmend si ‘komentues’ në veprën e tij *Komedia Hyjnore*.[50]

Ndikimi i Ibn Rushdit, lirisht mund të thuhet se, ishte më i fuqishëm në Perëndim se në Lindje. Sepse, Evropa, vetëm në kontakt me filozofinë dhe dijen islame dhe vetëm me ndërmjetësimin e Aristotelit nga myslimanët, do të fillojë ngritjen dhe zhvillimin e saj.[51]

---

[48] Madje Henry Corbin një kapitull të veprës së tij e quan “Filozofët e frymëzimit helenist”. Shih: Henry Corbin, po aty, fq. 167-200.
[49] Usp. Bučan, D. Al-Gazali i Ibn Rušd, 64-66.
[50] Citati ku theksohet Ibn Rushdi është:
Euclide geometra e Tolomeo,
Ipocrate, Avicenna e Galieno,
Averrois, che’l gran komento feo.
(Ptolomeun, Euklidin gjeometër,
Hipokratin, Galenin, Avicenën,
Averroesin, komentuesin e madh).
(Dante, Inferno, IV, 142-144, sipas: M. M. Sharif, po aty, fq. 540. Krhs.: Sa’d Abdulaziz, Felasifet’ul-islami, Kajro, 1977, fq. 46.
[51] Ahmed F. El-Ehwani, po aty, fq. 96.

Bibliografia:

1. Abdulaziz, Sa’d, Felasifet’ul-islami, Kajro, 1977.
2. Aruç, Numan Jusuf, Ibën Rushdi dhe filozofia e tij e arsimit, Logos-A, Shkup, 2006.
3. Averroës, Nesuvislost nesuvislosti, Naprijed, Zagreb, 1988.
4. Corben, Henry, Historia e filozofisë islame, Logos-a, Shkup, I-II, 1997.
5. El-Ehwani, Ahmed Fuad, Filozofia islame, Zëri Islam, Prizren, 2002.
6. El-Fahuri, Hana & Halil El-Xherr, Tarih’ul-felsefet’il-arabijjeti, pjesa 2, botimi 3, Bejrut, 1993.
7. Esposito, John L., Oksfordska historija islama, Zivinice, 2005/ 1428.
8. Glasse, Cyril, Enciklopedija Islama, Libris, Sarajevë, 2006.
9. http://www.muslimphilosophy.com/books/renan.pdf.
10. Ibn Rushd, Pajtimi ndërmjet sheriatit dhe filozofisë, në: Revista Edukata Islame, nr. 81/2006, Prishtinë.
11. Ibnu Rushdi, Traktati mbi konfirmimin e relacionin mes filozofisë dhe sheriatit, Rumi, Tetovë, 1993.
12. Ibrahimi, Nexhat, Vepra, vëllimi 8, Logos-A, SHkup, 2009.
13. Nasr, S. H. and O. Leaman, History of Islamic Philosophy, Part I, Tehran, (-).
14. Sharif, M. M., Historija islamske filozofije, I, August Cesarec, Zagreb, 1988.
15. Simpozij o arapsko-islamskoj kulturi, Prilozi za orijentalnu filozofiju, 18-19.05.1973, Sarajevë, 1974.
16. Smailagić, Nerkez, Leksikon islama, Sarajevë, 1990.
17. Veljačić, Čedomil, Razmedja azijskih filozofija, pjesa 2, Zagreb, 1978.
18. Vujaklija, Milan, Leksikon stranih reči i izraza, botimi 3, Beograd, 1980.

Nexhat Ibrahimi

IBN RUSHD (AVERROESI), THE MUSLIM GENIUS FROM ANDALUSIA

(Summary)

1. Introduction

The VII century of Hijra was characterized by political, economic and social instability in the Iberic Peninsula and north Africa. The Al-Murabitun was the most famous dynasty of the time (in 541 they lost power to the Al-Muwahhidun). This was the period during which Cordoba experienced its years of greatest splendor. Cordoba stood along other well-known cities such as Athens, Alexandria, Rome and Baghdad. The two most distinguished families of the time were Ben Hamdin and Ben Rushd, the former mainly dealt with politics, whereas the latter mainly dealt with jurisprudence and science.

نجاد ابراهيم

ابن رشد العبقرى المسلم من الاندلس

(خلاصة البحث)

يتميز القرن السابع الميلادى بظروف سياسية و اقتصادية و اجتماعية غير مستقرة فى شبه الجزيرة بيرني و افريقيا الشمالية . مع ان تغيير الامارات كان يتكرر كثيرا امارة المرابطين أضاعت الحكم من قبل الموحدين سنة 541 هـ . على الرغم من كل هذا فان قرطبة كانت اكثر شهرة فى تلك الفترة فشهرتها كانت على مستوى مدينة اثينا و الاسكندرية و روما و بغداد . فى تلك الفترة الزمنية و فى تلك المدينة اشتهرت قبيلتان : بنو حامدين و بنو رشد و كانت الاولى تنشغل بالسياسة و الثانية بالحقوق و العلوم بعبدا عن السياسة .

Mr. Ejup Haziri

LEGJISLACIONI ISLAM

Besimi Islam dhe legjislacioni

E keqja është përhapur në masë të madhe, zemrat janë dalë nga destinacioni i tyre, epshi është fuqizuar aq shumë saqë është bërë imponues për ta, e njerëzit kanë devijuar nga feja e Allahut të Madhëruar nga besimi dhe legjislacioni, adhurimi e morali, politika e organizimi. Legjislacioni i Zotit u mungoi njerëzve, e nuk mbeti nga legjislacioni diç tjetër pos disa namaze që kryhen, përkujtime që lexohen, Kur'an që këndohet në disa raste gëzimi e mërzie. E, legjislacioni nuk erdhi për këtë, të cilin i Lartmadhërishmi e bëri program jete, mënyrë lumturie dhe rrugë për shpëtim.[1]

E nga kjo mungesë e legjislacionit, në jetën e shumë njerëzve, si të atyre që i përkasin Islamit, apo të tjerëve, u krijua një bindje e re sa i përket Islamit, se ai është vetëm një rit me disa adhurime të veçanta, e i cili nuk ka ndërlidhje me çështjet e jetës dhe ligjeve, ashtu siç nuk ka lidhje me organizimin, teknologjinë, të arriturat...etj, por ka lidhje vetëm me xhamitë, që kur është koha e namazeve i kryejnë, e kur është

[1] El-Bega, Mustafa Dib, *Usul-ut-Teshri' el-Islamij 2, etherul ediletu-l Muhtelef fiha fi-l Fikhil Islamij*, pa vit botimi, Damask: Dar el-Kalem, fq. 3.

koha e ligjëratave i dëgjojnë, e në raste të caktuara dëgjojnë pjesë të caktuara nga libri i shenjtë. Ky është kuptimi më i ngushtë që ata krijojnë për Islamin, fatkeqësisht shumë prej myslimanëve kanë këtë bindje, se çdo gjë që ndërlidhet me xhamitë është Islam, e çdo gjë jashtë tyre nuk i përket atij.[2]

Por e vërteta qëndron krejtësisht ndryshe, ngase Islami është edhe ajo që ndërlidhet me adhurime, por edhe ana tjetër që ndërlidhet ngushtë me shtetin dhe ligjin, ndaj edhe ndarja e tij bëhet në dy grupe (lloje):

Besim (akideh): Vërtetim nga zemra e besimtarit që domosdoshmërish duhet të besojë në to.

Ligj (legjislacion-sheriah): Dispozita vepruese që domosdoshmërish duhet t'i praktikojë besimtari në jetën e tij.

Vendi i besimit është zemra[3], kurse i legjislacionit trupi apo gjymtyrët e trupit[4].

Besimi është çështja esenciale dhe primare për të cilën kërkoi Krijuesi, siç është besimi në ekzistencën e Krijuesit, se s'ka krijues përpos Tij, Ai cakton e zgjedh, është i vetmi që meriton të adhurohet, Ai ka krijuar gjitha krijesat, asgjë nuk është i ngjashëm me Të.[5] Për këtë Krijuesi tha: ***"Thuaj: Ai, Allahu është Një! Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet*** *(i mbështetet)* ***për çdo nevojë. As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë.[6]" "Thuaj: "A pos Allahut, krijues i qiejve dhe i tokës, që ushqen të tjerët, ndërsa vetë nuk ushqehet, të pranojë Zot tjetër?" Thuaj: "Unë jam i urdhëruar të jem i pari që bindem dhe*** *(urdhërohem)* ***: të mos bëhem kurrsesi nga idhujtarët."[7] "Ai nuk ka shok*** *(nuk adhuroj tjetër).* ***Me këtë*** *(thjeshtësi të*

[2] Këto janë mendimet nga mendjet e ngurta që nuk pasqyrojnë realitetin, nuk e arsyetojnë atë, e gjykimi i tyre është në suaza tepër të ngushta, por përveç tyre ekziston edhe një grup njerëzish që qëllimshëm dëshirojnë ta paraqesin Islamin vetëm brenda kufijve të xhamisë apo adhurimeve të caktuara, e jo si sistem jete.

[3] Ana e brendshme.

[4] Ana e jashtme.

[5] Sheltut, Mahmud, *El-Islamu Akidetun ve Sheriatun*, bot.i XVIII, boton: Dar esh-Shuruk, Kajro-Egjipt, 1421h-2001m, fq. 17.

[6] Kur'ani, Ihlas: 1-4.

[7] Kur'ani, Enam: 14.

adhurimit vetëm për Zotin) ***jam i urdhëruar dhe jam i pari i myslimanëve*** *(i pari që pranoj dhe bindem)****! Thuaj: " A të kërkojë Zot pos Allahut, e Ai është Zot i çdo sendi*** *(ekzistues)****..."***[8]

Allahu zgjedh kë të dojë nga robërit e Tij, e dërgesën e Tij e përcjell nga robërit e Tij fisnik, engjëjt, dërgon të dërguar për t'i ftuar njerëzit në besim dhe vepra të mira.[9] Besimi gjithashtu është i domosdoshëm edhe në engjëjt, që luajnë rolin e ambasadorëve mes Zotit dhe të dërguarve të Tij dhe në librat e shenjta që njihen si dërgesa të rëndësishme nga Krijuesi te krijesat e Tij.

E këto dërgesa përmbajnë besimin e pakontestueshëm në ditën e Gjykimit, e që njihet ndryshe si besimi në botën e përtejme.[10]

Kurse legjislacioni Islam është rruga e drejtë dhe reale, e cila e ruan njerëzoren nga shtrembërimi dhe devijimi, e shmang atë nga rrëshqitjet e së keqes dhe tundimet e epshit, e ky është burimi i ëmbël që shëron gjokset e njerëzisë, ringjall shpirtrat e tyre dhe freskon mendjet e tyre.[11]

E qëllimi nga legjislacioni hyjnor është rrugëtimi i drejtë që duhet ta bëjë njeriu, në mënyrë që ta fitojë krenarinë e fesë dhe lumturinë e të përtejmes.

Kur themi legjislacioni hyjnor kemi për qëllim atë që erdhi nga Allahu i Madhëruar dhe të cilin e komunikoi dhe transmetoi në përpikëri i Dërguari i Tij, Allahu është Ligjvënës.[12] Dispozitat e legjislacionit të përmendur konsiderohen ligje, të cilat më pas kërkohen të aplikohen në jetën e njerëzve, pa hezitim dhe në mënyrë të tërësishme.

Besimi konsiderohet thelbi i feve qiellore dhe esenca rreth së cilës përqendrohen shtyllat e legjislacionit (deaimu-sh-sheriati), e Allahu nuk pranon legjislacion nga njerëzit përveç nëse është përmirësuar be-

[8] Kur'ani, Enam: 163-164.
[9] Sheltut, Mahmud, *El-Islamu Akidetun ve Sheriatun*, fq. 17-18.
[10] Op. Cit.:fq. 18.
[11] El-Katan, Mena' Halil, *Vuxhub Tahkimu-sh-Sheriati-l Islamijeh*, boton: Dar-ut Tevzi' ven-Neshr el-Islamijeh,pa vit dhe vend botimi fq. 9.
[12] Op. Cit.:fq. 10.

simi i tyre, të kenë besuar në Allahun e Plotfuqishëm, në të padukshmen (alemu-l-gajbi), në botën e përtejme, në llogari, shpërblim e ndëshkim, parajsë e ferr.

E, nëse është fuqizuar ky besim në shpirtin e njeriut, atëherë do të jetë e mundur konstruktimi i shoqërisë duke e llogaritur si të domosdoshme legjislacionin në jetën e tyre, në raport me lidhjet e tyre ndaj Krijuesit, lidhjet e ndërsjella në mes njerëzve dhe gjithësisë me jetën, ndaj edhe besimi ishte gjëja e parë që të Dërguarit e Allahut thirrën në të.[13]

Ky legjislacion gjatë thirrjes së të Dërguarit të Allahut në Mekke, pothuajse trembëdhjetë vjet, u përball me atë shoqëri vetëm në reformimin e besimit (islah el-akideh), thellimin e rrënjës së besimit, ruajtjen e pastërtisë së tij, ndaj Islami bëri dy dëshmitë[14] deklaratë për realizimin e besimit dhe qelës për hyrjen e njeriut në islam.

Dëshmia në të besuarit në një Zot të vetëm (vahdanijeh) nënkupton përsosmërinë dhe plotësimin e besimit dhe dëlirje nga ajo që nuk i takon atij. Kurse dëshmia në dërgesën e të Dërguarit Muhamed nënkupton vërtetësinë në engjëj, të dërguar, libra, ditës së fundit, si dhe nënkupton domosdoshmërinë e pasimit.

Lidhur me këtë në Kur'an thuhet: ***"I dërguari i besoi asaj që iu shpall prej Zotit të tij, e ashtu edhe besimtarët. Secili i besoi Allahut, engjëjve të Tij, shpalljeve të Tij, të dërguarve të Tij. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të dërguarit e Tij, dhe thanë: "Iu përgjigjëm thirrjes dhe respektuam urdhrin. Kërkojmë faljen tënde o Zoti ynë! Vetëm te Ti është ardhmëria jonë".***[15] Gjithashtu thotë: ***"Nuk është tërë e mira*** *(e kufizuar)* ***t'i ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson Allahut, ditës së gjykimit, engjëjve, librit, pejgamberëve dhe pasurinë që e do t'ua japë të afërmve, bonjakëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirimin e robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zeqatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë,***

[13] Op. Cit.:fq. 49.
[14] Është fjala për dëshminë e shehadetit.
[15] Kur'ani, Bekare: 285.

dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të sinqertit dhe të tillët janë ata të devotshmit.”[16]

Besimi për të cilën i dërgoi Allahu të dërguarit e Tij kishte për qëllim të besohej vetëm një Zot, pra ai besim veçohej në monoteizëm. Në Kur’an thuhet: ***“Ne nuk dërguam asnjë të dërguar para teje e të mos i kemi shpallur atij se: Nuk ka zot tjetër përveç Meje, pra më adhuroni!”***[17]

E kjo nënkupton që njeriu të mos dalë nga nënshtrimi e përulja ndaj Allahut, si dhe të mos i nënshtrohet (përulet) dikujt tjetër që i hyn në të drejtë Allahut, e që ndryshe njihet si nënshtrimi ndaj despotëve e idhujve (tagutëve), qoftë ky nënshtrim me epshe dhe dëshira, apo ndonjë pushteti ligjvënës e despotik. E çdo tiran që ua merr të drejtat robërve të Zotit, njerëzit e quajnë despot.[18] Sundimi me atë që nuk e ka zbrit Allahu është despoti, e ai që gjykon me atë që nuk e ka zbrit Allahu është despot, e nënshtrimi dhe përulja ndaj sunduesit apo gjykimit është adhurim ndaj despotëve. I Madhërishmi në lidhje me këtë ka potencuar: ***“A i vure re ata që mendojnë se besuan atë që të zbriti ty, dhe atë që zbriti para teje, se si dëshirojnë që mes tyre të gjykojë djalli, e duke qenë se janë të urdhëruar që të mos e besojnë atë. E djalli dëshiron t’i humbë në pafundësi.”***[19]

Islami nuk është vetëm besim sentimental i izoluar nga jeta njerëzore, por besimi është baza dhe esenca e fesë, prej saj rrjedh legjislacioni i cili organizon gjitha çështjet e jetës që i shërbejnë njeriut në jetën e tij. Shembulli i besimit i ngjan shembullit të pemës, ndërsa legjislacioni është degë e tij, kur përmirësohet besimi dhe ngulitet thellë në zemër thellohet trungu i pemës, lëshon degët dhe jep frytet e saj në jetën njerëzore për ata që e pasojnë plan-programin e Zotit, qëndrojnë pranë kufijve të Tij, ndjekin ligjin e Tij dhe veprimet e Islamit.[20]

16 Kur’ani, Bekare: 177.
17 Kur’ani, Enbija: 25.
18 El-Katan, Mena’ Halil, *Vuxhub Tahkimu-sh-Sheriati-l Islamijeh*, fq. 55.
19 Kur’ani, Nisa: 60.
20 El-Katan, Mena’ Halil, *Vuxhub Tahkimu-sh-Sheriati-l Islamijeh*, fq. 51.

Allahu i dërgon të dërguarit e Tij me besim (akideh) tek robërit e Tij që të proklamojnë besimin në të vetmin Zot, distancimin e njerëzve nga politeizmi dhe idhujt, të nënshtrohen dhe t’u binden urdhrave të Zotit dhe ta pasojnë ligjin e tij me punë dhe vepra, e sikur këto të mos jenë atëherë ky besim do të ishte një ftesë që realiteti nuk do ta pranonte, përkundrazi do të ishte në kundërshtim me veprimet dhe organizimin e kolektivit, e thirrja për të do të ishte një gënjeshtër dhe fjalë e kotë. Çfarë vlere do ta kishte besimi në Allahun e vetëm po që se njerëzit e tillë më pas do t’u përkasin-besojnë pushteteve qeverisëse në kundërshtim me Zotin, ku sunduesit e tyre nuk i nënshtrohen ligjit të Zotit.

Secili i dërguar nuk u dërgua me një besim të privuar nga pushteti ligjvënës praktikues, mirëpo dërgohej me besim që bashkon edhe dispozitat vepruese, të lejuarat e të ndaluarat për aq kohë sa do të jetë dërgesa (shpallja) efektive, gjersa e dërgon Allahu një të dërguar pas tij.[21]

Lidhur me këtë, Kur’ani për Isain thotë: ***“Dhe*** *(kam ardhur)* ***që t’ju vërtetoj Tevratin që e keni para duarsh, t’ju lejoj disa që u ishin ndaluar juve, kam ardhur me argument nga Zoti juaj, pra kini frikë Allahun dhe më dëgjoni mua.”***[22] Derisa në Tevrat thuhet: ***“Ne u caktuam atyre në të*** *(në Tevrat)* ***kundërmasat ndëshkuese: njeriu*** *(mbytet)* ***për njeriun, syri për syrin, hunda për hundën, veshi për veshin, dhëmbi për dhëmbin, por edhe plagët kanë kundërmasë. E kush e falë atë*** *(hakmarrjen)*, ***ajo është shpagim*** *(nga mëkatet)* ***për të. E kush nuk vendos sipas asaj që zbriti Allahu, ata janë mizorë*** *(të padrejtë).*[23]

Besimi luan rolin e brendshëm, e ligji atë të jashtëm, dhe se këto dy komponentë janë të domosdoshëm për ngritjen e individit dhe shoqërisë. Me fjalë tjera Islami është besim dhe legjislacion, e legjislacioni nënkupton angazhimet (detyrat) praktike që i solli Islami në sferën e adhurimeve dhe raporteve të ndërsjella mes njerëzve. Kurse besimi nuk është vetëm çështje praktike për të kryer një proces, por është

21 Op. Cit.:fq. 53.
22 Kur’ani, Ali Imran: 50
23 Kur’ani, Maide: 45

edhe çështje teorike që kërkohet nga secili mysliman t'i besojë me zemër, ngase Allahu e ka informuar atë nëpërmjet librit të Tij, apo nëpërmjet shpalljes tek i dërguari i Tij.[24]

Pra, ky është besim i vetëm dhe unik, i cili nuk ndërron me ndërrimin e kohës dhe vendit ashtu siç nuk ndryshon me ndryshimet e individëve dhe popujve.[25] Dhe ky besim Islam është besim monoteist i pastër ndaj Zotit të vetëm e të Lartësuar, i cili e komunikon zemrën dhe mendjen, ngacmon ndjenjën dhe zgjon reflekset psikologjike duke e zgjuar mënyrën e të menduarit dhe intelektit.[26]

Besimi islam përveç që është i nevojshëm, ai është edhe i domosdoshëm për njeriun ashtu siç është i domosdoshëm për të uji dhe ajri, ashtu që ai pa këtë besim është i humbur, e humb veten dhe ekzistencën e tij.[27]

Ky besim është i qartë e i pranuar, është besim i natyrshëm, i qëndrueshëm, i patundur, i argumentuar dhe mesatar; as i tepërt e as të qenit i mangët.

Erdhi Islami dhe i ftoi njerëzit në adhurim të vetëm ndaj Allahut si dhe të largohen nga çdo adhurim tjetër ndaj zotërave të pretenduar apo idhujve, qoftë të jetë ai adhurim në njerëz, xhinë, apo të një bote krejtësisht tjetër, qiellore apo tokësore. Shpirti i Islamit është besimi, besimi monoteist, Allahu është i vetëm dhe vetëm Ai meriton të adhurohet. Gjëja më e mirë që e tha i Dërguari Muhamed dhe të Dërguarit para tij qe fjala 'La ilahe Il-lall-llah. Dëshmia se nuk ka Zot tjetër pos Allahut'[28]

Porosia e parë në Kur'an dhe nismëtarja prej së cilës i jepnin besën të Dërguarit të Allahut kushdo që pranonte fenë Islame, qe kjo:

[24] Mehdeli, Muhamed Akil ibn Ali, *Mukaddimetun fi-l Akideti-l Islamijeti ve Ilmi-l Kelam*, bot. I-rë, dar-ul Hadith, Kajro-Egjipt, 1993m, fq. 13.
[25] Abd, Abduletif Muhamed, *Kavaidu-l Islamijeti Inde-l Imami-l Gazalij*, dar-uth-Thekafeti-l Arabijeti, Kajro-Egjipt, 1407h-1987m, fq. 13.
[26] Gazali, Muhamed, *Akidetu-l Muslim*, dar-ul Kutub el-Islamijeh, Kajro-Egjipt, 1400h-1980m, fq. 6.
[27] Eshkar, Umer Sulejman, El-Akidetu fil-Lah, bot. X-të, daru-n-Nefais Lineshri Vet-Tevzi', 1415h-1995m, fq. 15.
[28] Kardavi, Jusuf, *El-Ibadetu Fi-l Islam*, bot. XXIV-të, Mektebetu Vehabijeh, Kajro-Egjipt, 1416h-1995m, fq. 139.

'Besojeni Allahun dhe mos i përshkruani Atij asgjë.' Kjo ishte edhe gjëja e parë që i Dërguari i ftonte mbretërit, princat dhe udhëheqësit e ndryshëm; që të adhurohet vetëm Allahu dhe të mos i shoqërohet Atij asgjë, si dhe t'i braktisin zotat që ata dhe njerëzit i kishin marrë të tillë.

I Dërguari i Allahut i përfundonte dërgesat e tij që iu dërguan Kisrasë, Nexhashiut dhe mbretërve tjerë me këtë ajet nga Kur'ani Famëlartë: ***"O ithtarë të librit*** *(Tevrat e Inxhil)*, ***ejani*** *(të bashkohemi)* ***te një fjalë që është e njëjtë*** *(e drejtë)* ***mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, pos Allahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos e konsiderojmë njëri-tjetrin zotër pos Allahut"! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi myslimanë*** *(besuam një Zot)****"!***[29]

Kur'ani konfirmoi se kjo ftesë ishte ftesë e gjithë të dërguarve, të cilët thirrën popullin e tyre në besimin e vetëm ndaj Allahut[30] dhe distancimin nga adhurimi i putave dhe despotëve, e çdo gjë që adhurohet jashtë Allahut është adhurim i pavlefshëm. Dy adhurime mund të jenë; ai ndaj Allahut apo ndaj idhujve (tiranëve, despotëve), e ai që bën mendjemadhësi[31] ndaj adhurimit të Allahut, bie në adhurim të kotë (ndaj idhujve e tiranëve).[32]

Për këtë Kur'ani proklamoi: ***"Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t'u thonë: "Adhuroni vetëm Allahun, e largojuni djajve*** *(adhurimit të tyre)!"* ***Por, pati nga ata që Allahu e udhëzoi dhe pati nga ata që ishte i gjykuar me humbje, pra udhëtoni nëpër botë dhe shihni se si ishte fundi i gënjeshtarëve?"***[33]

Nuk ka nder më të madh për njeriun e mençur sesa ta adhurojë atë që e ka krijuar, formësuar dhe nderuar, si dhe ta dëbojë adhurimin jashtë Tij. Nuk ka fitim më të madh për lumturinë e njeriut, qetësinë e ndërgjegjes së tij sesa t'i adresojë brengat e tij ndaj të vetmit Zot, t'i

[29] Kur'ani, Ali Imran: 64
[30] Shih më tepër për këtë: Sheltut, Mahmud, *El-Islamu Akidetun ve Sheriatun*, fq. 10.
[31] Mendjemadhësia e kishte larguar djallin nga adhurimi ndaj Allahut në adhurim të kotë.
[32] Shih më tepër: Kardavi, Jusuf, *El-Ibadetu Fi-l Islam*, fq. 140.
[33] Kur'ani, Nahl: 36.

nënshtrohet, përulet dhe ta dojë Atë, e të mos e shpërndajë zemrën e tij për zotëra të pretenduar e idhuj të falsifikuar.[34]

Këtu na bëhet e qartë se besimi dhe legjislacioni janë të ndërlidhura njëra me tjetrën sikurse ndërlidhja e frutave me pemë[35], dhe kishte plotësisht të drejtë kur Muhamed Kutbi potencoi se "Feja e zbritur e Allahut është përherë besim e legjislacion; besim në zemër që thotë se Allahu është një dhe i vetëm dhe i fton njerëzit për ta adhuruar vetëm Atë, dhe legjislacion që rregullon jetën e njerëzve në tokë në raport me nënshtrimin e tyre ndaj Allahut".[36]

Definicioni dhe kuptimi i legjislacionit

Parimisht duhet të bëjmë sqarimin e fjalës sher'un dhe sheriatin që të dyja nënkuptojnë ligj, legjislacion apo legjislativ.

Fjala *sher'un* - شرع në kuptimin etimologjik ka kuptimin e rrugës së drejtë e cila shpie te uji, ajo gjithashtu ka kuptimin e burimit të ujit që i bashkon njerëzit për të pirë dhe për t'iu dhënë ujë kafshëve, e arabët nuk e quajnë atë vend *sher'un* - شرع vetëm nëse është i pandërprerë dhe i drejtë...[37]

Ndërsa në kuptimin terminologjik ka këtë kuptim: Atë që Allahu ua shfaqi robërve të Tij nga feja, e cila është rrugë e drejtë dhe e qëndrueshme, e Allahu është Ai i Cili e bëri legjitime këtë fe.[38] Sipas këtij, kuptimi nënkupton shfaqjen e rrugës, sqarimin e saj dhe pasimin e saj.

[34] Kardavi, Jusuf, *El-Ibadetu Fi-l Islam*, fq. 102.
[35] Mehdeli, Muhamed Akil ibn Ali, *Mukaddimetun fi-l Akideti-l Islamijeti ve Ilmi-l Kelam*, fq. 31.
[36] Kutb, Muhamed, *El-Islamu Kebedilun an-il Efkari ve-l Akaid-il Mustevredeti ve Ebhathun uhra*, bot. I-rë, Mektebetu-s Sunetu, Kajro-Egjipt, 1413h-1993m, fq. 103.
[37] Ibni Mendhur, Ebi-l Fadl Xhemaludin Muhamed ibn Mukrim el-Efrikij el-Misrij, *Lisanul Arab*, bot.III-të, dar -us-Sadir, Bejrut-Liban, 1414h-1994m, vëll.VIII, fq. 176-177; Ibni-l Ethir, Ebu-s Seadat Mubarek ibn Muhamed, *En-Nihajetu fi Garibi-l Hadith*, (recenzurë të Tahir Zavi dhe Mahmud Tanahi) boton: Isa el-Halebij, Kajro-Egjipt, 1963m, vëll.II, fq. 231; El-FejruzAbadi, *El-Kamus el-Muhit*, bot.Vi-të, boton: Muesesetu err-Rrisaletu, Bejrut-Liban, 1419h-1998m, fq. 733; Rrafii, Ahmed ibn Muhamed ibn Alij el-Mukrij el-Fejjumi, *El-Misbahu-l Munir fi Garibi-sh Sherhi-l Kebir*, boton: dar-ul Fikr, fq. 473.
[38] El-Bermuti, Muhamed Amimul Ihsan, *Et-Ta'rifat-ul Fikhijeh*, bot.I-rë, dar-ul Kutub el-Ilmijetu, Bejrut-Liban, 1424h-2003m, fq. 121.

Ndërsa definicioni i fjalës *sheriatun*-شريعة në kuptimin etimologjik jep dy kuptime; e para: Burim i ujit, dhe e dyta: Rrugë e drejtë, e cila nuk ka shtrembërime.[39]

Në këtë dy kuptime vjen edhe në *mu'xhemu-l vesit:* Fjala sheriat në kontekstin gjuhësor nënkupton rrugë të drejtë, ashtu siç ka ardhur edhe në librin e ndershëm: ***"Pastaj, Ne të vumë ty në një rrugë të drejtë të fesë, pra ti ndiqe atë e mos ndiq dëshirat e atyre që nuk dinë."***[40] Sikurse që nënkupton burimin e ujit,[41] rreth të cilit mblidhen njerëzit për kërkim uji, e nuk është quajtur me këtë emër vetëm se nga qartësia dhe dukshmëria e qartë.[42]

Ndërsa në kuptimin terminologjik apo në kuptimin e juristëve (fukahave) ka shumë mendime të ndryshme, por të përafërta ndërmjet vete. Në *Ta'rifat el-Fikhijeh*, thuhet: Urdhëresa e pasimit të adhurimit, apo: Rruga e fesë që duhet ndiçur. Fjala *sher'un* dhe *sheriatun* kanë të njëjtin kuptim. Në *Magrib* thuhet: Sher'atu dhe sheriatu kanë këtë kuptim: Rruga e cila është e qartë në fe.[43]

Thuhet se fjala sheriatin-legjislacion ka kuptimin e asaj që Allahu bëri ligj për robërit e Tij nga rregullat dhe dispozitat.[44] Apo vendosja (përcaktimi) e rregullave nga Allahu për robërit e Tij, duke i obliguar ata me këtë, e Ai është Ligjvënës.[45]

[39] Bedran, Bedran Ebu-l Ajnejn, *Esh-Sheriatu-l Islamijetu, Te'rihuha ve Nadhrijetu-l Milkijetu vel-Ukud*, boton: Muessesetz Shebabu-l Xhemaah, Aleksandri-Egjipt, fq. 27.
[40] Kur'ani, Xhathije: 18.
[41] Komisioni i Akademisë së gjuhës Arabe, *El-Mu'xhemu-l Vesit*, bot.II-të, Mexhma El-Lugah el-Arabijeh, Kajro-Egjipt, 1405h-1985m, fq. 505; Husejni, Abdulfetah, *Te'rihu-t Teshri' el-Islamij*, bot.IV-të, Kajro-Egjipt, 1411h-1990m, fq. 5; Rrazi, Muhamed ibn Ebi Bekr, Muhtaru-s Sihah, dar-ul fikr, Bejrut-Liban, 1401h-1981m, fq. 335.
[42] Rrafii, Ahmed ibn Muhamed ibn Alij el-Mukrij, el-Fejjumi, *el-Misbahu-l Munir fi Garibi-sh Sherhi-l Kebir*, dar-ul fikr, Bejrut-Liban, fq. 310.
[43] El-Bermuti, Muhamed Amimu-l Ihsan, *Et-Ta'rifatu-l Fikhijeh*, bot.I-rë, dar-ul kutub el-ilmijetu, Bejrut-Liban, 1424h-2003m, fq. 121-122.
[44] *El-Munxhid Fi-l Lugati ve-l I'lam*, bot.XXXVII-të, dar-ul Meshrik, Bejrut-Liban, 1998m, fq. 382.
[45] Ibni-l Ethir, *En-Nihajetu fi Garibi-l Hadith*, vël.II, fq. 231.

Në kuptim më të përgjithësuar mund të thuhet: Ajo që përcaktoi dhe vendosi Allahu i Madhëruar për robërit e Tij nga dispozitat me të cilat erdhi një i dërguar nga të dërguarit e Allahut, qoftë të jetë kjo me mënyrën e veprimit praktik apo me mënyrën e besimit (teorik).[46]

Pra, sipas gjitha definicioneve nënkuptohet ajo që Allahu shpalli dhe caktoi nga feja, rregulla e dispozita të caktuara e të ndryshme[47], apo ato që Ai urdhëroi të kryhen e të ndiqen si namazi, agjërimi, zekati dhe veprat tjera[48] ashtu siç i Madhërishmi urdhëroi të ndiqet rruga e drejtë: ***"Pastaj, Ne të vumë ty në një rrugë të drejtë të fesë, pra ti ndiqe atë e mos ndiq dëshirat e atyre që nuk dinë."***[49]

Pra ky legjislacion (sheriat) është i drejtë sikurse rruga pa kthesa dhe pa shtrembërime, dhe se ky legjislacion ngjason me burimin e ujit për shkak se është rrugë për jetën shpirtërore dhe ushqim për mendjet, ashtu siç uji është rrugë për jetën trupore.

Me legjislacion nënkuptohen përcaktimi i rregullave dhe dispozitave, e në këtë kontekst ka ardhur edhe në Kur'an: ***"Ai ju përcaktoi juve për fé atë që ia pat përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me ç'gjë e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain.*** *(I porositëm)* ***Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të. Për idhujtarët është rëndë kjo në çka ju i thirrni ata. Allahu veçon për të*** *(për besim të drejtë)* ***atë që do dhe e udhëzon në të atë që i drejtohet Atij."***[50] Pra, legjislacioni ka të bëjë me një mori rregullash e dispozitash, të cilat i përcaktoi Allahu për njerëzit, nëpërmjet gjuhës së të Dërguarit Muhamed, të cilat dispozita u regjistruan në Kur'an dhe Sunet.[51]

Një definicion më i detajuar sa i përket legjislacionit është edhe ky: Atë që Allahu e bëri ligj për robërit e Tij, nga besimi, adhurimi,

[46] Tehanevij, Muhamed A'la ibn Alij, *Keshaf Istilahatu-l Ulum*, Kalkuta, 1862, fq. 199.
[47] Zejdan, Abdulkerim, *El-Med'hal Lidiraseti-sh Sheriati-l Islamijeh*, Muessesetu-rr Risaletu, Bejrut-Liban, 1401h-1981m, fq. 38.
[48] Kardavi, Jusuf, *Med'hal Lidiraseti-sh Sheriati-l Islamijeh*, Mektebetu Vehabijeh, Kajro-Egjipt, 1990m, fq. 7.
[49] Kur'ani, Xhathije: 18.
[50] Kur'ani, Shura: 13.
[51] Serjeti, Abdulverud Muhamed, *Te'rihu-l Fikhi-l Islamij ve Nadhrijatuhu el-Ametu*, dar-un Nehdatu el-Arabijetu, Bejrut-Liban, 1993m, fq. 9-10.

morali, marrëdhëniet e njerëzve, organizimi i jetës, organizimi i marrëdhënieve mes njerëzve dhe mes tyre e Zotit, në mënyrë që të arrihet lumturia e tyre në këtë botë dhe në të përtejmen. [52]

Ligjvënësi i legjislacionit është Allahu, e jo dikush tjetër, ai përcaktoi dhe urdhëroi për legjislacionin e drejtë, të gjithë, pa përjashtim. Ai thotë: ***"Ata që ju adhuroni përveç Allahut, nuk janë tjetër vetëm se emra që i pagëzuat ju dhe prindërit tuaj. Allahu nuk shpalli ndonjë fakt për ta, vendimi*** *(në çështjen e adhurimit)* ***nuk i takon kujt, pos Allahut, e Ai urdhëroi të mos adhuroni tjetër vetëm Atë. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë."***[53] Ai që përcaktoi këtë legjislacion është Allahu, e ***"...Allahu është më i dijshmi, ligjdhënësi më i drejtë."***[54] ***"...ligjdhënës i matur."***[55]

Ky legjislacion përmban në vete një grumbull dispozitash, të cilat i zbriti shpallja te i Dërguari i Allahut, Muhammedi, prej të cilave dispozita veçojmë tri lloje:

1-Dispozita të bindjes (besimit-i'tikadijeh): Janë ato që ndërlidhen me Allahun, cilësitë e Tij, besimin në Të, ato që ndërlidhen me të dërguarit, besimi në misionin e tyre, në engjëjt, xhinët, çështjet e botës së përtejme, ringjalljes, llogarisë, peshimit, parajsës dhe skëterrës.[56] Këto i takojnë botës së fshehur *(Alemu-l Gajbi)*, të cilat njeriu i kupton në bazë të dëgjimit nga të dërguarit dhe lajmëtarët.

2-Dispozita edukuese (tehdhibijeh): Janë ato që ndërlidhen me mirësitë që kërkohen nga njeriu t'i veprojë ato, si fjala e vërtetë, mbajta e fjalës-marrëveshjes, durimi, garancia, si dhe të këqijat që duhet njeriu të distancohet prej tyre, si rrena, tradhtia, mashtrimi, mosmbajtja e premtimit[57], etj.

[52] El-Katan, Mena Halil, *Et-Teshri' vel Fikhu fi-l Islam*, bot.III-të, mektebetu vehabijeh, Kairo-Egjipt, 1409h-1989m, fq. 13-14.
[53] Kur'ani, Jusuf: 40.
[54] Kur'ani, Nisa: 92.
[55] Kur'ani, Nisa: 104.
[56] Shelebi, Muhamed Mustafa, *El-Med'hal fi-t Ta'rifi bi-l Fikhi-l Islamij*, dar-un Nehdatu el-arabijeh, Bejrut-Liban, 1405h-1985m, fq. 29.
[57] Serjeti, Abdulverud Muhamed, *Te'rihu-l Fikhi-l Islamij ve Nadhrijatuhu el-Ametu*, fq. 10.

3-Dispozita praktikuese (amelijeh): Janë ato që ndërlidhen me veprat e njerëzve dhe organizimi i marrëdhënieve të tyre me Krijuesin e tyre, siç janë namazi, agjërimi, zekati, haxhi, apo organizimi i marrëdhënieve mes njerëzve, siç është shitblerja, dhurata, qiraja, pengu, martesa, shkurorëzimi, etj.[58]

Me fjalë tjera, ky legjislacion ka të bëjë me dispozita të besimit, moralit dhe marrëdhënieve mes njerëzve dhe Krijuesit të Tyre.[59]

Ky legjislacion është legjislacioni i fundit hyjnor, i cili u kompletua atë ditë që u kompletua feja: ***“...Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju islamin fe...”***[60] ***“E kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit.”***[61]

Është legjislacion i ndërlidhur me legjislacionet e mëparshme dhe vjen nga e njëjta vijë, por me ndryshime thelbësore, për faktin se legjislacionet e mëparshme qenë të përshtatshme vetëm për kohën sa qëndronte i dërguari dhe vlente për gjenerata të caktuara, kurse ky i fundit vlen për gjitha kohërat dhe është i përshtatshëm për secilën gjeneratë. Në Kur’an thuhet: ***“...Për secilin prej jush, Ne caktuam ligj e program*** *(të posaçëm në çështje të veprimit)****...”***[62]

Rrjedh nga e njëjta vijë por me dispozita të ndryshme nga ato të mëparshmet, në pajtim dhe konform kohës dhe mentalitetit të popullit. Për të qenë më afër lexuesit, duhet të sjellim një apo dy shembuj që e dëshmojnë legjislacionin me dispozita të ndryshme mes dy kohëve dhe dy gjeneratave të ndryshme. Legjislacioni i Musait dhe popullit të tij si dhe legjislacioni i Muhamedit dhe popullit të tij. E fjala është për pendimin, se si pranohej ai në legjislacionin e Musait dhe në atë të Muhamedit, dhe shembulli i dytë në mes dy legjislacioneve ka të bëjë me përlyerjen e rrobës. Të fillojmë nga e para; pendimi në raste të

[58] Shelebi, Muhamed Mustafa, *El-Med’hal fi-t Ta’rifi bi-l Fikhi-l Islamij…*, fq. 29.
[59] Op. cit.: fq. 27.
[60] Kur’ani, Maide: 3.
[61] Kur’ani, Ali Imran: 85.
[62] Kur’ani, Maide: 48.

caktuara në kohën e Musait ishte jo edhe i lehtë, nganjëherë për t’u pranuar pendimi për ndonjë vepër të shëmtuar, duhej të sakrifikohej ai njeri. Kur’ani bukur mirë e ka shtjelluar këtë fenomen të hershëm:

“Dhe kur Musai popullit të vet i tha: “O populli im, me adhurimin e viçit *(në vend të Zotit),* ***ju i bëtë zullum vetvetes, pra pendohuni para Krijuesit tuaj, dhe mbyteni vetveten. Kjo për ju është më së miri te Krijuesi juaj. E Ai ua pranoi pendimin tuaj, Ai është Mëshirues, ndaj pranon shumë pendimin.”***[63]

Sipas këtij ajeti, kuptojmë se pendimi i tyre ishte i pranuar me një kusht. Ai kusht ishte: Ta mbysnin njëri-tjetrin, nëse dëshironin që Allahu i Madhëruar t’ua pranonte pendimin. Ata e kishin adhuruar viçin në vend të Zotit, përderisa pejgamberi Musa nuk ndodhej në mesin e tyre, pastaj pas rikthimit të Musait, ai i urdhëroi ata që të kthehen nga gabimet e tyre dhe të pendohen tek Allahu Lavdiplotë, t’i nënshtrohen Atij, t’i zbatojnë urdhrat e Tij dhe të largohen nga ndalesat. Ai i lajmëroi se pendimi i tyre nga mëkatet është mbytja e tyre.[64]

Ndërsa në legjislacionin e Muhamedit, pendimi është krejtësisht i lehtë: ***“Nuk ka dyshim se Unë e fal atë që është penduar, që ka besuar, që ka bërë vepra të mira dhe që përqendrohet për në rrugën e drejtë.”***[65] Le të përmendim edhe ajetin më shpresëdhënës në Kur’an që nuk ia mbyll dyert askujt: ***“Thuaj: “O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, sepse vërtet Allahu i fal të gjitha mëkatet, Ai fal shumë dhe është mëshirues!”***[66]

Shumë të lehtë e ka bërë pendimin Allahu në legjislacionin e fundit, madje siç ka thënë edhe vetë i Dërguari i Allahut: ***“Keqardhja për mëkatin e kryer është pendim.”***[67]

[63] Kur’ani, Bekare: 54.
[64] Haziri, Ejup, *Pendohu, o mëkatar!* Fondacioni i Rinisë Islame, Zurich, 2007, fq. 248.
[65] Kur’ani, Ta Ha: 82.
[66] Kur’ani, Zumer: 53.
[67] Transmeton Ibni Maxhe, nr. i hadithit 4252, Bejhakiu, 7612. Albani ka thënë se hadithi është autentik, shih hadithin në Sahih el-Xhami, nr. 6802.

Ky ishte shembulli i parë i një dispozite të caktuar ndërmjet dy legjislacioneve të ndryshme, që të dyja hyjnore, ndërsa shembulli i dytë është i një sfere tjetër, asaj të jurisprudencës, dhe ka të bëjë me përlyerjen e rrobës. Në legjislacionin e Musait, në rast se përlyhet rroba, nuk mund të falesh me atë rrobë të përlyer, por për të kryer namazin nevojitej heqja e asaj pjese të rrobës së përlyer, derisa në legjislacionin e Muhamedit mjafton larja e asaj pjese, e jo heqja e rrobës së përlyer, e as prerja e saj.

Legjislacioni i fundit, për dallim nga ata paraprak, është i kompletuar, për faktin se nuk ka të bëjë me një popull të caktuar apo me disa gjenerata, por ka të bëjë me popuj të ndryshëm, vende të ndryshme dhe me kohë të pacaktuar, për dallim nga legjislacionet e mëparshme që vlenin vetëm për një popull. Në Kur'an thuhet: ***"...Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju islamin fe..."***[68]

Legjislacionet paraprake dhe nevoja e njeriut për to

Njeriu nuk mund të jetojë i vetëm në këtë kozmos, atij i duhet shoqëria për ta jetuar jetën e tij si duhet dhe për të përmbushur nevojat e tij të domosdoshme. Përveç kësaj, i nevojitet një ligj që e mbron atë. Është krijuar me dy fuqi të kundërta mes vete; fuqia e epshit e cila e drejton atë kah e keqja derisa i tejkalon kufijtë dhe armiqëson të tjerët, dhe fuqia e mendjes e cila e fton atë për të mirën derisa ndjek rrugën e drejtë dhe mesataren në çdo gjë.[69] Mirëpo, vetëm mendja nuk mjafton për t'i rezistuar epshit, ngase bota është e mbushur me mashtrime, të cilat lënë gjurmë të pashlyeshme në shpirtin e njeriut, e për këtë historia është dëshmitarja më e mirë se çfarë ndodhish kanë ndodhur (lindur) nga epshi, që vetëm mendja nuk mundi t'i ndalojë ato nga veprimi. Madje, e mira dhe e keqja janë sprovë nga Krijuesi: ***"...Ne, në shenjë sprove ju sprovojmë me vështirësi e kënaqësi..."***[70]

[68] Kur'ani, Maide: 3.
[69] Shelebi, Muhamed Mustafa, *El-Med'hal fi-t Ta'rifi bi-l Fikhi-l Islamij…*, fq. 20.
[70] Kur'ani, Enbija: 35.

Nga këtu, ishte më se e nevojshme që mendja ta ketë një ndihmës që do t'i ndihmojë për të mbizotëruar e mira, e për këtë Allahu i Madhëruar dërgoi të dërguar e zbriti libra për t'i ndihmuar njeriut në jetën e tij. E me libra të zbritura urdhëroi edhe aplikimin e ligjeve hyjnore për të parandaluar të keqen dhe të shëmtuarën, si dhe për të vënë në aplikim të drejtën.

Njeriu u caktua të jetë mëkëmbës në këtë tokë: ***"...Unë po krijoj*** *(po përcaktoj)* ***në tokë një zëvendës!..."***[71] E këtë mëkëmbës nuk e la pa ndonjë ligj që rregullon jetën e tij dhe aplikon drejtësi mes individëve.[72]

Legjislacioni e shoqëroi këtë njeri që nga krijimi i tij apo që nga ekzistimi i rendit njerëzor, duke mos lënë shoqëri e popull pa i caktuar edhe kornizat ligjore të tyre. Këto ligje edhe pse në shumë raste ndryshonin nga njëra- tjetra, kishte pika të caktuara që të gjitha legjislacionet thërrisnin në to, sikurse që ishin parimet e besimit, që kjo e fundit nuk ndryshonte në asnjë legjislacion: ***"Ne nuk dërguam asnjë të dërguar para teje e të mos i kemi shpallur atij se: Nuk ka zot tjetër përveç Meje, pra më adhuroni!"***[73] Në një vend tjetër thuhet: ***"O ithtarë të librit*** *(Tevrat e Inxhil)*, ***ejani*** *(të bashkohemi)* ***te një fjalë që është e njëjtë*** *(e drejtë)* ***mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, pos Allahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos e konsiderojmë njëri-tjetrin zotër pos Allahut"! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi myslimanë*** *(besuam një Zot)* ***"!***[74]

Ndërsa sa u përket disa dispozitave praktikuese, ato ndryshonin nga populli në popull dhe nga legjislacioni në legjislacion: ***"...Për secilin prej jush, Ne caktuam ligj e program*** *(të posaçëm në çështje të veprimit)* ***..."***[75] Siç mund të jetë obligimi i namazit, agjërimit dhe lutjeve të caktuara, që mund të ndryshonin nga shoqëria në shoqëri dhe nga ligji në ligj.

[71] Kur'ani, Bekare: 30.
[72] Shelebi, Muhamed Mustafa, *El-Med'hal fi-t Ta'rifi bi-l Fikhi-l Islamij…*, fq. 21.
[73] Kur'ani, Enbija: 25.
[74] Kur'ani, Ali Imran: 64.
[75] Kur'ani, Maide: 48.

Besimi në të dërguarit e mëhershëm dhe në librat e tyre që i zbriti Allahu, ishte pjesë e besimit në secilin legjislacion, edhe në legjislacionin tonë është e njëjta dispozitë: ***“Ai ju përcaktoi juve për fé atë që ia pati përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me ç’gjë e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain.*** *(I porositëm)* ***Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të. Për idhujtarët është rëndë kjo në çka ju i thirrni ata. Allahu veçon për të*** *(për besim të drejtë)* ***atë që do dhe e udhëzon në të atë që i drejtohet Atij.”***[76] Në një vend tjetër thuhet: ***“Thuaj: “Ne i kemi besuar Allahut, edhe asaj që na u zbrit neve, edhe asaj që i është zbritur Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit dhe pasardhësve. Edhe asaj që i është dhënë Musait dhe Isait, edhe asaj që i është zbritur të gjithë pejgamberëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi mes tyre dhe ne vetëm Atij i jemi dorëzuar”.***[77]

Këto legjislacione e vërtetonin njëra-tjetrën ngase i përkitnin të njëjtit burim dhe secili legjislacion paralajmëronte për atë paraprak dhe për atë që do të vijë më vonë, duke e paralajmëruar edhe të dërguarin që do të vijë më pas.[78] Le të jemi më konkret me tre shembuj. I pari flet për çështjen e Tevratit, i cili i kishte zbritur të dërguarit Musa: ***“Ne e zbritëm Tevratin, në të cilin është udhëzimi i drejtë dhe drita. Sipas tij, gjykuan ndaj atyre që ishin jehudi, pejgamberët që ishin të bindur, gjykuan edhe dijetarët e devotshëm e paria fetare, ngase ishin të obliguar ta ruanin librin e Allahut dhe ishin mbrojtës të tij.”***[79] I dyti flet për çështjen e Inxhilit që i kishte zbritur të dërguarit Isa: ***“Ne vazhduam gjurmët e tyre*** *(të pejgamberëve)* ***me Isain, birin e Merjemes, vërtetues i Tevratit që kishin më pranë. Atij i dhamë Inxhilin, që është udhëzim i drejtë dhe dritë, që është vërtetues i Tevratit që kishin pranë, që ishte udhëzues e këshillues për të devotshmit.”***[80] I treti flet për çështjen e Kur’anit që i kishte zbritur të dërguarit Muhamed: ***“Ne edhe ty*** *(Muhammed)* ***ta zbritëm librin*** *(Kur’anin)* ***e vërtetë që është vërtetues i***

[76] Kur’ani, Shura: 13.
[77] Kur’ani, Ali Imran: 84.
[78] Shelebi, Muhamed Mustafa, *El-Med’hal fi-t Ta’rifi bi-l Fikhi-l Islamij…*, fq. 25.
[79] Kur’ani, Maide: 44.
[80] Kur’ani, Maide: 46.

librave të mëparshëm dhe garantues i tyre. Gjyko pra mes tyre me atë që Allahu e zbriti, e mos pëlqe epshet e tyre e të largohesh nga e vërteta që të erdhi. Për secilin prej jush, Ne caktuam ligj e program *(të posaçëm në çështje të veprimit)****. Sikur të donte Allahu, do t’ju bënte një popull*** *(në fe e sheriat)****, por deshi t’ju sprovojë në atë që ua dha juve, andaj ju*** *(besimtarë)* ***përpiquni për punë të mira. Kthimi i të gjithë juve është te Allahu, e Ai do t’ju njoftojë me atë që kundërshtoheshit.”***[81]

Të gjitha legjislacionet e mëparshme përgëzuan për të dërguarin e fundit dhe ligjin e tij që do të vijë e për këtë çështje Kur’ani thotë: ***“Që pranojnë të dërguarin*** *(Muhammedin)****, Pejgamberin arab,*** *(që nuk shkruan as nuk lexon)****, të cilin e gjejnë të cilësuar*** *(të përshkruar me virtytet e tij)****, tek ata në Tevrat dhe në Inxhil, e që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet, dhe heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta. Pra, ata të cilët e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmojnë, veprojnë me dritën që iu zbrit me të, të tillët janë të shpëtuarit.”***[82]

Këto legjislacione, të gjitha së bashku, e plotësojnë konstruktimin e legjislacionit qiellor, që ka për qëllim udhëzimin e njerëzve, mbrojtjen e vlerave etike, largimin nga të këqijat. E të gjitha këto ngjasojnë me ndërtimin e një ndërtese, ku secili legjislacion plotësoi diçka prej saj. Në këtë kontekst veçojmë thënien e të Dërguarit Muhamed, i cili thotë: ***“Shembulli im dhe shembulli i të dërguarve paraprak është sikurse shembulli i një njeriu që ka ndërtuar një shtëpi, e kompletoi dhe e zbukuroi atë, me përjashtim të një tjegulle që nuk e ka vendosur në të, e njerëzit hynë në të dhe çuditen nga ajo, e thonë: “Sikur të ishte vendosur ajo tjegull. E unë jam ajo tjegull dhe unë jam vula e të dërguarve.”***[83]

Të gjitha këto legjislacione ishin frymëzim hyjnor dhe kishin zbritur në intervale të ndryshme kohore, derisa u përmbyll me legjislaci-

[81] Kur’ani, Maide: 48.
[82] Kur’ani, Araf: 157.
[83] Transmeton Buhariu në Sahihun e tij, nr. i hadithit 3271; Muslimi në Sahihun e tij, nr. i hadithit 4239. Hadithi përcillet nga Ebu Hurejre dhe është autentik.

onnin e fundit hyjnor, të cilin Allahu zgjodhi për robërit e Tij[84]: ***"...Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju islamin fe..."***[85]

Gjendja e njerëzimit para Islamit

Para se të flasim për legjislacionin e fundit hyjnor, të flasim në pika të shkurta për gjendjen e njerëzimit, gjegjësisht arabëve para ardhjes së legjislacionit, për të ardhur në përfundim se përse erdhi një legjislacion pikërisht në këtë kohë dhe në këtë shoqëri.

Gjendja e njerëzisë në prag të shpalljes së Islamit ishte në shkallën më të keqe, buzë greminës. Kjo gjendje nuk ishte aspak më e mirë as në botën e gadishullit arab. Këta të fundit kishin hyrë në errësirën më të madhe të së keqes, të cilët ishin shumë larg qytetërimit, ngase dituri e pakët u kishte arritur atyre nga jehudët dhe krishterët.[86] Padituria i kishte përfshirë në masë të madhe, e shkrim-leximi ishte simbolik. Për këtë gjendje, shpallja më vonë e konfirmoi analfabetizmin dhe gjendjen e tyre të mjerë:

"Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t'ua lexojë ajetet e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë librin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme."[87]

Ndarja në fise ishte stili i jetesës së tyre[88], por edhe jetesa e tillë shpesh qonte në luftëra e beteja të gjata, madje shpesh ato fillonin edhe pa ndonjë shkak. Por, ndodhte që të zhvilloheshin luftëra e beteja për shkak të fyerjes së një robëreshe, shuplakës së ndonjë fëmije apo rrahjes së ndonjë kafshe[89], e me këto të zgjaste lufta për vite të tëra, derisa vendet bëheshin objekt shkatërrimi, gratë mbeteshin të veja,

[84] Shelebi, Muhamed Mustafa, *El-Med'hal fi-t Ta'rifi bi-l Fikhi-l Islamij…*, fq. 26.
[85] Kur'ani, Maide: 3.
[86] Emin, Ahmed, *Fexhru-l Islam*, fq. 211.
[87] Kur'ani, Xhuma: 2.
[88] Zejdan, Abdulkerim, *El-Med'hal Lidirasetish Sheriatil Islamijeh*, Dar Omer ibnu-l Hattab, Aleksandri-Egjipt, 2001, fq. 17.
[89] Është e njohur lufta kur një person e qëllon gjirin e devesë së personit të fisit tjetër, dhe aty fillon lufta në mes atyre dy fiseve, e cila zgjat dyzet vite. Apo lufta e Dahis-it dhe Gabraut, që fillon nga një shuplakë.

fëmijët jetimë, nderi nëpërkëmbej, e secili flinte me frikë ndaj vetes dhe pasurisë së tij.[90]

Nuk kishte ndonjë ligj të veçantë që veprohej sipas tij, por ekzistonte sistemi i fiseve apo kabileve, ku në secilin fis gjendej udhëheqësi i fisit, i cili e mbronte familjen dhe fisin e tij. Po ashtu ishte e njohur edhe aleanca që bëhej ndër fisnore. Fisi ishte kombësia e arabëve, jeta e arabit ishte e lidhur me jetën e atij fisi, ndaj shteti për arabin ishte në suaza dhe kufij të fisit që i takonte. Secili fis kishte një lloj sovraniteti, e shpeshherë fiset bashkoheshin me njëra-tjetrën për interesa dhe qëllime të caktuara.[91]

Njerëzit jetonin të ndarë në qytete dhe fshatra të largëta, e këta të fundit ishin shumë të ndryshëm nga të parët. Ata jetonin të ndarë në dy shtresa; të lirë dhe robër *(ahrar ve abid)*. Robërit ishin në duart e zotërinjve të tyre, të cilët nuk kishin të drejtë të vepronin asgjë, pa lejen paraprake të zotërisë së tyre. Shumë prej tyre kalonin tërë jetën e tyre si skllav dhe kurrë nuk e fitonin lirinë. Ishin të kufizuar në çdo pikëpamje dhe nuk mund të martoheshin, vetëm se në raste të rralla, e për këtë arsye, kur erdhi Islami i urdhëroi besimtarët që të kujdesen për robërit dhe të trajtohen njësoj si të tjerët, madje urdhëroi besimtarët që të kujdesen edhe për martesën e robërve. ***"Dhe martoni të pamartuarat*** *(të pamartuarit)* ***edhe robërit e robëreshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme. Nëse janë të varfër, Allahu i begaton nga mirësitë e Tij, Allahu është bujar i madh, i gjithëdijshëm."***[92]

Gjakmarrja ishte mjaft e përhapur në shoqërinë arabe para-islame, saqë kjo dukuri pothuajse ishte bërë preokupim i përditshëm i asaj shoqërie. Nëse vritej një njeri i ndershëm apo i shtresës së lartë, familja e tij nuk kërkonte mbytjen e vrasësit por e kërkonte një të ndershëm apo të shtresës së lartë nga familja e vrasësit, ngase në shoqëri dominonte thënia: Gjaku nuk pastrohej ndryshe vetëm se me mbytjen e të ndershmit apo me një njeri të ngjashëm sikur i vrari.[93] Mbytjet

[90] Shelebi, Muhamed Mustafa, *El-Med'hal fi-t Ta'rifi bi-l Fikhi-l Islamij…*, fq. 46.
[91] Xhevvad, Alij, *El-Mufessal fi Te'rihi-l Arab Kable-l Islam*, fq. vëll.I, fq. 476.
[92] Kur'ani, Nur: 32.
[93] Xhevvad, Alij, *El-Mufessal fi Te'rihi-l Arab Kable-l Islam*, fq. vëll.VI, fq. 122.

ishin të shpeshta dhe ato bëheshin për qëllime të ulëta, pa kurrfarë të drejte. Pas ardhjes së Islamit, u ndaluan që të gjitha, me përjashtim kur mbytja e tij është e drejtë: ***"...mos e mbytni njeriun sepse mbytjen e tij e ndaloi Allahu, përpos kur është me vend..."***[94]

Në shoqëri mbretëronin zakone të liga e jo qytetëruese, zakone të prapambetura e prapanike, që kreu i këtyre zakoneve prapanike përmblidhet në dy: Idolatria dhe mbytja e vajzave për së gjalli. Idolatria-besimi në idhuj e puta që ata i besonin si zota ishte përhapur në masë të madhe. Shoqëria e asaj kohe kishin humbur lidhjen me Krijuesin e tyre dhe kishin filluar adhurimin e idhujve, të cilët nuk dëgjonin, nuk shihnin dhe as që kishin efekt për ndonjë dëm apo dobi, megjithatë, njerëzit kishin krijuar konceptin e tyre se ata meritojnë të adhurohet. Këtë koncept të gabuar Kur'ani ua kishte përkujtuar më vonë asaj shoqërie: ***"Mirëpo, ata*** *(idhujtarët)* ***në vend të Tij adhuruan zota të tjerë, të cilët nuk krijuan asgjë, sepse ata edhe vetë janë të krijuar. Ata nuk posedojnë për vetvete as dëm as dobi, ata nuk kanë në dorë as vdekje as jetë, e as ringjallje."***[95] Ky koncept prapanik ishte përcjellë dhe ruajtur me fanatizëm të madh, duke anashkaluar mendjen për t'i dhënë përparësi imitimit të verbër nga paraardhësit e tyre. Ishte e njëjta logjikë e kësaj shoqërie me atë të shoqërisë së Ibrahimit:

> ***Kur ai babait dhe popullit të vet u tha: "Ç'janë këto statuja që i adhuroni?" Ata thanë: "I gjetëm të parët tanë, që po i adhuronin". Ai u tha: "Edhe të parët tuaj e edhe ju qartë ishit të humbur!"***[96]

Ndërsa varrosja e vajzave për së gjalli ishte zakon i disa fiseve të caktuara, të cilat fise e shihnin nder e krenari varrosjen e vajzave,[97] derisa fisi kurejsh prej të cilit rrjedh edhe i Dërguari i fundit asnjëherë nuk kishte bërë diçka të tillë.

Këtij fenomeni negativ Kur'ani i ka kushtuar shumë rëndësi të madhe, derisa e shoi krejtësisht: ***"Kur ndonjëri prej tyre lajmërohet me*** *(lindjen)* ***vajzë, fytyra e tij prishet dhe bëhet pot mllef. Fshihet prej***

[94] Kur'ani, Enam: 151.
[95] Kur'ani, Furkan: 3.
[96] Kur'ani, Enbija: 52-54.
[97] Zejdan, Abdulkerim,*El-Med'hal Lidirasetish Sheriatil Islamijeh*, fq. 18.

njerëzve, për shkak të asaj të keqeje me të cilën u lajmërua *(e konsideron bela, e jo dhuratë prej Zotit)****. Mandej,*** *(mendon)* ***a do ta mbajë atë, ashtu i përulur, apo do ta mbulojë atë*** *(të gjallë)* ***në dhe. Sa i keq është ai gjykim i tyre."***[98]

Një veprim të tillë Islami e konsideroi njërin nga mëkatet e mëdha dhe një fatkeqësi për njerëzimin: ***"Ju mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne ua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve, e mbytja e tyre është mëkat i madh."***[99]

Disa nga ata që përqafuan më vonë fenë islame kishin varrosur bijat e tyre për së gjalli, njëri prej tyre ishte Kajs ibn Asim el-Minkarij nga fisi beni Temim, i cili kishte varrosur për së gjalli hiq më pak se tetë vajza të tij, para se ta pranonte Islamin.

Përveç aspektit fetar dhe shoqëror që shoqëria e kësaj kohe ndodhej buzë greminës, as ai politik nuk ishte në një nivel të kënaqshëm. Në këtë shoqëri mungonte rendi e ligji, nuk kishte lider që do ta udhëhiqte shtetin, por ai udhëhiqej në bazë të klaneve që gjykonin sipas interesave të tyre personale, e jo sipas drejtësisë që kërkohej. I forti e shtypte të dobëtin, e i dobëti nuk kishte ku të ankohej[100]. Nuk i jepej përparësi rendit por zakonit klanor. Përdorimi i forcës me metoda të vrazhda ishte bërë dukuri mjaft e shpeshtë, ku në shumicë rastesh pësonin të dobëtit dhe ata që nuk kishin përkrahje.

Sidoqoftë, nën këto rrëmuja të mëdha dhe në këtë gjendje kaotike, një ligj që rregullon raportet e ndryshme në këtë shoqëri ishte domosdoshmëri e kohës dhe një lider që do të udhëhiqte anën ideologjike e politike brenda kësaj shoqërie do të ishte shpëtim për mbijetesën e këtij rendi shoqëror.

- vijon -

[98] Kur'ani, Nahl: 58-59.
[99] Kur'ani, Isra: 31.
[100] Këtë fenomen disa vite më vonë do ta përshkruan i përndjekuri që kishte zgjedhur për strehim Abisininë e krishterë, me qëllim që t'i shpëtonte torturave dhe padrejtësive kurejshe, ai para mbretit Nexhashij, tha: "O mbret, ishim një popull në injorancë që adhuronim idhujt, hanim cofëtinën, vepronim marrëzira, lidhjet familjare i kishim shkëputur, fqinjët i torturonim, i forti nga ne e shtypte të dobëtin..."

Mr. Ejup Haziri

ISLAMIC LAW

Islamic faith and law

(Summary)

Evil has spread considerably, hearts have gone astray, lust has become insatiable, people have moved away from the religion of Allah the Magnificent and from his laws. Nothing is left of the laws of God apart from certain prayers and the recitation of the Qur’an in times of joy or sorrow. And, the laws were not meant for this. These laws were meant to be a way of living - the road to salvation.

ايوب حازيري

التشريع الاسلامي

(خلاصة البحث)

الايمان بالاسلام والتشريع

لقد انتشرت الخبائث بكثرة وخرجت القلوب من المألوف وقد تم تقوية الشهوة حتى أنها أصبحت تقودهم الى حيث تشاء والناس انحرفوا عن سبيل الرشاد و عن الشرع الصحيح والخلق الكريم. لقد ضاع من تشريع الله تعالى ولم يبق منه الا بعض الصلوات التى تؤدى الى مناسبة ذكرى الموتى والقرآن الكريم يقرأ بمناسبة الافراح او الموتى الا أن التشريع الاسلامي لم يأتى لهذه المناسبة وجاء ليكون برامج لحياة المسلم في هذه الدنيا والآخرة.

Refik Vitia

MYDERRIZI SHEHID ISMET ef. LIMANI*
(Ld. 19.07.1946 – vd. 12.05.1999)

Hyrje

S’ka dyshim se në fushën e thirrjes, arsimit e të kulturës sonë islame dhe kombëtare në Kosovë e me gjerë, zë vend edhe alimi-hoxha dhe myderrizi i shquar Ismet ef. Limani. Puna e palodhshme e tij në këto vende bën që ai të mos harrohet kurrë. Mësimet, fjalët dhe vepra e tij bëjnë që edhe pas plot njëmbëdhjetë vjetësh të përsëriten thëniet e tij nga bashkëkohësit e tij dhe ato të kujtohen me ëndje. Sakrificat e tij, e në veçanti aktiviteti i tij në Xhaminë e Hajvalisë si imam e mualim, por edhe si një edukator i denjë i të rinjve dhe të rejave të këtij fshati, bëri që sot nga duart e tij të dalin teologë, doktorë, gjuhëtarë e shumë profesionalistë të ndryshëm, në mesin e tyre edhe unë kam qenë njëri nga shumë ish-nxënësit e tij.

Nisur nga ky fakt dhe nga shumë të tjerë që nuk u përmendën këtu, në këtë përshkrim biografik për myderriz Ismet ef. Limanin, do t’i

* Pjesë nga punimi i diplomës me titull “Myderriz Ismet ef. Limani – Jeta dhe vepra”, e mbrojtur në Fakultetin e Studimeve Islame të Prishtinës më datë 28.10.2010, nën mbikqyrjen e mentorit Mr. Qemajl Morina.

shpalosim disa të dhëna për jetën dhe veprën e këtij myderrizi dhe patrioti të shquar, pa pretenduar që të thuhen të gjitha. Pavarësisht se në interesimet e mia për jetën dhe veprimtarinë e myderriz Ismet ef. Limanit kam hasur në përkrahje të xhematit, njerëzve dhe bashkëkohësve, bashkëveprimtarëve të tij, të cilët më jepnin kurajë që të punoja sa më shumë në zbulimin e jetës dhe veprimtarisë së një misionari, të cilin populli nuk do ta harrojë kurrë.

Jetëshkrimi i myderriz Ismet ef. Limanit

Myderriz Ismet ef. Limani rrjedh nga një familje e sinqertë dhe me autoritet të konsiderueshëm në fshatin Raincë të Preshevës me rrethinë. Ismet ef. Limani u lind më 19 korrik të vitit 1946, në fshatin Raincë të komunës së Preshevës dhe ishte fëmija i pestë i Islamit dhe Salihes, i ati Islami ishte haxhi i respektuar, ndërsa e ëma e tij, Salihja rridhte nga një familje me tradita hoxhallarësh, babai i saj kishte marrë ixhazetnamenë, por edhe vëllai i saj Mulla Mustaf ef. Jakupi kishte mësuar në Medresenë e Preshevës, te myderriz hafëz. Nexhati Ahmedi.

Gjenealogjia e myderriz Ismet ef. Limanit është si vijon: Myderriz Ismeti ishte biri i Islamit, Islami i biri i Limanit, Limani i biri i Sylejmanit, Sylejmani i biri i Zahirit, Zahiri i biri i Hetemit e kështu me radhë.

Arsimimi

Ismet efendiu mësimet e para i mori nga nëna e tij Salihja, e cila, siç thamë, rridhte nga një familje fetare. Qysh në moshën 4-5 vjeçare filloi të mësonte praktikumin e kushtit të parë të Islamit namazin, ndërsa në moshën shtatëvjeçare e përvetësoi atë.

Shkollën fillore e nisi në shkollën “Zenel Hajdini” në vendlindje në vitin 1953-1954. Mësuesi i tij, prof. dr. Mehmet Halimi, i cili në vitin shkollor 1958-1959 shërbeu në fshatin e vendlindjes së mulla Ismetit, dhe një vit i kishte dhënë mësim, përveç tjerash, thotë: “Ismet Limani ishte një nxënës përherë i buzëqeshur, kishte një natyrë të zgjuar dhe ishte kureshtar për dije e mësim. Në orët e mësimit ai ishte shumë i disiplinuar. Duke u bërë sy e vesh, me interesim më përcillte në orë të mësimit. Dhe unë vërejta tek ai një etje të madhe për mësim e dije. Ndaj nga ai prisja shumë. Është mëkat i madh të shuhej një talent i tillë.”

Gjatë shkollimit të tij tetëvjeçar Ismet ef. pos që vijonte mësimet në shkollën fillore, ai ishte regjistruar edhe te hoxha i fshatit myderriz Qail ef. Memiqi për t’i marrë hapat e parë të mësimbesimit islam. Mirëpo, Ismet efendiun që nga fëmijëria e derisa u burrërua e përcolli një fat i keq dhe si hije e përcillte pushteti serbo-sllav. Ja se ç’thotë, përveç tjerash, ish-mësuesi i tij dr. Mehmet Halimi: “Në ditarin tim pata shkruar: Sot u shqetësova tepër. Në kohën e mësimit, arsimtarja e punëdores Leposava i rrahu pamëshirshëm dy nxënës shqiptarë: Ismet Limanin dhe Ruxhdi Rashitin. Kjo rrahje shtazarake ndodhi ndërmjet orës së parë dhe orës së dytë, kur nuk ishte pushim,… Qëndrimi aq i vrazhdë i arsimtares Leposava dhe sjellja e saj i kalonte të gjitha normat dhe metodat pedagogjike…Ky gjest i saj barbar më shqetësoi pa masë, sepse ky ishte një shqetësim i dyfishtë: derisa për nxënësit ishte një ndëshkim i vrazhdë fizik, për mua ky ishte një ndëshkim i rëndë shpirtëror. Mësuesi patjetër do të shqetësohet për nxënësit e vet. Ai nuk mund të rrijë. Madje, duhet të kujdeset për ta, sepse ai është prind i dytë i tyre...”

Kështu me mundime dhe sakrifica Ismet ef. e përfundoi shkollimin e tij fillor me sukses të shkëlqyeshëm më 20 maj 1961. Kushtet e vështira ekonomike nuk i lejuan që të vazhdonte shkollën e mesme, për të cilën kishte dëshirë të flaktë. Pas plot katër vjetëve nga kur kishte kryer filloren, Ismet ef. regjistron me korrespondencë Medresenë e Mesme “Alaudin” në Prishtinë në vitin 1965-66, por megjithëkëtë, ai nuk e kishte ndërprerë vijimin e mësimbesimit te myderriz Musli

ef. Musliu nga Letovica, e më vonë kishte dëgjuar ligjërata edhe te myderriz Fejzullah ef. Salihu.

Medresenë e Mesme “Alaudin” e kreu më 26 shtator 1970. Virtytet më të larta, më të ndershme e më njerëzore i trashëgoi nga familja e tij, cilësitë intelektuale që i fitoi gjatë shkollimit në medresenë “Alaudin” në Prishtinë, e bënë Ismet efendiun njeri të kompletuar e të formuar.

بسم الله الرحمن الرحيم
جمهورية مصر العربية
جامعة الأزهر

Faksimili i Diplomës së Myderriz Ismet ef. Limanit

Pas përfundimit të medresesë, Ismet ef. u interesua për të vazhduar studimet, prandaj me ndihmën dhe mirëkuptimin e prindërve dhe të vëllezërve, të cilët e donin dhe e respektonin shumë, ai mori rrugën për në Kajro, me dëshirën që të studionte në Universitetin e mirënjohur “Al-Azhar”, i cili atë vit (1972-1973), kremtonte 1300-vjetorin e themelimit të tij.

Viti i parë i studimeve për Ismet ef. ishte vit përgatitor. Mirëpo, duke parë se Ismet efendiu ishte ndër studentët më të mirë, udhëhe-

qësit e Universitetit vendosin t’ia sigurojnë studimet dhe banimin falas. Madje, edhe një herë në vit për të ardhur në vizitë familjare, si dhuratë për suksesin e treguar në vitin përgatitor.

Gjatë studimeve universitare në Kajro, Ismet ef. kishte takuar një shqiptar, i cili kohë më parë kishte migruar nga Shqipëria (siç thoshte ai, quhej efendi Hamdiu), i cili te Ismet efendiu la përshtypje të thella si njeri i mirë e posaçërisht si njeri shumë intelektual. Siç thoshte Ismet ef., edhe intelektualët arabë i drejtoheshin atij për ndihmë të gjuhës letrare arabe, të cilën e kishte përvetësuar më mirë se gjuhën amtare. Mirëpo, i ndjeri as nuk kishte krijuar familje as nuk kishte pasur fat më të kthehej e ta shihte atdheun, sepse shumë shpejt kishte vdekur në dhe të huaj.

Në Universitetin e “Al-Az’harit”, Ismet ef. ishte njëri nga studentët më të dalluar si në sjellje po ashtu edhe në virtyte të larta morale dhe shpirtërore. Studimet i kreu me sukses në vitin shkollor 1976/77, dhe saktësisht më 30 gusht 1977, diplomoi në Fakultetin e Sheriatit dhe Drejtësisë dhe mori diplomën.

Pas diplomimit dhe marrjes së titullit të profesorit-myderrizit, Ismet efendiu i kthehet vendlindjes, sepse dëshira e flaktë e tij ishte që t’i shërbej’ vendit të tij dhe bashkëkombësve të tij.

Veprimtaria

Pas kryerjes së studimeve, ai kthehet në vendlindje me dëshirë që aty të punojë e të veprojë, por kjo mundësi atij nuk iu dha kurrë, edhe pas mundimeve të tij dyvjeçare.

Në vitin 1979, Bashkësia Islame e RSFJ së atëhershme e pranoi si imam në xhaminë e Nishit, e cila për vite më radhë nuk kishte pasur imam. Aty punoi dy vjet deri në kohën e shpërthimit të demonstratave studentore në Kosovë. Po në atë kohë një ekip mjekësor i shqiptarëve të Kosovës, të cilët punonin në Libi, kërkonin një përkthyes të gjuhës arabe, të cilën gjuhë Efendiu e kishte përvetësuar mirë përderisa ishte në studime. Atje ai punoi katër vjet.

Me të përfunduar misionin e tij në Libi kthehet në vendlindje për të provuar edhe kësaj radhe që të punonte dhe të kontribuonte në këtë vend, por kësaj radhe pushteti serbo-sllav i atëhershëm nuk i jepte as leje ndërtimi për shtëpi. Kur myderrizi e kupton se qëndrimi i tij në atë vend është i pamundur detyrohet të arratiset së bashku me të vëllanë nga vendlindja për në Kosovë.

Në vitin 1986 në fshatin ish-Mirditë tashmë Matiçan vendoset për banim ku edhe sot jeton familja e tij. Po në këtë kohë në fshatin Hajvali filloi ndërtimi i xhamisë dhe kërkohej një imam për të. Myderrizi këtë ofertë e pranoi me gjithë zemër, kështu më në fund u realizua dëshira e kamotshme e tij që të punonte dhe të kontribuonte te bashkëkombësit e tij.

Në xhaminë e Hajvalisë përveç misionit të imamit-mualimit ai kontribuoi shumë në edukimin e brezave të rinj, të cilët mësonin mësimbesimin, edukatën, moralin islam por edhe shkronjat e para të Kur’anit, për të vazhduar më pastaj me lehtësi medresenë dhe studimet tjera, në vend dhe jashtë vendit. Me punën dhe aktivitetin e tij, ai u bë shumë i afërt, si me të rriturit, po ashtu edhe me të rinjtë, të cilët e çmonin dhe e respektonin shumë.

Ishte i njohur edhe në ligjëratat e tij, ndonëse gjatë ligjërimit të tij nuk e ngrinte zërin, ai ishte tejet i qartë. Ata të cilët gjatë asaj kohe i kishin dëgjuar ligjëratat e tij në xhami dhe tubimet të ndryshme fetare, dhe të cilët janë në jetë akoma, me kënaqësi të posaçme dhe admirim i interpreton ato në frymën më burimore.

Në Hajvali, Ismet ef. punoi dhe dha kontributin e tij më të madh, deri me shpërthimin e luftës së fundit të vitit 1998-99, kur edhe myderrizi përjetoi fatin e shumë shqiptarëve, të cilët përjetuan regjimin sllav të Milloshevïqit, prej viteve 1981.

Myderriz ef. Ismeti, ndonëse kishte një diapazon të gjerë të njohurive, ai ishte mjaft modest, ishte i urtë, i durueshëm dhe mjaft inteligjent. Përpos gjuhës amtare, mjaft bukur dhe rrjedhshëm njihte gjuhën arabe, në të cilën kishte përkthyer derisa ishte në Libi. Kishte njohuri të përgjithshme në shkencat islame.

Ishte edhe anëtar i Shoqatës së Ulemave pranë Këshillit të Prishtinës, ku veçohej me angazhimin dhe punën e tij të palodhshme si në kryerjen e detyrës së imamit-mualimit, po ashtu edhe në shpërndarjen e literaturës së atëhershme, ishte ndër anëtarët më aktiv në komunën e Prishtinës.

Jo vetëm që ishte aktiv në shpërndarjen e literaturës islame por edhe vetë kontribuoi në të, ishte i njohur edhe në shkrimet që kishte botuar në revistën "Dituria Islame" në të cilën kishte filluar të shkruante për Biografinë e pasardhësve të Pejgamberit a.s. si personalitete të shquara të fesë islame", si për Ebu Bekër Es-Sidikun, të cilën edhe e kishte botuar.

Kishte shkruar edhe për Omer Ibn Hatabin, Osman Ibn Afanin, Ali Ibn Ebi Talibin, por këto të fundit nuk kishte arritur t'i botonte.

Ishte i njohur edhe në përkthimet që i bënte nga gjuha arabe, në revistën "Dituria Islame". Në lëmin e Fikhut kishte përkthyer një artikull për namazin.

Thuajse gjatë tërë jetës së tij, dha potencialin e fundit për përhapjen e fjalës së Allahu të Madhëruar dhe të Dërguarit të lavdëruar, ai asnjëherë nuk u pajtua me ideologjitë komuniste e socialiste, e as me përkrahësit e tyre. Myderriz Ismet ef. Limani ishte njeri i fesë dhe i atdheut, ishte një person simpatik si nga pamja ashtu edhe nga shpirti.

Kontributi i myderriz Ismet ef. Limanit në Xhaminë e Hajvalisë

Të flasësh për kontributin e myderrizit në xhaminë e Hajvalisë, janë të pakta fjalët ngase pikërisht në këtë vend ai arriti kulmin e veprimtarisë së tij të bujshme, veprimtari që la gjurmë edhe sot e kësaj dite. Xhamia e Hajvalisë u hap në vitin 1987, dhe imam i parë i saj u emërua myderriz Ismet ef. Limani.

Përveç detyrës së imamit në xhami, ai punoi edhe si edukator i gjeneratave të reja në frymën fetare patriotike e kombëtare në fshat dhe rrethinë, ishte i flakët që ta shohë atdheun të çliruar nga armiku serb, gjë që e ka potencuar edhe në ligjërata dhe tubime të ndryshme.

Me sukses organizonte mësimbesimin islam në xhami, gjenerata të shumta mësonin nga myderrizi shkronjat e para të Kur'anit, për të vazhduar më pastaj me lehtësi këto studime në medrese e në universitete të ndryshme vendore e të shteteve të tjera islame. Me kontributin e tij sa e sa studentë nga këto treva kanë kryer dhe po kryejnë me sukses studimet e tyre, pa dyshim se ishte meritë e myderriz Ismet ef. Limanit.

Myderriz Ismet ef. Limani së bashku me nxënësit e tij me rastin e përfundimit të njërës nga hatmet kuranore

Në kohën sa ishte imam Ismet ef. xhamia ishte shndërruar në një tempull dijenie e edukimi fetar e kombëtar, grupe-grupe nxënësish hynin e dilnin nga dyert e xhamisë varësisht se si e kishin orarin mësimor të koordinuar nga myderrizi. Me sukses organizonte hatmet kuranore me nxënës dhe nuk mbetej as një vit të paktën pa mbajtur një hatme kuranore, të shpeshta ishin edhe nga dy hatme. Numri i nxënësve arrinte mbi njëqind nga e gjithë rrethina, si nga Hajvalia, Mramori, Kishnica, Janjeva etj.

Ishte ndër imamët-mualimët më të zellshëm në Kryesinë e Shoqatës së Ulemave të Prishtinës në kohën e tij, zelli i tij tregohej në tri

pikat kryesore që duhej t’i ketë një mualim e ai i posedonte ato, ishte imam i rregullt, shpërndarës i rregullt i literaturës islame në fshat dhe rrethinë, por edhe arritja e kulmit të veprimtarisë e tij të mësimbesimit islam në xhaminë e Hajvalisë dhe organizimi i hatmeve Kura’nore me nxënësit e tij në të cilat çdoherë ftohej Kryesia e Shoqatës së Ulemave të Kosovës.

Me rastin e një Hatme Kuranore Myderriz Ismet ef. Limani (në këmbë i treti nga e djathta) së bashku me disa nga Kryesia e Shoqatës së Ulemave të Kosovës dhe disa xhematlinj.

Nxënësit e myderrizit

Në mesin e shumë aktiviteteve të myderriz Ismet efendiut ishte edhe sjellja e kuadrove të reja të nxënësve në xhaminë e Hajvalisë, të cilët më pastaj do të vazhdojnë mësimet dhe studimet e tyre në lëmi të ndryshme në vende të ndryshme.

Me përkujdesje dhe përgjegjësi të madhe Ismet ef. iu përkushtua detyrës së imamit në një ambient, ku njohuritë për fenë islame ishin të pakta. Mirëpo, në saje të punës së tij të palodhshme dhe vullnetit të tij të çeliktë, ishte ndër imamët më aktiv të mësimbesimit. Këtë e dëshmojnë më së miri brezat e tërë të të rinjve dhe të rejave, të cilët mësuan parimet themelore të fesë islame, falë kontributit dhe angazhimit të tij të palodhshëm.

Aktiviteti, puna, mësimbesimi islam i ushtruar në xhaminë e Hajvalisë, nga ana e myderrizit mund të shihet edhe në revistën “Dituria Islame”, në të cilën disa nga aktivitetet me nxënës janë të publikuara edhe në të.

Rrugën e Myderrizit e ndjekin sot nxënësit e tij, sepse njerëz të tillë siç ishte myderrizi janë fenerë që nuk shuhen dot, prandaj duhet t’i kemi shëmbëlltyrë, në punët dhe aktivitetet tona si thirrës.

Sot shumë nga ata që morën hapat e parë të mësimbesimit islam nga myderrizi janë bërë teologë, doktorë e shumë profesionalistë të ndryshëm të kualifikuar që shërbejnë në vend dhe jashtë vendit. Falë mundit, punës dhe suksesit të tij sot pesë xhami funksionojnë nga nxënësit e tij në Kosovë dhe dy në Perëndim siç janë:

-Rexhep Metolli i cili shkronjat e para të Kuranit i mori nga Myderrizi për të vazhduar më pastaj Medresenë e Mesme “Alaud-din” në Prishtinë, shkollimin e lartë e përfundoi në Emiratet e Bashkuara Arabe, diplomon në Shkenca Humane dhe Shoqërore, drejtimi Letërsi angleze, punon si imam-mualim në një xhami në Llugano të Zvicrës.

-Blerim Gashi pas mësimeve të para që merr nga myderrizi përfundon Medresenë e Mesme “Alauddin” në Prishtinë, regjistrohet në Fakultetin e Studimeve Islame, punon në Suedi si imam-mualim.

-Irfan Islami po ashtu ishte nxënës i myderrizit, i cili përfundoi Medresenë e Mesme “Alauddin” në Prishtinë, shkollimin e lartë përfundoi në Emiratet e Bashkuara Arabe, drejtimi Sheriat dhe Ligje dega Tefsir-Hadith. Punon imam-mualim në xhaminë e Matiçanit.

-Bahtir Gashi ka përfunduar Medresenë e Mesme “Alaudin” në Prishtinë, është pranë diplomimit në Fakultetin e Studimeve Islame, punon imam-mualim në xhaminë e Konjuhit.

-Ekrem Kosumi ka përfunduar Medresenë e Mesme ‘Alaudin” në Prishtinë, regjistrohet në Fakultetin e Studimeve Islame, punon në fshatin Tugjec si imam-mualim por edhe në shkollën e fshatit si ligjërues i Gjuhës angleze.

-Xheladin Fazliu përfundon Medresenë e Mesme “Alaudin” në Prishtinë, është pranë diplomimit në Fakultetin e Studimeve Islame, punon imam-mualin në xhaminë e Hajvalisë.

-Refik Vitia pas përfundimit të Medresesë së Mesme “Alaudin” në Prishtinë, regjistrohet në Fakultetin e Studimeve Islame, është pranë diplomimit, punon në xhaminë e re në Mramor-Suteskë.

-Fuad Morina pas përfundimit të Medresesë së Mesme “Alaudin” në Prishtinë, rrugëton në Kajro të Egjiptit për t’u regjistruar në Universitetin e El-ez’herit, diplomon në Sheriat dhe Juridiksion, njëkohësisht përfundon edhe Ekonomikun në Kosovë dega Administratë dhe Menaxhment, punon në shtypin ditor “Koha Ditore”.

-Avdyl Pacolli regjistron Medresenë e Mesme “Alaudin” në Prishtinë me korrespodencë, të rregullt përfundon Mjekësinë, diplomon në Fakultetin e Mjekësisë së Përgjithshme, punon në Urgjencën e Qytetit-Prishtinë.

-Nazim Bajrami ka përfunduar Medresenë e Mesme “Alaudin” në Prishtinë, diplomon në Fakultetin Juridik dega Kriminalistikë.

-Suad Vitia ka përfunduar Medresenë e Mesme “Alaudin” në Prishtinë, ka regjistruar Fakultetin e Studimeve Islame.

-Naxhie Pacolli regjistrohet në Medresenë e Mesme “Alaudin” në Prishtinë me korrespodencë, të rregullt përfundon teknikën, drejtimi PTT, regjistron Fakultetin e Studimeve Islame, është pranë diplomimit.

-Kimete Rukovci përfundon shkollën e mesme “Sami Frashri”, diplomon në Fakultetin Ekonomik, vazhdon magjistraturën në degën Banka dhe Financa.

-Elfete Vitia-Islami ka përfunduar Medresenë e Mesme “Alaudin” në Prishtinë, regjistron Fakultetin në Emiratet e Bashkuara Arabe, dega Sheriat dhe Kanun.

-Drita Sopjani ka regjistruar Medresenë e Mesme “Alaudin” në Prishtinë me korrespodencë, të rregullt përfundon Mjekësinë, punon në QKUK si infermiere.

-Minire Vitia ka përfunduar shkollën e Mesme të Mjekësisë, ka punuar si infermiere në Ambulancën e Hajvalisë, diplomoi në Fakultetin e Edukimit, tash punon në diasporë si edukatore në një çerdhe fëmijësh.

-Bukurie Sopjani përfundon Medresenë e Mesme “Alaudin” në Prishtinë, regjistron Fakultetin e Studimeve Islame.

E shumë studentë dhe studente të tjera të profesioneve të ndryshme, të cilat nuk patëm mundësi t’i përmendim që të gjithë.

Kalimi në Botën tjetër i Ismet ef. Limanit

Myderriz Ismet ef. Limani, me aktivitetin e tij në xhaminë e Hajvalisë, ishte bërë halë në sy të pushtetit serb, sidomos në vitet e fundit. E me gjithë presionet, pengesat që i bënte pushteti serb, Ismet efendiu, asnjëherë nuk u nda nga xhamia dhe nga xhematlinjtë e tij, madje edhe gjatë bombardimeve të Aleancës Veriatlantike mbi caqet serbe. Namazi i fundit i tij në xhaminë e Hajvalisë qe ai i xhumasë më 26 mars 1999. Ndërsa për namazin e Kurban Bajramit më 29 mars 1999, forcat ushtarake-policore serbe myderrizin nuk e lejuan të shkonte në xhami.

Me zemër të thyer myderriz Ismet efendiu u detyrua të qëndronte në shtëpi. Pritja nuk i zgjati shumë, sepse në orën 14:00 të po të asaj dite, forcat ushtarake kriminale policore serbe e sulmuan fshatin e myderrizit, ku vranë trembëdhjetë burra, gra e të rinj, tërë popullatën e pafajshme e dëbuan nga shtëpitë e tyre me dhunë për në malësinë e Mramorit dhe të Marecit. Në mesin e tyre ishte edhe myderriz Ismet efendiu me familjen e tij, i cili u strehua te haxhi Ismajl Gashi në Mramor, aty qëndroi tri javë. Pas tri javësh me gjithë familjen e tij dhe me disa të rinj merr rrugën në malet e Gollakut dhe të Karadakut për të arritur në vendlindjen e tij në Preshevë, atje qëndroi te vëllezërit dhe të afërmit e tij.

Siç mësojmë nga i vëllai i myderrizit, Ridvani, më 11 maj, myderrizi i kishte thënë se do të kthehej në Kosovë, sepse nuk mund të qëndronte pa e ditur se ç’po ndodhte atje. E lutëm, thotë Ridvani, të gjithë që të priste edhe ca kohë për të parë se si do të përfundonte gjithë ajo rrëmujë, por kot. Prandaj, të mërkurën më 12 maj 1999 në orën 9:00, ai u nda nga të afërmit e tij, siç e shohim më vonë përgjithmonë, duke u thënë atyre ***“se nuk mund të qëndrojë më i ndarë nga xhemati im dhe xhamia ime në Hajvali“***. Që nga ky moment kontaktet e familjarëve me myderrizin kishin përfunduar. Me autobus u nis nga Bujanoci për në Gjilan për të arritur në Prishtinë. Në hyrje të fshatit Llapnasellë të Prishtinës, ku kryesisht jetojnë serbët, në vendin ku

gjatë fushatës serbe në Kosovë ishte vendosur punkti famëkeq i ushtrisë dhe i policisë serbe, ishte ndaluar autobusi me të cilin udhëtonte Ismet ef..

Sipas fjalëve të Bajram Krasniqit, i cili në ditën kritike kishte udhëtuar me autobusin në fjalë prej Gjilanit për në Prishtinë, me 21 anëtarë të familjes e të cilit më pas i qenë vrarë babai dhe vëllai, policët serbë i kishin urdhëruar të zbresin nga autobusi gjashtë persona:

1. Ismet Islam Limani, lindur më 1946
2. Hajriz Bali Krasniqi, lindur më 1939
3. Bashkim Hajriz Krasniqi, lindur më 1967 (i biri i Hajrizit)
4. Sejdi Hajdar Sallahu, lindur më 1950
5. Agron Muhedin Kryeziu, lindur më 1967
6. Shpëtim Thaçi, lindur më 1975

Sipas fjalëve të Bajram Krasniqit, të lartpërmendurit i kishin bërë rresht dhe si duket, pas largimit të autobusit, menjëherë i kishin ekzekutuar, pasi i kishin ekzekutuar personat në fjalë kriminelët serbë u kishin kallur edhe kufomat për ta humbur krimin, më pastaj i kishin futur në një gropë.

Pas plot dhjetë muaj pritjeje të myderrizit qysh kur kishte dalë nga shtëpia, dhe deri më tani familja e tij kishin jetuar me të vetmen shpresë se ndoshta babai, vëllai e kushëriri i tyre do të gjendej diku, si shumë shqiptarë të tjerë, nëpër burgjet serbe. Mirëpo, shpresa e tyre përfundoi, kur ushtarët suedezë të KFOR-it më 25.02.2000 zbuluan një varrezë masive, ku kriminelët i kishin futur menjëherë pas ekzekutimit. Pasi që gjërat e gjetura në varrezën në fjalë u sollën në Institutin e Mjekësisë Ligjore, të afërmit e shehidëve bënë identifikimin vetëm me anë të disa gjësendeve, që ata i kishin pasur me vete dhe në bazë të disa pjesëve të rrobave që kishin mbetur pa u djegur.

Ekipi që ka bërë obduksionin e këtyre 6 shqiptarëve të vrarë është udhëhequr nga dr. Flamur Blakaj, mjek ligjor në Institutin e Mjekësisë në Prishtinë.

Pas identifikimit, më 3 mars 2000, iu dorëzua kufoma e myderrizit familjes për ta bë rivarrimin e tij në varrezat e fshatit Matiçan. Ishte ky një moment sa i pikëlluar, aq edhe madhështorë, sepse për t’i bërë

nderimin e fundit morën pjesë më se 2.000 veta , nga vendlindja e tij Presheva, Bujanoci, Prishtina, xhematlinjt e tij nga xhamia e Hajvalisë e shumë vende të tjera të Kosovës. Pas kryerjes së ceremonive fetare nga i ndjeri, në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, foli Mr. Qemajl ef. Morina. , i cili ndër të tjera, kishte thënë: "Me vrasjen e tij nga dora kriminale serbe, Këshilli i Bashkësisë Islame të Prishtinës dhe Bashkësia Islame e Kosovës humbën njërin ndër imamët më aktivë dhe më të zellshëm. I ndjeri la pas vetes bashkëshorten, djalin dhe katër vajza. Ngushëllimi i vetëm për ta është puna dhe angazhimi i tij për të mirën e përgjithshme.

Përfundimi

Myderriz Ismet ef. Limani jetoi dhe veproi në një kohë nga më të vështirat duke përfshirë vitet 1946 me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore deri me fillimin e demonstratave studentore dhe gjithë popullore të viteve 1981, gjithë ajo vuajtje e popullit shqiptar e përfshiu edhe myderrizin e njohur të asaj kohe dhe vazhdoi deri me përfundimin e trysnive, persekutimeve por edhe masakrimeve serbe të vitit 1998-99, ku edhe ra shehid Myderriz Ismet ef. Limani.

I lindur në fshatin Raincë të Preshevës, në një familje të nderuar e të respektuar, i edukuar dhe i formuar si intelektual i guximshëm për çështje fetare dhe kombëtare, ishte një figurë e dalluar në punën dhe aktivitetin e tij, falë dijës, guximit, drejtësisë dhe gjakftohtësisë së gërshetuar në vetë personalitetin e tij.

S'ka dyshim se në fushën e thirrjes, arsimit e të kulturës sonë fetare dhe kombëtare në Kosovë e më gjerë, zë vend të rëndësishëm edhe alimi-hoxha apo myderrizi i shquar, Ismet ef. Limani.

Gjatë tërë jetës së tij dha potencialin e fundit për përhapjen e fjalës së Allahut xh.sh. dhe të Dërguarit a.s.v.s. ai asnjëherë nuk u pajtua me ideologjitë komuniste e socialiste, e as me përkrahësit e tyre, Myderriz Ismet efendiu ishte njeri i Fesë dhe i Atdheut.

Emrin e myderriz Ismet ef. Limanit me epitetin më të lartë dhe me nder e respekt do ta bartë biblioteka në Xhaminë e Hajvalisë "Biblioteka Ismet ef. Limani". Këtë myderrizit ia kemi pasur borxh, për t'u treguar gjeneratave të mëvonshme se si ishte një misionar i Islamit edhe në ato ditë të cilat ishin nga më të vështirat.

E lusim Allahun xh.sh. që gjithë ata që ranë për lirinë e vendit tonë t'i pranojë në radhën e shehidëve, e lusim Allahun e Madhëruar që të na bashkojë në Xhenet me gjithë ata që dhanë më të shtrenjtën për lirinë e vendit tonë.

Literatura:

- Ramadan Shkodra-Sadik Mehmeti-Agim Gashi, *IMAMËT DËSHMOR-SHEHIDË Në luftën e fundit në Kosovë 1989/1999*, Monografi, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë 2010.
- Rexhep Abazi, *Kriminelët nuk kursyen as imamët*, "Dituria Islame", nr.142, Prishtinë 2002.
- S. Beqiri, *U Identifikuan 6 Shqiptarë të vrarë*, Gazeta "Rilindja", Prishtinë, 3 Mars 2000.
- Mr. Qemajl Morina, *Në mesin e të masakruarve edhe imami i Hajvalisë*, Gazeta "Koha Ditore", Prishtinë, 2 Mars 2000.
- H. Emërllahu, *U rivarros imami i Hajvalisë Ismet I. Limani*, Gazeta "Bujku", Prishtinë, 3 Mars 2000.
- Mr. Qemajl Morina, *Edhe një varrezë masive me viktima shqiptare*, Gazeta "Kosova Sot" Prishtinë, 2 Mars 2000.
- Xheladin Fazliu, *Imami që mbijetoj shumë sakrifica*, "Horizonti', nr 1, Prishtinë, f.9.
- Disa dorëshkrime të myderriz Ismet ef. Limanit, Biografi e pasardhësve të Profetit a.s si personalitete të shquara të fesë islame, të huazuara nga Suad Limani, djali i Myderrizit, Matiçan.
- Fotot janë marrë nga Suad Limani (djali i myderrizit Ismet ef. Limanit), Matiçan.

Intervistat dhe bisedat:

- Intervistë me Ridvan Sylejmanin, vëlla i myderrizit, bërë me 11.05.2010, Matiçan.
- Intervistë me Mr. Qemajl Morinën, bërë me 22.06.2010, Prishtinë.
- Intervistë me Prof. Bajrush Ahmetin, bërë me 10.06.2010, Prishtinë.
- Intervistë me Hajrullah Hoxhën, bërë më 08.06.2010, Prishtinë.
- Intervistë me Bajram Krasniqin, të cilit iu vranë babai dhe vëllai së bashku me myderrizin, bërë më 14.07.2010, Grashticë.
- Intervistë me Isë Makollin, xhematlinj i myderrizit, bërë më 18.07.2010, Hajvali.
- Intervistë me Shaqir Pacollin, xhematlinj i myderrizit, bërë më 2.06.2010, Hajvali.
- Intervistë me Selim Pacollin, bërë më 11.07.2010, Hajvali.
- Intervistë me Irfan Islamin ish-nxënës i myderrizit, bërë më 25.07.2010, Hajvali.
- Intervistë me Blerim Gashin ish-nxënës i myderrizit, bërë më 20.07.2010, Hajvali.
- Intervistë me Ekrem Kosumin ish-nxënës i myderrizit, bërë më 8.08.2010, Hajvali.
- Intervistë me Fuad Morinën ish-nxënës i myderrizit, bërë më 1.08.2010, Hajvali.
- Intervistë me Nazim Bajramin ish-nxënës i Myderrizit, bërë më 1.08.2010, Hajvali.
- Intervistë me Avdyl Pacollin ish-nxënës i myderrizit, bërë më 1.08.2010, Hajvali.

Refik Vitia

Muderiz ISMET ef. LIMANI (19.07.1946 – 12.05.1999)

(Summary)

Muderiz Ismet ef. Limani is an important personality in the field of Islamic education and culture in Kosova and further. His hard work makes the memory of him eternal. His teachings and sayings are still remembered. Thanks to his work, in particular his activities as the imam of the Mosque in Hajvalia as well as his activity as a teacher, a considerable number of youngsters from this village have become professionals in different areas: theologians, doctors, linguists, etc. I too, had the honor to be one of his pupils.

رفيق فيتيا

المدرس عصمت افندى ليمانى

حياته وأعماله (19.07.1946 – 12.05.1999)

(خلاصة البحث)

لا شك أن من بين العلماء الكوسوفيين الذى كان لهم تأثير ملموس في المجال الدعوى والتعليم هو العالم الشهيد عصمت افندى ليمانى. ان عمله الدؤوب وجهوده المضنية في اعلاء كلمة الله جعلنا نحن تلاميذه لا ننساه أبدا مهما بعدت الأيام. ان تضحياته الجمة وعمله المستمر بصفة خاصة كإمام و معلم و مؤدب بجامع قرية هيواليا جعل أن عدد كبير من الشباب والشابات يصل اعلى درجات التعليم العلمي مثل الأطباء و المعلمين و من حسن حتي أنني تلمذت عليه.

POEZI

Prof. dr. Adem Zejnullahu

POEZIA E MULLA VESEL XHELDIN GUTËS

1. Shqiptarët në rrjedhat historike

Historia e zhvillimit dhe formimit të shteteve të ndryshme në botë dëshmon se shumë popuj krijuan etnitetin e tyre kombëtar e fetar, duke u bazuar, në radhë të parë, në parimet e vetëdijes kombëtare ose të fesë. Në këtë vazhdë edhe shqiptarët nuk bëjnë përjashtim të madh.

Të dhënat historike dëshmojnë se faktori fetar me shekuj, në hapësirën e Gadishullit Ballkanik, nxiti konflikte të përmasave të mëdha etnike, të cilat u shndërruan në luftëra të përgjakshme ndërmjet fqinjëve.

Shqiptarët gjatë rrjedhave historike u ballafaquan me shumë vështirësi të ndryshme, të cilat kushtëzuan formimin e vonshëm të shtetit shqiptar, madje edhe sot e kësaj dite, jo në tërë hapësirën etnike. Një vonesë të tillë e shkaktoi robëria e gjatë shekullore e perandorive të mëdha si dhe aleancat e fshehta të shteteve fqinje, për copëtimin dhe rirobërimin e trojeve shqiptare.

Në këto rrethana të ndërlikuara meritë të veçantë në vetëdijesim kombëtar për formimin e shtetit shqiptar patën rilindësit, të cilët kishin vizion të qartë, për formimin dhe funksionimin e tij, krahas shteteve më të përparuara në Evropë e në botë.

Veprimtarinë kombëtare pas rilindësve e ndoqën edhe shumë figura të shquara të dijes, të kulturës, të shkencës, të fesë e të aksioneve luftarake deri në ditët e sotme, të cilët kontribuuan për çlirimin kombëtar të popullit tonë. Në këtë vazhdë një vend të rëndësishëm zë edhe figura e Mulla Vesel Xheladin Gutës. Veprimtaria letrare e këtij poeti bejtexhi deri vonë nuk ka qenë e njohur për lexuesin. Tani vonë u botua përmbledhja e tij me poezi *“Perëndia më frymëzoi”*.

Sipas krijimtarisë së tij poetike dhe kujtesës së popullit, ky hoxhë tërë jetën ia kushtoi ngritjes së popullit tonë në aspektin fetar e kombëtar. Ai në ligjëratat e tij foli me patos për Zotin e gjithëfuqishëm, krijuesin dhe sunduesin e gjithësisë, por edhe për kombin, për shtetin, për të vërtetën, për drejtësinë dhe për lirinë. Këtë përcaktim dhe frymëzim të denjë e dëshmon poezia e tij lirike në përmbledhjen *“Perëndia më frymëzoi”*, e cila u botua pas vdekjes së autorit, e që e morëm për shqyrtim.

2. Atdheu, feja, liria, frymëzimi

Titulli i veprës ngërthen në vete një simbolikë të shumanshme, që rrok dimension të gjerë e të thellë kuptimor e artistik, fetar e kombëtar, në kohë e në hapësirë të caktuar historike.

Jeta ka vlerat e saj të çmueshme, kur njeriu ato ka mundësi t’i kultivojë, t’i ruajë dhe t’i gëzojë. Për t’i pasur e gëzuar ato, ai duhet të angazhohet dhe të sakrifikojë shumë. Më të rëndësishmet në jetë janë **atdheu, liria dhe shëndeti**, pa të cilat jeta nuk e ka vlerën e vet. Poetët thonë, kur ka atdhe dhe liri, ka dashuri dhe ardhmëri, por kur këto mungojnë, atëherë ka: padituri, ëndrra, vuajtje, mjerim e zymtësi. Kjo ndjenjë, klithje dhe përkushtim e përshkon tërë poezinë e këtij poeti liridashës. Vepra e tij reflekton mesazhe e imazhe të caktuara fetare, jetësore, filozofike e kombëtare, të cilat bartin në vete porosi të caktuara për breznitë e ardhshme se si duhet formuar e dashur feja, atdheu, liria e kombi.

Perëndia e krijoi njeriun, duke ia dhënë aftësitë mendore e fizike për ta farkuar fatin e vet. Përvoja jetësore dëshmon se idealet dhe ve-

prat e mëdha nuk arrihen lehtë, për t'i realizuar ato duhet mund, sakrificë individuale e kolektive. Shqiptarët nëpër shekuj luftuan dhe sakrifikuan shumë për të mbijetuar në trojet e veta.

Mulla Vesel Xheladin Guta fuqinë mbinatyrore të Krijuesit të gjithësisë e ndien thellë në qenien e tij shpirtërore, andaj frymëzohet dhe e shpreh atë me anë të figurave stilistike në poezi. Pra, poezia e tij është frymëzuar në radhë të parë në mënyrë të drejtpërdrejt nga *Kur'-ani i madhëruar* dhe vlerat e shumta të tij, sidomos nga ato që flasin për vlerën e fesë, të lirisë, të kombit dhe të shtetit.

Po të vështrohet ligjërimi poetik i Mulla Vesel Gutës, nga pikëvështrimi i brendshëm dhe i jashtëm, del në pah e dhëna - se në këto vargje rrah fuqishëm pulsi jetësor e shpirtëror i njeriut tonë nëpër rrjedhat e ndryshme historike në mbarë hapësirën etnike. Vargjet e tij, ndonëse të përshkruara nga nota fetare, ato ngërthejnë në vete tematikë e motivikë shoqërore, që karakterizojnë kohën, hapësirën dhe periudhën e caktuar historike të popullit tonë, përpjekjet, luftërat dhe sakrificat e shumta për çlirim e pavarësim kombëtar.

Vepra "*Perëndia më frymëzo*i" e Gutës ndahet në tetë cikle poezish: *I. Vargje mbi besimin, II. Ecje gjurmëve të shenjta (kushtuar Muhamedit a.s.), III. Mbi librin e shenjtë, IV. Këngë shpirti (ilahi),V. Burimi i dritës, VI. Kulla e kushtrimit, VII. Mbi disiplinën shpirtërore dhe VIII. Drejt amshimit.*

Mund të thuhet se frymëzimet e këtij poeti në tërësi kanë burimin nga *Kur' ani i madhëruar*, që rrezaton tërë kompleksitetin e kësaj bote dhe të asaj pas vdekjes. Vargjet dhe strofat e kësaj poezie reflektojnë mesazhe për lexuesin, njeriun se nuk ka asgjë në jetë, që nuk e ka bazën në *Kur'an*, por dhe shpjegimin e vet të mirëfilltë.

Le t'i kthehemi opusit letrar të poetit për të parë disa nga frymëzimet e tij, të cilat në mënyrë të hollësishme pasqyrojnë ndjenjën e thellë të botës së tij të brendshme shpirtërore, për preokupimet e shumta fetare e kombëtare, që vijnë si valë deti e hyjnë në frymëzimet e këtij poeti bejtexhi, të cilat e rrëmbejnë si valët e detit: herë-herë të qeta e herë-herë të furishme, duke i formësuar ndjenjat dhe idetë në artikulim poetik.

3. Me penë e me pushkë kundër robërisë

Të shumta ishin hallet individuale e të përbashkëta të popullit tonë në kohën kur jetoi e veproi Guta. Ai me invencion të theksuar i shprehu ato në poezi, të cilat kanë kryesisht ngjyrim fetar, kombëtar, didaktik dhe utilitar. Në vargjet e tij gufon ndjenja e zjarrtë për të jetuar në liri, për ta kultivuar fenë lirshëm në pajtim me udhëzimet e *Kur'anit të madhëruar*, si dhe për t'u arsimuar e edukuar gjeneratat e reja në pajtim me dëshirat dhe synimet e kombit më të përparuar në botë.

Vargjet e këtij poeti shprehin fuqishëm revoltën kundër regjimeve të huaja pushtuese. Ato reflektojnë kundërshti të thella ndërmjet poetit, në një anë, dhe, në anën tjetër realitetit të hidhur jetësor e historik që zë fill në përplasje me parimet e Gutës, qysh në fëmijërinë e tij të hershme, atëherë kur ai filloi ta shijojë bukurinë dhe vrazhdësinë e jetës, që rëndoi si ortek bore, i rëndë mbi supet e tij. Ishte kjo koha e rëndë e robërisë së regjimeve të huaja, që shkaktonin të gjitha të këqijat mbi popullin shqiptar. Kjo figurë e shquar me anë të ligjëratave dhe shkrimeve të tij, denoncoi me kohë pa kompromis të gjitha padrejtësitë e ndryshme, që i shkaktonin individët, shoqëria e sidomos aparati shtetëror serb ndaj shqiptarëve. Ai thoshte se drejtësia si parim jetësor e shoqëror ka përmasa gjithënjerëzore-universale, të cilën duhet ruajtur e kultivuar me përkushtim, sepse është virtyt i shoqërive të qytetëruara.

ta lana gafletin
n' gjum mos t' rrina ma
se jashta drejtsijes
tjeter pshtim nuk ka.[1]

Qëndrimin filozofik, fetar e kombëtar të Mulla Vesel Xheladin Gutës, përballë dhunës së shtetit okupator serb, e shpreh poezia dhe pjesëmarrja e tij aktive, e drejtpërdrejt në mbrojtjen e vijës kufitare, më 1941 në fshatin Tërrnoc afër Bujanocit. Ky hoxhë në këtë kohë,

[1] Mulla Vesel Xheladin Guta, *Perëndia më frymëzoi*, Focus – Shkup. Vjersha: *N' goni ej vllazen e t' par*, f. 36.

kur ishte në rrezik vendi, i bëri thirrje popullit, besimtarëve, patriotëve, liridashësve që të lënë shtëpitë e xhamitë dhe të rrokin armët për të mbrojtur atdheun në kufi. Edhe vetë, i pari mori armën dhe shkoi në vijën e parë të frontit, duke e konsideruar vdekjen për atdhe si detyrë-borxh fetar, moral e patriotik e kombëtar. Në këtë betejë të përgjakshme Mulla Xheladin Guta u plagos rëndë. Mesazhin dhe imazhin e kësaj lufte e paraqesin këto vargje:

hade shokë
e vllazni
per vatan e per liri
t' besatum jem te tan
per me deken me dushman
Zoti i Madh t' lumi Ty
t' ri e t' vjetër e sabi
se rahmetin t' madh e ki
me gzim jemi na tuj shku
kufirin dona me ru…[2]

Për Gutën dashuria ndaj atdheut është mbi të gjitha, ngase atë e thotë edhe *Kur'ani i madhëruar*, që për liri të popullit duhet shpenzuar tërë pasurinë, tërë mundin dhe sakrifikuar jetën, sepse në atë mënyrë fitohet dhe përjetësia.

s' kemi kçyr shka ka n' Kur'an
qysh me liftu per vatan
mall e shpirt me dhan
e me liru popullin ton[3]

Dimension tjetër, që shenjëzon poezinë e Vesel Xheladin Gutës, është **njësimi** i popullit për një ideal të lartë fetar e kombëtar. Vizioni i tij për çështjen fetare e kombëtare trajtohet në një numër të konsideruar të poezive. Ai në unitetin e popullit shihte forcën mbrojtëse, prosperitetin dhe vetëdijesimin për çështjen fetare dhe kombëtare. Ndërkaq, ndarjen nëpër parti të ndryshme e ndjente si pikë të dobët të

2 *Vepra e cituar*, f. 107.
3 *Vepra e cituar*, f. 99.

shqiptarëve, të dhembshme, që dëmtonte kauzën e përgjithshme kombëtare, veçanërisht në periudhat më delikate të historisë, siç ishte ajo gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore.

Shok e t' par e vllazni
Mos t' punojm me parti
Se na ban kjo zemer zi
E nuk mujm me pas liri
Partin s' ban me permen
Kta ta hupim n' paçim men.[4]

Popullit shqiptar gjatë historisë, të këqijat më të mëdha i erdhën nga pushtuesit e huaj, e veçanërisht nga serbët, të cilët në vazhdimësi plaçkitën, dogjën, vranë dhe shpërngulën me dhunë popullin tonë nëpër vende të tjera, me qëllim të caktuar që në trojet shqiptare të mos ketë shqiptarë. Këtë zezonë, Mulla Veseli e vërejti me kohë, andaj e denoncoi fuqimisht në poezitë e tij, duke bërë thirrje të hapur për luftë e sakrificë mbinjerëzore.

krejt shka kem dona me shkri
e do t' vdesim per liri
o me mir deka se robin
n' tokë t' kurkujt s' kena hi
kta n' drejt tan mu faru
venin ton s' kena me lshu[5]

4. Martirizimi si akt madhor

Vesel Xheladin Guta thekson se vdekja për atdhe është sikur të rilindësh, ngase është vdekje e amshuar, të cilën e lakmon shumëkush. Martirizimin për liri - *shehidët, (dëshmorët)*, i lavdëron edhe Zoti me *Kur'an*. Guta në vargjet e tij që kanë bazë kur'anore të gjitha vlerat e botës shpirtërore dhe materiale i adreson në emër të dëshmorëve, sepse ata i meritojnë të dyja botët.

4 *Po aty*, f. 103.
5 *Po aty*, f. 105.

halbuki asht shkru n' Kur' an
N' dashi t' vdeken mos me kan
hem me pas erz e iman
hem me kan suntar n' ven tan
N' gjyn me gjak per vatan.[6]

Po të vështrohen vargjet e lartshënuara nga rrafshi informativ e kuptimor, shihet qartë se komponentët fetarë e kombëtarë kanë shenja të barazimit në vargjet e poezisë e të veprimtarisë së këtij poeti bejtexhi. Ato i ndërrojnë prore vendet. Korrespondojnë natyrshëm ndërmjet vete, me fije të dukshme, duke e plotësuar, fuqizuar, avancuar dhe funksionalizuar njëra-tjetrën si një tërësi e vetme që ka për qëllim kryesor kultivimin e dashurisë ndaj atdheut dhe çlirimin e popullit nga sundimi i huaj. Kjo porosi e poezisë së Gutës është shprehje e një ndjenje të thellë patriotike e qytetare e vetëdijes së një populli në aspektin e forcimit të besimit fetar e kombëtar, ashtu dhe të ngritjes së përgjithshme arsimore e kulturore.

Frymëzim i veçantë në një numër të konsideruar të poezive të Mulla Vesel Xheladin Gutës janë vlerat e shumëfishta të Kur'anit të madhëruar dhe figura e Muhamedit a.s. Në këtë prizëm ai sheh dhe këndon bukurinë dhe vrazhdësinë e kësaj bote dhe mrekullitë e botës tjetër për njerëzit, që i meritojnë t'i kenë e t'i gëzojnë të dy këto bota.

Në disa poezi të kësaj përmbledhjeje, Guta shpreh ndjenjën e dhembjes për copëtimin e trojeve shqiptare, siç ishin: Sanxhaku i Nishit, Çamëria etj., për tragjedinë dhe gjenocidin e popullit tonë, që pësoi në këto krahina në të kaluarën nga armiqtë tanë. Për poetin Guta, robëria dhe copëtimi i tokave të atdheut janë të këqijat më të mëdha, andaj poeti zëshëm i drejtohet me lutje Zotit që ta shpëtojë popullin shqiptar nga robëria dhe copëtimi i tokave të tyre.

e lutmi shum Perenin
ta gzojm token ton daim
na shiptart çi jem n' ket din
e lutim Zotin ja Rahim
kthenaj lirin ja Kerim[7]

[6] *Po aty*, f. 98-99.
[7] *Po aty*, f. 108.

Në fund mund të themi se kjo poezi, me të gjitha të metat që hetohen, sidomos në aspektin gjuhësor e stilistik, në artikulimin poetik të vargjeve e të strofave, shënon një kualitet më të lartë në krahasim me pararendësit e tij bejtexhinj, si në aspektin e frymëzimit, ashtu dhe të formësimit artistik. Kjo poezi, edhe pse e shkruar me alfabetin arab, shquhet për mendim të thellë filozofik, ligjërim të artikuluar poetik, të veshur me një petk folklorik, por me një procedim të rrjedhshëm revolucionar e patriotik që si poentë kanë **atdheun-fenë-kombin**, si determinantë kryesore, që nënkupton se njëra pa tjetrën nuk bën, nuk funksionon, nuk ka vlerë, madje as jeta s'është jetë, as feja s'është fe, as shteti s'është shtet, pa të tria si një e tërësishme.

Prof. dr. Adem Zejnullahu

THE POETRY OF MULLAH VESEL XHELEDIN GUTA

(Summary)

1. Albanians throughout history

The history of the development and formation of different states throughout the world shows that many nations created their national and religious identities based on (primarily) the principles of national or religious consciousness. The Albanians are no exception to this.

History bears testimony to the fact that religious factors incited ethnic conflicts, which turned into bloody wars between neighbors in the Balkans throughout the centuries.

آدم زين الله

شعر ملا واصل جلادين غوتا

(خلاصة البحث)

الالبان في مجرى التاريخ

ان تطوير و تشكيل الدول المختلفة فى العالم يشهد بأن تكوين القومي والديني اعتمد على مبادئ الوعي القومي أو الديني. و في هذا الاطار لا يمكن استثناء الشعب الالباني.

ان المراجع التاريخية تشهد بان العامل الديني عبر القرون لعب دورا مهما لدى شعوب البلقان هو سبب في صراعات قومية التى تحولت الى حروب واسعة نطاق ودامية بين الجيران.

PËRVJETOR

Sadik Mehmeti

JEHONA E PËRKTHIMIT TË PARË KOMPLET TË KUR'ANIT NË SHTYPIN SHQIPTAR[1]

Sikurse dihet, ndikimi i Kur'anit në jetën e shqiptarëve është i pranishëm që nga shek. XV, por idenë për përkthimin e Kur'anit në gjuhën shqipe e gjejmë që në kohën e Rilindjes Kombëtare, kur *Ilo Mitko Qafëzezi*, më 1921, kishte botuar të përkthyera në shqip 6 suret e para të Kur'anit. Më vonë, nismëtarë për përkthimin e Kur'anit do t'i gjejmë dy personalitete të shquara në fushën e islamologjisë, por dhe në fushën e atdhetarizmit: *Hafiz Ali Korçën* dhe *Hafiz Ibrahim Dalliun.* Përpjekjet për të përkthyer Kur'anin në gjuhën shqipe kanë vazhduar edhe më 1944, kur qe bërë edhe një përkthim, i cili nuk arriti të botohej, sikundërqë nuk u botua as përkthimi i *Vehbi Ismailit* në SHBA dhe ndonjë tjetër.

Qershori i vitit 1985 ndërkaq, shënon njërën nga ngjarjet më të rëndësishme të kulturës islame në gjuhën shqipe, sepse për herë të parë në Prishtinë u botua përkthimi i Kur'anit në gjuhën shqipe.

[1] Kumtesë e lexuar në Shtëpinë e Kulturës "Xhemajli Berisha" në Prizren, më dt. 30.04.2010, me rastin e shënimit të 25-vjetorit të përkthimit të parë komplet të Kuranit në gjuhën shqipe.

Këtë fat e pati *Feti Mehdiu*, i cili, pas një pune disavjeçare, shqiptarëve u ofroi përkthimin e Kur'anit në gjuhën e tyre, të cilin përkthim e botoi Kryesia e Bashkësisë Islame në Prishtinë[2].

Përkthimi i parë komplet i Kur'anit në gjuhën shqipe ndonëse nga besimtarët myslimanë shqiptarë qe pritur shumë mirë, dhe ndonëse interesimi për të pasur një ekzemplar të tij ishte jashtëzakonisht i madh, sa që *atë botë ky ishte libri më i kërkuar në Kosovë*, megjithatë, në shtypin shqiptar nuk pati ndonjë jehonë të theksuar.

Shtypi shqiptar që botohej në Kosovë, nuk i kushtoi ndonjë vëmendje këtij përkthimi, dhe këtë nuk e bëri as shtypi shqiptar jashtë kufijve të Kosovës.

Duke shfletuar shtypin shqiptar, del përshtypja se interesimi për këtë përkthim të Kur'anit u bë me mjaft vonesë.

Pavarësisht rrethanave dhe arsyeve që kanë ndikuar për këtë fakt, shkrimet në shtypin shqiptar për përkthimin e parë komplet të Kur'anit në gjuhën shqipe duhet ndarë në dy periudha.

Periudha e parë nga viti i botimit 1985 e deri më 1992, kur kemi vetëm dy shkrime dhe atë vetëm në Kosovë dhe *Periudha e dytë* nga viti 1992 e këndej, ku kemi një mori shkrimesh në shtypin shqiptar, jo vetëm në Kosovë, siç ndodhi në periudhën e parë, por gjithandej trojeve shqiptare.

Në të vërtetë, dy vjet pas botimit të Kur'anit të përkthyer në gjuhën shqipe, d.m.th. në vitin 1987, në gazetën *"Rilindja"*, e cila, megjithëse ishte nën ndikimin e politikës zyrtare të kohës, u botua shkrimi i parë për përkthimin e parë të Kur'anit në gjuhën shqipe[3].

Në qoftë se bashkëkombësi ynë i fesë krishtere Ilo Mitko Qafzezi më 1921, ishte i pari që bëri një përpjekje serioze për të përkthyer Kur'anin në gjuhën shqipe, një bashkëkombës tjetër, po i fesë krishtere nga Prishtina, prof. dr. Engjëll Sedaj, ishte i pari që shkroi në shtypin shqiptar për përkthimin e parë të Kur'anit në gjuhën shqipe.

[2] "Kur'an-i", përktheu Feti Mehdiu, botoi Kryesia e Bashkësisë Islame për RSS, Prishtinë, 1985.

[3] Engjëll Sedaj, Duke lexuar Kuranin në gjuhën shqipe, në gazetën "Rilindja", e shtunë 14.02.1987.

Ky artikull nën rubrikën *“Mbresa”*, mban titullin *“Duke e lexuar Kur’anin në gjuhën shqipe”*. Kurse shkruesi i tij, mbetet autori i parë në shtypin shqiptar që ka shkruar për përkthimin e parë të Kur’anit në gjuhën shqipe. Sigurisht që ky shkrim ka simbolikën e vet dhe fletë për marrëdhëniet e mira dhe tolerancën ndërfetare te shqiptarët jo vetëm në Kosovë.

Në vitin 1986 në vjetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës *“Takvim”* do të botohet edhe një vështrim kritik nga Emin Behrami[4], të cilit, një vit më vonë, do t’i përgjigjej përkthyesi dr. Feti Mehdiu[5].

Ndonëse kjo periudhë ishte fare e varfër, vitet që do të pasojnë, në shtypin shqiptar gjithandej ku jetojnë shqiptarët, do të vërshojnë lajme, informata, analiza, komente e vështrime për përkthimin e parë të Kur’anit në gjuhën shqipe, madje do të bëhen edhe disa intervista me përkthyesin dr. Feti Mehdiu.

Në këtë periudhë, në revistën *“Dituria Islame”*, do të botohet një vështrim për përkthimet e Kur’anit nga aspekti gjuhësor nga prof. *Isa Bajçinca*[6], ku një pjesë do t’i kushtojë edhe përkthimit të parë. Ky vështrim pasohet nga një reagim i prof. dr. Mehmet Halimit[7], po në “Dituria Islame”.

Në vitin 1999 në gazetën “Flaka”, që del në Shkup, do të botohet një intervistë me prof. dr. Feti Mehdiun, përkthyesin e parë të Kur’anit komplet në gjuhën shqipe[8].

Në vitin 1999, Dr. Feti Mehdiu e botoi për herë të dytë përkthimin e tij të Kur’anit me disa përmirësime, në këtë rast këtë përkthim e quajti me një titull shumë domethënës *“Kur’ani dhe Hija e tij shqip”*[9].

[4] Emin Behrami, Vështrim Kuranit të përkthyer në gjuhën shqipe nga Feti Mehdiu, në: “Takvim”, Prishtinë, 1986, f. 148-160.

[5] Feti Mehdiu, Për Kur’anin me Kur’an, në: “Takvim”, 1987.

[6] Isa Bajçinca, Mbi përkthimin e Kur’anit në gjuhën shqipe, në: “Dituria islame”, nr. 36, Prishtinë, 1992, f. 21-25.

[7] Mehmet Halimi, Vështrim i vonuar, por i dëshiruar, në: “Dituria Islame”, nr. 38, Prishtinë, 31-33.

[8] Intervistë me Prof. Dr. Feti Mehdiun, studiues dhe profesor i gjuhës arabe në Universitetin e Prishtinës, Kur’ani bosht i literaturës islame, në: “Flaka”, e shtunë 11-12 dhjetor 1999, Shkup.

[9] “Kur’ani dhe Hija e tij shqip”, përktheu Feti Mehdiu, botoi Logos A-IHH, Stamboll 1999.

Duke pasur parasysh se në këtë kohë qenë krijuar rrethana të reja për shqiptarët, ky botim pati një jehonë të madhe. Atë që s’e bëri shtypi shqiptar për botimin e parë, sikur u mundua ta lajë me rastin e ribotimit të këtij përkthimi.

Kështu shkrime për këtë ribotim do të hasim në gazetat ditore që botohen në Prishtinë, si “Rilindja”, “Zëri, “Drita”, “Kosova Sot”, dhe në gazeta të tjera. Gjithashtu u shkrua po thuajse në të gjitha gazetat shqiptare që botoheshin asokohe në Kosovë edhe për promovimin e këtij përkthimi që u mbajt në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Prishtinës[10].

Në vitin 2005 kur u bënë 20 vjet nga përkthimi i parë i Kuranit në gjuhë shqipe, në organizim të *Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës*, në Prishtinë u mbajt një sesion shkencor me temën bosht *“Kurani tek shqiptarët”*, ku u bë fjalë edhe për përkthimin e parë të Kur’anit në gjuhën shqipe.

Po në këtë vit u bënë edhe disa intervista me përkthyesin e Kur’anit, nga revistat “Mendimi Islam” që botohet në Prizren, “Argumenti” (mars 2006, f. 24-25) në Prishtinë, “Këshilla” në Tiranë, kurse shtypi ditor, përveç si informacion, botoi një vështrim të Ramadan Shkodrës me titull *“20-vjet të përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe (1985-2005)”*, i cili vështrim u botua po thuaj në të gjitha gazetat e Prishtinës dhe u plasua në ueb-faqe të ndryshme. Ky shkrim u botua në “Zëri”, “Epoka e Re”, “Dituria Islame”, “Java”, “Kosova Sot”, etj., po edhe në Shqipëri, si në revistën “Universi” etj.[11]. Ramadan Shkodrës i takojnë meritat kryesore se në shtypin shqiptar të këtyre viteve gjejmë informata dhe shkrime për përkthimin e parë të Kuranit në gjuhën shqipe.

[10] Shih p.sh. shkrimet: V. Veliu, Kur’ani dhe hija e tij shqip, në: “Rilindja”, Prishtinë, dt. 12.8.2000, R. Shkodra, Doli nga shtypi botimi i dytë “Kur’ani dhe hija e tij shqip”, në: “Dita”, e enjte 13 korrik 2000; Habib Zogaj, Latinët, Kur’anin e përkthyen qysh në vitin 1141, në: “Kosova sot”, 28.04.2000, etj.

[11] Ramadan Shkodra, 20-vjet të përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe (1985-2005), si për shembull në: “Epoka e re”, e shtunë 2.7.2005; I njëjti, në: “Kosova sot”, e shtunë-e diel 25-26 qershor 2005; I njëjti, në: “Dituria Islame”, nr 179, Prishtinë, 2005, f. 31-33, si dhe në gazeta e revista të tjera.

Për përkthimin e parë të Kur'anit në gjuhën shqipe si një ngjarje e madhe, si në rrafshin fetar ashtu edhe në atë kulturor e shkencor, sigurisht që ka informacione dhe shkrime edhe në ndonjë gazetë a revistë tjetër me karakter lokal, që këtu për arsye të kuptueshme edhe mund të mos jenë përmendur. Nga ana tjetër, në faqe të ndryshme të internetit ka informacione të bollshme për këtë përkthim.

Nga sa u tha më sipër mund të përfundojmë se:

- Numri i shkrimeve, informatave, intervistave, vështrimeve të botuara në shtypin shqiptar për përkthimin e parë komplet të Kur'anit në gjuhën shqipe, dëshmon për një interesim të vazhdueshëm për këtë përkthim.

- Në periudhën e parë 1985-1992, ky përkthim më shumë jehonë ka pasur në shtypin që botohej në gjuhën serbokroate në ish-Jugosllavi[12] dhe në shtypin arab sesa në shtypin shqiptar që botohej asokohe gjithandej ku jetojnë shqiptarët.

- Në periudhën e parë, edhe pse jo përmes shtypit, jehona për botimin e këtij përkthimi të Kur'anit përhapej me shpejtësi drite nga goja në gojë, nga veshi në vesh, nga zemra në zemër..., për të flitej me të madhe në oda e mexhlise të ndryshme, në hydbet dhe në qyrsitë e xhamive.

- Në periudhën pas 1992 shkrimet për këtë përkthim janë të bollshme dhe të natyrave të llojllojshme, megjithëkëtë për këtë përkthim ka nevojë dhe duhet të shkruhet edhe më shumë.

- Dhe fare në fund, përkthyesit të parë të Kur'anit në gjuhën shqipe, akademik Feti Mehdiut i qoftë hallall, jo pse hyri në histori, por sepse e bëri historinë, duke na dhënë një përkthim solid të Kur'anit në gjuhën tonë dhe kështu ua mundësoi bashkëkombësve të tij që ta lexojnë dhe ta kuptojnë Librin e Allahut në gjuhën e tyre.

---

[12] ***, Prevod Kur'ana na albanskom jeziku, në: "Glasnik", nr. 4/1985, Sarajevo; Idriz Demirović, Događaj albanske kulture, në: "Glasnik", nr. 5/1985, Sarajevë, ***, Kur'an na albanskom, në: "Glas koncila", nr. 45, dt. 10 nëntor 1985, Kur'an na albanskom, në: "Islamska misao", nr. 85, Sarajevë, 1985; Deset najtraženi knjiga, në: NIN", Beograd, 12 janar 1986; Darko Tanasković, Prvi prevod Kur'ana, në albanski, në: "Kultura istoka", 1986 etj.

Sadik Mehmeti

THE ECHO OF THE FIRST COMPLETE TRANSLATION OF THE QUR'AN IN THE ALBANIAN PRESS

(Summary)

The Qur'an started influencing the lives of the Albanians in the XV century. The idea to translate the Qur'an into Albanian first appeared during the period of the Albanian National Renaissance, in 1921, when *Ilo Mitko Qafëzezi*, published the first 6 Sura of the Qur'an translated into Albanian. The first ones to initiate the translation of the Qur'an into Albanian were two distinguished personalities in Islamology and great patriots: *Hafiz Ali Korça* and *Hafiz Ibrahim Dalliu*. The efforts to translate the Qur'an into Albanian continued during 1944, when a translation was made but could not be published. The latter was also the case with the translation of *Vehbi Ismaili* in the USA.

صادق محمتی

صدى ترجمة الأولى لمعانى القرآن بالكامل في الصحافة الألبانية

(خلاصة البحث)

كما هو معروف أن تأثير القرآن الكريم في حياة الشعب الألباني يبدأ من القرن الخامس عشر الا أن افكار لترجمة معانيه الى اللغة الألبانية تبدأ في عصر النهضة عندما قام الو متكو جافززى سنة 1921 بترجمة ست صور للقرآن الكريم. فيما بعد المبادرات للترجمة معانى القرآن الكريم من قبل العلماء المسلمين مثل الحافظ علي كورشا و الحافظ ابراهيم داليو. ان محاولات لترجمة معانى القرآن الكريم الى اللغة الألبانية استمرت حتى سنة 1944 عندما اكتمل ترجمة معانيه الا أنه لم يتم طبعه كما لم يتم طبع ترجمة معانى القرآن الكريم الذى قام به الامام وهبى اسماعيل فى الولايات المتحدة. الا أنه في شهر يونيو سنة 1985 سجل حدثا مهما في الثقافة الاسلامية واللغة الالبانية لأنه تم طبع أول ترجمة كاملة لمعانى القرآن الكريم بمدينة بريشتينا.

VËSHTRIME

Elez Osmani – New York

GAZALI "FLISTE" SHQIP PARA 50 VJETËSH - ME PENDËN E AHMET RAMOS*

Z. Ahmed Ramo kujtoj se është përkthyesi i parë i një vepre të Gazalit në gjuhën shqipe. Ai më 1959 e boton në Romë librin e tij të përkthyer **"Nga përtëritja e diturisë fetare-Balsami i lumturisë"** nga Ebu Hamid El Gazali (1058-1111). Librin e ka përkthyer nga gjuha angleze. Në fakt publicisti i shquar amerikan **Claud Field** e kishte përkthyer veprën e Gazalit "**Kimjai saadet**" që në vitin1909 nga gjuha persiane, në gjuhen angleze duke e titulluar si **"The Alchemy of happiness**". Siç dihet Gazali e kishte shkruar veprën e tij voluminoze **Ihjau ul umuddin** në gjuhën arabe, më vonë nga i njëjti brumë, por në një version të shkurtër, ai e kishte shkruar në gjuhën persishte veprën e cituar, e cila ishte shume e përhapur. Në gjuhën angleze janë edhe dy përkthime tjera të botuara e të kësaj vepre: **Henry A.Homes** e ka përkthyer nga **gjuha turke "Alchemy of happiness by Mohammed al Ghazali the Mohammedan philosopher"** dhe tjetri nga **Muhammad Nur Abdu Salam Al Ghazzali On Knowing Yourself and God** që e ka përkthyer nga gjuha persiane. Abdu Salam e kritikon përkthimin e Field për mangësi në tekstin e tij. Ndërkaq Hommes .....Që të tri përkthimet ndryshojnë dukshëm nga njeri-tjetri.

Sidoqoftë, Ahmet Ramo kishte lexuar përkthimin e Fieldit dhe kishte provuar që lexuesit shqiptar në diasporë t'i vërë në dispozicion mendimet filozofike të Gazalit. Libri i Feld-it ka tetë kapituj dhe libri ka....faqe. Por, Ahmet Ramo ia shton edhe pjesën e dytë. Siç na thotë vetë në parathënien e tij "Bisedë rreth subjektit" "pjesa e dytë është një përmbledhje e një përkthimi në anglishten prej një savanti pakistanez, z. Sejid Navab Ali, nga Ihja el ulumi. Duke qenë që të dyja po prej një burimi, i nënshkruari (A.R) tërhoqi ato më interesantet të udhëzimit jetik, si dhe ato që merren me skenat intelektuale dhe shpirtërore të kategorisë ordinere...f.18") Kështu që Kimjai Saadet –Ballsami i lirisë "në gjuhen shqipe është paksa më i zgjeruar.

Mendojmë se përkthimet e tij nga gjuha angleze, kishin një qëllim madhor. Ai dëshironte për ta përforcuar të vërtetën se Islami është universal e jo një besim që u përqafua vetëm nga orienti. Punimet e Ahmet Ramos, serioze e pasuruan literaturën fetare në gjuhen shqipe, të cilës me mjaft sukses i printe Imam Vehbi Ismaili. Ato ngritën cilësinë e saj në pikëpamje teorike dhe qenë një tregues i aftësive të tij punuese e intelektuale. Ai provoi të mbajë të ndezur shkëndijën atdhetare, letrare e fetare, ta ushqente e ta kristalizonte me stilin dhe gjuhën e tij që ai e quan "*atë shqipen e dëgjuar prej mëmave n'Atdheun e lindjes"*

Kush ishte Ahmet Ramo?

Përkthimet dhe shkrimet e tij të japin të kuptosh se ka pasur një sens të shquar intelektuali. Njihte mirë gjuhën angleze dhe kishte njohuri fetare. Kureshtja na shtynte që të mësonim diç më shumë për të. Ndaj, duke shfletuar faqe gazetash të kohës dhe libra të ndryshëm, kemi arritur disi që të sigurojmë disa të dhëna për jetën e këtij intelektuali dhe besimtari të devotshëm, që ka jetuar dhe vepruar në disa qytete të Amerikës.

* Ky punim është botuar në gazetën "Dielli" në New York, v. 2010.

Ahmet Ramo u lind në Tragjaz të Vlorës nga fillimi shekullit XX. Në Amerikë erdhi ende pa i mbushur të njëzetat e moshës së tij. Ai posa zuri punë dhe u stabilizua një fije, filloi të shkojë natën në shkollë dhe e mësoi gjuhën angleze shumë mirë, për ta shkruar dhe për ta lexuar. Ai ishte i pasionuar pas librit dhe kohën e lirë e kalonte nëpër biblioteka duke lexuar literaturë të ndryshme në gjuhën angleze, e në veçanti atë Islame. Lexonte me vëmendje përkthimin e Kur'anit dhe kishte marrë një njohuri të mirë për Islamin.

"Ahmet Ramo ishte iniciatori dhe frymëzuesi i themelimit të Shoqërisë Myslimane Shqiptaro-Amerikane, me qendër në Detroit, më 1945, e cila më soli mua, shkruan Imam Vehbi Ismaili, si udhëheqës fetar...Ahmetin, thotë ai, e njoha shumë mirë, meqë vitin e parë pasi erdha këtu banuam së bashku, derisa u martova. Ishte i pastër në shpirt dhe në veshje, bujar, i dashur dhe patriot idealist. Ka ndihmuar materialisht dhe moralisht shumë shqiptarë që filluan të vinin në Detroit, që linin atdheun për të shpëtuar nga komunizmi enverist"

Biografia e tij, disi më mirë kompletohet nga artikujt që i kemi gjetur të shkruar në "Dielli". Por, disa të dhëna i ka shkruar edhe vetë me rastin e botimit të librit "Balsami i lumturisë", të cilin ai e përktheu. Ai shkruan:

"Kur po liparitja në një bibliotekë të Nju-Jorkut, më zuri syri titullin e një libërze "The Alchemy of happiness", që shqip mund ta quash ilaçi ose balsami i lumturisë. Titulli i saj më magjepsi se s'ka njeri që të mos dojë lumturinë sado që dendur e kërkojmë atje ku nuk gjendet. Fillova t'a lëçit me një shije dhe etje shpirtrore aqë sa i a kapërxen shijes që ndjen një i ri kur është duke leçitur ndonjë rumancë të zjartë. Humba krejt n'të, gjersa m'u hoq vrejtja se biblioteka po mbyllej dhe jo vetëm kaqë, po më pat shkuar edhe ora e punës.

U largova prej atij qyteti dhe kudo që vejë vizitoja bibliotekat, por *Balsami i Lumtërisë* s'gjëndej gjëkundi. Kaluan vitrat me rrëmbim, filloi pleqërija, dhe bashkë me këtë edhe sëmundjet. Një ditë kur po rrijë i murzitur dhe në mendime, më vjen Imam Vehbiu me një libërzë në dorë dhe më thotë, "T'a solla 'Kimja-i-Saadet-in", mbasi ay është emri origjinal i librës, dhe shton, "Ke dashur t'a shohish të shqipëruar.

Mbaro-je vetë atë punë". M'erdhi si atij që takohet me ndonjë mik që e ka kërkuar tërë jetën. E leçita disa herë dhe aqë herë më tepër më shtoi zellin t'i vihem përkthimit.

Pothuaj në një vit përkthimi u'plotësua, dhe në të njëjtën kohë ndjeva se qënkesh edhe shëruar. Me të vërtetë, në kohën që qeshë duke u dergjur, studimi i kësaj libre më bëri të harroj ndjenjat dhe lëngatat e kësaj bote. Sufitë thonë, "Kur njeriu harron hallet e tij atëjere flet vetë Perëndija për 'të". Të hedhurit e mëndjes në bukuritë abstrakte qënka një antidotë që kartharis (spastron) mëndjen e njeriut nga ndjenjat egoistikë të kësaj bote. Kjo vërtetohet jo vetëm me të thënat e profitvet që Gazaliu i quan psikollogët e shpirtit, por, kur t'u kemi vënë veshin pasojave të bëmjeve t'ona, vërtetësija e saj s'na lë dyshim".

Ahmet Ramo ishte larguar nga Nju-Jorku dhe kishte shkuar në Detroit. Atje së bashku me të tjerët e kishin formuar Shoqërinë Shqiptare Myslimane, ku ishte edhe anëtar i Këshillit drejtues. Pastaj zëvendëseditori i revistës së saj "Jeta Myslimane Shqiptare". Ishte shumë aktiv, i papërtueshëm i shkathët. Ata që e njohën Ahmetin, sot është vështirë t'i gjesh. Shumica kanë vdekur edhe nëse është ndonjë, nuk dihet se kah janë të shpërndarë nëpër shtetet e Amerikës. Megjithëkëtë, **e kam** kontaktuar publicistin e njohur, **Idris Lamajn,** që jeton në Nju-Jork dhe më tha: "E kam njohur personalisht Ahmetin...ani pse ka vdekur që 40 vjet, e më shumë e mbaj mend se ishte fisnik, mendjemprehtë, energjik i papërkulur, i dashur dhe bujar. Ishte i pendës. Dinte pse punonte dhe për çka punonte. Kishte dashuri dhe besim të patundur te Zoti"

Më shumë nuk arritëm të mësojmë për të apo familjen e tij, por fundi i jetës së tij është pasqyruar në gazetën "Dielli" në mënyrë dinjitoze, me ç'rast jepen edhe dromca të ndryshme nga jeta e tij.

Gazeta “Dielli” për Ahmet Ramon

Në një artikull qendror ***“Dy Shoke teVjeter*** në gazetën “Dielli” ***“R.XH.Gurrazezi***, duke përkujtuar shëmbëlltyrën e tij shkruan kështu:

“...Këtu do të flas pak dhe për një shqiptar tjatër të vjetër që u muar shumë a pakë me lëvizjen shqipëtare n'Amerikë. Ky është Z. Ahmet Ramo, i cili më të rrallë përdorte llagapin “Gjon Varfi,” dhe ish nga Tragjasi i Vlorës. Kish kohë të gjatë n'Amerikë, dhe ish në moshë të lashtë. Në vjetët e fundit vuante nga shëndeti, dhe vdiq në Kenosha, Vis, në Jenarin e shkuar, po varrimi i tij u-bë në Chicago.

Në letrën e fundit që më dërgoi nga Kenosha në nëntorin e shkuar, shënonte se të nesërmen do të vinte në Chicago bashkë me z. Kalosh Hamdia për të marrë pjesë në festën e Ditës së Flamurit, ku atje do të takojnë dhe z. Xhafer Deva nga Kalifornia. Përveç të tjerave, më thosh dhe këto në letrën e tij: “Jam i pa mundur dhe allergie. Duart i kam të pira (mpira) dhe gjakun lart...Na kënaqe tepër me artikujt që shkrove te Dielli...Po munde doku ndo njëherë...” Më vjen keq që s'vajta dot!

Z. Ahmet Ramo qe Shqipëtar i mirë, dhe fetar i dedikuar. Besonte në kombësi edhe në fe, po s'qe “shëntor.” Cili është ay njeri i gjallë që ka shpëtuar nga të metat e jetës? Dëshëroj të shoh një!

Si Shqipëtar, qe kombëtar dhe e desha, po si shok në punët shoqërore ish pak' i lëvizur, dhe për atë shkak shumë njerës nuk e shikojin me sy aqë të mirë. Pat hyrë në Vatrë si anëtar dhe pat dalë disa herë, po prapë Vatrën e çmonte.

Më 1943-44, Z.Ahmet Ramo ish sekretar i Degës së Vatrës në Detroiti dhe i dërgoj editorit një përgënjeshtrin zyrtar që e botoj në Diell pa lejë të kryetarit dhe pa pyetur zyrtarët e tjerë të komisionit. Për atë shkak, kryetari thirri një mbledhje të Degës dhe e shtroj çështjen e sekretarit përpara anëtareve për bisedim. Ajo mbledhje e gjeti të fajshim sekretarin dhe e dënoj duke e shuar emërin e tij nga lista e anëtarëve të Vatrës.

Duke ditur se ay kish 20 e ca vjet që ish hequr nga Vatra, u – habita kur pashë në Diell dy vjet të shkuar se Z.Ahmet Ramo hyri prapë në Vatrë dhe mori pjesë aktive për të forcuar Degën e Chicago-s! Ajo gjë më bëri të mejtohem, dhe thashë: “Siç duket, Ahmetit j'u-qas vdekja dhe dëshëron të vdesë si Vatran, me shpresë që në botën tjetër - n'atë botë që ay beson se është shtruar me lule të bukura ku njeriu i ka të gjitha të mirat dhe s'bëhet merak për gjësendi- munt të bashkohet me Vatranët e vjetër që shkuan përpara tij!” Ashtu qoftë!

Në një përshkrim të bukur për Ahmet Ramon që u-botua në “Dielli” më 12 Mars 1969, vura re se ay paska lënë një librë inglisht të pa botuar! Kjo është një gjë shumë e madhe, aqë më tepër dhe e pabesuar, për një njeri që s'ka parë, ose s'ka mbaruar, asnjë shkollë inglisht të shkruajë libra në gjuhën inglishte! Inglishtia është gjuh' e shvilluar mirë, është gjuhë shkollarësh me një gramatikë të mbaruar që vetëm shkollarët e flasin dhe e kuptojnë siç duhet, dhe vetëm ata munt të shkruajnë libra inglisht. Kurse shqipia ka mbetur pas gjuhëve të botës, është palëruar mirë, s'ka një gramatikë të caktuar, të gjith' ata që mundohen të shkruajnë përdorin gramatikën e tyre të veçantë, dhe kështu çdo njeri që sëshëron munt të shkruajë një librë shqip!

Z. Ahmet Ramo kish dëgjuar se në New York ish një shtëpi botonjëse (Publishing House) e vogël që shtypte libra dhe broshura me një çmim t'ulët, dhe javën e fundit të Shtatorit 1964 vajti atje me qëllim për të shtypur librin e tij. Kur shkoj, e përcolla gjer në “Bus Station,” bashkë me të ish dhe një mik i tij edhe imi, i cili sot jeton në Qytetin e Math. Po në Nju Jork, ay s'erdhi dot në marrëveshje me botonjësin, shkakun përse i çmimit të lartë apo i lëndës që mbante libri, nuk e di dot.

Me vdekjen e z. Ahmet Ramo - Gjonvarfi hupmë një Shqiptar të mirë dhe patriot të kthiellt.

(R.XH. GURRAZEZI

faqe 8 e merkur 30 prill1969 Vol.57-NO.12)

TESTAMENTI I TIJ - AMANET PËR BREZA

Ahmet Ramo ndërroi jetë duke lënë prapa një kujtim të nderuar për veten,duke fisnikëruar edhe më shumë emrin e emigrantin të ri.Me veprimtarinë etij dinjitoze, në lëmin shoqëror, kombtar e fetar provoi të ndihmoi edhe pas vdekjes duke lënë testament pasurinë e tij për disa institucione.Në **Dielli** lexojmë:

Ahmet Ramo bëhet shembull edhe pas vdekjes

Më 17 Janar(1969) ndrroi jetë në Kenosha, Visconsin i ndjeri Ahmet Ramo, ku kishte vajtur për të pushue ca ditë te miku i tij Z. Kalosh Hamdia. Varrimi i tij u bë në Chicago, me 21 Janar, nën kujdesin e Kushëririt të parë të tij Z. Veledin Capoj.

Për t’a përcjellur në jetën e perjetëshme kishin ardhur nga Detroiti Zonja Hava Dule Kelcyra dhe Z. Z. Ferdin Toptani, Tajar Shaska, Erëblin Mehmetaj, Xhelo Koçiu, Azem Shehu dhe Bilbil Ymeraj. Nga Nju Jorku, Z.Z. Ago Agaj dhe Enver Shapilo, nga Kenosha Z.Z. Kalosh Hamdia e Hazbi Dikkoli.

Nga Chicago, me gjithë që ishte ditë pune, kishin ardhur për t’a përcjell një numër i madh miqësh, ku në mes të tyre dallova patriotin e mirnjojtur, Vatranin bujar Z. Etem Hoxha, i cili me gjithë që sapo kishte dalur nga spitali, dhe ishte edhe i pa fuqishëm nuk e kishte lënë shpirti që të mos e përcillte shokun e tij të rinisë.

Shërbimet fetare i bëri i përn. Imam Vehbi Ismaili, i cili mbas detyrës fetare mbajti një fjalë, ku në mes të tjerave tha:

Fjala e Imamit

“Jemi mbledhur sot për t’a përcjellur në jetën e përherëshme të Ndjerin Ahmet. Vëllezër dhe motra të dashura! Profeti i ynë, Muhammedi, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të ka urdhëruar e ka thënë: “Për tri gjëra njeriu shpërblehet e i shkruhen sevape dhe pas vdekjes: Kur lë fëmijë të mirë që luten për të, kur shkruan një libër që lezohen dhe i shërben njerëzisë, dhe kur lë dhurata për shoqëritë fetare humanitare.” Ahmeti do të vazhdojë të shpërblehet me dy të fundit, se ka lënë librin “Balsami i Lumturisë” që lezohet me andje shpirtësore, dhe shumicën e frutit të djerësës së ti ja la vakut Institueve fetare, humanitare e edukative.”

Ahmetin e kam njohur ç'prej ditës së parë që erdha n’Amerikë, 24 Prilli 1949, me që ishte dërguar nga Dertroit bashkë me të Ndjerin Hysen Kole që të më pritnin në Nju York. Me vdekjen e Ahmetit humbi një mik i sinqert, një shok besnik që na lidhte një bashkpunim afro njëzet vjecar.

Ahmet Ramo kishte një kulturë të gjërë fetare. Kohën e tij, pas pune e kalonte gjithnjë duke studjuar libra mbi filozofinë e fesë Islame. Ramo bashkë me të ndjerët: Ali Orhan, Dyle Kelcyra, Hysen Kole, Qamil Floqi, Hamit Zagari, Ameli Goskova e Riza Voskopi- këtu po përmendi vetëm disa prej atyrë që kanë ndrruar jetë janë themeluesit e Shoqërisë Muslimane Shqiptare.

Imami lezoj një letër të Përnd. Baba Rexhep, që i drejtohej të kushëririt Z. Veledin, dhe çfaqe keqardhjen për të mos mundjen të merrte pjesë personalisht për shkaqe shëndetsore, dhe shprehte ngushllimet e tija dhe të klerit Bektashian për këtë humbje të pazëvendsuar.

Ramo kishte një kurrajo të pashoqt civile, kur i mbushej mendja dhe përqafonte një ide, dhe sikur të tërë bota t’ishin kundra nuk kishte gjë që t’ia trondiste.

Imami përfundoi duke thënë: “Veledin, n’emër tim personal dhe të Shoqëria Muslimane Shqiptare, dhe të Z. Vahit Cika, Kryetar I Qëndrës Islamike Shqiptare të Nju York, Nju Jersey: I cili e donte dhe I admironte Ahmedin-të paraqes ngushllimet më të përzemërta, duke ju lutur Zotit që të ndjerin t’a vendosi në parais, dhe juve t’ua ap durim.”

Imami lezoj një letër të Përnd. Baba Rexhep, që i drejtohej të kushëririt z. Veledin, dhe cfaqe keqardhjen për të mos mundjen të merrte pjesë personalisht për shkaqe shëndetsore, dhe shprehte ngushllimet e tija dhe të klerit Bektashian për këtë humbje të pazëvendsuar.

Pastaj mori fjalën z**. Halim Zeqiraj** I cili tha: “Miqt dhe shokët dhe të gjithë ata që e kanë njohun do ta kujtojnë Ahmetin, si Shqiptarin më të mirë, si besimtarin më të fortë, si moralitin më të pastër si njerin me karakter të ndershëm e të papërkulur: ata, me kalim të kohës, nuk do ta harrojnë buzëqeshjen e tij, urtësin e tij, diturin e tij, shpirtin humanitar të tij…

“Për të gjitha këta arësye, sot që e percjellim për në banesën e fundit, I tregojmë respektin dhe nderimin t’onë jo vetëm me kurorat e lulevet që I stolisin arkivolin por dhe me hidhërimin e thellë që ndiejmë të gjithë në shpirtë.”

Enver Shaska i emocionuar mbajti një fjalë shumë të përmalleshme mbi të ndjerin, dhe do t’ishte dëshira e jonë që t’a raportonin krejtësisht, por duke qenë se do të bëhet shumë gjatë për shtyllat e Diellit po mjaftoj me këtë pjesë: “Kur këtheu nga udhëtimi që bëri do vjet të shkuara në Europë dhe në lindjen e afërme, pata rastin t’a takoj Ahmetin dhe patëm një bisedin të gjatë, në mes të tjerave dhe tha se kur ishte në Cairo të Egjyptit, ndërsa po rrinte në një kafene, I kishin vajtur dy nga të legatës komuniste Shqiptare të atjeshme, me qëllim që t’a bënin për vehte; të parën pyetje që I bënë I thanë seç bëjnë organizatat tradhtare të mergimit?” Ahmeti urtësisht e ëmbël u ep përgjigjen e duhur që kishte; ata nuk muarëm me guxim të bënin pyetje të tjera, butësisht u tha; “Djem ju flas kështu se unë jam në një moshë të shkuar: Shqiprija më dhëmbset që ka rënë në duar të këqija, më dhembi dhe ju si të rinj që ini bërë vegla e të mallkuarvet. Organizatat që më pyesni, presin që kur ta shkasin këmbët juvej, ato të jenë të organizuara për t’I dalë zot vendit tyrej e jo të lihet për Serbër e Grekër. Ato Organizata mundohen të ndreqin gabimet tuaja, gabime… hatara të rënda që juvej bëni dita ditës në shtyp e në radio karshi botës së lirë e sidomos çpifjet e sharjet e ndyta për Amerikën e Vilsonit. Organizatat në fjalë ngrenë zërin lart në botën e lirë duke thënë se s’eshtë popull shqiptar fajtor për sa thamë më larg, por një klikë terroriste që sundon vendin t’onë. Janë ata që vranë neve e farëfisin t’onë, janë ata që shtypin e torturojnë mbarë popullin shqiptare për një ideallogji false që s’ka asnjë lidhje me historin’ e traditat e popullit t’onë.

Nga këto përgjigje kuptuen komisarët e kuq se te Ahmeti nuk zinte vend propaganda e tyre dhe hiken.”

Z. Shaska e përfundoi duke caqur ngushëllimet e tija dhe të miqëvet të Nju- Jorkut.

I fundit foli miku I ngusht I Ramos, **Z. Ing. Agim Sula,** I cili mbas lexoj një pjesë të librit “Ballsam I Lumturis” që thotë se ata që I shërbejnë komunitetit që rrojnë nuk vdesin, por jesin gjithëmonë të paharruar*;*

Shprehi ngushllimet n’emër të vet dhe të Z. Abaz Kupi, Kryetar, dhe Z. Selim Domani, Sekretar’ I Lëvizjes Kombëtare të Legalitetit.

Ahmet Ramo ka shërbyer si nënkryetar, sekretar dhe anëtar I Komisjonit të Qëndrës së Shoqëris Muslimane Shqiptare në Detroit. Ka qenë dhe ndihmës Editori I revistës “Jeta Muslime Shqiptare” që doli për tet vjet nën drejtimin e të Përnd. Imam Vehbi Ismaili. Përveq që ka përkthyer librin “Ballsami I Lumturisë” dijmë se ka shkrojtur dhe një libër në formë romance, në gjuhën Inglisht, mbi Tragjezin vend-lindjen e tij; urojmë që kushëriri I tij, me shokë një ditë t’a botojë. Ramo ka qenë aktiv, kohëra të kaluara dhe në Vatren në Chicago dhe Detroit, besoj se këtë aspect të jetës së tij, do të shkruej ndonjë Vatran I vjetër.

Ahmet Ramo sikur ishte shpirt njeriu sa ishte I gjallë, dhe pas vdekje e tregoj shpirt-lartësin e tij, duke I lënë nga një mij dollar këtyre organizatave: Kryeqit të Kuq Amerikan, Shoqëris të Kancerit, Fondit të Studentave të Vatrës, shoqërivet Muslimane Shqiptare: Chicago, Detroit, Nju York, e Vaterbury. Nga pesëqind dollar, Teqes Bektashiane të Detroitit dhe Shoqërisë Muslimane të Philadelphies. Lutemi që dhe Shqiptarët tjerë të marrin shembull nga këto vepër mirëbërese e të ndjerit Ramo.

I përjetshëm qoftë kujtimi I tij, Zoti I bëftë vend të ndjerit Ahmet Në Parais me njerzit e drejtë. Z. Veledin Capos I dërgojmë ngushëllimet tona.

Dielli, Volumi no 57, nr 6., Faqe 1&4.
Vorcester, Massachusets, Vednesday March 12, 1969

Vatren tonë gjatë vitit 1968 vazhdimisht dhe bëri shumë anëtarë të ri

Ahmet Ramo qe ftuar nga z.Hamdi Kaloshi në Kenosha, Vis. Per të kaluar do kohë në qetësi, kështu e la Chikago-n dhe shkoi te miku që e kishte ftuar fisnikërisht e sipas traditave shqiptare. Përpara se të shkonte në Kenosha na shkrojti një letër shumë të përmallshme,që është një testament I tij,si të kishte paraparë vdekjen.Në letër na thot se ai kishte paramenduar për Fondin e Studentëve të Vatres, dhe për Faltoret, ku bënte pjesë, duke lenë kursimet e tij.

Ne e kujtojmë me respekt dhe lusim Zotin që shpirtin e tij ta vendosë në vendin e merituar në jetën e përjetshme. I përjetshëm qoftë kujtimi i Tij.

Dielli Boston Mass.Vol.N0.56
Nr.1 e mërkurë, 12 shkurt 1969, f.3

I ndjeri Ahmet Ramo i la fondit të studentëve $1000

Ai kujtoi edhe institutet fetare e ndërkombëtare në Amerikë

Përpara se të shkonte në Visconsin te një mik i tij, Ahmet Rama na shkroi nji letër, që e kemi ruajtur dhe nuk kishim të drejtë ta botojmë, ku na thonte se ai do të mendonte dhe për fonde të studentave të Vatrës, mbasi e ndinte se shëndeti i tij nuk ishte aq i mirë.

Sipas lajmeve që kemi patur e tani veqanërisht pas korrespodencës së veqantë që po botojmë në këtë numbër të gazetës, I ndjeri dhe I dashuri Rama I la fondin të studentit të Vatrës $1000. Ky është një gjest ose nji sjellje shumë fisnike që do ta kujtoj të ndjerin mik derisa fondi I Vatrës ku janë të depozituara rreth $40,000 do të vazhdojë të përkrah studentët të racës shqiptare në Amerikë e ky fond do të vazhdojë sepse është I depozituar në nji bankë, prej së cilës jepen bursa në bazë

të interest banker në cdo mot. Ky fond nuk preket dhe do të vazhdojë. E bijtë tanë do ta gëzojnë duke mos harruar kurrë atë që e themeluan dhe e pasuruan. Ramo I kujtoi dhe institutet fetare tona që do të lusin Zotin për të.

Ne përulemi për respekt përpara kujtimit të Mikut të Vatrës dhe lusim Zotin të prehet në vendin e të Drejtëve para Perëndisë.

Mbas shërbimevet fetare në vorresat, Z. Veldin Capoj shtroi një drekë në një prej restauraneve të qytetit, dhe falënderoj popullin për nderin që I kishin bërë si për lulet ashtu dhe për pjesmarrjen e tyre, duke u lutur që t’ju u shpërblente në gëzime.

LIRIA DHE PËRGJEGJËSIA E NJERIUT (fragment nga “Balsami i Lirisë”) përkthyer nga Ahmet Ramo

Veprimet bëhen me vullnet ose pa vullnet. Ndryshimi është në gradë dhe jo në lloj. Sikur dikush të matet të godasë dikë në kokë, ose t'ia nxjerrë sytë, dora përnjëherësh dhe pa hamendur do të ngrihet të mbrojë kokën, gjithashtu edhe sytë vetvetiu do të mbyllen. Akti i shpejtë i dorës ose i syve rrjedh nga vetëdija, e cila shtyn vullnetin të ngucë dorën ose sytë për mbrojtje. Ka edhe raste të tjera kur mohimi ose pranimi i një akti varet në arsyen dhe sapo arsyeja e pranon, vendimi zbatohet menjëherë posi në shembullin e sipërm. Ky akt përbën vullnet. Ndoshta, vullneti duke u influencuar nga imagjinata ose arsyeja, zgjedh njërin midis dy problemeve. Për shembull, një njeri, të cilit i është rënduar jeta nga dhembjet trupore ose nga vuajtjet mentale, është në dilemë dhe ka për të zgjedhur midis dy problemeve - të vrasë veten apo të rrojë. Po i dha arsye vetes se vdekja ka për ta shpëtuar nga mizëria e vuajtjes, ai do të preferojë vdekjen, megjithëse dashuron jetën. Këtu shfaqet vullneti. Urdhri që i është dhënë vullnetit komunikohet nëpër kanale të posaçme dhe dora e zbaton duke bërë vetëvrasje.

Njeriu mban balancën midis determinueses dhe lirisë personale. Seria e ngjarjeve është në vijë të caktuar, por zgjedhjen e bën njeriu vetë. Ulematë tanë, për arsye studimi dhe sqarimi, kanë shpikur fjalët si Kaab (acquisition) për ta çuar nga fjala xhebr (domosdoshmëri, necessity). Ata thonë, zjarri djeg nga domosdoshmëria, se ashtu është caktuar natyra e tij; por njeriu ka përgjegjësinë e përdorimit të zjarrit, kurse në Fuqimadhin Zot gjendet shkaku i fundit i zjarrit, ihtijar. <Sigurisht>, flet Perëndia në Kuran, “Ne s’i krijuan për zbavitje qiejt dhe tokën dhe ç'gjendet midis tyre, por për një qëllim të lartë, sado që shumica e njerëzisë s’e kupton”. (Kuran: XLIV. 38)

Sigurisht ka një qëllim të caktuar në tërë gjithësinë. Ky varg uniform ngjarjesh s'është kot. Këtu mund të bëjmë këtë pyetje. - Kurse Perëndia qenka prototipi i shkakut, pse librat e shenjta lëvdojnë ose kërcënojnë njeriun për aktet e tij? A duhet të besojnë se qenkan dy shkaqe për një efekt? - Përgjigjja ime është se fjala shkak s'është kuptuar kthjellët, sepse kjo fjalë mund të përdoret me dy kuptime: Për shembull, mund të themi se vdekja e një njeriu – u shkaktua nga xhelati ose nga urdhri i mbretit. Të dyja këto thënie janë me vend, se, po të mos kishte urdhër, nuk do të kishte as xhelat. Po kështu, Perëndia është shkaku i parë se Ai ka fuqinë krijuese. Njëkohësisht edhe njeriu bëhet shkak veprimesh, por bazuar në përgjegjësinë e vullnetit të lirë.

Në Kur’an ka ca versete, ku fjala shkak është përdorur me dy kuptime: “Engjëlli i mortjes do t'ju shkaktojë vdekjen, pastaj do të silleni te Zoti”.

“Zoti e merr shpirtin në kohën e vdekjes” (Kur’an XXXII-11, dhe XXXIX-42). “Luftoi ata, o Muhammed, se Perëndia do t’i përlajë dhe do t’i turpërojë ata me dorën tënde”. Dhe prapë, “Ti, o Profet, nuk i munde, por ishte Perëndia, Ai që i mundi, si një shenjë dhurate për besimtarët” (Kur’an, IX-14 dhe VII-17).

Prej verseteve kuranore të lartpërmendura kuptohet se fjala shkak shenjëzon fuqinë kreative dhe i përshtatet vetëm Perëndisë. Meqë fuqia e njeriut është përngjasimi (image) i fuqisë kreative të Zotit, për njeriun fjala shkak merr kuptimin figurativ. Shtrohet pyetja, pse njeriu të dënohet për keqbërjet dhe shpërblehet për mirëbërjet? Më parë, le

të konsiderojmë natyrën e shpërblimit si edhe atë të dënimit. Provat na tregojnë se nomet fizike kanë një rrugë të caktuar si një e një që bëjnë dy. P.sh. ai që preferon të hajë helmin s'ka të drejtë të ankohet, sepse vetë cilësia e helmit është të shkaktojë vdekjen. Gjithashtu, çdo veprim që bën njeriu ai lë shtytjen e tij në mëndje, dhe kështu puna e mirë ose e keqe ka pasojën e natyrës së vet. Pasojat e bërjeve të përparshme (antecedents) janë zbuluar ashtu siç janë bërë zbulime në mjekësi.

Çdo veprim lë përshtypjen e saj në zëmër dhe i jep fuqinë motivit që e shtyri ose e nguti kundrejt aktit. P.sh. hipokrizia mpin zemrën, por motivi hyjnor të heq në lumturi. Si vepra e mirë ashtu edhe puna e ligë zhvillohen sipas proporcionit të motivit. Mirëbërja e keqbërja kanë natyrë të kundërt, prandaj ajo anë që peshon më tepër ndalon efektin e anës tjetër.

Psikologët e shpirtit janë profetët, dhe po nuk i dëgjove, ke për të pësuar mundimin e pasojës. “Sigurisht, thotë Kur’ani, krijuam njeriun me konstitucion të mbaruar (Muslim); pastaj e bëmë më të poshtër të të poshtërve, përveç atij që beson dhe bën mirësi; ky do të ketë shpërblim të pashteruar” (Kuran, XCV, 4-6).[1]

---

[1] Shënim:
Nëse njeriu është nga natyra i mirë ose i keq, është një pyetje që ka turbulluar mendjet e dijetarëve të kohës së lashtë. Për këtë janë dhënë disa përgjigje, të cilat përmblidhen në tri teori:
1. Njeriu, thonë, lind nga natyra i keq. Arsimimi veçse e frenon shtazërinë, dhe qytetërimi është vetëm një lustër. Një pikëpamje e tillë është fe dëshpërimi.
2. Njeriu, thonë, është as i mirë as i keq; mëndja është si një tabelë e pashkruar (tabula rasa), në të cilën çdo bërje lë përshtypjen e saj.
3. Ca të tjerë thonë se mirësia dhe ligësia janë të ndërlikuara ose të pleksura në natyrën e njeriut, se ai ka natyrën engjëllore dhe natyrën satanike. Zhvillimi i secilës varet nga forca e rrethanave; këto natyra janë si dy farëza; secila farës që mbillet dhe shikohet me kujdes, do të rritet dhe ka për të dhënë frutat e saj.
Le të shohim se ç’thotë Kur’ani për këtë pikë: “E krijuam njeriun me më të mirën vet, por në qoftë se bën keq, do ta bëjmë më të poshtrin e të poshtërve, përveç atij që bën mirësi; ky do të trashëgojë shpërblime të pashteruar”. Kjo revelatë e Kur’anit thekson natyrën e njeriut. Ai lind i mirë dhe për mirësi, por meqë ka marrë përsipër përgjegjësinë e vullnetit të lirë, duhet të ketë kujdes për mirësinë. Njeriu lind vetëm me një farëz dhe ajo është gjëza (entity) e përplotësuar; po u përdor keq quhet ligësi. Ligësia është negative, e krijuar vetë prej njeriut dhe jo gjë kreative prej krijuesit.

Nojmat e Krijuesit
Kur ustai çirakut çekanin i dorëzoi,
Ai e di sepse dhe nga puna shpejt filloi;
Si ky çekan, duart tona nojmat e Ustait janë;
Drejtimet e Tij, për ne, po atë kuptim kanë.
Kur nojmën ia kupton dhe urdhrin ia pohon,
Veçse një gjë të ndalon kur s'do dhe kur përton.

Fatalizmi
Të kujt dega lëkunden prej tufanit,
Dhe kujt fruta derdhen në kokën e gjumashit?
Fatalizëm quhet kur n'udhtim dremit,
Fatalizmi bekimet nga dora t'i qit.
Fatalisti në mes të banditëve fle, ëndërron.
Dhurata prej Zotit pa mundim kërkon.
Kur nojmat e Zotit në mendje s'i vini,
Sado që i thoni vetes burra, burra s'jeni,
Sado që i thoni vetes fetar, Fenë s'e dini;
Shquartësin' e arsyes harruar e kini.
Ju, kokët e shkreta posi zalli jini,
Ku farë drithi s'bin, se mirënjojtje s'kini.
Nëse tek Zoti mbështetesh, ngreu mos përto,
Me urdhrin e Tij gati, punën vazhdo.

Mirënjojtja
Falënderimet, prej Zotit pranohen kur punon,
Kur me thashetheme kohën kot s'e shkon.
Të jesh mirënjojtës tek Zoti, lutje janë,
Sa më tepër mirënjojtës aqe bekime kanë,

Është interesante të vërehet i njëjti ekspresion në Mesnevi-n e Xhelaleddin Rumiut, i cili u lind më 1207 P.K., nëntëdhjetë e shtatë vjet pas vdekjes së Muhamed Gazaliut. Vargjet që pasojnë janë marrë në një nga volumet e Mesnevi-s së Xhalaleddin Rumiut, përkthyer nga persishtja në anglishten prej Whinfield-it (1898) (S.N.A).

I Tërëdëgjueshmi me anën t'ënde degjon,
Dhe prapë me anën t'ënde punën t'a mbaron.
Po i pranove urdhrin, punën mbar'e ke,
Po i lipe afrimin, miku besnik i Tij je.

Ahmet Ramo

MUHAMMEDI (A.S) MËSUESI I URDHËRIT TË LARTË

Qëllimi i fesë: Në analet e Fesë vetëm veprat e Profetit Muhamed kthjellësuan konceptin e vertetë të saj.Jo se bota ish ose kish qenë pa fe, porse fea besohesh si një insttutë për të kenaqur përendinë dhe për tu favorizuar prej saaj duke përkthelur me anë ofertash dhe lutjesh.

Muhammedi e rdhi për ti japij një objektivë të re fesë-jo shpëtim prej digradimit të njeriut (Salvation from the fall), por zhvillim të fuqisë potenciale te pa dukur të njeriut, së bashku me rritjen morale se njeriu nuk qenka lindur me mëkatet, por me një konshtitutë te përsosur dhe pa cenqë ka të thot Moslim ose Musliman.

Kualitete e fshehta të njeriut pas mësimeve te Profetit, nuk zhvillohen dhe ndriçohen me oferta, sakramente etj. se Perandija nuk ka nevojë, por nevojë ka njeriu të zhvillohet mentalisht moralisht, me bukuri dhe vullnet duke u pajosur me cilësi hyjnore, Divine atributes, të cilat Feja Islame i njeh dhe urdhëron 99 cilësira.

Njeriu fillon me trup an daj natyra karnale pridominon, por natyra e miresisë dhe bukurisë duhen shvilluar, pra Profiti si profesor anatomije dhe psikologjie eksploron fund ekrye mendjen e njeriut: ndanë të rremen prej së vertetës dhe të shëmtuarën prej bukurisë.

Njeriu pason prej egos,tamhut dhe pashrimit (pasionit).Profiti nuk propozon ti shdukim instikte të tilla se edhe këto janë cilësi hyjnore, por propozon kontrollimin e tyre.Për shembull:Zemrimi i pa kontrolluar merr një formë të ligë, si armiqësi, temperament të keq, abuzim, tirani e loj lloj krimesh.Me anën tjetër zemri mi në udhen ebukurisë sjell kurajo,zotësi,trimëri, durim tolerancë e tjera.Pashërimi në rrugën e shëmtuar sjell kurvërinë,semundje e tj.,kur në rrugën e bukurisë sjell dashuri,miqësi, virtyte, paqe, fëmijë të mbarë etj. Duket para së gjithash ajo gjë që eshtë e mirë prej shpërdorimit bëhët edhe eshëmtuar.

Qëllimi i Fesë islame nuk është të pretendosh dashuri për perendinë me ane ofertash, por është një zhvillim gradual duke praktikuar Cilësitë Hyjnore të cilat spastrojnë koshentën (Vetedijen-koshiencen E.O)e njeriut t'arrijë në Koshentën Perendore.

“Gjerësia e Parajsës është që në qiell e gjerë në Tokën” Muhammedi

Ka patur njerës por ka edhe që pandehin se fea është për të shiguruar një vent në parajsën e cila gjendet diku jashtë kësaj bote.Këtë ide të gabuar Kur'ani e ka ekspozuar ku thotë: “Parajsa është një gjendje ose kondite shpirituale enjë shpirti të shvilluar, kurse skëterra është e kundërta e saj”. Një emisar i Heraklusit pranë Profitit kur mësoi për revelatën e Muhammedit për mbi parajsen vrapoi ta pyesë, ndofta më dhunë,kurse parajsa qenka pa anë e fund,atëhere vendi për skëterren ku mbtet?Përgjigjeja eProfitit qe:”Lavdi pastë Allahu, kur vjen dita çe gjenë natën”.Pas pipamjes së Profitit Xhenneti dhe xhehenemi,njera quhet kopësht i lulëzuar dhe tjetar vendi ku spastrohesh. Njëra është kondita e një shpirti të shvilluar dhe tjetar kondita e nje shpirti që ka nevojë për spastrim.Është një udhëtim evolucionar**.**

Morali një reflektim i cilësive hyjnore:

Për herë të parëbota realizoi se besim në Zotin ka të thot besim në virtytet që kanë të bëjnë me Cilësitë Hyjnore” thotë hoxha Kemaludin dhe shton...Është vetëm në shekullin e fundit që shohimse kjao e vertetë po shijon agjimin e Botës peendore.”

Kur'ani në gjashtë pjesë

Hoxha Kemaluddin në librin e famshëm “The Ideal Prophet”,thot se dijetarët Islam e kanë ndarë Kur'anin në gjashtë pjesë me Përendinë në figura Qendrale:

I.-Përmend cilësitë e Tij,atributet,ose format e ndryshme me të cilat Zoti ka bërë manifest vetëhen.

II.-Referon funkcionin e ketyre objekteve,duke shpjeguar punën në cilëdo.

III.-Nevoja për konformimin,për t'u adaptuar më të tilla atribute që janë quajtur virtyte,drejtësi e pastërti.Siç do gjë e bërë,e ndierë ose e imagjinuar që nuk pajtohet me të tilla cilësira ose manifesta hyjnore quhet mëkat.

IV.-Shpjegon jetën epritme e cila ilustrohet gjithë po me ato principe. Duket pra, se Kur'ani është reveluar për të vetmin qëllim ta bejë Zotin, me aqe sa është e mundur, për të njohur tek njeriu me anën e atributeve të Tij. Jo se Perendia ndien nevojë personale, por për të mirën e njeriut se kjao është methoda me e shkurtër dhe me e sigurt me te cilën njeriu ndriçohet dhe vazhdon udhëtimin e e vo-lucionuar. Kur'ani çdo shembull e jep me anën e natyres, andaj është quajtur libra e Natyrës. Njeriu vetëm të bejë një krahasim.

Formula e jetës së një muslimani:

Muhammedi, A.S na la trashëgim për udhë-heqje një formulë që kapërcen në bukuri dhe në efekt çdo formule tjatër; dhe na këshillon të përseritin në çdo rast: “Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim”, është for-mula e fillimit të njëpune;dhe përberë prej dy atributesh, ose cilësi të Zotit;dhe ka të thot: “më emrin e Zotit, Mëshironjës dhe dhuronjës”. Mëshironjës se i ka falë njëeriu ment, trup, gjallëri, nermjet te sqenave të ndryshme, diell, shi, zjarr ujë tokë etj., pa ndonjë shberblim. Dhuro-njës se për çdo një punë të mirë që bejmë Ay na shpeërblen më tepër se sa e meritojmë. Psikologjia na kallëon se njeriu është ashtu si? Mejton, pra kur mejton njeriu mëshirë praktikon mëshirë; jep kur i mundet pa ndonjë shpërblim, si këshill'ë, mësim, si ndihmë morale ashtu dhe materiale. Kur vjen puna që të shpërblej të tjerët shpërblen me peshën e drejtësisë. A dëshiron të duash Zotin ? Thotë Profiti, Atëhere duaj njerëzinë.

FORMULLA E PËRSHENDETJES: As-salamu Aleikum : “Paqë mbi ju.” Selam është një prej Cilsivet Hyjnore dhe ka të thotë: “Zoti i Paqës është ruajtësi, pra, edhe ti ben paqe me njerëzine. Kjo formullë përdoret edhe prej Masonvet.

SKA NDËRMJETËS MIDIS ZOTIT DHE NJERIUT: Për herën e pare u-stabilizua se s'la nevoje për ndërmjetës midis njeriut dhe Zotit. Kurani thotë: Ata që mundohen pas Meje u tregoj rrugen t'Ime, dhe kur t'u pyesin (O Profit) thuaju se jam më i afërt nder ta se sa është vehtëja e tyre.

MONOTHEISMI NË FORMËN MË TË PASTËRT:

Ëstht'i vetëmi Muhammedi që stabilizoi monotheismin në idenë më të qartë Ky zot nuk ka shoq as që munt të shëmbellehet. Përgjithë-risht natyra me njeriun së bashku është manifestim'i Tij dhe s'la nevo-jë për rikorporim. Perëndive që u falëshin besët pagane, të cilat s”janë tjatër veç se krijimet e Zotit në natyren, Profiti i rrëzoi të gjitha për dhe dhe ato që quheshin perëndi atehere janë shërbëtorët e njeriut sot.

KONSTITUCIONI I NJERIUT ËSHTË PA CENË: Për herën e parë bota mësoj prej Profitit se njeri ështe lindur me konstitucionin e saktë, pa trashëgim mëkati, por njeriu mëkaton pas lindjes. Konstitu-cioni i tijë ka kapabilitet të bëhet më i lartë se engjijt, por prap është në rrezik prej (ignorancës) të bëhet më i poshtëri i të poshtërët, Kuran PROMBLEM I MIRËSISË DHE LIGËSISE: Perëndia është burimi i mirësisë. Kurani. Çdo gjë është krijuar për një shërbim. Përdorimi i një gjëje në masën e logjikes dhe të ethikës është virtutë; dhe shperdo-rimi gjith'i asaj gjëje bëhet ves, mëkat.

VËLLEZËRIA UNIVERSALE: Për herën e parë bota mësoj këte principë prej Muhammedit. Nga të tërë profitërit (A.S.) para Muham-medit vetëm Krishti ënderroi për një vëllezëri universale, por Kritiani-zma nukë ka mundur të shpëtojë prej uurejtjes raciale dhe fetare. Për çifutet Perendia quhesh Perëndia e Abrahamit dhe Isakut; në Persi quhesh Mazda i Persisë; në Indi ish Brahma i Hinduvet. Por Muham-medi, A.S. e quajti “RAB-UL-ALEMIN” Perendia i të tërë botëve, që ndihmon çdo racë e fe; qofte se janë: Muslimanë, të Kershterë, Jahu-

dij, Sabian etj., por me një konditë: Në qoftë se besojnë Perendinë dhe ndihmojnë njerëzine.

Mundi të bashkojë fise dhe raca të ndryshme të botës Islame, as njeri a komb më superior se tjetri. "Më superiori i juaj, tha është ay që vazhdon në urdhërat e Perëndise." Përshkroi me anën e revelatës veprat e çdo profiti, dhe u tha Muslimanëvet se këta janë profitrit t'uaj dhe se s'la ndryshim nërmjet të njerit dhe tjertrit. Spastroi nga abuzimet si Davidin, Daudin e Lutin, veçanërisht denoncoi kalumnitë e jahudive kundrejtë Krishtit, dhe e quajtj Frymën e Zotit, si dhe t'ëmën Merjemea e Pastërt.

S'KA SHTËRNGACË NË FENË: Për herën e parë principa e lirisë fetare u fol dhe u praktikua prej Muhamedit. I quajti tërë Profitrit vëllezër dhe revellatat e secillit të njëjta, por shtoi se besimtarë t e profitvë të më parshëm kanë cenuar revellatat, pra Kurani u-dërgua si një rikapitulacion, për të vëndosur ato që kanë humbur, si dhe predikimi të rea q'i desh koha.

KURANI NJË CHALLENGE I PA KONTESTAR: Profiti ftoi njerëzin e kohës së tij dhe të siçdo kohës se pritme se në qoftë se janë të sinqertë, po kanë dyshim, le të mbelidhen duke u-munduar të bejnë një revellatë më të mirë se të Kuranit, ose si të Kuranit. Më kot se historia e të katërmbëdhjet shekkullave të Islamizmëse ka provuar këtë të vërtetë, dhe Kurani qëndron i pa kontestuar. Reforma shekullin e fundit kanë filluar të bëhen duke u huar prej Muhammedit. Në shekullin e sotmë shikohen shume ligje e reforma, por zori është se ma e madhje reformë është ndryshimi i attidutës mentale, tolerance fetare, ndalim monopolit, i lirë prej prexhudismes raciale, dhe kontrollimi i egos, tamaut. Këto nuk munt të shërohen as me reforma as me ligjë, por duhet një përsonalitet si ay i Muhammedit.

KUR LEJOHET LUFTA: Për herën e parë bota mësoi prej Profetit se kur është e drejtë për të përdorur armën, bota ngaherë ka parë luftëra, për shkak feje ose tjetër. Si profitrit e Hinduve ashtu dhe të

Hibruve kanë përdorur pallën dhe shpesh herë pa të drejtë. I vetëmi esht Muhammedi që i vuri luftës kufi, dhe e lojoj vetëm kur se armiku vjen të të robroje, të të rrembejë kafshitën e bukës dhe kur se të mbohon lirin e koshiencës. Beri thirje terë botës të bashkohen, për hirë të paqës, se ndryshe Historia dëshmon se jeni të humbur. Së Bashku luftoni kundrejt tiranjt gjersa aq të kërkoj paqë, por mos e kapërceni kufine."

(Jeta myslimane shqiptare, reviste fetare-kulturore (Del kater herë në mot*) –Organ i shoqërisë Muslimane Shqiptare) Vol.III Nr.1 Janar - mars 1952 Rebiul Thane-jamad-al Thanee 1371, Editor Imam vehbi Ismaili, ndeihmës editorë: RXh.Gurrazezi, Ahmet Ramo

* Shën yni: Kjo revistë ka kohë që nuk botohet

الز عثماني

الحرية و مسؤلية الانسان

(مختصر من "ادعية الحرية")

(خلاصة البحث)

ان اعمال الانسان تتم بارادة أو بغيرها الفرق هو فى الدرجة و ليس في النوع. اذا أراد احد ان يصيبك في الرأس او يخلع عينيك اليد تلقائيا ترتفع لحماية الرأس و كذالك العيون سوف تغلق تلقائيا. العمل السريع لليد والعينين يتم يوعي كامل الذي يدفع اليد للدفاع عنه هناك احوال اخرى حيث يتم دفاع تلقائيا وهذا يسمى ارداة الانسان.

Elez Osmani

FREEDOM AND HUMAN RESPONSIBILITY (excerpt from “Balsami i Lirisë”)

(Summary)

Human actions can be conscious or unconscious. If someone tries to hit someone else on the head or to poke him/her in the eye one’s hand will go up immediately and without hesitation to protect the head and the eyelids will shut automatically to protect the eye.

VËSHTRIME

Esilda Luku

VËSHTRIM MBI NDIKIMIN E BASHKËJETESËS PESËSHEKULLORE SHQIPTARO-OSMANE NË IDENTITETIN KOMBËTAR SHQIPTAR

Përmbajtja e shkurtër: Në gjirin e elitës politike dhe kulturore shqiptare, debati mbi natyrën e identitetit kombëtar përshkohet nga rryma orientaliste që mbështetet në strukturën konceptuale binare Lindje-Perëndim. Qasja dikotomike është konceptuar si një përpjekje e vazhdueshme e shqiptarëve për t'u shkëputur nga "demoni oriental" drejt Oksidentit, duke "anatemuar" periudhën otomane. Mbështetur në të dhëna të kulturës materiale e shpirtërore, si dhe fakte historike e gjuhësore, studimi argumenton se marrëdhënia pesëshekullore shqiptaro-turke përfaqëson një modus vivendi, e ngritur mbi një korpus të përbashkët vlerash shumë përmbajtësore. Bashkëjetesa mes dy popujve e pasuron dhe e zhvillon më tej identitetin kombëtar shqiptar, të ndërtuar mbi substratin autokton pellazgjiko-ilir.

Çështja rreth "natyrës" së identitetit kombëtar shqiptar ka përbërë boshtin tematik të shumë veprave e artikujve me rëndësi politiko-historike e letrare, që kanë gjetur dritën e botimit, qysh nga periudha e Rilindjes Kombëtare deri në ditët e sotme.

Ky diskurs, në gjirin e elitave politike dhe intelektuale, është dominuar nga rryma e orientalizmit shqiptar, e ndërtuar mbi strukturat konceptuale homogjene e binare Lindje - Perëndim. Fetishizimi i Oksidentit, si përfaqësues i botës së zhvilluar e qytetëruar nga njëra anë, dhe demonizimi i Orientit, të prapambetur e pacivilizuar nga ana tjetër, shërbyen për të "ligjësuar" përpjekjen e shqiptarëve për t'u shkëputur nga Lindja dhe për t'u orientuar drejt Perëndimit.

Në këtë udhëkryq "zgjedhjeje" dhe "zgjidhjeje" është konceptuar debati mbi identitetin kombëtar shqiptar. Perëndimi është e kundërta e Lindjes.[1] Ose me Perëndimin, ose kundër tij! ...por assesi me logjikën e hermafroditit: edhe me Perëndimin, edhe me Lindjen. Ka ardhur koha të themi të vërtetën.[2] Kjo ndarje ontologjike dhe epistemologjike midis Perëndimit dhe Lindjes përshkroi ligjërimin orientalist të elitës, sipas së cilës: "përballë demokracisë qëndron despotizmi, përballë aktivizimit qëndron pasiviteti, përballë dëshirës dhe arsyes për dije qëndron gjumi dehës, përballë individit kërkues qëndron anadollaku, që jetën e vet e jeton si ëndërr dhe largohet prej saj pa lënë ndonjë gjurmë. Oksidenti përballë Orientit."[3]

Mbi bazën e kësaj logjike dikotomike, elita politike dhe intelektuale shqiptare stigmatizoi pjesën lindore të "Vijës së Teodosit", duke formuluar stereotipe e përdorur klishe përçmuese ndaj të ashtuquajturit "demon oriental" dhe influencës së tij në procesin e ndërtimit të identitetit kombëtar shqiptar.

Si ideologjia orientaliste e Rilindjes, ashtu edhe ajo bashkëkohore u njëjtësuan në vlerësimin e "periudhës pesëqindvjeçare osmane in toto si një kundërtezë e gjithçkaje që përfaqëson Evropa apo Perëndimi. …ajo shihet si një tunel, në fund të të cilit shqiptarët dolën të shfytyruar, pra …është një kohë kundërhistorike".[4] Kjo periudhë "u anatem-

---

[1] Mustafa Nano. *Europa, destinacioni X*. Tiranë: Korbi, 2002, f. 16

[2] Baton Haxhiu. "Kthimi i njeriut", *Korrieri*. Tiranë, 09.08.2005

[3] Enis Sulstarova. *Arratisja nga Lindja: orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja*. Tiranë: Dudaj, 2006, f.212

[4] Enis Sulstarova. "Provincializimi i Evropës" dhe debati publik mbi integrimin evropian", *Polis* nr.2/2006, f. 17

ua" si "shkaktare" e krijimit dhe e konsolidimit të shoqërisë orientale shqiptare me histori e identitet fragmentar. "Këta shekuj përbëjnë një proces të vazhdueshëm retrogradimi dramatik të mbarë shoqërisë, të gjithë strukturave të saj, një depërtim të vazhdueshëm, herë brutal e herë të tjera paqësor, të qytetërimit të pushtuesit në të gjitha indet e shoqërisë, duke zmbrapsur, duke luftuar, duke fshirë e ndrydhur e shpërfytyruar jo pak qytetërimin e mëparshëm që gjetën aty."[5]

Një qasje e tillë "provinciale", e artikuluar nga disa prej përfaqësuesve të elitës intelektuale, që e etiketon "turkun" si kundërideal të vlerave morale e shoqërore dhe arritjeve ekonomike e politike të shqiptarëve, përbën një përpjekje të dështuar për t'i deleguar "tjetrit" të gjithë barrën e përgjegjësisë për mosefektshmëri. Sipas filozofit Maurice Merleau-Ponty, konceptet "vetja" dhe "tjetri" e humbin rivalitetin e bazuar te kundërvënia absolute dhe nuk përfaqësojnë më një strukturë logjike simetrike, ku dy polet do të ishin të ndarë, të tendosur përreth një hapësirë në cilësinë e një zone të pastër demarkacioni. …Ata ndërkallen e krijojnë një tërësi që s'mund të jetë as si disa syresh, as si të tjerët, as bashkimi i tyre i thjeshtë mekanik. Bëhet fjalë për një realitet tjetër në lëvizje të pandërprerë.[6]

Përkundrazi, elita politike dhe kulturore shqiptare nuk e konsideronte marrëdhënien reciproke një modus vivendi, por, për të, Lindja ishte e kundërta e Perëndimit, ndaj projektonte "arratisjen" sa më parë prej saj. Për më tepër, përcaktimi i Orientit si i vetmi "fajtor" për obskurantizmin e shoqërisë shqiptare gjen shprehje në ndarjen konceptuale të orientalizmit shqiptar - në të jashtëm, duke e cilësuar "turkun" si "tjetrin" themelor të identitetit shqiptar, mishërim i Azisë, barbarisë, së keqes, prapambetjes dhe - në orientalizëm të brendshëm,[7] drejtuar shqiptarëve të orientalizuar si "gjak i prishur", të cilët kishin nevojë për rehabilitim moral të menjëhershëm.

---

[5] Piro Misha. *Duke kërkuar rrënjët ose…kthimi i shqiptarëve në histori*. Tiranë: Toena, 1997, f. 28-29

[6] Artan Fuga. *Shtigje drejt guvës së gjarprit: mbi filozofinë e sistemeve politike*. Tiranë: Ora, 2004, f.108

[7] Sulstarova, *Arratisje nga Lindja…*, f. 22

Qasjes dikotomike, të prezantuar nga mendimi intelektual për çështjen e identitetit kombëtar, i kundërvihet realiteti shqiptar që falë bashkëjetesës në harmoni e tolerancë mes dy popujve, shqiptarë e turq, për një periudhë pesëshekullore, mundi të krijojë një simbiozë vlerash e arritjesh, të cilat konsiderohen pjesë konstruktive e identitetit tonë kombëtar.

Bashkekzistenca e gjatë paqësore shqiptaro-otomane ishte rezultat i ndjekjes së politikave qeverisëse konsensuale dhe bashkëpunimeve shumëpërmasore politiko-ekonomike, ushtarake, social-kulturore e fetare të ngritura mbi bazën e interesave dhe përfitimeve reciproke. Këtë marrëdhënie e dëshmon procesi i integrimit të shqiptarëve në strukturat e administratës perandorake dhe shtetërore osmane.

Një politikë e tillë pragmatiste u bë e mundur në saje të aplikimit të dy mënyrave kryesore: së pari, vendosjes së sistemit osman të timarit, që u garantonte elementeve të familjeve me origjinë senjoriale dhe ushtarake lënien në tokat e tyre me cilësinë e timariotëve osmanë. Paralelisht me ruajtjen e statusit të mëparshëm mbi pronat e poseduara prej kohësh, krerët feudalë shqiptarë u përfshinë në procesin e bashkimit në radhët e spahinjve osmane. Së dyti, zbatimi i sistemit të gulamit, që konsistonte në përgatitjen, në sarajin e sulltanit, që në moshë të vogël të djemve të parisë vendëse, të cilët nëpërmjet praktikës së devshirmesë mund të depërtonin lehtësisht në gjirin e burokracisë shtetërore, civile dhe ushtarake. Ndërsa fiseve malësore shqiptare shteti osman, në vend të regjimit të timarit dhe sistemit të gulamit, të cilët nuk gjetën terren të përshtatshëm gjeografik për aplikim, u njohu një pozitë autonome vetëqeverisëse, me kusht që të paguanin një haraç të përvitshëm dhe të dërgonin ushtarë në fushatat luftarake osmane.[8]

Për rregullimin e marrëdhënieve ekonomike, shoqërore, politike e juridike në mbarë perandorinë respektohej dokumenti themeltar, Sheriati. Sipas prof. dr. Kristo Frashërit, gjatë hulumtimit të dokumenteve

---

[8] Nuray Bozbora. *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*. Tiranë: Dituria, 2002, f. 69

jo të pakta të zyrave të Sheriatit të kazave të Shqipërisë, është konstatuar se kadilerët dhe naibët e qyteteve tona, kanë qenë të porositur të zbatonin Sheriatin e Imam Azamit, të cilin Porta e Lartë e gjykoi si më të përshtatshëm për Rumelinë. Veç kësaj, ndikimin e qytetërimit lokal shqiptar në korpusin juridik të Perandorisë Osmane e dëshmojnë edhe kanunametë që administrata otomane hartoi për sanxhaqet e Shqipërisë, redaktuar në përshtatje me kushtet lokale. Për më tepër, kadilerët e kazave të Shqipërisë, si duket me porosi të organeve më të larta, kishin të drejtë që për çështje të veçanta të jepnin vendime duke u mbështetur në të drejtën zakonore lokale.[9] Një politikë e tillë "kompromisi juridik", që rregullonte marrëdhëniet komplekse mes dy popujve, ishte "çelësi" i bashkëjetesës së suksesshme institucionale dhe shoqërore.

Këtë modus vivendi e dëshmon sidomos angazhimi i një numri të konsiderueshëm nëpunësish shqiptarë në të gjitha nivelet e administratës shtetërore dhe civile osmane. Falë integrimit natyral në kastën drejtuese, shqiptarët u rekrutuan deri në postet më të larta. Pohojmë se "numri i sadriazemëve (kryeministrave) ishte rreth 35, ndër të cilët mund të përmendim: Ahmet Pasha Dukagjinin (1514), Ibrahim Pashën (1522), Gedik-Ahmet Pashën etj., pa llogaritur numrin e jashtëzakonshëm të vezirëve (ministrave), bejlerëve, shejhul-islamëve dhe gjithashtu disa bashkëshorte të sulltanëve e valide sultanas".[10] Të shumtë ishin dijetarët e shkrimtarët me origjinë shqiptare, si p.sh., Bedri Esad-Efendiu (profesor i teologjisë), Esat Efendi Janina (profesor i filozofisë), Hafiz Ali Korça (shkrimtar) etj.; arkitektë e ndërtues, si Sedefqar-Mehmet Biçakçiu, Mimar Sinani etj.; mjekë të shquar, si dr. Hasaf Ajdonati nga Paramithia, dr. Sezai Çomo nga Libohova, dr. vet. Sejfi Vllamasi nga Kolonja etj; gjyqtarë të shkallës kombëtare e ndërkombëtare, si Masar Asllani nga Nepravishta (drejtor i Hetuesisë Penale), Ismail Efendiu nga Ninati, një nga prokurorët më të nderuar në Sulltanatin Osman gjatë viteve 1900-1912 etj. I gjithë korpusi i funk-

[9] Kristo Frashëri. *Identiteti kombëtar shqiptar dhe çështje të tjera*. Tiranë: Edisud, 2006, f. 127

[10] Ervin Hatibi. "Identiteti shqiptar". www.worldbulletin.net

sionarëve shqiptarë, të ingranuar në poste të rangjeve të ndryshme të strukturës shtetërore dhe administrative osmane, bashkëpunuan ngushtësisht dhe besnikërisht me politikanët dhe burrat e shtetit më të shkëlqyer turq të kohës së vet për të mirën e të dy kombeve, të atij turk e të atij shqiptar.[11]

Në lëmin social-kulturor bashkëjetesa pesëshekullore shqiptaro-otomane krijoi një sistem vlerash materiale e shpirtërore, zakonesh, rregullash, shprehish, virtytesh e vesesh, që konsiderohen pjesë e qenësishme e identitetit kombëtar shqiptar. Kjo paketë vlerash që ndërton marrëdhëniet kulturore dhe aktivitetin tonë të përditshëm gjen shprehje tek "adetet që shoqërojnë ceremonitë e lindjes, të martesës dhe të varrimit; mënyra e jetës në shtëpi dhe në shoqëri; ceremonitë fetare në ndërtesat dhe vendet e kultit; veshjet e grave myslimane në shtëpi e jashtë saj; muzika dhe vallet popullore me ndikime orientale; gastronomia e pasur me veçori orientale; arti popullor nën influencën e artit turk e arab; krijimtaria letrare, fetare, iluministe, pedagogjike, morale, dokumentare e shkruar me alfabetin arab; monumentet fetare kulturore siç janë xhamitë, teqetë dhe tyrbet…etj."[12] Këto të fundit reflektojnë simbiozën harmonike të stilit të importuar me teknika e elemente të njohura vendase të shek.XI-XV, si kupolat, qemerët, kornizat dhëmbështare, ndërtimet me gurë e harqe rrethore etj. Modelet e objekteve të kultit islam, me karakter monumental, u morën nga Stambolli, por u ndërtuan nga mjeshtër vendës, të tilla si xhamia Mbret në kalanë e Elbasanit (1492), ajo në pazarin e Krujës (1539), e Muradies në Vlorë (1542) etj.[13] Për më tepër, ekzistojnë dëshmi të vijueshmërisë së gjinisë së ndërtimeve të kultit të krishterë, të grupuara në: 1. Kisha njënefëshe, 2. Kisha me strukturë në formë kryqi me kupolë dhe 3. Bazilika, të cilat janë të ngjashme për sa u përket strukturave dhe kompozimit planimetrik me kishat bizantine të ndërtuara para pe-

[11] Ibrahim D. Hoxha. *Turqit dhe shqiptarët*. Tiranë: Hasan Tahsini, 1994, f. 27-32

[12] Rexhep Qosja. *Realiteti i shpërfillur: vështrim historik mbi pikëpamjet e Ismail Kadaresë për identitetin shqiptar*. Tiranë: Toena, 2006, f. 76

[13] Petrika Thëngjilli. *Historia e popullit shqiptar: 395-1875*. Tiranë: Toena, 2000, f. 305

riudhës osmane.[14] Dekorimi i veprave të kultit islam me disa arabeske dhe me kaligrafi arabe që pasqyrojnë citate nga Kurani, ndërsa mjediset e kishave zbukurohen me piktura murale e ikona përbën një tjetër dëshmi të gërshetimit të vlerave artistike e arkitektonike në jetën e qyteteve shqiptare. Arkitektura urbane u pasurua edhe me objekte të karakterit civil, si hanet, hamamet, kullat e sahateve që, të marra së bashku, tregojnë për nivelin e lartë të zhvillimit ekonomiko-social e kulturor të shoqërisë sonë në periudhën e bashkekzistencës mes dy popujve.

Në të kundërt, orientalistët shqiptarë kanë nënvizuar elementet kontradiktorë që përshkuan marrëdhënien e gjatë shqiptaro-otomane. Shkrimtari Ismail Kadare në sprovën "Identiteti evropian i shqiptarëve" stigmatizon nostalgjikët e sotëm të Perandorisë Osmane, duke u kujtuar se: "edhe sikur shtypje e plojë të tmerrshme të mos kishte pasur, do të mjaftonte tragjedia e ndalimit të shkollave për disa shekuj rresht, për të kapur përmasat e së keqes. …U dëmtua e u tret trupi i saj [Shqipërisë], por po aq i lemeritshëm ishte gjymtimi i trurit nga terri i gjatë i padijes. E veç kësaj ndërprerje ogurzezë do të mjaftonte të kujtonin nxënësit dhe mësuesit e masakruar, kur kapeshin duke mësuar shkrim e këndim, në bodrumet e fshehta, për të kuptuar se përse gjuha shqipe u ngrit më pas në statusin e martirit dhe përse zuri vendin e një tempulli."[15]

Çështja e vështirësisë së arsimimit të shqiptarëve në gjuhën kombëtare zë vend të rëndësishëm edhe në programet politike e kulturore të ideologëve të Rilindjes Kombëtare. Këta të fundit kritikuan ashpër ideatorët e Reformave të Tanzimatit, të cilët planifikuan të lejonin arsimimin në gjuhët amtare të të gjithë elementeve të perandorisë, duke ua mohuar këtë të drejtë vetëm shqiptarëve. Shtetarët osmanë insistonin që shqiptarët t'i njihnin sipas besimit fetar, për rrjedhojë myslimanët duhet të mësonin në institucionet arsimore turke, katolikët në ato latine, ndërsa ortodoksët në shkollat greke. Ky qëndrim i Portës së

[14] Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë. *Historia e popullit shqiptar. V. 1*. Tiranë: Toena, 2002, f. 712-713
[15] Ismail Kadare. *Identiteti evropian i shqiptarëve*. Tiranë: Onufri, 2006, f. 26-27

Lartë synonte ruajtjen e unitetit të islamit dhe shmangien me çdo kusht të formimit të një ndërgjegje kombëtare në gjirin e botës myslimane, e cila mund të mbizotëronte mbi solidaritetin fetar.

Me gjithë pengesat institucionale të pushtetit qendror dhe presionet me karakter nacionalist-fetar të kombësive fqinjë, boshti i veprimtarisë së elitës intelektuale ishte: "shqiptarët nuk mund të ekzistojnë pa gjuhën shqipe dhe kjo e fundit nuk mund të ekzistojë pa alfabetin e vet dhe pa shkolla".[16] Kjo devizë "e injektuar" thellë në dejtë e shqiptarëve i bëri ata të pamposhtur përballë torturave të nëpunësve të Portës, të cilët i rrihnin dhe i poshtëronin në publik. I tillë ishte rasti i H.I. Dalliut, që përpos rrahjes sistematike pa mëshirë, iu nënshtrua edhe presionit psikologjik me pyetje, si: "Arnavutçe severmisin?" (a e do shqipen?); ai përgjigjej "severim" (e dua).[17]

Mirëpo, duke synuar objektivitetin shkencor dhe mbështetjen në faktet historike vlen të përmendim se në dritën e lëvizjeve reformuese që ndërmori Tanzimati në fushën e arsimit, intelektualët shqiptarë në Stamboll krijuan shoqata shkencore, kulturore me veprimtaritë botuese përkatëse. Këtë e dëshmon themelimi zyrtar, në Konferencën e Stambollit, më 12 tetor 1879, i organizatës së quajtur "Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip", e cila botoi veprën me titull "Alfabetare e gluhësë shqipe", që përmbante, përveç alfabetit të Stambollit të hartuar nga Sami Frashëri, dhe disa shkrime mësimore të përgatitura nga Pashko Vasa, Jani Vreto e Koto Hoxhi.[18] Për më tepër, më 1885 sulltan Abdyl Hamiti dha leje që në shkollat shqiptare të përdorej gjuha kombëtare. Më 7 mars 1887, në Korçë, u themelua shkolla e parë shqiptare për djem. Ndërsa më 1891, po në qytetin e Korçës, u hap shkolla e parë kombëtare shqipe për vajza nga Gjerasim D. Qiriazi. Pa përmendur numrin e madh të shkollave në Shkodër të drejtuara nga klerikë të urdhrit françeskan, më pak ato ortodokse në Jug apo shkollat shqipe që vepronin në ilegalitet.

[16] Stavro Skëndi. *Zgjimi kombëtar shqiptar: 1878-1912*. Tiranë: Phoenix, 2000, f. 127
[17] Sulejman Külçe. *Shqipëria në historinë osmane*. Tiranë: GlobusR, 2004, f. 205
[18] Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë. *Historia e popullit shqiptar. V. 2*. Tiranë: Toena, 2002, f. 211-212

Orientalizmi bashkëkohor shqiptar stigmatizoi edhe rrymën e bejtexhinjve, të zhvilluar në shek.XVIII - fillim shek.XIX, që shënon një letërsi vendëse të shkruar me shkronja arabe e të ndikuar fuqishëm nga modelet letrare turke, persiane e arabe.[19] E paraqitur kinse si një krijimtari letrare që demaskonte problemet shoqërore-klasore e erotike të kohës, një pjesë e madhe e poezive të bejtexhinjve s'ishin gjë tjetër veçse bejte dhe lavde për pedofilinë. "Ik prej meje çun i vogël/ ik prej meje gjeç belanë/ do vete t'i them sat' ëme/ prej teje nuk gjej derman". Kjo letërsi është vlerësuar prej tyre si nënkulturë, e futur kontrabandë, nën pasaportën e artit popullor.[20]

Përbërës thelbësor i identitetit kombëtar të çdo populli është gjuha, e cila pasurohet vazhdimisht si rezultat i kontakteve mes kombeve të ndryshme, bartës të kulturave të larmishme. Ky proces përshkoi gjuhën shqipe, por edhe gjuhët tjera ballkanike gjatë periudhës së komunikimit intensiv shumëplanësh me Perandorinë Osmane. "Pjesa më e madhe e leksemave turke jo vetëm u është përshtatur, por edhe është kthyer në një përbërës "natyral" të gjuhës së përgjithshme dhe asaj rajonale. Në periudhën otomane këto fjalë jo vetëm pranoheshin në gjuhën e folur, por edhe iu bashkëngjitën letërsisë, gjuhës së mësuar fetare, shkresave administrative dhe teksteve të tjera të shkruara. Dihet se jo të gjitha huazimet të përcaktuara si turqizma kanë prejardhje turke, pasi pjesa më e madhe e turqizmave të huazuara direkt nga Turqia, vijnë nga arabishtja ose persishtja, e ndoshta do të ishte më e saktë të përdornim termin "orientalizma të huazuara nga turqishtja"".[21] Për këtë çështje, profesor Eqerem Çabej thekson se "për gjuhën shqipe dija është në gjendjen e favorshme që mund të kryejë njëfarë shtresëzimi në punën e marrjes së elementeve turke".[22]

19 Robert Elsje. *Histori e letërsisë shqiptare*. Pejë: Dukagjini, 1997, f. 71
20 Kadare, *vepër e përmendur*, f. 29-30
21 Lindita Latifi. *Mbi huazimet turke në gjuhën shqipe krahasuar me gjuhët e tjera të Ballkanit*. Tiranë: Dudaj, 2006, 14
22 *Po aty*, f. 19

Për huazimet turke në gjuhën shqipe janë kryer një varg studimesh të lavdërueshme nga studiues vendës dhe të huaj, të cilët kanë hedhur dritë sidomos mbi aspektin historik të depërtimit të tyre, si dhe mbi klasifikimin leksikor, duke përcaktuar edhe sferat kuptimore të huazimeve. Në "Fjalorin e orientalizmave në gjuhën shqipe", autori T. Dizdari numëron 4406 huazime të drejtpërdrejta nga gjuha turke, ndër të cilat rreth 1400 janë në fjalorin e gjuhës shqipe. Ndërsa studiuesi A. Kostallari bën klasifikimin semantik të turqizmave si më poshtë:

Sfera ku kanë hyrë turqizmat	**Numri i turqizmave (përafërsisht)**
Administrata, gjykatat, ushtria	800
Feja islame	170
Ushqimi, mjetet e gatimit e të ngrënies	360
Veshmbathja e stolitë	420
Zejtaria, ndërtimi e arkitektura	380
Shëndetësia, mjekësia	250
Ekonomia, tregtia	320
Arsimi	90
Lojëra zbavitëse	100
Etika, estetika	50
Masat e kohës, vëllimit, peshës dhe monedhat	120
Ngjyrat	30
Muzika	100
Lundrimi e mjetet e tij	70
Bujqësia e blegtoria (duke përfshirë florën dhe faunën)	430
Dukuri gjeografike - natyrore	80
Sfera të tjera	mbi 200

Turqizmat, si pjesë e rëndësishme e leksikut të gjuhës shqipe, janë përdorur gjerësisht nga orientalistët shqiptarë, të periudhës së Rilindjes Kombëtare, me qëllim "demaskimin" e prapambetjes nën influencën e Anadollit apo si fyerje "drejtuar myslimanit shqiptar, djalit të një të krishteri tradhtar, i cili u konvertua në islam, si një trashëgimi e

padëshirueshme e shtypjes osmane”.[23] Terminologjia e pasur me turqizma përshkon edhe diskursin e sotëm publik të elitave politike e kulturore, në medien e shkruar dhe vizuale apo veprat e botuara, qoftë për të “njollosur” imazhin e kundërshtarit politik me etiketime, si “oriental”, “turk”, “pasha” etj., ashtu edhe për të identifikuar të ashtuquajturin “precent frenues” në perspektivën integruese të Shqipërisë për në bashkësinë evropiane.

Në periudhën otomane, identiteti fetar i shqiptarëve u pasurua falë përhapjes gjerësisht të besimit islam, që predikonte vlera të larta shpirtërore e morale, si vëllazërinë, ndershmërinë, tolerancën, fisnikërinë e shpirtit, respektin ndaj më të mëdhenjve e prindërve, dënonte veset, sjelljet imorale etj.[24] Për rrjedhojë, depërtimi i shpejtë i Islamit në gjirin e popullsisë nuk e cenoi, përkundrazi e konsolidoi bashkëjetesën ndërfetare të shqiptarëve. “Në një fshat, në afërsi të Gjakovës, Fra Kerubino dhe shoqëruesi i tij, u pritën në një shtëpi me përzemërsi, me fjalët: “Urdhëroni etër! Në shtëpinë tonë kemi katolicizëm, islamizëm dhe ortodoksizëm”. Frati Kerubino u trondit nga fakti se si mikpritësit e tij lavdëroheshin “me këtë diversitet të feve”, me ekzistencën e kësaj laramanie të trefishtë në të njëjtën familje”.[25]

Për tolerancën e harmoninë fetare në marrëdhëniet shqiptaro-otomane dëshmon edhe ekzistenca e “kriptokristianizmit” (krishterëve të fshehtë) apo “laramanisë”,[26] në pjesën veriore katolike, dukuri e njohur ndonëse jo e institucionalizuar nga autoritetet e Portës. “Më 1568, sanxhakbeu i Dukagjinit, Kasëm beu, raportonte se banorët, në juridiksionin e tij, kur u lindnin fëmijë i çonin më parë në kishë dhe i pagëzonin te prifti, pastaj u vinin emra myslimanësh duke përdorur kështu një emër mysliman dhe një emër të krishterë.”[27]

[23] Hatibi, *artikull i përmendur*…www.worldbulletin.net
[24] Petrika Thëngjilli. *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit (1506-1839)*. Tiranë: Maluka, 2002, f. 356
[25] Gazmend Shpuza. “Dukuri të bashkëjetesës ndërfetare”. www.forumishqiptar.netshowthread.php
[26] Edwin Jacques. *Shqiptarët*. Tiranë: Kartë e Pendë, 1999, f. 255
[27] Shpuza, … www.forumishqiptar.netshowthread.php

Religjioni islam, ndonëse i përhapur në masë te popullsia e krishterë, qoftë nëpërmjet praktikës së përqafimit vullnetar të vlerave shpirtërore të tij apo konvertimit të kushtëzuar prej politikave pragmatiste të pushtetit qendror, me qëllim njësimin fetar të popujve të perandorisë, nuk arriti të shndërrohej në rregullator të jetës sociale të shqiptarëve. Ky fakt dëshmohet p.sh., tek institucioni i martesës. Institucionalizimi i poligamisë në fenë islame nuk preku traditën monogame të martesës shqiptare.

Bashkëjetesa dhe toleranca ndërfetare në shoqërinë shqiptare shprehte rëndësinë e vendosjes së përkatësisë kombëtare mbi identitetin fetar. Për këtë arsye, shqiptarizma mbizotëroi procesin e formësimit dhe konsolidimit të identitetit kombëtar të shqiptarëve, që proklamohej në programet nacionaliste të ideologëve të Rilindjes me thënien e Pashko Vasës: “Feja e shqiptarit është shqiptaria”.[28] Ky parim politik, pa dyshim afetar, por jo antifetar, luajti rolin e platformës ideore që udhëhoqi bashkimin e shqiptarëve, pavarësisht përkatësisë religjioze. Megjithatë, vlen të përmendim kontributin pozitiv të fesë islame në ndërtimin e identitetit kombëtar, pasi konvertimi në myslimanë i ndihmoi shqiptarët të ruanin karakterin etnik kundrejt sllavizimit, serbizimit dhe greqizimit.

Në të kundërt, diskursi i sotëm politik e mediatik përshkohet nga orientalizmi me nota të forta islamofobike. Përkatësia fetare myslimane përdoret gjerësisht nga kundërshtarët për të denigruar performancën e politikanëve apo njerëzve publikë, si dhe për të “identifikuar” faktorin që pengon realizimin e aspiratës integruese të shqiptarëve. Për më tepër, islamofobia ka depërtuar thellë në indet e gjithë shoqërisë shqiptare, duke vepruar brenda “një horizonti përfytyrimesh orientaliste, sipas të cilave “tjetri” është lindor, i prapambetur, mysliman, tradicional, patriarkal, i korruptuar, irracional, fanatik, i rrezikshëm … etj. Besimtari mysliman shqiptar, aq më tepër po të ketë mjekër a shami koke, konsiderohet si jashtë modelit të qytetarit normal, laik,

[28] Fatos Lubonja. “Feja dhe shqiptaria në ditët e sotme”, *Korrieri*. Tiranë, 18 maj 2008

fetarisht tolerant, evropian, modern, racional, përparimtar”.[29] Kësaj pikëpamjeje “provinciale”, që mbizotëron mediumet publike, i kundërvihet Abdi Baleta kur thotë se “ruajtja e islamit në trojet shqiptare ka rëndësi jetike për ruajtjen e identitetit dhe individualitetit kombëtar shqiptar. Evropa duhet të na pranojë si pjesë e saj me individualitetin tonë”.[30]

Qasja e orientalistëve shqiptarë, rilindës e bashkëkohës, që mbështetet në struktura konceptuale binare për ndërtimin e identitetit kombëtar, e pozicionon këtë të fundit në hapësirën aksiologjike midis Perëndimit dhe Lindjes, në përpjekje të vazhdueshme për t’u arratisur nga orienti demoniak drejt Perëndimit.[31] Një perceptim i tillë polarizues nuk u përshtatet dinamikave historike e politike të zhvillimit të shoqërisë sonë. Kjo për faktin se kultura shqiptare, e kategorizuar si aktive, ka aftësi të absorbojë erëra të ndryshme kulturore, të cilat nuk e cenojnë përkatësinë e saj, por ndikojnë në thellimin e diversitetit dhe pluralitetit, duke sjellë pasuri dhe zhvillim.

Mbështetur në këtë pikëpamje, konkludojmë se “nuk ka identitet shoqëror të thjeshtë, të njëtrajtshëm dhe të pandërmjetëm. Të gjitha identitetet janë të strukturuara dhe komplekse”.[32] Konkretisht, identiteti kombëtar shqiptar ndërtohet mbi bazën e një substrati të vjetër etnokulturor pellazgjiko-ilir, të pasur me vlera humaniste, që, nga njëra anë, ka ushqyer vetëdijen individuale dhe kolektive të shqiptarëve dhe nga ana tjetër, ka mundësuar modifikimin e mbivendosjeve jashtë tipologjike nga mekanizmat vendës, siç reflekton p.sh., përvoja e përftuar gjatë bashkëjetesës pesëshekullore shqiptaro-otomane, e cila konsiderohet pjesë konstruktive e identitetit tonë kombëtar. Në këtë mënyrë, autoktonia dhe aloktonia përshkohen nga komunikimi konvergues në favor të së parës.

---

[29] Sulstarova, *vepër e përmendur*, f. 210
[30] Abdi Baleta. “Shqiptarët përballë terrorizmit intelekual të Falaçit”, *Rimëkëmbja*, 2002, f. 144
[31] Besnik Pula. “Recensë e Enis Sulstarova, Arratisje nga Lindja: Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja”, *Polis*, Nr.2/ 2006, f. 61
[32] Shkëlzen Maliqi. “Çështja kombëtare: identiteti shqiptar”. www.albasoul.com/vjeter/modules.php

Esilda Luku

AN APPROACH TO THE INFLUENCE OF THE CENTENIAL COEXISTENCE BETWEEN ALBANIANS AND TURKS ON THE NATIONAL IDENTITY OF THE ALBANIANS

(Summary)

The discourse of the Albanian political and intellectual elite on the nature of national identity is characterized by an Orientalist approach, which is based on the binary conceptual structure East-West. This dichotomous approach was conceived as a continuous effort by the Albanians to break loose from the Orient in order to turn towards the Occident, anathematizing the Ottoman period. Based upon cultural, material and spiritual data, as well as historical and linguistic facts, the paper argues that the 5 century long coexistence between Albanians and Turks symbolized a modus vivendi, based on a common set of values. The coexistence between the two adds to the national identity of the Albanians, which is built upon the Pelasgian-Illyrian substrate.

اسيلدا لوكو

نبذة عن تأثير في الهوية الالبانية بين الالبان والعثمانيين في غضون خمسة قرون

(خلاصة البحث)

محتوى مختصر: نلاحظ أن النقاش بين صفوة السياسيين والمثقافين الالبانيين حول هوية القومية تعتمد على تيارين الشرقي والغربي. التيار الاول يعتمد على المحاولة للهروب من الشرق نحو الغرب و ذلك متناسين الفترة العثمانية و لكن اعتمادا على المراجع الثقافية والمادية والروحية و كذالك على الوثائق التاريخية واللغوية يثبت لنا بان فترة التعايش بين الالبان والعثمانيين لمدة خمسة قرون كانت فترة تعايش مشترك و ذات منافع مشتركة. التعاون بين الشعبين يثرى الهوية الالبانية التى بنيت على التراث بلازغو–الير.

EKONOMI ISLAME

Dr. Naceur Jabnoun

ISLAMI DHE MENAXHMENTI - (5)

LIDERSHIPI DHE MOTIVIMI

Lidershipi

Lidershipi ka të bëjë me dhënien, duke pritur që të merr. Ai ka të bëjë me kujdesin, duke mos u kujdesur të jetë i kujdesur. Ka të bëjë me përkrahjen, duke mos ditur të jetë i përkrahur. Ka të bëjë me të qenët i drejtë, me ata të cilët nuk janë të drejtë me ty.

Lidershipi ka të bëjë me dhënien e dimensioneve të humbura për ndjekësit. Ka të bëjë me përhapjen e rendit nga kaosi, krijimin e mirëbesimit nga mosbesimi, besimit nga dyshimi dhe guximit nga frika. Lidershipi ka të bëjë me bërjen e ndryshimeve. Liderët nuk është e domosdoshme të mbajnë pozita të autoritetit. Influenca e tyre nuk buron as nga pasuria e as nga fuqia.

Ebu Xhafer el-Mensuri, themelues i dinastisë së Abasitëve, njëherë u parashtroi një pyetje disa prej të besuarve të tij. Ai i pyeti:

“Kush është gjeraqina e Kurejshëve? Ata iu përgjigjën: “Udhëheqësi i besimtarëve, i cili ka themeluar pushtetin, ka pushuar trazirat, dhe shuan përvojën e hidhur”. Ai tha: ”Nuk më jeni përgjigjur në pye-

tjen time”. Ata thanë: “A është Muavija? Ai tha: Jo. Ata thanë: “A është Abdulmelik Mervani? Ai tha: Jo. Ata thanë: Kush tjetër o udhëheqës i besimtarëve? Ai tha: Abdurrahman ibn Muavije, i cili i iku me dinakëri majave të heshtave dhe teheve të shpatave, duke udhëtuar nëpër shkretëtirë, dhe duke lundruar në dete, derisa arriti në një territor të huaj. Atje, organizoi qytetet, mobilizoi ushtritë, dhe rithemeloi pushtetin e tij pasi që e kishte humbur plotësisht, me menaxhment dhe vendosmëri të fortë. Muavija arriti lartësinë e tij përmes përkrahjes së Omerit dhe Othmanit, mbështetja e të cilëve i lejoi atij të kapërcejë vështirësitë; Abdulmeliki për shkak të punës së mëparshme; dhe Udhëheqësi i besimtarëve përmes luftës së të afërmve të tij dhe solidaritetit të përkrahësve të tij. Por, Abdurrahmani e bëri atë vetëm, pa ndihmën e askujt tjetër, përveç gjykimit të vet, duke u mbështetur në asgjë tjetër, përveç se në vendosmërinë e tij”. (Ibn Ethiri, 5:182).

Allahu xh.sh. krijoi qeniet njerëzore, ju dhuroi aftësinë e mendjes, dhe gjithë Universin ua nënshtroi atyre. Kjo do të thotë që Allahu xh.sh. ju siguroi njerëzve aftësitë dhe burimet. Disa njerëz dhe kombe kanë më shumë sukses sesa që bënë të tjerët në përdorimin e asaj që u ka dhënë Allahu xh.sh. Shkalla e suksesit të kombeve varet kryesisht nga lidershipi dhe motivimi i tyre. Muslimanët kanë arritur një sukses unik historik. Majkëll Hart konsideroi Muhamedin a.s. si njeriun më me ndikim në historinë njerëzore. Aktualisht, vendet të cilat tregojnë rritje të shpejtë janë ato të cilat janë të privilegjuara me lidership më të mirë. Në këtë kapitull, do të adresojmë konceptin e lidershipit nga perspektiva islame. Do të fillojmë me definimin e lidershipit, pastaj do të vazhdojmë me mësimin e cilësive të një lideri të mirë.

Performansa e një organizate është shumë e ndikuar nga kualiteti i lidershipit. Lideri duhet të merr përgjegjësinë e plotë për organizatën. Pastaj, lidershipi duhet të kuptohet më shumë si një shërbim ndaj organizatës dhe anëtarëve të saj. Thënia e Muhamedit a.s. mbështet këtë kuptim, që është në pajtim me konceptet e TQM. Muhamedi a.s. thotë:

“Lideri (udhëheqësi) i njerëzve është shërbëtori i tyre”. (Taberaniu)

Lidershipi është i domosdoshëm për suksesin e çdo pune kolektive, ashtu siç është e qartë në thënien e Muhamedit a.s. të cituar më poshtë:

"Nëse tre persona janë duke udhëtuar, duhet të caktojnë një lider nga mesi i tyre". (Ebu Davudi)

Kështu, Islami aprovon dobinë e lidershipit.

Fakti që udhëheqës të ndryshëm janë caktuar nga Muhamedi a.s. në situata në ndryshme, mbështet nocionin që efikasiteti i lidershipit varet nga përshtatja mes liderit, pasuesve dhe situatës.[1] Kjo na sugjeron që liderët që janë të suksesshëm në një situatë me një grup të caktuar, mund të mos jenë të suksesshëm në situatën tjetër, apo me një grup tjetër. Ali ibn Ebu Talibi r.a. ishte pyetur njëherë, pse periudha e tij ishte më e keqe se periudha e Ebu Bekrit dhe e Omerit r.a. Ai tregoi që arsyeja për këtë ishte se ata kishin ndjekës më të mirë se ai.

1 - Cilësitë e Lidershipit

Shkathtësitë e kërkuara për lidership nuk janë vetëm teknike. Në fakt, shkathtësitë e sjelljes janë ato më kritiket. Hibbani, në mënyrë përmbledhëse përshkruan karakterin e Abdurrahmanit. Ai shkruan, "Abdurrahmani ishte i përmbajtur haptazi, shumë i ditur, dhe mendjehollë, me vendosmëri të shpejtë dhe të fortë. Pastaj ishte larg nga përshkrimi si person i plogësht, i shpejtë dhe punëtor, i cili nuk gëzonte as qetësi e as kënaqësi në përtaci. Kështu, ai nuk do të lejonte trajtimin e çështjeve te të tjerët. Ishte guximtar dhe trim, me gjerësi dhe thellësi. Kishte momente të tërbimit e shumë pak momente të qetësisë. Ishte artikulues dhe orator; poetik, perfeksionist dhe tolerant; bujar dhe i sinqertë. Kujdesej për përcjelljen e funeraleve dhe lutej për të vdekurin. Ashtu siç printe në lutje kurdo që ishte i pranishëm në namazet e xhumasë dhe të bajrameve, mbante edhe hytben në minber. Vizitonte të sëmurin, dhe dilte të takonte njerëzit e zakonshëm e ecte në publik".

---
[1] Gibson et. Al. "Organizations", Business Publications Inc., Texas (1985) p. 361.

Paraqitja e mësipërme përfshin cilësitë e lidershipit si dituria, vetëpërmbajtja, vendosmëria, oratoria, bujaria, puna e madhe, pjesëmarrja, dhe guximi. Në atë që do të vijojë, do të listojmë në detaje cilësitë kryesore të lidershipit islam.

1) Fuqia dhe besimi

Liderët duhet të jenë të aftë dhe të besueshëm, që do të thotë: ata duhet të jenë të fuqishëm dhe besnik. Mungesa e një prej këtyre dy shtyllave te lideri mund të dëmtojë seriozisht organizatat. Këto dy shtylla janë shprehur në ajetin vijues kuranor:

...إِنَّ خَيْرَ مَنِ ٱسْتَـْٔجَرْتَ ٱلْقَوِىُّ ٱلْأَمِينُ ﴿٢٦﴾

"…më i miri i atij që do ta marrësh në shërbim është ai i fuqishmi, e besniku!" *(el-Kasas: 26)*

...وَإِنِّى عَلَيْهِ لَقَوِىٌّ أَمِينٌ ﴿٣٩﴾

"…unë për të kam fuqi dhe jam i sigurt!" *(en-Neml: 39)*

قَالَ ٱجْعَلْنِى عَلَىٰ خَزَآئِنِ ٱلْأَرْضِ ۖ إِنِّى حَفِيظٌ عَلِيمٌ ﴿٥٥﴾

"Ai *(Jusufi)* ***tha: "Më cakto mua përgjegjës të depove të vendit, unë jam besnik i dijshëm".*** *(Jusuf: 55)*

Të gjitha ajetet e mësipërme janë dëshmi e faktit që lideri duhet të jetë i aftë dhe i besueshëm. Jusufi a.s. posedonte aftësitë dhe diturinë e nevojshme për të mbikëqyrë thesarin e tokës, prandaj ofroi shërbimet e tij për t'u kujdesur për të.

Padyshim, nuk është detyrë e lehtë të gjendet dikush që është shumë i aftë dhe shumë i besuar. Në shumë raste, gjejmë njerëz që mund të marrin rezultat shumë të lartë në një cilësi, por janë mesatar në anën tjetër. Shpesh, ndonjëri ka nevojë të bëjë zgjedhje, cilën cilësi duhet të zëvendësojë. Duke pasuar traditën e Muhamedit a.s., mund të arrijmë lehtësisht në përfundim që së pari vinë aftësitë e nevojshme, derisa besimi mbetet të kërkohet. Për shembull, Amr ibn As ishte caktuar nga Muhamedi a.s. për të udhëhequr muslimanët, duke përfshirë edhe

sahabët e njohur, në betejën e “Dhatu Selasil”, vetëm katër muaj pasi që kishte pranuar Islamin. Kjo ndodhi ngase Amri posedonte aftësi më të mira ushtarake se pjesa tjetër e ushtrisë. Gjithashtu, halifët përdornin të njëjtin kriter. Kjo çështje është shpjeguar mirë nga Ibn Tejmije në librin e tij “es-Sijase esh-Sheria’a”. Xhevdet Se’id[2] shpjegon në librin e tij, *“Puna, aftësia dhe dëshira”* që një udhëheqës i dobët do të jetë shumë i dëmshëm për një organizatë, derisa një lider i aftë mund të jetë shumë i dobishëm, madje edhe nëse nuk ka qenë mjaft i besuar, pasi që mangësitë e tij mund të zëvendësohen duke e kontrolluar atë. Në fakt, lideri nuk do të ketë fuqi absolute, pasi që Islami kërkon menaxhmentin participues dhe verifikimet e balancimet.

2) Të bërit e shumë liderëve që të dëgjojnë dhe falin

Një prej definicioneve më të mira për një lider të mirë është ai i dhënë nga Demingu, i cili thotë: “Lider i mirë është ai që shtynë që shumë liderë t’i dëgjojnë njerëzit dhe të falin gabimin”.

Muhamedi a.s. formoi një gjeneratë të tërë liderësh. Ai ishte i suksesshëm përmes dëgjimit të pasuesve (sahabëve) të tij, duke u konsultuar me ta. Ata ishin të aftë të përhapnin mesazhin e Islamit pas tij. Liderët që i zhvilloni do të përmirësojnë më tej lidershipin tuaj, duke përmirësuar gabimet tuaja. Omeri r.a. veproi si lider mes liderëve të tij. Ai kurrë nuk dërgoi një sahab më të moshuar si guvernator (vali) të tij, por në vend të kësaj i mbajti afër tij për t’u siguruar që do të përmirësohet nëse bën ndonjë gabim.

3) Mirësia dhe besimi në Allahun xh.sh.

Muhamedi a.s. ishte i butë dhe falës. Liderët krijojnë angazhim të vullnetshëm të vartësve të tyre. Lidershipi nuk ka të bëjë me detyrimin dhe frikën. Ka të bëjë me respektin dhe si i tillë lideri duhet të jetë i butë dhe falës.

---

[2] Jawdat Sa’id, “Work is a skill and a Will”, Damascus, (1983), p. 29.

فَبِمَا رَحۡمَةٖ مِّنَ ٱللَّهِ لِنتَ لَهُمۡۖ وَلَوۡ كُنتَ فَظًّا غَلِيظَ ٱلۡقَلۡبِ لَٱنفَضُّواْ مِنۡ حَوۡلِكَۖ فَٱعۡفُ عَنۡهُمۡ وَٱسۡتَغۡفِرۡ لَهُمۡ وَشَاوِرۡهُمۡ فِي ٱلۡأَمۡرِۖ فَإِذَا عَزَمۡتَ فَتَوَكَّلۡ عَلَى ٱللَّهِۚ إِنَّ ٱللَّهَ يُحِبُّ ٱلۡمُتَوَكِّلِينَ ﴿١٥٩﴾

“Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun, se Allahu i do ata që i mbështeten”. *(Ali Imran: 159)*

Ajeti i mësipërm na mëson qartë që lideri i mirë duhet të jetë i mirë me pasuesit e tij, që të mos i mbingarkojë, që t’i fal dhe të kërkojë nga Allahu xh.sh. t’i fal ata.

4) Konsultimi

Ajeti i mësipërm na mëson për domosdoshmërinë e konsultimit. Lideri duhet të konsultojë ndjekësit e tij kur të merr vendime të rëndësishme që mund t’i dëmtojnë ata. Kjo do të shpie te vendime të mirëinformuara dhe të mirëpritura. Shiko kapitullin mbi menaxhmentin participues.

5) Vendosmëria

Gjithashtu, ajeti i mësipërm thekson vendosmërinë si një prej karakteristikave të një lideri. Në një ajet tjetër, Allahu xh.sh. thotë:

يَٰيَحۡيَىٰ خُذِ ٱلۡكِتَٰبَ بِقُوَّةٖۖ وَءَاتَيۡنَٰهُ ٱلۡحُكۡمَ صَبِيّٗا ﴿١٢﴾

“O Jahja, merre librin me shumë kujdes, dhe ashtu Ne i dhamë atij urtësi kur ishte fëmijë”. *(Merjem: 12)*

...وَإِن تَصۡبِرُواْ وَتَتَّقُواْ فَإِنَّ ذَٰلِكَ مِنۡ عَزۡمِ ٱلۡأُمُورِ ﴿١٨٦﴾

“…po në qoftë se duroni dhe ruheni, ajo është gjëja më vendimtare”. *(Ali Imran: 186)*

Nëse lideri shfaq këmbëngulje në kohën kur problemet e tij janë të origjinës njerëzore të një fuqie më të madhe, atëherë thuhet se ai ka vendosmëri. Një shembull i vendosmërisë mund të shihet në rastin e profetëve, si Muhamedit a.s., i cili u persekutua në fazat e hershme të misionit të tij nga udhëheqësit kurejshit, por i cili këmbënguli fuqishëm. Allahu xh.sh. thotë:

فَٱصْبِرْ كَمَا صَبَرَ أُو۟لُوا۟ ٱلْعَزْمِ مِنَ ٱلرُّسُلِ...﴿٣٥﴾

***“Ti** (Muhamed) **duro, ashtu sikurse duruan të dërguarit e vendosur…”.** (el-Ahkaf: 35)*

6) Dituria dhe urtësia

Lideri duhet të ketë dituri dhe urtësi. Kjo është evidente në ajetin vijues mbi Jahjan (Xhonin) dhe Musën (Mosa) r.a., të cilët ishin profetë të Allahut xh.sh.

وَلَمَّا بَلَغَ أَشُدَّهُۥ وَٱسْتَوَىٰٓ ءَاتَيْنَـٰهُ حُكْمًا وَعِلْمًا ۚ وَكَذَٰلِكَ نَجْزِى ٱلْمُحْسِنِينَ ﴿١٤﴾

***“E pasi ai** (Musai) **e arriti moshën madhore dhe u bë i pjekur, Ne i dhamë atij urtësi, e dituri. Kështu ne i shpërblejmë bamirësit”.** (el-Kasas: 14)*

Liderët duhet të kenë dituri dhe urtësi në fushën e tyre të udhëheqjes, në mënyrë që të marrin iniciativa që mund t’i shtojnë vlerë organizatave. Veç kësaj, me diturinë e specializuar të lidershipit që kërkohet në një fushë të caktuar, ai është i aftë të bëj një gjykim të informuar si dhe të komandojë vartësit e tij.

7) Tevekul

Ajeti 159 i sures Ali Imran thekson rëndësinë e tevekulit pasi të merret një vendim. Tevekul është mbështetja në Allahun xh.sh. pasi të bëjmë të gjitha përpjekjet. Koncepti i tevekulit është diskutuar gjerësisht në kapitullin 14. Ebu Bekër es-Sidiku r.a. demonstroi tevekulin në formën e tij më të pastër. Ai është përshkruar të jetë shumë besnik

për të lënë ndonjë vend për planifikim dhe shumë taktik dhe energjik në planifikimin e tij për të lënë ndonjë vend për besim.

8) Të qenët shembull

Liderët duhet të jenë shembuj. Ata duhet të lënë që veprimet e tyre të flasin më fort se fjalët e tyre. Liderët kanë përgjegjësi të krijojnë dhe ruajnë kulturën e organizatës. Nëse lideri punon shumë, atëherë punëtorët ka mundësi të punojnë më shumë. Në anën tjetër, nëse një lider nuk është i angazhuar për objektivin e organizatës, ai nuk do të jetë i aftë të motivojë të tjerët për të. Nëse fjalimi i liderit është në kundërshtim me ndjekësit e tij, atëherë, ai, shpejt ose vonë do të humb aftësinë të ndikojë te pasuesit e tij. Islami qorton fuqishëm ata të cilët nuk praktikojnë atë që thonë. Allahu xh.sh. thotë:

يَـٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ لِمَ تَقُولُونَ مَا لَا تَفْعَلُونَ ﴿٢﴾ كَبُرَ مَقْتًا عِندَ ٱللَّهِ أَن تَقُولُوا۟ مَا لَا تَفْعَلُونَ ﴿٣﴾

***“O ju që besuat! Pse po e thoni atë që nuk e punoni? Tek Allahu është shumë e urryer ta thoni atë që nuk e punoni!”** (es-Saf: 2-3)*

۞ أَتَأْمُرُونَ ٱلنَّاسَ بِٱلْبِرِّ وَتَنسَوْنَ أَنفُسَكُمْ...﴿٤٤﴾

***“A po i urdhëroni** (thirrni) **njerëzit për punë të mira, e veten tuaj po e harroni?...”.** (el-Bekare: 44)*

Shembulli i kësaj lloj udhëheqjeje është manifestuar te Muhamedi a.s. , për të cilin Allahu xh.sh. thotë:

لَّقَدْ كَانَ لَكُمْ فِى رَسُولِ ٱللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِّمَن كَانَ يَرْجُوا۟ ٱللَّهَ وَٱلْيَوْمَ ٱلْـَٔاخِرَ وَذَكَرَ ٱللَّهَ كَثِيرًا ﴿٢١﴾

***“Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh Allahun”.** (el-Ahzabë: 21)*

Liderët duhet të jenë gjithnjë të vetëdijshëm për atë që janë shembuj. Zakonisht personaliteti i tyre transmetohet në kulturën e organizatës. Liderët janë kulturëbërës dhe ata do të jenë më të mirë ashtu me dashje, e jo duke nënkuptuar.

9) Përgjegjësia dhe prekshmëria

Liderët duhet të posedojnë një ndjenjë më të madhe të përgjegjësisë sesa të tjerët. Lideri duhet të ndjehet thellë përgjegjës për çka do që është nën autoritetin e tij/saj, dhe përgjegjësia detyron llogaridhënien në këtë botë dhe në Botën tjetër. Omeri r.a., halifi i dytë i Muhamedit a.s., njëherë tha që kishte frikë që një mushkë mund të rrëzohej në rrugët malore të Irakut dhe të thyente këmbët, dhe Zoti mund ta pyeste pse nuk kishte shtruar rrugët në atë pjesë. Kjo demonstron shkallën në të cilën Omeri ndjente përgjegjësinë, që i lejoi atij të arrinte përsosmëri menaxheriale, të njohur historikisht. Omer ibn Abdul Azizi, ishte shumë i kujdesshëm në përdorimin e çdo gjëje nën kontrollin e tij, duke besuar që përgjegjësia e tij është burim i poshtërimit dhe i pendimit në Botën e Përjetshme. Ky qëndrim i Omer ibn Abdul Azizit rezultoi me përdorimin optimal të burimeve të ymetit.

Liderët nuk duhet të jenë vetëm përgjegjës, por edhe të ndjeshëm ndaj të tjerëve. Pasi që menaxherët e ndjeshëm vendosin veten në këpucët e tjerëve, ata janë më të aftë në kontrollimin e përshtatshmërisë së vendimeve të tyre. Veç kësaj, ndjeshmëria përkrah besimin mes vartësve, të cilët ka mundësi të shkëmbejnë ndjeshmërinë e liderëve, duke dhënë më shumë. Ndjeshmëria ishte një prej karakteristikave kryesore të Muhamedit a.s. Allahu xh.sh. thotë:

لَقَدۡ جَآءَكُمۡ رَسُولٞ مِّنۡ أَنفُسِكُمۡ عَزِيزٌ عَلَيۡهِ مَا عَنِتُّمۡ حَرِيصٌ عَلَيۡكُم بِٱلۡمُؤۡمِنِينَ رَءُوفٞ رَّحِيمٞ ﴿١٢٨﴾

“Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët”. *(et-Tevbe: 128)*

10) Vetëpërmbajtja

Gjithashtu, lideri duhet të jetë i vetëpërmbajtur. Kjo është evidente në ajetin vijues kuranor, ku Allahu xh.sh. thotë:

إِنَّ إِبۡرَٰهِيمَ لَحَلِيمٌ أَوَّٰهٞ مُّنِيبٞ ﴿٧٥﴾

“Vërtet, Ibrahimi ishte shumë i butë, shumë i dhembshëm dhe i kthyeshëm”. *(Hudë: 75)*

Transmetohet se i Dërguari a.s. ka thënë:

“I fortë mes jush nuk është ai që i mposht të tjerët, por ai i cili mund të kontrollojë veten në momentin e zemërimit”. (Muslimi)

وَجَعَلۡنَا مِنۡهُمۡ أَئِمَّةٗ يَهۡدُونَ بِأَمۡرِنَا لَمَّا صَبَرُواْۖ وَكَانُواْ بِـَٔايَٰتِنَا يُوقِنُونَ ﴿٢٤﴾

“Dhe prej tyre Ne bëmë prijës që me urdhrin Tonë udhëzojnë, pasi që ata *(që i bëmë prirës)* ***ishin të durueshëm dhe ndaj argumenteve Tona ishin të bindur”.*** *(es-Sexhde: 24)*

Zemërimi dhe nxitimi i liderëve mund të sjell rezultate katastrofike. Liderët nuk duhet t’i marrin gjërat personalisht dhe të reagojnë nga zemërimi apo të kalojnë egon e tyre. Ata duhet të mbajnë qetësinë, racionalizmin, drejtësinë dhe urtësinë e tyre.

Allahu xh.sh. thotë:

وَلَنَبۡلُوَنَّكُم بِشَيۡءٖ مِّنَ ٱلۡخَوۡفِ وَٱلۡجُوعِ وَنَقۡصٖ مِّنَ ٱلۡأَمۡوَٰلِ وَٱلۡأَنفُسِ وَٱلثَّمَرَٰتِۗ وَبَشِّرِ ٱلصَّٰبِرِينَ ﴿١٥٥﴾

“Ne do t’ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria, e nga jeta e edhe nga frytet, po ti jepu myzhde durimtarëve”. *(el-Bekare: 155)*

11) Vizioni

Liderët duhet të kenë gjithashtu vizion apo qëllim afatgjatë dhe duhet të fokusohen në arritje graduale. Dr. Mahathir Muhamed, kryeministër i Malajzisë,[3] thotë që lideri i mirë duhet të jetë planifikues afatgjatë:

"Unë besoj që liderët duhet të shikojnë shumë më përpara dhe të mos shikojnë për qëllimet e menjëhershme".

Vizioni është ajo që e dallon një lider nga një menaxher i thjeshtë. Në fakt, Muhamedi a.s. dhe sahabët (pasuesit) e tij ishin të aftë të durojnë vështirësi dhe humbje të mëdha për të arritur një sukses afatgjatë. Kjo e karakterizoi liderin e ndjerë të të drejtave civile Dr. Martin Luter Kingun në vizionin e tij për Amerikën tolerante nga pikëpamja racore. Ky vizion është shprehur në thënien e Dr. Kingut, "Unë kam një ëndërr". Dr. Mahathir kritikon ashpër liderët që janë të shqetësuar për fitimet e menjëhershme.

12) Komunikimi

Nuk mjafton për liderët të jenë të angazhuar për objektivin e tyre afatgjatë dhe plot me ide nëse nuk dinë si të komunikojnë. Aftësitë komunikuese janë të nevojshme për çdo pozitë udhëheqëse. Kjo është arsyeja që shtyri Musën a.s., kur ishte caktuar si i dërguar i Allahut, të kërkojë të shoqërohet nga Haruni a.s., vëllau i tij, i cili ishte orator në fjalimin e tij. Kjo shihet në ajetin vijues:

وَأَخِى هَـٰرُونُ هُوَ أَفْصَحُ مِنِّى لِسَانًا فَأَرْسِلْهُ مَعِىَ رِدْءًا يُصَدِّقُنِىٓ ۖ إِنِّىٓ أَخَافُ
أَن يُكَذِّبُونِ ﴿٣٤﴾

"E vëllai im, Haruni, është më orator se unë, andaj dërgoje atë me mua ndihmë që të vërtetojë fjalët e mia. Unë kam frikë se do të më shpallin gënjeshtar". *(el-Kasas: 34)*

[3] Mahathir Muhammad, Kryeministër i Malajzisë, në një fjalim të mbajtur me 24 gusht 1993, në ora 11

13) Etja për të mësuar: Adaptimi

Sipas teorisë së rastisjes së lidershipit,[4] është i vështirë trajnimi i liderëve për situata të ndryshme të lidershipit. Megjithatë, si liderët ashtu edhe vartësit, gjithmonë duhet të kërkojnë të rritin njohuritë e tyre dhe të përmirësojnë aftësitë për të qenë në gjendje t'i adaptohen ndryshimeve të reja në botën gjithnjë e në zhvillim.

...وَقُل رَّبِّ زِدْنِى عِلْمًا ﴿١١٤﴾

"…Thuaj: "Zoti im, më shto diturinë". *(Ta Ha: 114)*

14) Drejtësia dhe ndjenja e pastër e besnikërisë

Lidershipi kërkon drejtësi dhe ndjenjë të pastër të besnikërisë. Kjo është shpjeguar në ajetin vijues:

يَـٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ كُونُوا۟ قَوَّٰمِينَ لِلَّهِ شُهَدَآءَ بِٱلْقِسْطِ ۖ وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ
شَنَـَٔانُ قَوْمٍ عَلَىٰٓ أَلَّا تَعْدِلُوا۟ ۚ ٱعْدِلُوا۟ هُوَ أَقْرَبُ لِلتَّقْوَىٰ ۖ ...﴿٨﴾

"O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë. Bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kini drojë Allahun…". *(el-Maide: 8)*

Qeniet njerëzore kanë tendencë t'i lejojnë ndjenjat të mbulojnë gjykimin e tyre. Ky mbulim shpie te padrejtësia. Një lider duhet të shmang këtë nëse dëshiron të sigurojë dhe të ruaj respektin e ndjekësve të tij, dhe në këtë mënyrë do të merr performansën më të mirë nga ata. Sigurisht që nuk është e lehtë të zbatohet drejtësia nëse bie ndesh me interesin e dikujt. Ne megjithatë mund të vlerësojmë vetëm drejtësinë e dikujt në këtë rast.

Në një ajet tjetër, Allahu xh.sh. thotë:

[4] Friedler, F. E., "Contingency Model and The Leadership Process", In Gerkowitz (ed.), Advances in Experimental Social Psychology, Vol. 11, Academic Press, N.Y., (1978).

قُلْ إِن كَانَ ءَابَآؤُكُمْ وَأَبْنَآؤُكُمْ وَإِخْوَٰنُكُمْ وَأَزْوَٰجُكُمْ وَعَشِيرَتُكُمْ وَأَمْوَٰلٌ ٱقْتَرَفْتُمُوهَا وَتِجَٰرَةٌ تَخْشَوْنَ كَسَادَهَا وَمَسَٰكِنُ تَرْضَوْنَهَآ أَحَبَّ إِلَيْكُم مِّنَ ٱللَّهِ وَرَسُولِهِۦ وَجِهَادٍ فِى سَبِيلِهِۦ فَتَرَبَّصُوا۟ حَتَّىٰ يَأْتِىَ ٱللَّهُ بِأَمْرِهِۦ ۗ وَٱللَّهُ لَا يَهْدِى ٱلْقَوْمَ ٱلْفَٰسِقِينَ ﴿٢٤﴾

***“Thuaj** (o i Dërguar): **“Në qoftë se etërit tuaj, djemtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasuria që e fituat, tregtia që frikësoheni se do të dështojë, vendbanimet me të cilat jeni të kënaqur,** (të gjitha këto) **janë më të dashura për ju se Allahu, se i dërguari i Tij dhe se lufta për në rrugën e Tij, atëherë, pritni derisa Allahu nuk vë në rrugën e drejtë njerëzit e prishur”.** (et-Tevbe: 24)*

Nga ajeti i mësipërm, mund të nxirret përfundim që në asnjë rrethanë, lideri nuk duhet të lëkundet nga të qenët besnik ndaj Allahut xh.sh. Prandaj, nëse ekziston ndonjë konflikt në mes të interesit të familjes së dikujt dhe drejtësisë, ai duhet të shkojë kah drejtësia.

15) Informimi mbi mundësitë dhe kufizimet e pasuesve

Lideri duhet të jetë i informuar mbi mundësitë e pasuesve. Kurrë nuk duhet të nënvlerësojë vartësit e tij. E as duhet të humb shpresën në ta. Muhamedi a.s. thotë:

“Kushdo që thotë që njerëzit janë në humbje është ose më i humburi mes tyre ose është shkaktari që ata të jenë në humbje”. (Muslimi)

Liderët gjithashtu duhet të jenë të informuar për kufizimet e vartësve të tyre, në mënyrë që të mos i ngarkojnë me atë që nuk mund të bartin.

لَا يُكَلِّفُ ٱللَّهُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا...﴿٢٨٦﴾

***“Allahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij…”.** (el-Bekare: 286)*

وَمَآ أَعْجَلَكَ عَن قَوْمِكَ يَٰمُوسَىٰ ﴿٨٣﴾ قَالَ هُمْ أُو۟لَآءِ عَلَىٰٓ أَثَرِى وَعَجِلْتُ إِلَيْكَ رَبِّ لِتَرْضَىٰ ﴿٨٤﴾ قَالَ فَإِنَّا قَدْ فَتَنَّا قَوْمَكَ مِنۢ بَعْدِكَ وَأَضَلَّهُمُ ٱلسَّامِرِىُّ ﴿٨٥﴾

***“Po ty o Musa: “Ç’të nguti para popullit tënd?” Ai u përgjigj: “Ja, ata janë pranë meje e unë u nguta te Ti, o Zoti im, që të jesh i kënaqur ndaj meje!” Ai** (Allahu) **tha: “Ne sprovuam popullin tënd pas teje, dhe ata i hodhi në humbje Samiriji!”.** (Ta Ha: 83-85)*

Ajeti i mësipërm tregon që Musa a.s. ishte i nxituar për një shkak të mirë dhe mendoi se njerëzit e tij ishin duke e ndjekur mirë. Fatkeqësisht, ata u lanë prapa dhe përfunduan duke adhuruar një dem.

16) Vetëdija për kufizimet e tij

Lideri duhet të jetë i vetëdijshëm për kufizimet e tij, në mënyrë që të merr ndihmën e nevojshme për të forcuar atë. Kështu, do të mundësojë që të zbatojë misionin e tij në mënyrë efektive dhe efikase dhe kështu arritjen e suksesit. Kjo është treguar në ajetin vijues:

وَأَخِى هَٰرُونُ هُوَ أَفْصَحُ مِنِّى لِسَانًا فَأَرْسِلْهُ مَعِىَ رِدْءًا يُصَدِّقُنِىٓ ۖ إِنِّىٓ أَخَافُ أَن يُكَذِّبُونِ ﴿٣٤﴾

***“E vëllai im, Haruni, është më orator se unë, andaj dërgoje atë me mua ndihmë që të vërtetojë fjalët e mia. Unë kam frikë se do të më shpallin gënjeshtar”.** (el-Kasas: 34)*

Në ajetin e mësipërm, Musa duke pranuar dobësinë e tij kërkoi për ndihmë për të kompensuar këtë. Duke vepruar kështu, i ndihmoi më mirë kauzës së tij.

2 - Zhvillimi i lidershipit

Fakti që shumë liderë të shquar posedonin aftësi më të mëdha se që kishin njerëzit e tjerë, sugjeron që liderët duhet të kenë disa veçori që i veçojnë nga qeniet e tjera njerëzore.[5] Kjo teori duhet të quhet teoria e tiparit. Kjo teori mbështetet nga mësimet e Muhamedit a.s., i cili luste Allahun xh.sh. që të udhëzonte një prej dy njerëzve të fuqishëm të fisit të tij në Islam, për shkak të tipareve të personalitetit të tyre. Muhamedi a.s. thotë:

“O Allah! Forco Islamin me atë që është më i dashur te ti: Ebu Xhehlin (Omer ibn Hakim) ose Omer ibn Hatabin”. (Tirmidhiu)

Gjithashtu, Muhamedi a.s. thotë:

“Njerëzit janë sikur minierat. Më i miri prej tyre në Xhahilijet (para Islamit) është më i miri pas Islamit, nëse mësojnë”. (Buhariu dhe Muslimi)

Thënia e mësipërme e Muhamedit a.s. sugjeron që tiparet e liderëve janë shumë të rëndësishëm, por efikasiteti i tyre do të varet nga mësimi apo marrja e diturisë së nevojshme. Ky nocion mund të përfshijë gjithashtu atë se kur të arrihet dituria e nevojshme, liderët mund t’i përshtaten më mirë situatave të ndryshme. Nëse veçoritë e liderëve janë fituar apo dhuruar, kjo është çështje filozofike. Autori beson që ato janë fituar dhe dhuruar.

Megjithatë, fitimi i këtyre tipareve është proces i gjatë që duhet të ndodh në një fazë të hershme. Atributi kryesor i një lieri është ndjenja e përgjegjësisë apo e ndjeshmërisë. Disa njerëz kufizojnë përgjegjësinë e tyre vetëm te vetja. Të tjerët kanë sferë më të madhe të përgjegjësisë. Lideri duhet të jetë person me ndjeshmëri për të tjerët. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i lidershipit janë vendimet. Njerëzve duhet t’u besohet autoriteti për të marrë vendime që nga mosha e re. Menaxherët mund të kontribuojnë në zhvillimin e liderëve duke deleguar autoritetin te vartësit e tyre. Detyra kryesore në zhvillimin e lidershipit është

[5] Baron R. A., Greenberg, J. “Behavior in Organizations”, Allyn and Bacon, Boston (1989), p. 376

identifikimi i liderëve potencial. Këtyre liderëve potencial duhet pastaj t’u mësohen mësime të ndryshme të lidershipit. Gjithashtu, ata duhet të trajnohen të udhëheqin dhe të marrin vendime përmes delegimit të autoritetit.

Hosner[6] thekson që funksionet kryesore të një lideri janë krijimi i ndjenjës së angazhimit mes ndjekësve të tij dhe nxitja e tyre të kontribuojnë diçka më tepër, apo disa përpjekje shtesë për të mirën e organizatës. Kjo lë të kuptohet që rolet kryesore të një lideri janë motivimi i pasuesve të tij/saj. Koncepti i motivimit në Islam do të prezantohet në kapitullin tjetër. Gjithashtu, kapitulli tjetër do të adresojë faktorin kryesor te punëtorët, kënaqësinë.

STUDIM RASTI

Lidershipi i Ebu Bekrit

Ebu Bekri r.a., njeriu i parë që pranoi Islamin, ishte sahabiu më i ngushtë dhe vjehërri i Muhamedit a.s. Shquhej për besimin e fortë dhe zemërgjerësinë e tij. Kur Muhamedi a.s. ndërroi jetë, të gjithë sahabët e tij u mallëngjyen. Omeri r.a. shkoi deri në pikën e mohimit të vdekjes. Duke qenë i ballafaquar me këtë situatë, Ebu Bekri r.a. tha: “Kushdo që e ka adhuruar Muhamedin, Muhamedi është i vdekur, por kushdo që e ka adhuruar Allahun, Allahu është i gjallë dhe kurrë nuk vdes”. Allahu xh.sh. thotë:

وَمَا مُحَمَّدٌ إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِن قَبْلِهِ ٱلرُّسُلُ ۚ أَفَإِيْن مَّاتَ أَوْ قُتِلَ ٱنقَلَبْتُمْ عَلَىٰٓ
أَعْقَـٰبِكُمْ ۚ وَمَن يَنقَلِبْ عَلَىٰ عَقِبَيْهِ فَلَن يَضُرَّ ٱللَّهَ شَيْـًٔا ۗ وَسَيَجْزِى ٱللَّهُ
ٱلشَّـٰكِرِينَ ﴿١٤٤﴾

[6] Hosner, L., T., “A strategic View of Leadership”, in strategic Planning and Management handbook, edited by King and Cleland (1987), p. 47

"Muhamedi nuk është tjetër vetëm se i dërguar. Edhe përpara tij pati të dërguar *(që vdiqën ose u vranë).* ***E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa*** *(nga feja ose nga lufta)?* ***E kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën dëm Allahut aspak, kurse Allahu do t'i shpërblejë mirënjohësit".*** *(Ali Imran: 144)*

Njerëzit heshtën dhe Omeri ra në tokë pasi që këmbët e tij nuk mund të duronin. Ishte sikur të mos ishte dëgjuar kurrë më parë ai ajet.

Deklarimi i Ebu Bekrit në lidhje me vdekjen e Profetit a.s. solli një lehtësim dhe qetësi të menjëhershme mes sahabëve. Megjithatë, kjo tragjedi ishte shkëndijë për grindje dhe heretizëm gjatë gjithë Gadishullit Arabik. Shumë prej fiseve arabe refuzuan të paguajnë zekatin dhe disa njerëz pretenduan profetizmin. Heretizmi ishte sfida kryesore me të cilën ballafaqohej Ebu Bekri si halifi i parë. Në këto rrethana, Ebu Bekri duhej të vendoste nëse do të dërgonte apo jo ushtrinë e tetëmbëdhjetë vjeçarit, Usame ibn Zejd, për të luftuar romakët, ashtu siç kishte planifikuar i Dërguari a.s. Shumë sahabij, duke përfshirë edhe Usamën, sugjeruan që ky operacion duhej të anulohej dhe ajo ushtri duhej të mbahej në Medine për të mbrojtur atë nga çdo sulm i mundshëm nga hipokritët. Ebu Bekri insistoi në dërgimin e ushtrisë, pavarësisht rreziqeve të shoqëruara me këtë vendim. Ai tha: "Pasha Allahun nuk do të thur nyjë nga i Dërguari i Allahut. Nëse zogjtë na kapin dhe kafshët e egra e rrethojnë Medinën, dhe nëse qentë ecin afër këmbëve e nënave të besimtarëve, unë pa dyshim do të furnizoj ushtrinë e Usamës".

Ebu Bekri gjithashtu vendosi t'i luftojë hipokritët që kontrollonin gjithë Gadishullin Arabik, me përjashtim të Medinës, Mekës dhe Taifit. Omeri kundërshtoi këtë vendim në fillim. Ai mendoi se nuk ishte e drejtë të luftoheshin njerëzit vetëm pse nuk paguanin zekat. Gjithashtu, konsideronte që kjo nuk ishte ide e mirë për të luftuar ata, derisa ushtria e Usamas ishte akoma jashtë. Sidoqoftë, Ebu Bekri insistoi në opinionin e tij, duke deklaruar se ai do t'i luftonte ata pasi që përmbaheshin nga dhënia e asaj që i jepnin Muhamedit a.s. Ai më pastaj tha: "Shpallja ka përfunduar dhe feja është kompletuar. A do të pakësohet derisa unë të jem gjallë?" Kur Omeri pa bindjen dhe vendosmërinë e madhe të Ebu Bekrit, ndryshoi menjëherë qëndrimin e tij.

Tri nga fiset hipokrite dëshiruan të shfrytëzonin mungesën e ushtrisë së Usamës nga Medina, për të sulmuar atë. Kështu, lëvizën në periferi të qytetit dhe dërguan të dërguarit e tyre te Ebu Bekri për ta detyruar të bënte kompromis me ta dhe të pranonte refuzimin e tyre për të paguar zekatin. Ebu Bekri refuzoi kërkesat e tyre dhe i sulmoi në befasi në të njëjtën natë. Kjo shënoi humbjen e parë të hipokritëve. Më vonë, ushtria e Usamës u kthye në Medine dhe Ebu Bekri filloi dërgimin e ushtrive të tij për të luftuar fiset e ndryshme hipokrite.

Ebu Bekri ishte i njohur për dëshirën e fuqishme dhe besimin në kauzën e Allahut xh.sh. si dhe mençurinë dhe taktikat e tij. Ai është përshkruar të jetë shumë besnik të lë ndonjë vend për planifikim dhe shumë taktik dhe energjik në planifikimin e tij për të lënë ndonjë vend për besim. Kur Ebu Bekri dërgoi një ushtri të udhëhequr nga Halidi për të luftuar profetin e vetëshpallur Tulejha ibn Huvejlid, nuk e përmendi në publik. Në vend të kësaj tha, "O njerëz! Shkoni në emrin e Allahut dhe bekimin e Tij. Lideri juaj është Halidi derisa t'ju takoj. Unë po shkoj në drejtim të Hajberit (fis çifut në Gadishullin Arabik) derisa t'ju takoj", por Ebu Bekri nuk shkoi në Hajber. Ai e tha këtë vetëm që të zë në befasi armikun dhe të detyrojë Hajberin të rri në fshatin e tyre e mos t'u ndihmojë hipokritëve. Kjo është një prej ngjarjeve që tregon mençurinë dhe taktikat e Ebu Bekrit. Pasi që përfundoi me hipokritët, Ebu Bekri filloi të dërgojë ushtritë e tij për të siguruar kufijtë e muslimanëve me persianët dhe romakët.

Pasi që Ebu Bekri sundoi vetëm për dy vite dhe pasi kryesisht ishte i preokupuar me luftërat kundër hipokritëve, lidershipi i tij nuk dëshmoi shumë risi administrative. Megjithatë, krijoi thesarin, caktoi gjykatësin suprem, dhe ndau shtetin islam në regjione të ndryshme administrative. Ai delegoi autoritetin te komandantët e tij. Këto arritje administrative ishin shumë kritike, pasi që shtruan rrugën për zhvillimet e pas Shpalljes të ndërmarra nga Omeri.

MOTIVIMI

Askush nuk di më mirë për një makinë se ai që e ka dizajnuar dhe prodhuar atë. Ngjashëm, askush nuk di më shumë për njeriun dhe natyrën e tij, sesa Krijuesi i tij.

أَلَمۡ نَجۡعَل لَّهُۥ عَيۡنَيۡنِ ۝٨ وَلِسَانٗا وَشَفَتَيۡنِ ۝٩ وَهَدَيۡنَٰهُ ٱلنَّجۡدَيۡنِ ۝١٠

"A nuk i dhamë Ne atij dy sy? Edhe gjuhë e dy buzë? Dhe i sqaruam atij për të dy rrugët". *(el-Beled: 8-10)*

إِنَّا هَدَيۡنَٰهُ ٱلسَّبِيلَ إِمَّا شَاكِرٗا وَإِمَّا كَفُورًا ۝٣

"Ne e udhëzuam atë në rrugë të drejtë, e ai do të jetë: mirënjohës ose përbuzës". *(el-Insan: 3)*

إِذۡ قَالَ رَبُّكَ لِلۡمَلَٰٓئِكَةِ إِنِّي خَٰلِقُۢ بَشَرٗا مِّن طِينٖ ۝٧١

"Kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë po krijoj një njeri nga balta". *(Sad: 71)*

Pasi që Allahu xh.sh. na ka krijuar, Ai është i Vetmi që na njeh më së miri, dhe prandaj, mund të arrijmë të kuptojmë veten nga Kurani. Ekzistojnë shumë aspekte të vetëkuptimit që mund të mësohen në Kuran, por për momentin duam të adresojmë çështjen e motivimit. Do të fillojmë me prezantimin, sesi të planifikojmë për motivim. Pastaj, do të diskutojmë shpërblimin dhe ndëshkimin. Seksioni i tretë do të mbulojë motivimin shpirtëror dhe në fund do të theksojmë drejtësinë si një faktor higjienik.

1 - Planifikimi për motivim

Hapi i parë në motivim ndodh që në procesin e planifikimit. Gjithnjë është më mirë që qëllimet të zgjidhen dhe të definohen përmes një procesi pjesëmarrës. Pastaj, natyra e qëllimeve, sa sfiduese që janë, dhe nëse ndodhen brenda forcës së organizatës janë shumë kritik në përcaktimin e nivelit të motivimit.

Objektivi më shpërblyes inspiron dedikim dhe përpjekje më të mëdha. Njerëzit kanë nevojë të dinë ndihmën personale që u ofron arritja e qëllimeve. Kanë nevojë të dinë qëllimin. Në rast se kultura organizative përfshin ndjenjën e përkatësisë dhe të angazhimit mes të gjithë anëtarëve të organizatës, nuk do të jetë e vështirë për askënd të identifikojë atë që është e mirë për të, në arritjen e qëllimeve. Kjo do të thotë që kultura organizative ndikon në motivim. Në anën tjetër, lloji i motivimit dhe lloji i sistemit të shpërblimit që përfshin ajo, gjithashtu prek kulturën organizative. Për shembull, shpërblimet e grupit mund të nxisin ndjenjën e komunitetit më mirë se shpërblimet individuale. Pastaj, çdo lloj i padrejtësisë do të shkarkojë kërkesën për një kulturë të kolektivitetit.

Qëllimet që janë brenda forcës së organizatës janë qëllime që përshtaten mirë me aftësitë dhe burimet e organizatës. Kjo do të thotë që ai nuk është lehtësisht i realizueshëm për organizatën të arrijë këto qëllime, por pritet që organizata të shquhet në arritjen e tyre. Në rast se organizata nuk posedon aftësitë dhe burimet e nevojshme të arrijë objektivat e saj, atëherë i duhet të planifikojë për sigurimin e më shumë burimeve dhe të aftësive përmes trajnimit dhe rekrutimit.

Menaxhmenti duhet të vendos programe të duhura trajnuese teknike dhe të sjelljes. Programet e trajnimit janë të domosdoshme kur punëtorëve u mungojnë aftësitë e nevojshme për të kryer detyrat e tyre, pasi që njerëzit janë armiq të asaj që injorojnë. Programet e trajnimit po bëhen më kritike pasi që mjedisi i biznesit po ndryshon shpejt.

Pastaj, duhet të theksohet fakti që plani i përshtatet forcës së organizatës, pasi që njerëzit duhet të besojnë që mund të arrijnë objektivin e dëshiruar. Kjo garanton një nivel të lartë të pritjes përpjekje-performansë. Pa vetëbesim, punëtorët mund të irritohen. Për të adresuar çështjen e besimit, menaxherët duhet të provojnë të bëjnë disa deklarata që tregojnë besimin te vartësit e tyre.

Në planifikimin afatgjatë, nuk mjafton që objektivi afatgjatë të jetë shumë tërheqës dhe të jetë brenda forcës së organizatës. Është njëlloj e rëndësishme që qëllimet e ndërmjetme të jenë tërheqëse, përndryshe arritja e objektivit afatgjatë do të vihet në pyetje. Gjithashtu,

është shumë e rëndësishme të vendoset lidhja e drejtpërdrejtë mes çdo veprimi përgjatë rrugës që shpie te objektivi afatgjatë dhe vetë objektivit afatgjatë. Kemi parë që çdo veprim, pavarësisht madhësinë, ka një vlerë korresponduese (shpërblim apo ndëshkim) në objektivin afatgjatë të Islamit. Në këtë mënyrë, njerëzit do të fokusohen në objektivin afatgjatë dhe do të kuptojnë që performansa mediokër apo e vogël në çdo moment do t'i ndjek ata për një kohë të gjatë. Ne jemi përpjekur të përdorim këtë mënyrë në motivimin e dy klasave të studentëve të biznesit, të cilët ndajnë të njëjtin profesor, për të studiuar për një term të përbashkët. Më pas, u shpjeguam studentëve të një prej klasave që termi i tyre jo vetëm do të ndikojë në nota te lëndët e tyre, por madje do të ndikojë në notat mesatare grumbulluese të tyre, pasi që notat e lëndës do të paraqiten gjithmonë në transkriptet e tyre. Më pastaj, u treguam, që kjo do të ndikojë te lloji i punës që do të kenë, dhe nëse do të shkojnë apo nuk do të shkojnë në aspiranturë. Veç kësaj, nëse ata do të mund të pranohen në aspiranturë, ky term do të kontribuojë në përcaktimin e shkollës që do të shkojnë. Në parim, ne u kemi treguar studentëve që termi do të ndajë gjithë jetët e tyre. Më pas, këta studentë janë pyetur nëse kuptimi i rëndësisë së termit në atë mënyrë i ka motivuar, e ata, që të gjithë u përgjigjën pozitivisht. Në të vërtetë, mjetet e klasës që u janë ekspozuar një motivimi të tillë ishin 117.8% të klasës tjetër.

Shembulli i tre punëtorëve ndërtimor, diskutuar në seksionin "Objektivi" (Pjesa II Planifikimi) është relevant në këtë kontekst. Një prej këtyre punëtorëve ishte pyetur çfarë bënte, ndërsa ai i kishte thënë, se po vendoste tulla. Kjo i korrespondon nivelit më të ulët të veprimit në figurë. Kur punëtori i dytë ishte pyetur çfarë po bënte, ai ishte përgjigjur se po ndërtonte një mur. Kjo i korrespondon qëllimit të nivelit mesatar në figurë. Në fund, kur ishte pyetur punëtori i tretë me të njëjtën pyetje, ai u përgjigj që po ndërtonte një shtëpi. Kjo i korrespondon objektivit të nivelit më të lartë në figurë. Nga kjo është e qartë që punëtori i tretë ishte më shumë i motivuar, pasi që ai pa më shumë kuptim në atë që ishte duke bërë sesa që dy punëtorët tjerë. Menaxherët duhet t'i bindin punëtorët që të gjithë janë duke ndërtuar një shtëpi

apo duke kontribuar në qëllimin përfundimtar, sesa t'i bënë të ndihen që janë vetëm duke vënë tulla apo duke kryer një detyrë pothuajse domethënëse.

Muslimanët duhet të përqendrohen në objektivin afatgjatë të xhenetit. Nuk duhet të lidhen shumë me qëllimet e ndërmjetme në këtë jetë. Ne shpërblehemi për përpjekjet qëllimmira, madje edhe nëse dështojmë t'i kryejmë mirë, e lë më të arrijmë rezultatin. Ndryshe nga ajo që sugjerohet nga Vroomi,[7] motivimi ynë nuk varet nga pritjet e performansës dhe rezultatit.

Muhamedi a.s. thotë:

"Nëse vjen Kiameti dhe ndonjë nga ju është duke mbjell, nëse mundet ta mbjellë atë, e të largohet, atëherë duhet ta mbjellë atë". (Buhariu)

Sahabët e Muhamedit a.s. u shquan në ndjekje të hapjes së Mekës. Në të vërtetë, shumë prej tyre u bënë dëshmorë dhe nuk e panë kurrë Mekën, duke qenë muslimanë. Arsyeja kryesore në performansën e shkëlqyer të sahabëve të Muhamedit a.s. ishte ajo që ata besonin në shpërblimin në xhenet, pasi që përpjekjet apo orvatjet e tyre pavarësisht në arrijnë apo jo qëllimin tjetër, ishte hapja e Mekës.

Pasi të kompletohet planifikimi dhe vendosen lidhje të drejtpërdrejta në mes të veprimeve të ndryshme të kërkuara dhe objektivit afatgjatë, menaxherët duhet të ndajnë qartë përgjegjësitë mes vartësve të tyre. Ata, duhet të shpjegojnë qartë planin për vartësit e tyre, të cilët nuk ishin pjesë e procesit të planifikimit, pasi që njerëzit nuk mund të motivohen për të arritur atë që nuk dinë. Objektivi dhe mënyra për të arritur atë, duhet të jetë e pastër si kristal për çdonjërin.

Allahu xh.sh. thotë:

قُلۡ هَٰذِهِۦ سَبِيلِيٓ أَدۡعُوٓاْ إِلَى ٱللَّهِۚ عَلَىٰ بَصِيرَةٍ أَنَا۠ وَمَنِ ٱتَّبَعَنِيۖ ... ﴿١٠٨﴾

"Thuaj: "Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras te Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje…". *(Jusuf: 108)*

Ajeti i mësipërm tregon që Muhamedi a.s. dhe pasuesit e tij kanë kuptuar qartë rrugën e tyre.

[7] Vroom, V. H. "Work Motivation", N. Y., John Wiley, 1964

2 - Shpërblimi dhe ndëshkimi

Pasi që janë adresuar çështjet e mësipërme, vjen roli i shpërblimit dhe i ndëshkimit. Shpërblimi është një rezultat i dëshirueshëm që rezulton nga një sjellje e dëshirueshme, derisa ndëshkimi është rezultat i padëshirueshëm që pason një sjellje të padëshiruar. Shumë mendimtarë të menaxhmentit, argumentojnë që ndëshkimi kurrë nuk duhet të përdoret si mjet i motivimit. Argumentet e cituara kundër përdorimit të ndëshkimit përfshijnë frikën që mund të shpie te shtypja e sjelljes së dëshiruar shoqërore. Kjo mund të ndodh kur ndëshkimi është shumë i ashpër. Më pas, është argumentuar që ndëshkimi mund të rezultojë me efekte anësore negative siç janë: ankthi, sulmi dhe mbyllja në vete. Në realitet, ndëshkimi përgjithësisht është përdorë në organizata, në një mënyrë, apo tjetrën.[8] Islami përdor joshjen për shpërblim, e frikën nga ndëshkimi. Në të vërtetë, çdo qenie njerëzore nuk është realizues i madh, dhe shumë njerëz në faza të ndryshme të jetës së tyre priren të jenë të kënaqur me statusin e tyre dhe nuk e marrin parasysh përmirësimin, pavarësisht sa shumë shpërblim mund të marrin. Megjithatë, këta njerëz mund të motivohen më mirë përmes frikës së ndëshkimit. Zakonisht njerëzit veprojnë nga shpresa apo nga frika. Ata nganjëherë veprojnë në saje të faktorëve të tjerë siç janë dashuria dhe urrejtja, por ky i fundit mund të transferohet gjithmonë në shpresë dhe frikë. Bosnja është shkretuar në një gjenocid të zgjatur që rezultoi me vdekjen e qindra mijëra njerëzve dhe me përdhunimin e dhjetëra mijëra grave e fëmijëve.

Më 29 korrik 1993, Ministri i jashtëm i Bosnjës, Haris Silajxhiq, i cili dështoi të bind komunitetin ndërkombëtar për të hequr embargon e padrejtë të armëve të imponuara ndaj njerëzve të tij, thotë: “Nuk ka norma njerëzore, përveç nëse je i pasur apo i rrezikshëm”. Ky ishte një pohim fatkeq që komuniteti ndërkombëtar mund të motivohet ve-

[8] Katz, D., and Khan, R. L., “The Social Psychology of Organizations”, 2nd ed. N.Y., John Wiley and Son, (1979).

tëm përmes frikës apo shpresës. Në Islam, ose duhet shkuar prapa, ose duhet shkuar para. Allahu xh.sh. thotë:

إِنَّهَا لَإِحۡدَى ٱلۡكُبَرِ ﴿٣٥﴾ نَذِيرًا لِّلۡبَشَرِ ﴿٣٦﴾ لِمَن شَآءَ مِنكُمۡ أَن يَتَقَدَّمَ أَوۡ يَتَأَخَّرَ ﴿٣٧﴾

“S’ka dyshim se ai *(Sekari)* ***është një nga belatë më të mëdha. Është vërejtje për njerëz! Për atë nga mesi juaj që dëshiron të përparojë (në të mira) apo të ngecë”.*** *(el-Mudethir: 35-37)*

Në Islam, ekzistojnë si shpërblimi ashtu edhe ndëshkimi, si në këtë botë edhe në Botën tjetër, pasi që njerëzit veprojnë nga frika apo nga shpresa. Muhamedi a.s. si dhe të dërguarit e tjerë të Allahut xh.sh. ishin dërguar si përgëzues dhe qortues:

إِنَّآ أَرۡسَلۡنَٰكَ بِٱلۡحَقِّ بَشِيرًا وَنَذِيرًاۖ ... ﴿١١٩﴾

“Ne të dërguam ty me të vërtetën (me Kuranin), përgëzues dhe qortues…”. *(el-Bekare: 119)*

...فَبَعَثَ ٱللَّهُ ٱلنَّبِيِّـۧنَ مُبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ... ﴿٢١٣﴾

“…Allahu dërgoi pejgamberët përgëzues dhe qortues…”. *(el-Bekare: 213)*

رُّسُلًا مُّبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ لِئَلَّا يَكُونَ لِلنَّاسِ عَلَى ٱللَّهِ حُجَّةُۢ بَعۡدَ ٱلرُّسُلِۚ وَكَانَ
ٱللَّهُ عَزِيزًا حَكِيمًا ﴿١٦٥﴾

“Të dërguar që ishin lajmgëzues e kërcënues, ashtu që pas dërgimit të dërguarve njerëz të mos kenë fakt *(arsyetim)* ***para Allahut. Allahu është i pavarur në sundimin e vet dhe di si të veprojë”.*** *(en-Nisaë: 165)*

وَمَا نُرۡسِلُ ٱلۡمُرۡسَلِينَ إِلَّا مُبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَۖ ... ﴿٤٨﴾

“Ne të dërguarit nuk i dërgojmë ndryshe vetëm si përgëzues dhe qortues…”. *(el-En’amë: 48)*

Në të gjitha ajetet e cituara më lart, shihet që Allahu xh.sh. ka dërguar profetët të informojnë njerëzimin për shpërblimin në Botën tjetër si dhe t’i paralajmërojnë për ndëshkimin në Botën tjetër.

Do të ndëshkohen për të keqen dhe do të shpërblehen për të mirën.

قَالَ أَمَّا مَن ظَلَمَ فَسَوْفَ نُعَذِّبُهُۥ ثُمَّ يُرَدُّ إِلَىٰ رَبِّهِۦ فَيُعَذِّبُهُۥ عَذَابًا نُّكْرًا ﴿٨٧﴾ وَأَمَّا مَنْ ءَامَنَ وَعَمِلَ صَٰلِحًا فَلَهُۥ جَزَآءً ٱلْحُسْنَىٰ ۖ وَسَنَقُولُ لَهُۥ مِنْ أَمْرِنَا يُسْرًا ﴿٨٨﴾

***“Ai** (Dhulkarnejni) **tha: “Ai që vazhdon edhe më tej të jetë zullumqar, atë do ta dënojmë, pastaj i kthehet Zotit të vet, e Ai e dënon atë me një dënim të tmerrshëm”. Sa i përket atij që besoi dhe bëri vepra të mira, atij i takon shpërblimi më i mirë** (xheneti) **dhe atij nga ana Jonë do t’i bëjmë lehtësi** (në jetë)**”.** (el-Kehf: 87-88)*

Në fakt, si shpërblimi ashtu dhe ndëshkimi janë të domosdoshëm, madje edhe për performansa shumë të vogla.

فَمَن يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُۥ ﴿٧﴾ وَمَن يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُۥ ﴿٨﴾

***“E kush punon ndonjë të mirë që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punon ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë”.** (ez-Zelzele: 7-8)*

Aliu r.a., halifi i katërt i Muhamedit a.s. thotë:

“Sigurohuni që punëtori i mirë dhe punëtori i keq nuk janë të barabartë në pozitën para jush, pasi që veprimi i kësaj është nënvlerësim i të mirës e i vepruesit të saj, dhe inkurajim i të keqes e vepruesit të saj.”

Gjëja më e rëndësishme është shpërblimi apo së paku pranimi i performansës së mirë, pasi që mosveprimi i kësaj do të dekurajojë punëtorët dhe do të inkurajojë dembelët. Allahu xh.sh. thotë:

...إِنَّا لَا نُضِيعُ أَجْرَ مَنْ أَحْسَنَ عَمَلًا ﴿٣٠﴾

***“…Ne nuk i humbim shpërblimin atij që është bamirës”.** (el-Kehf: 30)*

Me qëllim të inkurajimit të përmirësimit të procesit te rregullimet e shpejta, është e domosdoshme që njerëzit të shpërblehen për përpjekjet e jo vetëm për arritjet. Muhamedi a.s. thotë:

“Kush bën përpjekje dhe e qëllon ka dy shpërblime, e kush bën përpjekje dhe nuk e qëllon ka një shpërblim”. (Ebu Davud)

Islami, pra shpërblen edhe përpjekjet, e jo vetëm rezultatin.

“Nëse vjen Kiameti dhe ndonjë nga ju është duke mbjell, nëse mundet ta mbjellë atë e të largohet, atëherë duhet ta mbjellë atë”. (Buhariu)

Fakti që Islami përdor si shpërblimin ashtu dhe ndëshkimin, nuk është arsyetim për menaxherët të fillojnë të ndëshkojnë vartësit e tyre për çdo gabim. Tendenca për të ndëshkuar, duhet të balancohet me falje, pasi që lider i mirë është ai i cili fal (shiko në seksionin e mëparshëm). Veç kësaj, veprat e mira fshijnë veprat e këqija, ashtu siç është përmendur në Kuran:

...إِنَّ ٱلْحَسَنَٰتِ يُذْهِبْنَ ٱلسَّيِّـَٔاتِ... ﴿١١٤﴾

***“…s’ka dyshim se veprat e mira i shlyejnë ato të këqijat…”.** (Hudë: 114)*

Të kërkuarit e shumtë në gabimet dhe cenet e rralla të punëtorëve mund të shpie deri te çoroditja, ftohja dhe zemërimi i tyre, duke zvogëluar kështu efikasitetin e tyre. Enesi r.a., një sahab i Muhamedit a.s. thotë që punoi për Muhamedin a.s. për njëzet vjet dhe që Muhamedi a.s. nuk e pyeti kurrë pse e bëri dhe çka bëri e as nuk i kërkoi të bëj gjëra që nuk dëshironte t’i bënte. Megjithatë, sjellja e Muhamedit a.s. me Enesin nuk është rregull absolut, e as çdo punëtor nuk është i kualifikuar e as i angazhuar si Enesi.

Është e nevojshme të kuptohet që vetë ndëshkimi nuk është motivues, por është frika nga ndëshkimi që i motivon njerëzit. Ndëshkimi është vetëm një përforcues që mund të bëhet kundër produktiv nëse përdoret jashtë mase. Mësimet islame paralajmërojnë nga ndëshkimi, por jo nga vetë ndëshkimi. Është argumentuar që personi i ndëshkuar mund të mësohet me ndëshkim dhe të ndalojë të provojë t’i shmanget atij. Ndëshkimi është më shumë një masë disiplinore.

Menaxherët, përgjithësisht duhet të jenë të kujdesshëm në përdorimin e masave disiplinore. Derisa është e mirë dhe e rekomanduar të lavdërohen veprat e mira para të tjerëve, dekurajohet që madje të merren hapur masat disiplinore. Masa të tilla janë më efektive kur të merren privatisht, pasi që madje edhe këshilla para njerëzve mund të kthehet në siklet për personin që është këshilluar. Kjo është veçanërisht e vërtetë, nëse ai që këshillohet është më i lartë (në post dhe pozitë) gjatë këshillës. Hersej dhe Blankard[9] pohojnë:

"Gjëja e fundit që duhet të mbahet mend është mbajtja private e ndërhyrjeve disiplinore. Si porosi, është ide e mirë të lavdërohen njerëzit në publik dhe problemet të zgjidhen privatisht. Nëse u drejtoheni pasuesve për problemet që i keni, ju i drejtoheni rrezikut t'i shqetësoni më shumë për Ferrin Infektues, sesa të zgjidhni problemin. Diskutimi i problemeve privatisht priret të bëhet më lehtë marrja e pikëve dhe mbajtja e personave të tjerë të përqendruar në procesin e zgjidhjes së problemit".

Ndërkohë, në mënyrë që ndëshkimi të jetë efektiv, shkelësi duhet të vetëdijesohet shumë qartë për të, dhe duhet të ekzekutohet drejtësisht për të gjithë punëtorët përgjegjës. Gjithashtu, duhet të zbatohet në një mënyrë, që është proporcionale për sjelljen e padëshiruar dhe të matur. Ndëshkimi nuk duhet të jetë aq i ashpër, pasi që krijon efekte anësore negative, dhe as nuk duhet të jetë aq i butë që të mos arrijë qëllimin e dëshiruar. Përgjithësisht, është më mirë të përdoret ndëshkimi menjëherë pas ndodhjes së reagimit të ndëshkueshëm. Në këtë mënyrë, ndëshkimi mund të lidhet drejtpërdrejtë me reagimin. Veç kësaj, menaxherët duhet të sigurohen që ata po ndëshkojnë për sjelljen e padëshiruar dhe jo për ndonjë arsye personale. Kështu, duhet ndëshkuar vepra e jo personi. Ata duhet të komunikojnë qartësisht arsyet për ndëshkime. Kur menaxherët ndëshkojnë dikë, nuk duhet të dobësohen duke dhënë atij/asaj një ndëshkim jo të rastit. Më e rëndësishme

[9] Hersey, P. and Blanchard, K., H. "Management of Organizational Behavior", 6th ed., Prentice Hall, New Jersey, (1993)

është që ndëshkimi të përdoret vetëm si shpresa e fundit. Atij duhet t'i paraprijë trajnimi, këshilla dhe masat disiplinore verbale.

3 - Motivimi shpirtëror

Motivimi në Islam nuk është i kufizuar në stimulimin monetar dhe material, por përfshin stimulimin shpirtëror, që ka provuar efikasitetin e tyre gjatë gjithë historisë.[10]

Aktualisht, motivimi më i rëndësishëm që kemi është besimi që puna jonë është ibadet (adhurim), për të cilën do të shpërblehemi. Një besim i tillë është një avantazh konkurrues. Fjalët e mira dhe paraqitja e mirë e njohjes dhe e lavdërimit, janë gjithashtu të rëndësishme. Allahu xh.sh. thotë:

...وَقُولُوا۟ لِلنَّاسِ حُسْنًا... ﴿٨٣﴾

"…dhe njerëzve u thoni fjalë të mira…". *(el-Bekare: 83)*

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ ضَرَبَ ٱللَّهُ مَثَلًا كَلِمَةً طَيِّبَةً كَشَجَرَةٍ طَيِّبَةٍ أَصْلُهَا ثَابِتٌ وَفَرْعُهَا فِى ٱلسَّمَآءِ ﴿٢٤﴾ تُؤْتِىٓ أُكُلَهَا كُلَّ حِينٍۭ بِإِذْنِ رَبِّهَا ۗ وَيَضْرِبُ ٱللَّهُ ٱلْأَمْثَالَ لِلنَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ ﴿٢٥﴾ وَمَثَلُ كَلِمَةٍ خَبِيثَةٍ كَشَجَرَةٍ خَبِيثَةٍ ٱجْتُثَّتْ مِن فَوْقِ ٱلْأَرْضِ مَا لَهَا مِن قَرَارٍ ﴿٢٦﴾

"A nuk ke kuptuar sesi Allahu bëri shembull: fjalën e mirë si pema e mirë që rrënjët e saj janë thellë *(në tokë)* ***e degët e saj janë lart. E që me vullnetin e Zotit, ajo e jep frytin e vet në çdo kohë. Allahu, pra u parashtron njerëzve shembuj ashtu që të mendojnë. Dhe shembulli i fjalës së keqe si një pemë e keqe që është shkulur mbi tokë e që nuk ka të qëndruar".*** *(Ibrahim: 24-26)*

Ajetet e mësipërme i motivojnë njerëzit të bëjnë vepra të mira, pasi që dobitë nga një vepër e tillë kurrë nuk përfundojnë. Ndërsa sa i

[10] (16) Al-Buraey, M. "Management and Administrative Development in Islam", (1990)

përket veprave të këqija, nga to askush nuk përfiton, prandaj duhet shmangur.

Duke theksuar rëndësinë e njohjes dhe të falënderimit të njerëzve për përpjekjet e tyre, Muhamedi a.s. thotë:

“Ai që nuk i falënderon njerëzit, nuk e falënderon Allahun”. (Ebu Davudi)

Iacoca mendon që inkurajimi është vital për ruajtjen e përfshirjes së vartësve të tij.

Në jetën e korporatës, duhet të inkurajoni të gjithë njerëzit tuaj të japin kontribut për të mirën e përgjithshme dhe të dalin me mënyra më të mira për bërjen e gjërave. Ju nuk keni për të pranuar çdo sugjerim të vetëm, por nëse nuk ktheheni te djaloshi dhe t’i thoni hej, ideja ishte e tmerrshme, dhe t’ia rrihni shpinën, ai kurrë nuk do të jep ndonjë tjetër. Ky lloj komunikimi i lejon njerëzit të dinë për çfarë llogariten në të vërtetë.[11]

Mësimet fetare mund të luajnë një rol të rëndësishëm në motivimin shpirtëror. Janë mësime të shumta islame që inkurajojnë muslimanët të jenë produktiv:

وَمِنْهُم مَّن يَقُولُ رَبَّنَآ ءَاتِنَا فِى ٱلدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِى ٱلْءَاخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ ٱلنَّارِ ﴿٢٠١﴾

“E, ka prej tyre që thonë: “Zoti ynë na jep të mira në këtë jetë, të mira edhe në botën tjetër, dhe na ruaj prej dënimit me zjarr!” *(el-Bekare: 201)*

وَٱبْتَغِ فِيمَآ ءَاتَىٰكَ ٱللَّهُ ٱلدَّارَ ٱلْءَاخِرَةَ ۖ وَلَا تَنسَ نَصِيبَكَ مِنَ ٱلدُّنْيَا ۖ. ﴿٧٧﴾

“Dhe me atë që ka dhënë Allahu, kërko *(ta fitosh)* ***botën tjetër, e mos le mangët atë që të takon nga kjo botë…”.*** *(el-Kasas: 77)*

[11] Iacoca, L., “Iacoca: An Autobiography”, Batman books, NY, 1984, p. 52

فَإِذَا قُضِيَتِ ٱلصَّلَوٰةُ فَٱنتَشِرُوا۟ فِى ٱلْأَرْضِ وَٱبْتَغُوا۟ مِن فَضْلِ ٱللَّهِ وَٱذْكُرُوا۟ ٱللَّهَ كَثِيرًا لَّعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿١٠﴾

“E, kur të kryhet namazi, atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkoni begatitë e Allahut, por edhe përmendni shpeshherë Allahun, ashtu që të gjeni shpëtim”. *(el-Xhumua: 10)*

وَقُلِ ٱعْمَلُوا۟ فَسَيَرَى ٱللَّهُ عَمَلَكُمْ وَرَسُولُهُۥ وَٱلْمُؤْمِنُونَ ۖ... ﴿١٠٥﴾

“Dhe thuaj: “Veproni, Allahu do ta shohë veprën tuaj, edhe i Dërguari i Tij e besimtarët…”. *(et-Tevbe: 105)*

Kur Allahu xh.sh. shfuqizoi namazin e natës (Kijamin) për sahabët, Ai përmendi një prej arsyeve të shfuqizimit: vështirësia me të cilën ballafaqohen tregtarët në udhëtimet e tyre tregtare.

.وَءَاخَرُونَ يَضْرِبُونَ فِى ٱلْأَرْضِ يَبْتَغُونَ مِن فَضْلِ ٱللَّهِ وَءَاخَرُونَ يُقَـٰتِلُونَ فِى سَبِيلِ ٱللَّهِ ۖ... ﴿٢٠﴾

“…Ai e diti se nga ju do të ketë të sëmurë dhe të tjerë që gjallërojnë nëpër tokë duke kërkuar nga begatitë e Allahut, e edhe të tjerë që luftojnë në rrugën e Allahut…”. *(el-Muzemil: 20)*

Muhamedi a.s. thotë:

“Ai, dy ditët e të cilit nuk janë të njëjta (në arritje) është i humbur”. (Dejlemi)

Ushqimi më i lejuar për robin është ai që fitohet nga duart e tij, nëse e bën me sinqeritet. (Buhariu)

“Tregtari i sinqertë dhe besimtari është me (në nivel me) dijetarët, besnikët dhe martirët”. (Tirmidhiu)

“Krijesat janë vartësit e Allahut dhe më i dashuri te Allahu mes tyre është më i dobishmi për ta”. (Taberaniu)

“Është më mirë për njeriun të merr litarin e të shkojë të marr dru, e t’i përdor si lëndë djegëse, se të kërkojë lëmoshë nga njerëzit, pa marrë parasysh i japin apo nuk i japin”. (Buhariu)

Të gjitha ajetet kuranore dhe hadithet të përmendura më lart, tregojnë rëndësinë e punës në Islam dhe shpërblimin që pritet nga kjo. Prandaj, nuk ekziston asnjë arsye për të qenë jo produktiv. Ne jemi krijuar të adhurojmë Allahun dhe një pjesë e rëndësishme e këtij adhurimi është puna e vështirë në rrugën e Tij.

Shumica e profetëve kanë bërë disa punë dore, duke përfshirë edhe Muhamedin a.s., i cili ishte bari në fëmijërinë e tij, e pastaj u bë tregtar. Ky fakt mund të sigurojë një motivim të brendshëm, duke kthyer vlerën e profesioneve të tilla. Muhamedi a.s. thotë:

“Davudi ishte bërës i mburojave, Ademi ishte bujk, Nuhu ishte marangoz, Idrizi ishte rrobaqepës, dhe Musa ishte bari”. (Hakimi)

Mësimet e Islamit theksojnë gjithashtu kualitetin dhe përsosmërinë në kryerjen e çdo pune.

“Allahu xh.sh. dëshiron që kur ndonjë nga ju bën një punë, le ta perfeksionojë atë”. (Bejhakiu)

Allahu xh.sh. ka urdhëruar përsosmërinë në çdo gjë. Kur të vrani, bëni në mënyrën më të mirë. Dhe kur therni (një kafshë për kurban) bëjeni në mënyrën më të mirë. Prandaj, çdonjëri nga ju duhet të mpreh thikën e tij, dhe të bëjë që kafshës t’i del shpirti me lehtësi. (Muslimi)

Motivimi mund të pengohet me çfarëdo trajtimi jo të drejtë që punëtorët mund të marrin apo të perceptojnë. Në anën tjetër, nëse punëtorët ndjejnë se trajtohen me drejtësi, ata madje do të jenë në gjendje të përballen me disa strese ekonomike dhe fizike. Seksioni vijues konturon vlerën e drejtësisë në vendin e punës.

4 - Drejtësia: Faktor moral

Pika më kritike në kënaqësinë e punëtorëve është drejtësia, pasi që padrejtësia godet civilizimin ashtu siç ka përmend drejtësisht Ibn Halduni në Mukadimen e tij. Punëtori duhet të sigurohet që puna e tij do të shpërblehet, apo së paku ai/ajo duhet të njihet për punën e mirë, përndryshe ai/ajo mund të humb çdo stimul për të mbajt gjallë produktivitetin dhe kualitetin. Punëtori duhet të ndjehet i trajtuar drejtë dhe duhet të merr të drejtat e tij, ashtu siç duhet të marr detyrat e tij. Është transmetuar se Muhamedi a.s. ka thënë: *“Padrejtësia është errësirë në Botën tjetër”*. (Buhariu dhe Muslimi)

“Do të jem kundër tre personave në Ditën e Ringjalljes: Atij që bën marrëveshje në emrin tim, por dëshmohet të jetë tradhtar, Atij që shet njeriun e lirë si skllav dhe ha vlerën e tij, dhe atij që punëson një punëtor e pasi t’ia kryej punën, nuk ia paguan rrogën”. (Buhariu)

“Ruajuni, nëse ndonjë i bën padrejtësi njeriut të kontraktuar, apo zvogëlon të drejtën e tij, apo e detyron të punojë mbi mundësinë e tij, apo merr ndonjë gjë prej tij pa pëlqimin e tij, do ta mbrojë atë, në Ditën e Gjykimit”. (Ebu Davudi)

Punëdhënësit nuk duhet të trajtojnë punëtorët e tyre me padrejtësi e as t’i vendosin në punë që janë mbi mundësinë e tyre. Islami është kundër padrejtësisë.

“Jepuni punëtorit pagën e tij para se t’i thahen djersët”. (Ibn Maxhe)

Hadithet e mësipërme lënë të kuptohet që njerëzve duhet t’u paguhen pagat, menjëherë sa të përfundojnë punën e tyre.

“Kushdo që dëshiron të shpëtohet nga Xhehenemi dhe të hyj në xhenet, duhet të trajtojë njerëzit në mënyrën që dëshirojnë të trajtohen”. (Muslimi)

Askush nuk dëshiron të trajtohet padrejtësisht. Prandaj, njerëzit duhet të trajtojnë njëri-tjetrin në mënyrën që dëshirojnë të trajtohen. Kjo është thirrje për ndjeshmëri.

Drejtësia është një prej qëllimeve kryesore të Islamit. Allahu xh.sh. thotë:

۞ إِنَّ ٱللَّهَ يَأۡمُرُ بِٱلۡعَدۡلِ وَٱلۡإِحۡسَٰنِ وَإِيتَآيِٕ ذِي ٱلۡقُرۡبَىٰ وَيَنۡهَىٰ عَنِ ٱلۡفَحۡشَآءِ
وَٱلۡمُنكَرِ وَٱلۡبَغۡيِۚ يَعِظُكُمۡ لَعَلَّكُمۡ تَذَكَّرُونَ ﴿٩٠﴾

"Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim". *(en-Nahl: 90)*

Në një ajet tjetër, Allahu xh.sh. thotë:

يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ كُونُواْ قَوَّٰمِينَ لِلَّهِ شُهَدَآءَ بِٱلۡقِسۡطِۖ وَلَا يَجۡرِمَنَّكُمۡ
شَنَـَٔانُ قَوۡمٍ عَلَىٰٓ أَلَّا تَعۡدِلُواْۚ ٱعۡدِلُواْ هُوَ أَقۡرَبُ لِلتَّقۡوَىٰۖ وَٱتَّقُواْ ٱللَّهَ... ﴿٨﴾

"O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë. Bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kini drojë Allahun…". *(el-Maide: 8)*

Njerëzit nuk duhet të dëshmojnë marrëveshjet e padrejta, por duhet që t'i eliminojnë ato me të gjitha mjetet. Pastaj¸ emocionet personale nuk duhet të qëndrojnë në rrugën e drejtësisë.

...وَأُمِرۡتُ لِأَعۡدِلَ بَيۡنَكُمُۖ... ﴿١٥﴾

"…jam urdhëruar të mbaj drejtësi mes jush…". *(esh-Shura: 15)*

Kur të gjykoni mes njerëzve, gjykoni me drejtësi dhe jepuni atyre, atë që meritojnë.

...وَلَا تَبۡخَسُواْ ٱلنَّاسَ أَشۡيَآءَهُمۡ... ﴿٨٥﴾

"…e mos u bëni padrejtësi njerëzve në sendet e tyre…". *(el-A'rafë: 85)*

Koncepti i drejtësisë është më përfshirës se koncepti i barazisë i njohur nga Stasi Adams, pasi që i pari nuk është i kufizuar në krahasimin e raportin e perceptuar të inputëve dhe përfundimeve me të tjerët. Për të hetuar shtrirjen dhe rëndësinë e drejtësisë në vendpunim, kemi

udhëhequr një studim për stafin akademik të Universitetit Ndërkombëtar Islamik. 83.87% e njerëzve të studiuar besonin që drejtësia është faktor moral, mungesa e të cilit rezulton në pakënaqësi. 16.3% e konsideruan atë si motivues. Disa prej njerëzve të studiuar shpjeguan që performansa e tyre nuk do të zvogëlohet nëse ata ndjeheshin të trajtuar padrejtësisht për shkak të kënaqësisë së madhe që merrnin nga punët e tyre dhe për shkak të përgjegjësisë morale ndaj saj. Të tjerët përmendin që drejtësia i siguron ata që do të shpërblehen për përpjekjet e tyre, dhe kështu kontribuon në motivimin e tyre. Kjo është ekuivalent me thënien që drejtësia rrit pritjen për rezultatet e performansës. Vetëm 6.45% të atyre të studiuar kufizuan perceptimin e tyre të padrejtësisë në krahasim me raportin input-output me të tjerët. Pjesa e mbetur e asaj që është studiuar përfshinë gjykimin e vlefshëm të bazuar në drejtësinë në termat e saj absolut dhe në krahasime me të tjerët në organizata të ngjashme.

Nuk mjafton për menaxherët të jenë të drejtë. Ata gjithashtu duhet të sigurohen që vartësit e tyre të perceptojnë atë, ashtu. Vendimet që menaxherët marrin duhet të jenë plotësisht të shpjeguara, në mënyrë që punëtorët të mos ndjenë asnjë padrejtësi. Omeri r.a. shpjegonte qartë arsyet për vendimet e tyre për të ndryshuar guvernatorët (valinjtë) e tyre.

Në anën tjetër, drejtësia nuk do të mbizotërojë vetëm duke theksuar që është e detyrueshme. Shumë menaxherë ikin me disa padrejtësi të rënda ndaj vartësve të tyre, dhe nuk është e pazakonshme për menaxherët të mbulojnë padrejtësitë për njëri-tjetrin. Pretendimi që drejtësia është pjesë e kulturës së një organizate nuk mjafton. Për drejtësinë duhet kujdesur me disa programe që përfshijnë përforcimin e drejtësisë. Duhet të ekziston një seksion i ankesave brenda apo jashtë departamentit të personelit. Megjithëse drejtësia ishte gurthemel i kulturës së sahabëve të Muhamedit a.s., dhe megjithëse është një prej qëllimeve të përgjithshme të Islamit, Omeri krijoi një agjenci për ankesa që kishte autoritetin për të kthyer drejtësinë.

Përmbledhje

Lidershipi është një shërbim i domosdoshëm në çdo organizatë. Efikasiteti i lidershipit varet nga lideri, ndjekësit, dhe situata. Liderët duhet të respektojnë dhe të konsultohen me ndjekësit e tyre. Pasi të merret vendimi, ata duhet të vendosin të zbatojnë atë, duke vendos besimin në Allahun xh.sh. Vizioni është ajo që e dallon një lider nga një menaxher i thjeshtë. Derisa si fuqia (aftësitë) dhe besimi apo sinqeriteti kërkohen te një lider, aftësitë duhet që gjithnjë të kenë prioritet. Liderët duhet të kenë ndjenjë të lartë të përgjegjësisë. Gjithashtu, ata duhet të posedojnë nivel të lartë të ndjeshmërisë ndaj ndjekësve të tyre. Ata kanë rolin e shembullit që ndikon thellë kulturën e organizatave. Detyra kryesore në zhvillimin e lidershipit është identifikimi i liderëve potencial që posedojnë ndjenjë të lartë të përgjegjësisë.

Motivimi fillon në fazën e planifikimit. Organizatat duhet të sigurohen që anëtarët e saj mund të lidhen dhe të angazhohen për qëllimet e tyre. Pastaj, duke vendosur një shkak direkt dhe lidhje efektive mes veprimeve të ndryshme që duhet të ndërmerren, dhe që objektivi afatgjatë i organizatës duket se do të rrit nivelin e motivimit.

Motivimi përfshin joshjen për shpërblim dhe frikën nga dënimi, pasi që njerëzit veprojnë nga frika dhe /ose nga shpresa. Shpërblimi duhet të përdoret më shumë se dënimi, pasi që tendenca për të dënuar duhet të balancohet me falje. Pastaj, është frika nga dënimi dhe jo vetë dënimi që rrit motivimin. Dënimi është mjaft masë disiplinore. Metodat shpirtërore janë motivues shumë efektivë dhe drejtësia është gurthemeli i kënaqësisë së punëtorëve.

Pjesa tjetër trajton konkurrencën dhe konfliktet. Në kapitullin tjetër, do të prezantohen dy kategoritë e konkurrencës. Islami inkurajon kategorinë e parë, derisa e ndalon të dytën.

- vijon -

Dr. Naceur Jabnoun

ISLAM AND MANAGEMENT - (5)
LEADERSHIP AND MOTIVATION

Leadership

(Summary)

Leadership has to do with the creation of order out of chaos, creation of trust out of distrust, belief out of disbelief and courage out of fear. Leadership has to do with the introduction of change. Leaders do not have to hold a position of authority. Their influence does not derive from their wealth or power.

د. ناصر جبنون

الاسلام و الادارة (5)

الزعامة و التحريض – الزعامة

(خلاصة البحث)

الزعامة تعتمد على الاعطاء منتظرا لكي يأخذ هو يعتمد على الرعاية غير منتظر الرعاية هو يعتمد على المساندة غير منتظر المساندة هو يعتمد على العدالة غير منتظر من الأخرين أن يكونوا عادلين معهم.

الزعامة تعتمد على الاعطاء تصورات للذين يتبعونه هو يعتمد على انتشار النظام ضد الفوضى الاعتماد على حسن النية ضد على عدم الثقة الاعتماد على الثقة عن عدمها الاعتماد على الشجاعة ضد الخوف.

الزعامة معناها ادخال التغييرات الجذرية. الزعماء ليس بضرورة أن يكونوا على وظائف مرموقة تأثيرهم لا يأتي من قوتهم او ثرائهم.

KUMTESË

Mr. Qemajl Morina

NEVOJA E DIALOGUT NDËRFETAR E NDËRKULTUROR PËR ARRITJEN E STABILITETIT NË BALLKAN*

E nderuara kryesi e punës,
Të nderuar përfaqësues të bashkësive fetare,
Të nderuar të pranishëm

Kam nderin sot të marrë pjesë në këtë Simpozium shkencor me titullin "Domosdoshmëria e dialogut ndërfetar e ndërkulturor për paqen botërore", organizuar nga Fondacioni për arsim dhe kulturë "Atmosfera" në Kosovë.

Kumtesën time po e filloj me citimin e ajetit kuranor:

"….O ithtarë të Librit *(Tevratit dhe Ungjillit),* ***ejani te një fjalë që është e njëjtë mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, pos Allahut, të mos i bëjmë Atij asnjë send shok, të mos konsiderojmë njëri-tjetrin zotër pos Allahut! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: Dëshmoni pra se ne jemi myslimanë".*** *(Ali Imran: 64).*

* Kumtesë lexuar në Konferencën e dialogut ndërkulturor e ndërfetarë, mbajtur në Prishtinë, më 4 qershor 2008.

Feja, sot, është një temë e pashmangshme në të gjitha rrjedhat shoqërore, politike e gjeostrategjike. Një numër i madh i problemeve akute të botës së sotme, zanafillën e kanë në mosmarrëveshjet fetare. Andaj, studimi i këtyre problemeve edhe në aspektin fetar, mund të na ndihmojë në eliminimin e shumë keqkuptimeve dhe urrejtjeve të trashëguara nga e kaluara, të cilat shfaqen jo vetëm në nënqiellin tonë ballkanik, por edhe më gjerë, për shkak të mos njohjes së rolit dhe misionit që duhet të luajnë fetë në shoqëritë njerëzore.

Mosnjohja e parimeve të feve apo keqpërdorimi i tyre nga individë të caktuar, shoqërive tona po u kthehet si bumerang me pasoja të paparashikueshme. Këtë më së miri e lustrojnë pamjet tragjike të luftërave të fundit në ish-Jugosllavinë në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit njëzet, ku në shënjestër ishin edhe objektet fetare, në veçanti xhamitë.

Kësaj teme një rëndësi të veçantë i kushton ish-sekretarja amerikane e Shtetit, Madeline Albright, në librin e saj me titull "The maighty and almighty", (I fuqishmi dhe i plotfuqishmi), ku komenton se formuluesit e politikave duhet të kuptojnë rolin e fesë, kur analizojnë situatën në vendet e ndryshme të botës dhe se, në rast konfliktesh, feja duhet të luajë një rol për nxitjen e paqes dhe jo acarimit të mëtejshëm të konfliktit.

Në këtë kuadër, zonja Albright thotë se shpeshherë konflikteve rajonale, qëllimisht, u janë dhënë nuanca fetare. Si shembull ajo përmend luftën në Kosovë. Sllobodan Milloshevia, thotë Albright, i kishte thënë ato vite se populli i tij kishte luftuar në shekuj për të mbrojtur "Evropën e krishterë", megjithëse, shton ajo, burim i konfliktit, ashtu sikurse në luftërat kundër Sllovenisë, Bosnjës dhe Kroacisë ishte në fakt shthurja e ish-Jugosllavisë.

Albright flet për rëndësinë e bashkëpunimit mes feve të ndryshme, kur ato bashkëjetojnë në një vend, duke theksuar nevojën e respektimit reciprok midis tyre. Përsëri ajo i rrëfehet Ballkanit dhe Kosovës:

"Kur isha në Kosovë gjatë konfliktit, pashë xhami të shkatërruara, të rrethuara me tela me gjemba. Por, fatkeqësisht, në udhëtimin tim

më të fundit, atje pashë se kishte ndodhur e kundërta: pashë kisha të shkatërruara dhe të rrethuara me tela”.

Duke mbrojtur kurdoherë idenë se fetë e ndryshme kanë shumë gjëra të përbashkëta në thelb, siç është predikimi i paqes, dashurisë dhe ndërgjegjes shoqërore, Albright nxjerr përfundimin se feja mund të bëhet një forcë shtytëse për lirinë dhe tolerancën në botë.

Dialogu ndërfetar dhe ndërkulturor pa alternativë

Ballkani gjendet në një udhëkryq me rëndësi strategjike, ku gjatë historisë janë gërshetuar interesat, si të Lindjes ashtu edhe të Perëndimit. Ai, shumë herë gjatë historisë u shndërrua në mejdan të fushëbetejave të ndryshme të interesave të fuqive të mëdha. Si rezultat i ballafaqimeve të tilla dhe dominimit politik, ushtarak e fetar të asaj apo kësaj fuqie, u krijua një mozaik i feve të ndryshme, që shoqëroi nënqiellin tonë ballkanik shekuj me radhë.

Në Ballkan, më mirë se gjithkund, në rruzullin tokësor, takohet Lindja me Perëndimin, Islami me Krishterimin. Por, edhe brenda vetë Krishterimit, aty me shekuj bashkëjetojnë dhe veprojnë dy kishat më të mëdha të krishtera, ajo Bizantine Ortodokse me Kishën Romake Katolike. Kurse në kuadër të Islamit, në nënqiellin e Ballkanit bashkëjetuan me shekuj sunitët dhe tarikatet e ndryshme.

Ky mozaik, jo vetëm ndërfetar, por edhe brendafetar krijon një diversitet të rrallë, i cili kërkon angazhim të vazhdueshëm për një dialog jo vetëm ndërfetar, por edhe brenda fetar apo ekumenik, sepse nganjëherë divergjencat dhe mospajtimet brendafetare janë më të mëdha dhe më të pakalueshme se sa ato ndërfetare. Kjo kërkon prej prijësve fetarë një angazhim të veçantë dhe vendosjen e një dialogu Brendafetar të vazhdueshëm për tejkalimin e keqkuptimeve dhe paragjykimeve të trashëguara nga e kaluara. Nuk janë të rralla rastet kur nga ekstremistë të rrymave të ndryshme, qoftë islame apo të krishtera të dëgjohen konstatime se nuk mund të ketë dialog mes nesh vetëm për së vdekuri.

Dialogu ndërfetar është domosdoshmëri dhe ai nuk ka alternativë tjetër. Në mungesë të tij zënë vend paragjykimet, keqkuptimet, urrejtjet dhe armiqësitë. Në Islam, ai është i sanksionuar me Kur'an:

“Ithtarët e Librit mos polemizoni ndryshe vetëm ashtu si është më së miri” *(El-Ankebut: 46).*

Kjo do të thotë se, nëse do të ekzistonin dy mënyra diskutimi, njëra e mirë e tjetra më e mirë, atëherë myslimani do të ndiqte atë që është më e mirë.

Ajo që fut paragjykime në raportet ndërmjet ithtarëve të të dyja feve të mëdha, është pikërisht moskuptimi reciprok si dhe ndërhyrja e disa individëve të huaj, të cilët duan ta përdorin fenë si mjet për arritjen e objektivave jofetare. Prandaj, është detyrë e njerëzve të arsyeshëm, veçanërisht e dijetarëve të të dyja feve, që të shmangin këtë përplasje, duke ndërhyrë me urtësinë e tyre për ta shuar këtë zjarr që përpin gjithçka.

Ne myslimanët, jemi të urdhëruar të besojmë Tevratin dhe Ungjillin, të zbritur si libra të shpallur të Allahut të madhërishëm. Ne gjithashtu, në mesin e profetëve pranojmë Musain dhe Isain, paqja e Zotit qoftë mbi ta, si dhe nënën e tij që Allahu e ka zgjedhur dhe shenjtëruar midis të gjitha grave.

Në Kur'anin famëlartë nuk ekziston ndonjë sure (kaptinë) që flet për nënën e Muhamedit, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të, për gruan e tij Hatixhen, apo bijën e tij Fatimen, por ekziston një kaptinë që i kushtohet Marisë (Merjemes) dhe një tjetër që i kushtohet familjes së Isait a.s., e cila quhet kaptina “Ali Imran”. Imrani ishte babai i Marisë: ***“Allahu zgjodhi Ademin, Nuhin, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit përmbi popujt tjerë”****. (Ali Imran:13).*

Andaj, këta shembuj të Kur'anit duhet të na shërbejnë si mësime konkrete se si duhet të jenë marrëdhëniet tona ndërfetare, të cilët kalojnë kufijtë e një dialogu ndërfetar në aksione konkrete të bashkëjetesës dhe bashkëpunimit, në interes të paqes dhe prosperiteti në rajon dhe më gjerë.

1. Myslimani beson se dallimet ndërmjet popujve dhe feve kanë ardhur nga vullneti i urtë i Allahut:

“Sikur të dëshironte Zoti yt, do t'i bënte njerëzit të një feje. Ata vazhdimisht janë në kundërshtim mes vete, përveç atij që mëshiron Zoti yt. Dhe për këtë i krijoi ata”. *(Hud: 118-119).*

2. Myslimani beson se gjykimi i të humburve dhe jobesimtarëve nuk do të ndodhë në këtë botë, por në tjetrën. Nuk na takon neve të gjykojmë. Vetëm Allahu i madhërishëm është Gjykatës i drejtë, Falësi dhe i Urti. Ai në Kur'an thotë:

“E për këtë shkak, ti thirr dhe përqendrohu ashtu si të është urdhëruar dhe mos shko pas dëshirave të tyre e thuaj: “Unë kam besuar në librat që shpalli Allahu, jam urdhëruar të mbaj drejtësi mes jush, Allahu është Zoti ynë dhe Zoti juaj: Ne kemi përgjegjësinë e veprave tona dhe ju të veprave tuaja, nuk ka polemikë mes nesh dhe jush. Allahu do të na tubojë të gjithë dhe vetëm tek Ai është përfundimi”. *(Shura:15).*

3. Myslimani beson në dinjitetin e njeriut për vetë faktin së është njeri. Lidhur me këtë, Buhariu përcjell nga Xhabiri se Pejgamberi a.s. u ngrit në këmbë kur para tij kaloi një xhenaze. Dikush prej të pranishmëve i tha: “O i dërguar i Allahut! Kjo ishte xhenazja e një çifuti”. Ai, paqja dhe shpëtimi Zotit qofshin mbi të iu përgjigj: “A nuk ishte ky njeri?!” Çfarë qëndrimi madhështor dhe çfarë përgjigje mahnitëse!

4. Myslimani beson se Drejtësia e Allahut zbatohet mbi të gjitha krijesat e Tij. Allahu i madhërishëm në Kur'an thotë:

“O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të vërtetën dhe të mos ju shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë”. *(el-Miade:8)*

Prandaj, myslimani nuk vepron me drejtësi vetëm ndaj atij që e do, dhe me padrejtësi ndaj atij që e urren. Ai mban drejtësinë me cilindo, qoftë ai mysliman apo jo, mik apo armik.

Lidhur me këtë Pejgamberi a.s. thotë:

“Ai që mundon një çifut ose të krishterë, në Ditën e Gjykimit mua do të më gjejë si paditës. Për cilindo që e mundon pa të drejtë një grup jomyslimanësh, unë jam armiku i tij. Ndërsa kujt i bëhem armik unë, ai edhe në Ditën e gjykimit do të jetë armik me mua”.

Ballkani në të kaluarën e largët dhe të afërt ka kaluar nëpër tragjedi dhe krajata të shumta. Në fillim të shekullit njëzet e një edhe në këtë pjesë të Evropës kanë ndodhur ndryshime pozitive, të cilat duhet të vazhdojnë edhe më tutje. Në Ballkan, raporti i forcave në mes popujve të tij pothuajse është i barabartë. Faktorizimi i popullit shqiptar do ta forcojë këtë baraspeshë në të ardhmen e afërt, si në aspektin etnik edhe atë fetar.

Bashkësitë fetare mund të luajnë një rol të rëndësishëm për kthimin e besimit në mesin e popujve të këtij rajoni, për shkak të tragjedive të së kaluarës. Për këtë lypset një vendosmëri dhe vullnet nga prijësit fetarë të të gjitha feve, në veçanti të atyre që kanë shkaktuar dhembje dhe tragjedi fqinjëve të tyre, të çfarëdo besimi qofshin ata.

Mundësitë tona dhe ndikimi ynë nuk mund të jetë vendimtar, mirëpo ai as nuk duhet të nënçmohet. Të bëjmë diçka për eliminimin e barrierave të luftës, urrejtjeve, armiqësive dhe paragjykimeve të së kaluarës. Të punojmë bashkërisht për kthimin e besimit të humbur midis fqinjëve. Të ndërtojmë urat e mirëkuptimit dhe mirëbesimit. Të bëjmë diçka që fëmijët tanë të mos e shikojnë njëri- tjetrin me mosbesim. Të mos mbeten qytetet dhe fshatrat tona të ndara në vija etnike dhe fetare.

Për këtë na obligojnë librat tanë të shenjtë, të cilët i lexojmë gjatë lutjeve tona të përditshme. Misioni i njerëzve të fesë është që midis popujve të kultivojnë dashurinë, respektin e ndërsjellë e të luftojnë urrejtjen dhe armiqësinë. Prijësit e fesë janë më të thirrur se kushdo tjetër që njerëzit t'i kthehen të ardhmes. Ata duhet të kontribuojnë që Ballkani të kthehet në një oazë paqeje e bashkëjetese midis të gjithë njerëzve që jetojnë në të, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike apo fetare.

Nuk mund të ketë tolerancë pa fe. Nuk mund të ketë tolerancë pa dialog. Nuk mund të ketë dialog pa njohuri fetare.

Mr. Qemajl Morina

THE NEED FOR INTERRELIGIOUS AND INTERCULTURAL DIALOGUE TO ACHIEVE STABILITY IN THE BALKANS

(Summary)

I have the honor to attend this symposium on “The need for interreligious and intercultural dialogue for peace in the world”, organized by the “Atmosfera” Foundation for Education and Culture in Kosova. I will begin my presentation with this ayat from the Qur’an:

“O people of the Scripture (Jews and Christians): Come to a word that is just between us and you, that we worship none but Allah, and that we associate no partners with Him, and that none of us shall take others as lords besides Allah. Then, if they turn away, say: "Bear witness that we are Muslims" (Al-Imarn:64).

كمال مورينا

حاجتنا الى الحوار الديني والثقافي للوصول الى استقرار في البلقان

(خلاصة البحث)

رؤساء الجلسة المحترمين

ممثلوا الديانات المختلفة

الحضور المحترمين

لي شرف أن احضر اليوم الندوة العلمية و عنوانها "ضرورة الحوار الديني والثقافي للسلم فى العالم" التى قامت بتنظيمها الجمعية للتعليم والثقافة "اتموسفيرا" في كوسوفو؟

سوف أبدا كلمتى بالآية الكريمة التى تدعو الى السلام:

"قل يا أيها الكتاب تعالو الى كلمة سواء بيننا و بينكم ألا نعبد الا الله ولا نشرك به شيئا ولا يتخذ بعضنا بعضا اربابا من دون الله فأن تولو فقولو اشهدوا بأنا مسلمون (آل عمران: 64)

TRAJTESË

Mr.sc. Rrezehana Hysa

POLITIKA ARSIMORE
E KONGRESIT TË ELBASANIT

Përpjekjet e patriotëve shqiptarë,[1] pas Kongresit të Manastirit 1908, dhe atij të Dibrës më 1909, rreth hapjes së shkollave shqipe, si dhe inkuadrimin e gjuhës shqipe në shkollat greke, turke dhe të tjera, përhapjen e alfabetit latin, formimin e klubeve dhe shoqërive të tjera në të gjithë vendet ku ekzistonin shqiptarët, nxjerrjen e gazetave dhe revistave në gjuhën shqipe etj.[2], e gjegjësisht përgatitjen dhe mbajtjen e Kongresit të Elbasanit, qeveria xhonturke dhe qarqet shoviniste greke e konsideronin si rrezik për Perandorinë osmane dhe shkollat greke[3], prandaj turqit e rinj nëpërmjet komitetit xhonturk Bashkimi dhe Përparimi, u angazhuan për zhdukjen e lëvizjes kombëtare shqiptare, duke ndërmarrë aksione gjegjësisht ndjekjen, burgosjen, dënimin, internimin e mësimdhënësve dhe veprimtarëve shqiptarë si dhe mbylljen e një pjese të konsiderueshme të shkollave shqipe, ndërsa te disa shkolla të tjera u përpoqën ta inkuadrojnë alfabetin arab. Prandaj, deputetët shqiptarë në Parlamentin e Stambollit, të revoltuar nga kjo gje-

[1] Instituti i Historisë: Ramiz Abdyli:Lëvizja kombëtare shqiptare 198-1910, Prishtinë, faq.246.
[2] Ali Vishko:Kongreset e alfabetit dhe të shkollës shqipe, Shkup, 1992, faq.75.
[3] Ramiz Abdyli:v.p. e cituar, Prishtinë, faq.246.

ndje e mjerueshme, kërkuan që ofiqet osmane të mos përzihen në veprimtarinë kulturore-arsimore të shqiptarëve[4].

Iniciativën për mbajtjen e kësaj mbledhjeje me karakter mbarëshqiptar, i cili mori vendime të rëndësishme për përhapjen e arsimit dhe shkollave shqipe[5] që në historinë e arsimit shqiptar është e njohur si Kongresi i parë arsimor[6], e mori klubi i Selanikut, prej fillimit të muajit mars të vitit 1909, mirëpo për shkak të trazirave dhe kryengritjes në Kosovë, ky eveniment u prolongua për më datën 20 gusht po të këtij viti. [7]

Kësisoj Kongresi i zhvilloi punimet prej 2-9 shtator të vitit 1909 në Elbasan, [8]në të cilën morën pjesë 35 delegatë me të drejtë vote nga 28 klube shqiptare[9] si dhe përfaqësues të shkollave misionare amerikane[10], të cilët i përfaqësonin interesat e shqiptarëve të të katër vilajeteve dhe klubin e Selanikut. Fatkeqësisht në këtë Kongres nuk morën pjesë delegatët e Vlorës, Shkodrës dhe Vilajetit të Kosovës, për shkak të gjendjes së tendosur që mbisundonte atje dhe pas ngjarjeve të përgjakshme të prillit po të atij viti. Prandaj, atdhetarët e Vilajetit të Kosovës me anë të klubit të Shkupit, autorizuan Mithat Frashërin që t'i përfaqësonte ata në këtë Kongres[11]

Mbajtja e këtij evenimenti u prit me entuziazëm të madh nga paria e vendit, nxënësit e shkollave, anëtarët e klubeve e të shoqërive të Elbasanit etj.[12]

Në Kongres përfaqësoheshin 2 grupe politike, krahu i moderuar me në krye Mithat Frashërin, që i jepte përparësi zbatimit të reformave, zhvillimit të kulturës e të arsimit të brezit të ri, përmes mësimit të

[4] Ali Vishko,v.p.e cituar, faq.78.
[5] Flajor encklipedik shqiptar, faq.511.
[6] Hajrullah Koliqi: Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptarë, Prishtinë, 2002, faq.203.
[7] Ali Vishko, v.p. e cituar,faq.78.
[8] Shefik Osmani: Fjalori i pedagogjisë,Tiranë,1983, faq.330.
[9] Ramiz Abdyli, v.p e cituar, faq.246.
[10] Hajrullah Koliqi, v.p.e cituar, faq.204.
[11] Ramiz Abdyli, v.p.e cituar, faq.248.
[12] Ali Vishko, v.p. e cituar, faq.81.

gjuhës shqipe në shkolla dhe hartimin e një programi të përbashkët të klubeve për veprimtarinë e mëtejme të tyre dhe krahu radikal që mbështeste këto reforma, por që synonin jetësimin sa më të shpejtë të autonomisë së Shqipërisë[13]

Kongresi me vota të fshehta zgjodhi për kryetar Dervish Himën[14], nënkryetar Mithat Frashërin dhe sekretarë, Simon Shuteriqin dhe Josif Haxhi Mina[15].

Aty u diskutuan 3 çështje kryesore që e preokuponin Lidhjen kombëtare shqiptare:

- Hapja e një shkolle normale me internat,e cila do të kishte 6 klasa dhe do të përgatiste kuadër mësimor për shkollat fillore në të cilën do të angazhoheshin tre profesorë, tre mësimdhënës dhe një drejtor,
- Krijimin e një qendre të vetme që do të merrej me buxhetin dhe organizimin e shkollave shqipe dhe
- Bashkërendimin më të mirë të veprimtarisë së klubeve kombëtare dhe miratimin e një programi të përbashkët[16].

Prandaj për t'i analizuar dhe jetësuar më konkretisht këto pika, delegatët e panë të arsyeshme formimin e tri komisioneve të veçanta, gjegjësisht komisionin për hartimin e një rregulloreje për strukturën dhe organizimin e shkollës normale, komisionin për hartimin e proje-

[13] Po aty, 248.
[14] Emri i vërtetë i të të cilit është Ibrahim Naxhi nga Dibra, veprimtar dhe patriot i shquar i Rilindjes kombëtare që mori pjesë drejtpërsëdrejti në përhapjen e kulturës dhe arsimit në trojet shqiptare, shpërndarjen e librave në gjuhën shqipe, në krijimin e qendrave mësimore në gjuhën shqipe në edukimin e brezit të ri me ndjenja patriotike etj.. Studioi mjekësinë në Stamboll, por për shkak të lëvizjeve patriotike në atë kohë iu kushtua çështjes për pavarësi të Shqipërisë. Gjatë rrugëtimit që beri në Elbasan Tiranë, Krujë, Dibër etj., veprimtaria e tij la gjurmë të thella si themelues i qendrave mësimore të gjuhës shqipe. Përveç të tjerave Dervish Hima ishe edhe drejtues dhe redaktor i disa organeve si: Zen i Shqipënisë, Romë 1899, që botohej në gjuhën shqipe dhe frëngjishte, Shqipëria, Napoli-Romë 1901-1902, Shqipëtari Stamboll, 1909 etj., që ishin burim i fuqishëm i informacionit për gjendjen e arsimit dhe kulturës në Shqipëri. (cituar sipas Fjalorit pedagogjik të Shefik Osmanit, Tiranë, 1983, faq.462). Në vitin 1908 për herë të parë në Shqipëri e solli me vete, flamurin e parë shqiptarë në atdhe që nga koha e Skënderbeut (Cituar sipas Hajrullah Koliqit, faq.204)
[15] Ali Vishko, v.p. e cituar, faq.83.
[16] Ramiz Abdyli, v.p. e cituar, faq.249.

kt-rregullores së një shoqërie shkollore qendrore dhe komisionin për hartimin e rregullores së përbashkët për të gjithë klubet shqiptare[17].

Pas një diskutimi të gjatë të delegatëve[18], ku shumica e seancave u mbajtën me dyer të mbyllura për arsye se aty trajtoheshin edhe çështje shumë diskrete të karakterit politik, për të cilat nuk mund të diskutoheshin në seanca të hapura, delegatët shprehnin kundërshtim dhe mosbesim ndaj regjimit xhonturk, nevojën e organizimit më të mirë të komiteteve të fshehta që vepronin pranë klubeve shqiptare si dhe vendosmëri për të siguruar autonominë e Shqipërisë.[19]

Pas një diskutimi disaditor u miratuan 15 vendime të rëndësishme për arsimin kombëtar shqiptar si: hapjen e një shkolle të mesme pedagogjike, themelimin e një shoqërie "Përparimi" në Korçë, hartimin e dy rregulloreve dhe atë njëra për organizimin e punës edukative të normales së Elbasanit dhe tjetra për veprimtarinë e shoqërisë "Përparimi", angazhimin e patriotëve shqiptarë për inkuadrimin e mësimit të gjuhës shqipe në të gjithë shkollat e huaja gjegjësisht në të gjithë vendbanimet shqiptare, hapja e shkollave bujqësore me qëllim të zhvillimit e të modernizimit të bujqësisë, luftimi i propagandave të huaja në viset shqiptare, organizimin dhe formimin e komiteteve të fshehta shqiptare, si dhe klubit të Manastirit iu dha mandati i bashkëveprimit për dy vjetët e ardhshme etj.[20]

Kongresi kombëtar për problemet e arsimit e përcaktoi strukturën e shkollës së mesme pedagogjike, në bazë të së cilës shkolla do të kishte gjashtë klasa dhe një kurrikulë mësimore sipas standardeve evropiane,[21]. Kësisoj plani do të përfshinte 30 lëndë të detyrueshme dhe 2 fakultative, ku gjuha shqipe me të gjithë degët e saj do të zinin vend me rëndësi, ndërsa prej gjuhëve të huaja do të mësoheshin gjuha turke dhe gjuha frënge, ndërsa gjuha angleze dhe greke si lëndë fakultative. Ndërkaq, prej shkencave ekzakte dhe shoqërore do të merreshin njo-

[17] Po aty, faq.249.
[18] Hajrullah Koliqi, v.p. e cituar, faq.205.
[19] Ramiz Abdyli, v.p. e cituar, faq.255.
[20] Ali Vishko, v.p. e cituar, faq.88.
[21] Fjalori pedagogjik, v.p. e cituar, faq.331.

huri nga matematika, historia, historia e natyrës me të gjithë degët e tyre, pastaj, filozofi, psikologji, pedagogji, logjikë, kimi, gjeografi, vizatim, muzikë dhe gjimnastikë. Plani përfshinte edhe mësim fetar të fesë myslimane, ortodokse dhe katolike.[22]

Ndër të tjera Kongresi vendosi edhe hapjen e shkollave bujqësore në vilajete, ku ndjekja e mësimeve do të ishte falas. Aty gjithashtu u shtrua edhe çështja e drejtshkrimit dhe gjuhës së shkruar shqipe dhe njësimi letrar i saj, duke pasur parasysh të folmen e Elbasanit, që nënkuptonte unitetin midis gegëve dhe toskëve.[23]

Në Kongres u ngrit edhe problemi i formimit të një klubi qendror që konsiderohej se do të ishte qendër kryesore e arsimit dhe përhapjes së kulturës së një populli, për të cilën i dha u mandati klubit Bashkimi të Manastirit, duke kundërshtuar propozimin për t'u bërë qendër Selaniku, ku ndikimi i turqve të rinj ishte i madh.[24]

Ndërkaq në pikën 2 të vendimit që mori ky Kongres, u vendos që shoqëria "Përparimi" apo siç u quajt ndryshe shoqëria e mësonjëtoreve shqiptare[25] të njihet zyrtarisht si person juridik dhe moral[26] që nënkupton sigurimin e lejes zyrtare prej qeverisë turke gjegjësisht asaj iu caktua dhe mori për sipër të sigurojë fonde për mbajtjen në këmbë të shkollës normale të Elbasanit,[27] të plotësonte gjërat më të nevojshme dhe më urgjente për shkollat shqipe që kërkonte arsimi shqiptar i kohës në fazën fillestare të saj, të organizonte mbi baza kombëtare brendinë e punës mësimore edukative, të përpunonte anën metodike të punës mësimore, të inkuadronte gjuhën shqipe në të gjithë shkollat e vendit, si dhe të ndërtonte në territoret shqiptare një sistem të ri arsimor.[28]

Shoqëria përveç tjerash e zgjodhi kryesinë si dhe hartoi rregulloren e shkollës normale në Korçë, krijoi qendra mësimore, ndihmoi në

[22] Ramiz Abdyli, v.p. e ctiuar, faq.247.
[23] Fjalori I pedagogjisë, v.p. e cituar, faq.331.
[24] Po aty…faq.331.
[25] Po aty, faq.527.
[26] ASHSH:Fjalori enciklopedik shqiptarë, Tiranë, faq.511.
[27] Shefik Osmani, v.p. e cituar, faq.527.
[28] Po aty, faq.527.

mbajtjen e shkollave të Pogradecit, të Devollit, të Gjirokastrës, të Libohovës, Leskovikut etj. Ajo gjithashtu aktivizoi mësimdhënës dhe shkrimtarë të kohës për hartimin e teksteve dhe programeve mësimore të shkollave fillore dhe të shkollave normale.[29]

Kongresi i parë arsimor shqiptar u prit me entuziazëm të madh nga forcat elite dhe përparimtare të kohës, duke përfshirë këtu edhe shtypin periodik të kohës e sidomos gazetën "Shqypja e Shqypnisë" e Josif Bagerit, ndërsa vendimet e Kongresit të Elbasanit e çuan përpara zgjerimin e rrjetit të shkollave e mësimit në gjuhës shqipe, respektivisht ngritën godinën hyjnore më madhështore në arsimit shqiptar gjegjësisht Normalen e Elbasanit apo Universitetin e parë shqiptar, e cila përgatiti kuadër mësimor për tërë Shqipërinë dhe tërë shqiptarët.

Literatura e shfytëzuar:

- Ali Vishko: Kongreset e alfabetit dhe të shkollës shqipe, Shkup, 1992
- ASHSH: Fjalori enciklopedik shqiptarë, Tiranë, 1985
- Fjalori enciklopedik, Tiranë, 2002
- Hajrullah Koliqi: Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar, Prishtinë, 2002.
- Ramiz Abdyli: Lëvizja kombëtare shqiptare, Prishtinë, 2004.
- Shefik Osmani: Fjalori i pedagogjisë, Tiranë, 1983.

[29] Po aty, 527.

Mr.sc.Rrezehana Hysa

THE EDUCATIONAL POLICIES OF THE ALBANIAN NATIONAL CONGRESS IN ELBASAN

(Summary)

The Young Turks as well as Greek chauvinist circles saw the efforts of Albanian patriots following the Congress in Manastir in 1908 and in Dibra in 1909, to open schools in Albanian, as well as to introduce the Albanian language in Greek, Turkish and other schools, to adopt the Latin alphabet, to establish clubs and associations in places with large Albanian communities and to publish newspapers and journals in the Albanian language, etc., respectively the organization of this congress as a threat to the Ottoman Empire and Greek schools. Thus, the Young Turks through the Union and Progress Committee did their utmost to destroy the Albanian national movement, through the persecution, imprisonment, punishment, deportation of Albanian teachers and activists as well as the closing of a considerable number of schools in Albanian. On the other hand, efforts were made to introduce the use of the Arab alphabet in other schools.

رزهانه هوسا

السياسة التعليمية لمؤتمر الباسان

(خلاصة البحث)

ان محاولات الوطنيين الالبان بعد مؤتمرماناستير 1908 و مؤتمر ديبرا 1909 حول فتح المدارس الالبانية وكذالك الادخال اللغة الالبانية في المدارس اليونانية والتركية و انشتار الابجدية اللاتينية وكذالك تكوين الاندية والجمعيات في كل الاماكن التى يسكن فيها الالبان و كذالك اصدار الصحف المجلات باللغة الالبانية استعدادا لعقد مؤتمر الباسان حكومة الاتراك الجدد و اليونانيون كان يرون خطرا على الامبراطورية العثمانية و بذلوا كسارى جهدهم لمنع انعقاد هذا المؤتمر بل أكثر من ذلك أن جمعية الاتراك "الاتحاد والترقي" بذلوا كسارى جهدهم لازالة الحركة الالبانية عن الوجود عن طريق اتخاذ الاجراءات التعسفية مثل اعتقال و نزول عقوبات قاسية على أعضاء الحركة.

LEKSIKOLOGJI

Naim Berisha

ORIENTALIZMAT NË LEKSIKUN E GJAKOVËS

Është fakt i pamohueshëm se popujt fqinj apo popujt të cilët kanë marrëdhënie mes vete, bashkë me shkëmbimin e elementeve të ndryshme kulturore i shkëmbejnë edhe fjalët[1]. Gjuha pasqyron rrugëtimin e një populli përgjatë historisë. Rrugëtimi historik Shqipërinë dhe shqiptarët i ka përballur me popuj të ndryshëm, dhe si rezultat i këtyre marrëdhënieve, gjuha shqipe ka shtresa të fjalëve nga gjuhët me të cilat kishte kontakte. Orientalizmat bëjnë pjesë në shtresën e huazuar të leksikut të shqipes, por janë dukuri edhe e gjuhëve tjera ballkanike.

Historia e futjes së orientalizmave në gjuhën shqipe nuk ka filluar që nga pushtimi i tokave shqiptare nga Perandoria Osmane, ajo është më e hershme. Po të marrim si kriter historik për fillimin e depërtimit të turqizmave në shqipen, praninë e tyre në të folmet e arbëreshëve të Italisë, mund të vëmë re se disa turqizma kishin hyrë në gjuhën shqipe para se të vendosej sundimi osman në Shqipëri[2]. Numri i orientalizmave në të folmet e arbëreshëve ishte i vogël dhe në sfera të caktuara

[1] F. Mehdiu, Orientalizmat: Hyrja dhe përdorimi i tyre në gjuhën shqipe, Tiranë 1989, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe.

[2] A. Kostallari, Rreth depërtimit të Turqizmave në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII, Tiranë 1989, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III,f 94.

të jetës. Siç është vënë në dukje, këto huazime të pakta janë marrë kryesisht nga fusha e veshmbathjeve dhe e orendive shtëpiake, si p.sh. çarçaf, çorape, gajtan, penxhere etj. ose nga terminologjia ushtarake, si p.sh. fitil, mejdan, daulle etj[3]. E Çabej si turqizmin e parë të dokumentuar në gjuhen shqipe e sjell fjalën ***haraç,*** fjalë të cilën sipas tij, e kishte përdorur Skënderbeu në një letër të tij. Depërtimi i orientalizmave në gjuhën shqipe u bë në një periudhë të gjatë kohore dhe kishte faktor të ndryshëm që ndihmuan depërtimin e tyre. Faktorët kryesorë që ndihmuan depërtimin e orientalizmave ishin: *vendosja e administratës shtetërore nga osmanët, islamizimi i popullsisë dhe letërsia e bejtexhinjve*. Autorët e letërsisë shqiptare së bejtexhinjve patën ndikim të fortë në gjuhën e tyre nga letërsia që zhvillohej në Perandorinë Osmane dhe futën në poezinë e tyre shumë fjalë të osmanishtes së kohës[4].

Një meritë shumë të madhe në studimin dhe mbledhjen e orientalizmave në gjuhën shqipe, ka padyshim Tahir Dizdari. Vepra e tij ***Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*** është një punë me vlerë të madhe për studiuesit e kësaj fushe dhe për leksikografinë në përgjithësi. Duhet pasur parasysh faktin se në grupin e orientalizmave të shqipes gjenden edhe fjalë të burimit arab dhe persian, fjalë të cilat në gjuhën shqipe u futën përmes turqishtes.

Depërtimi i orientalizmave në leksikun e Gjakovës është i hershëm. Përveç huazimit të fjalëve dhe të shprehjeve nga gjuha e folur, mësimeve fetare në gjuhën osmane të asaj kohe, edhe tradita e arsimit në gjuhën shqipe daton qysh në kohën e administrimit osman. Themeluesi i qytetit të Gjakovës ishte Sylejman Efendiu apo ndryshe ishte njohur me emrin Hadum Aga. Nga kjo periudhë veçojmë ndërtimin e xhamisë së Hadumit në vitin1554, mejtepit, bibliotekës, haremit, hamamit, ndërtimit të Sahat-Kullës, medresesë së madhe, hanit të vjetër, kompleksit të Teqesë së madhe si edhe urave lidhëse të qytetit mbi lu-

[3] E. Çabej, Për një shtresëzim kronologjik të huazimeve turke të shqipes. Studime Filologjike, 1975, nr. 4, f. 79-85.

[4] E. Lafe, Orientalizmat si verb poetik te Saadiu shqip, Revista shkencore Perla, Tiranë 2007, fq. 31-41.

min Krena, si ajo e Tabakut, ura e Taliqit etj, të cilat edhe sot ekzistojnë. E një rëndësie të veçantë ishte edhe ndërtimi i çarshisë së madhe, e ndërtuar me stilin oriental. Çarshia e madhe shërbeu si një qendër e fuqishme tregtare dhe zejtare, e që ruhet edhe sot e kësaj dite me të njëjtin plan që kishte. Përveç rrethanave të asaj kohe dhe faktorëve që përmendëm më lart, depërtimin e orientalizmave në leksikun e Gjakovës e ndihmoi edhe një vetëdije e përgjithshme[5] e krijuar asaj kohe, që gjuha e qyteteve konsiderohej si gjuhë e një shtrese më të lartë të shoqërisë. Kjo duhej të identifikohej me diçka dhe në shumë raste u përdorën orientalizmat për ta luajtur këtë rol.

Studimi i orientalizmave në leksikun e Gjakovës ka një rëndësi të veçantë. Profesor Idriz Ajeti thekson se dokumenti më i vjetër i shqipes së Kosovës, i shkruar me alfabetin arabo-turk, është Vehbija (që në gjuhën shqipe do të thotë dhuratë, dhunti) e Tahir Efendi Boshnjakut nga Gjakova. Për nga vjetërsia vendin e parë e zë *Vehbija* e Tahir Efendi Boshnjakut nga Gjakova, e shkruar sipas të gjitha gjasave, më 1835 dhe e botuar në Stamboll[6]. Shihet qartë se që në zanafillë të themelimit, Gjakova kishte një ndikim mjaft të madh e të vazhdueshëm nga kultura orientale, dhe depërtimi i orientalizmave në leksikun e Gjakovës ishte i pashmangshëm.

Se sa kishte depërtuar kultura dhe leksiku oriental në zhvillimin e jetës qytetare në Gjakovë po sjellim një shembull:

Nuk m'kujtohet a jomkon' pesë a gjashtë vjeçe kur m'kan' shti prindt n'shkollë. M'kanë shti ktu n'Mejtep. Baba nuk m'ka lon' me shku n'shkollë tjetër, se atëherë ke hapë ke hap shkolla n'serbisht, po mu nuk m'ka lon' baban'at shkollë. Une kom pas shoqe që shkun' n'shkollë serbisht. Atje kan' shku kush s'ka dashtë me shku n'mejtep. Klasën e kemi pasë shumë t'mirë. Jen' kon' me banka edhe jen' kon' veç për çika veç për djem. Kemi kemi mësu me nji klasë djem e çika. Mësues të parë e kam pasë Beqir Efendinë-Beqir Baraki(u)n. Deri sa e kom

[5] Kur themi vetëdije e përgjithshme kemi parasysh grupin e njerëzve që udhëhiqnin me Gjakovën, e që ishin: bejlerët, agallarët, esnafët etj.

[6] I. Ajeti, Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX, Vepra 2, Prishtinë 1998.

bo musafin hatme e kam pasë at' mësues. Kur e kemi bo hatme Musafin, jen' thirrë t'gjithë ulematë e Gjakovës e të Sarajevës për me na ngu neve qysh e kemi msu Musafin. Jan' konë Haxhi Mustafë Efendia, Haxhi Fahria(u), t'cilët rrijshin përmi Xhami të Hadumit edhe ishin ma t'mirët dhe ma t'shkollunit. Vijshin edhe ulematë pi Sarajevës edhe na vnojshin neve n'midis edhe e hapshin Musafin, e ku t'bijke fleta na pytshin. Kur e dijshim, n'ven se t'thojshin shkëlqyeshëm, thojshin ***jepja aritnomën,*** *d.m.th. shkëlqyeshëm. Kush dijke menjëherë e kalojshin. (rrëfimtarja 5, 79, Gjakovë)*[7]

Duke lexuar këtë pjesë teksti, të marrë nga rrëfimtarja e lartpërmendur, mund të vëresh se përveç orientalizmave që përdoren aty, edhe kultura fetare (orientale) ishte faktor i fuqishëm në zhvillimin e jetës në Gjakovën e asaj kohe, e që e ndihmoi shumë futjen e orientalizmave në leksikun e këtij qyteti.

Depërtimi i orientalizmave u bë dalëngadalë dhe depërtoi në të gjitha sferat e jetës. Si orientalizma të hershëm që u trashëguan nga koha e kontakteve të para mes shqipes dhe turqishtes, janë edhe orientalizmat nga **sfera e luftës** e që mund të hasen në të gjitha leksikun e shqipes. Edhe në leksikun e Gjakovës përdoren fjalë si: *bajrak*, *bori*, *dylbi*, *fitil*, *mejdan*, *haraç*, *hesap* etj.

Nga jeta shtëpiake kemi një mori orientalizmash, të cilët përdoren edhe sot e kësaj dite, dhe pothuajse e kanë zënë vendin e tyre në leksikun e Gjakovës. Orientalizma të tillë si: *tepsi*, *sini temel*, *oxhak*, *hajat*, *konak*, *bahçe (në të folurit e përditshëm shqiptohet si bahçe)*, *hambar (po ashtu shqiptohet hamar)*, *sinxhir*, *meze*, *qofte(qyfte)*, *qyshk*, *pekmez*, *paçe*, *pilaf*, *baxhë*, *kafaz*, *çarçaf*, *legen*, *perde*, *peshqir*, *qilim*, *turshi*, *reçel*, *sheqer*, *bozë*, *niseshte*, *sheqe pare*, *hanxhar*, *tas*, *tavë*, *taze etj.*

Nga jeta shoqërore përdoren orientalizma si: *adet*, *amanet*, *boja*, *bullë*, *bela*, *hesap*, *hajn*, *mavi*, *pishman*, *sfungjer*, *teneqe* etj. Duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e popullsisë në Gjakovë janë të fesë

[7] **Arbnora, Dushi.**
-Homo narrans-Rrëfimi personal gojor. Instituti Albanologjik, Prishtinë 2009.

myslimane, shtresa e huazuar e leksikut oriental zuri një vend me rëndësi në emërtimin e ideve fetare dhe personelit të shërbimit fetar. Fjalë të tilla janë: *Allah, abdes, dervish, duva, exhel, gjynah, hafiz, imam, mulla, namaz, hoxhë, pejgamber, xhami, teqe, tyrbe* etj[8]. Përdorimi i këtyre fjalëve zakonisht vërehet me rastin e ceremonive të ndryshme fetare islame, ku biseda kryesisht ka karakter edukues me këshilla fetare nga Kur'ani. Edhe me rastin e martesave këto fjalë gjejnë përdorim të madh, dhe shprehja e urimeve për çiftin e ri dhe familjen e tyre në të shumtën e rasteve ka elemente fetare. Si material i mirë për studimin e orientalizmave mund të shërbejnë ilahitë fetare të sektit Bektashi, ku vërehet një numër i konsiderueshëm i tyre.

Po sjellim pak vargje të një (ilahije) të emërtuar ***Lartësona Shejhun:***

Shehu i famshëm në këtë botë,
Trashëgimtar i Aliut tonë,
Rob i Muhamedit në iman,
Hasreti Pir, Zotriu ynë.

Me vetminë e Mustafasë,
U trondit kjo dynja,
Zbret shpallja prej Arshi-alasë,
Hasreti Pir, Zotëriu ynë.[9]

Duke shikuar vargjet e kësaj ilahije, është e qartë se edhe pse autori i ka përshtatur shumë me gjuhën standarde, prapëseprapë ka fjalë orientale që e vërtetojnë se sekti Bektashi ka kontribuar dhe kontribuon në përdorimin e fjalëve orientale në leksikun e Gjakovës.

Është interesant se kur shikohen turqizmat që i ka nxjerrë profesor Idriz Ajeti te Vehbija e Tahir Efendi Boshnjakut, vërehet se një numër i konsiderueshëm i tyre përdoren edhe sot e kësaj ditë si pjesë aktive e leksikut të Gjakovës. Një pjesë e këtyre turqizmave, të nxjerra nga

[8] Depërtimin e orientalizmave në leksikun e Gjakovës e ka ndihmuar edhe sekti mysliman i Bektashizmit, të cilët janë mjaft aktiv dhe me një anëtarësi të madhe (myhyb). Ilahitë që ata i këndojnë nëpër organizimet e tyre fetare kanë shumë fjalë orientale.
[9] Shejh Lutfi Shehu, Teqja nëpër kujtimet e mia, Prishtinë, 2005.

Idriz Ajeti janë këto: barabar, *duá, elbete, erz, gafil, hizmet, masraf, melun, nefs, nimet, tabiat,zahmet etj.*

Përveç orientalizmave që u përmendën më lart, ato gjenden edhe në fusha të tjera të jetës si: administratë, veglat e punës, lënda e parë, emërtimi i pemëve dhe barishteve të ndryshme si dhe një numër i madh emrash konkretë dhe abstraktë. Nga këto fusha që u përmendën kemi orientalizmat si: *açik, adalet, aferim, adet, ahër, âjam, ajét, ajran, akraba, allahile, allti, aman, amanet, badihava, bajat, bakall, bakllava, bakshish, batall, dallkauk, dallash, dalldis, dajre, dogri, evlad, hygjym, hafif, hajat, hashari, japi, jasha, kaba, kastile, kyvet, kismet, masllahat, mashalla, meremet, namazgjah, nahi, nur,olluk, ortak (artak), paçaver, pallavra, perdesyz, teveqel, tekrar, teslim, qervish, qeshme, qyl, rahmet, rrebe, sabah, saç, sagllâm, sahân, syret, synet, shyhret, tabâk, tabiât, takât, ujdis, ullúk, vakÍ, vakt, xhadé, xhep, yrnek, zagar, zanát, zarár* etj.

Përfundim

Po të shikojmë mE kujdes orientalizmat, vërejmë se në leksikun e Gjakovës janë të shtrirë pothuajse në të gjitha fushat e jetës. Shumica e këtyre fjalëve i përkasin leksikut aktiv, fjalë që përdoren më shpesh dhe nuk ka emërtime tjera për sendet që shënojnë. Orientalizmat shpesh përdoren edhe për të krijuar lojë fjalësh, ose për të përqeshur dikë. Shihet se depërtimi i hershëm i këtyre fjalëve në leksikun e Gjakovës, dhe përdorimi i gjatë ka bërë që një numër i tyre sot të jenë pjesë e fjalorit të gjuhës shqipe. Duhet cekur se modernizimi i jetës në vitet e fundit mund të ndikojë në largimin e disa orientalizmave, dhe zëvendësimit të tyre me fjalë të tjera për sendet gjegjëse. Faktorët tjerë që mund të ndikojnë në heqjen nga përdorimi të orientalizmave të panevojshëm për të folmen e Gjakovës, janë: ngritja e nivelit të arsimimit në përgjithësi, ndikimi çdo ditë e më i madh i anglishtes si një gjuhë globale etj.

***Përmbajtje e shkurtër**: Orientalizmat si një dukuri e mbarë gjuhëve ballkanike kanë zënë vendin e tyre edhe në leksikun e gjuhës shqipe. Është e ditur se depërtimi i orientalizmave në gjuhën shqipe filloi shumë herët, ndërkaq shtresa e huazuar e orientalizmave tashmë ka zënë vend në pjesën aktive të leksikut të shqipes. Gjakova, si një qytet me një traditë të vjetër qytetare, që nga themelimi e këtej bashkëjetoi me frymën kulturore orientale, duke marrë parasysh rrethanat në të cilat u zhvillua jeta në përgjithësi. Edhe sot e kësaj dite në leksikun e Gjakovës, shtresa e huazuar e orientalizmave zë një vend të konsiderueshëm. Orientalizmat në leksikun e Gjakovës i hasim pothuajse në të gjitha fushat e jetës. Përdorimi i tyre shpeshherë merr funksione të ndryshme gjatë të folurit. Orientalizmat mund t'i hasim si fjalë që nuk e kanë gjegjësen tjetër për t'u zëvendësuar (fjalë të tilla tashmë janë pjesë e mbarë leksikut të shqipes), i hasim edhe në funksione të ndryshme figurative (për lojë fjalësh, për krijimin e atmosferëve të caktuara me qëllime të caktuara etj). Gjakova përveç depërtimit të fjalëve orientale në leksik, ka edhe një pasuri të madhe të objekteve kulturore e fetare me stil dhe kulturë orientale, të cilat gjakovarët i ruajnë me fanatizëm.*

Leteratura:

Androkli, Kostallari.
-Rreth depërtimit të turqizmave në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII. Tiranë 1989, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III,f 94.

Arbnora, Dushi.
-Homo narrans-Rrëfimi personal gojor. Instituti Albanologjik, Prishtinë 2009.

Anton, Krajani.
-Hyrja e turqizmave në shqipen dhe përpjekjet për zëvendësimin e tyre. Tiranë 1972, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II,f 279.

Eqrem, Çabej.
-Studime gjuhësore III. Rilindja Prishtinë, 1987.
-Për një shtresëzim kronologjik të huazimeve turke të shqipes, Studime Filologjike. 1975, nr. 4, f. 79-85.

Emil, Lafe.
-Orientalizmat si verb poetik te Saadiu shqip. Revista shkencore Perla, Tiranë 2007, fq. 31-41
-Persizmat në gjuhën shqipe. Revista shkencore Perla, Tiranë 2007 Nr. 1 (44) fq. 162-169.

Feti, Mehdiu .
-Orientalizmat: Hyrja dhe përdorimi i tyre në gjuhën shqipe. Tiranë 1989, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III.f 407.

Idriz, Ajeti.
- Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX. Vepra 2, Prishtinë 1998.

Shaban, Demiraj.
- Gjuhësi ballkanike, Tiranë 2004.

Tahir, Dizdari.
-Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe. Tiranë 2005.

Naim Berisha

ORIENTAL WORDS IN THE LEXICON OF GJAKOVA

(Summary)

It is an undeniable fact that the peoples that live next to each other while exchanging different cultural elements exchange words as well. Language reflects the road of a people through history. Throughout history Albania and the Albanians had contacts with different peoples and as a result of these contacts the Albanian language borrowed many words from the languages it came into contact with. Oriental words are part of the Albanian lexicon but are also part of the other languages in the Balkans.

ناعم بريشا

الكلمات الشرقية في لهجة جاكووا

(خلاصة البحث)

يعد عملا مهما أن العشوب المجاورة يتبادلون فيما بينهم في أشياء ثقافية و لغوية يأخذون ويعطون فيما بينهم. اللغة تمثل تاريخ شعب عبر القرون. ان تاريخ الشعب الالباني لا يختلف عن كثير من الشعوب الاخرى ونتيجة لذلك نرى أن هناك تداخلات فيما بينهم في المجال اللغوي والكلمات الشرقية تعتبر من أكثر الكلمات التى اختلطت باللغة الالبانية ألا ان هذه الظاهرة موجودة أيضا في بقية اللغات البلقانية.

PORTRETE TË SAHABIJATEVE

Dr. Abdurrahman Rafet el-Basha

EL-GUEMEJDAU BINTU MILHAN
E njohur me llagapin Umu Sulejm

> **“Nuk kemi dëgjuar për ndonjë grua të jetë më dorëlirë se sa Umu Sulejm. Mehri i saj ishte Islami.”** Banorët e Medinës

Në kohën kur islami shndriti tokën me dritën e tij, El-Gumejdau bintu Milhan, ishte në të dyzetat e jetës së saj. Bashkëshorti i saj, Malik ibnu Nadr, tregonte kujdes të veçantë ndaj bashkëshortes së tij, duke ia bërë jetën e saj të lumtur për shkak të mençurisë, urtësisë, largpamësisë dhe sjelljeve të mira me të cilat cilësohej bashkëshortja e tij.

Dhe një ditë prej ditësh të Allahut të paharruara depërtoi në Medinë drita e parë e udhëzimit të Muhamedit nëpërmes thirrësit nga Meka, Mus’ab ibnu Umejrit. Për këtë udhëzim u hap zemra e Gumejdas, sikundër hapen lulet për të lajmëruar ardhjen e mëngjesit. Pas një kohe shumë të shkurtër, ajo e shpalli islamin e saj, në kohën kur numri i muslimanëve në Medinë nuk arrinte sa gishtat e dorës.

Pastaj kjo grua besnike e ftoi burrin e saj të pasur që të pajiset nga ai burim hyjnor dhe të ketë nderin që edhe ai t’i fitojë gëzimin dhe lumturinë e imanit.

Mirëpo, për fat të keq, kraharori dhe shpirti i Malik ibnu Nadrit, nuk ishte i hapur për fenë e re. Ai, përkundrazi, e ftoi gruan e tij që ta braktiste islamin dhe të kthehej në fenë e baballarëve dhe të gjyshërve. Secili nga bashkëshortët ishte i vendosur në qëndrimin e vet. Gumejdaja urrente të kthehej në mosbesim, pas besimit (imanit) ashtu siç e urren njeriu të hidhet në zjarr… Ndërsa, Maliku ishte i lidhur për fenë e baballarëve dhe gjyshërve me një fanatizëm të madh.

Gumejdaja kishte argumente dhe fakte me të cilat e mposhte bashkëshortin e saj. Thirrja e saj ishte e mbështetur në dritën e së vërtetës me të cilën nuk mund të ballafaqohej burri i saj.

Maliku kishte një idhull prej druri, të cilin e adhuronte. Ajo polemizonte me të, duke i thënë:

A po e adhuron një trup druri që ka mbirë në tokë, të cilin e shkel me këmbët e tua dhe në të i qet hedhurinat e tua?!

A po e adhuron tjetërkënd përveç Allahut, një dru që e ka bërë një mjeshtër abisinas nga mjeshtrit e Mekës?!

Meqenëse burri ishte ngushtuar para argumenteve të shumta dhe të qarta të bashkëshortes së tij, nuk i kishte mbetur tjetër, veçse ta braktiste Medinën dhe kishte marrë botën në sy e ishte nisur në drejtim të Shamit. Atje nuk kishte jetuar vetëm një kohë të shkurtër dhe kishte vdekur në politeizmin e tij.

* * *

Posa u përhap lajmi në Medinë se Gumejdaja kishte mbetur e vejë, shumë burra shprehën dëshirën që të martoheshin me të, por shumica prej tyre kishin frikë se ajo do t’i kthente ata për shkak të dallimit ndërmjet tyre dhe asaj në aspektin fetar.

Mirëpo, Zejd ibnu Sehli, i cili thirrej me llagapin Ebu Talha, e lakmoi atë për shkak të lidhjeve familjare, sepse që të dy ishin nga fisi Benu Nexhar.

* * *

Ebu Talha shkoi në shtëpinë e Gumejdas dhe i foli asaj me llagapin e saj duke i thënë:

Oj Umu Sulejm, kam ardhur që të të fejoj, prandaj, të lutem, mos më kthe të zhgënjyer.

Ajo ia ktheu: Betohem në Allahun, se njeriu si ti nuk mund të kthehet, o Ebu Talha. Mirëpo, ti je njeri jobesimtar, ndërsa unë jam grua muslimane dhe për mua nuk është e lejuar të martohem me ty. Nëse ti pranon të bëhesh musliman, nuk do të kërkoj prej teje kurrfarë mehri (pajë), le të jetë mehri yt për mua Islami.

Ai ia ktheu: Më lejo të mendoj rreth kësaj. Pastaj shkoi.

Të nesërmen ai erdhi tek ajo dhe i tha: Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut. Ai është i vetëm, nuk ka shoq dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i tij.

Ajo, atëherë i tha: Meqenëse ti e pranove fenë islame, unë jam e kënaqur që të jesh burri im. Atëherë, njerëzit filluan të thonë: Nuk kemi dëgjuar asnjëherë të ketë pasur ndonjë grua më dorëlirë në mehr se Umu Sulejm, mehri i të cilës ishte Islami.

* * *

Ebu Talha ishte i kënaqur me cilësitë fisnike me të cilat shquhej Umu Sulejm. Mirëpo, ajo që e gëzoi atë edhe më tepër, ishte fakti se ajo i lindi atij një djalë, i cili ishte dritë e syve të tij dhe gëzim i zemrës së tij.

Në momentet kur ai përgatitej të nisej në njërin prej udhëtimeve të tij, fëmija i vogël iu ankua për një sëmundje që e kishte goditur, për çka ai u frikua aq shumë sa që gati kjo gjë u bë pengesë për udhëtimin e tij.

Në mungesën e tij të shkurtër, djaloshi u dobësua aq shumë dhe ndërroi jetë. Umu Sulejm u tha familjes së saj:

Mos e lajmëroni Ebu Talhan për vdekjen e të birit të tij derisa t’i them unë për këtë.

* * *

Ebu Talha u kthye prej udhëtimit dhe atë e priti Umu Sulejm e gëzuar si asnjëherë më parë. Ai menjëherë e pyeti për fëmijën e tij e ajo i tha:

Lëre të qetë atë tash, sepse ai është në një vend më të mirë se asnjëherë më parë.

Pastaj ia ofroi atij ushqimin e darkës dhe filloi të bisedonte me të, duke ia futur gëzimin në zemrën e tij. Kur e vërejti se ai ishte ngopur dhe ishte çlodhur mirë, i tha:

O Ebu Talha, a mendon se kur njerëzit i rikthejnë gjërat e tyre, të cilat ua kanë dhënë në shërbim të tjerëve, a kanë të drejtë ata të mos ua japin atyre?

Ai tha: Jo.

Ajo atëherë ia ktheu: Allahu e mori atë që ta kishte dhuruar ty. Llogarite se fëmija yt tash është tek Ai.

Kështu Ebu Talha e pranoi vendimin e Allahut të Madhërishëm me kënaqësi dhe vendosmëri.

Posa u zgjua të nesërmen në mëngjes shkoi te Pejgamberi, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të, dhe ia tregoi tërë atë që kishte ndodhur me Umu Sulejmin. Atëherë, Pejgamberi a.s. u lut për të dy ata që Allahu t’ua kompensojë me një fëmijë edhe më të mirë se atë që kishte ndërruar jetë dhe që Allahu t’i bekojë ata.

Allahu i Madhërishëm i ishte përgjigjur lutjes së Pejgamberit të Tij dhe Umu Sulejmi mbeti shtatzënë. Në momentin kur e kishte kryer afatin e shtatzënisë, ajo ishte duke u kthyer për në Medinë nga një udhëtim së bashku me bashkëshortin e saj dhe Pejgamberin a.s.

Në momentin kur ata i ishin ofruar Jethribit asaj iu shfaqën dhembjet e lindjes. Ebu Talha u ndal që të jetë pranë saj, ndërsa Pejgamberi a.s. vazhdoi rrugën që të hyjë në Medinë para se të bjerë muzgu i mbrëmjes. Atëherë, Ebu Talha i ngriti duart kah qielli dhe tha:

O Zoti im! Ti e di se unë dëshiroj të dal me të Dërguarin Tënd kur ai del dhe dëshiroj të kthehem me atë kur ai kthehet, por sot më pengoi kjo që Ti po e sheh.

Umu Sulejmi atëherë i tha: O Ebu Talha, betohem në Allahun se unë nuk ndiej dhembje nga kjo lindje, sikurse kam ndier nga lindja e

mëparshme. Nisu menjëherë dhe mos u vono që të jemi në shoqërimin e Pejgamberit a.s.

U nisën dhe posa arritën në Medinë, ajo lindi foshnjën e saj dhe ai ishte djalë. Atëherë ajo iu tha atyre që ishin pranë saj:

Mos t'i japë askush gji para se ta dërgoni te Pejgamberi a.s.

Të nesërmen në mëngjes e dërgoi atë vëllai i tij Enes ibnu Malik dhe posa e pa Pejgamberi a.s. se ishte nisur tek ai i tha:

Me siguri Umu Sulejmi paska lindur.

Ajo iu përgjigj: Po, o i Dërguari i Allahut. Pejgamberi a.s. e vendosi foshnjën në prehrin e tij dhe e kërkoi një hurmë prej hurmave të Medinës dhe e mbajti në gojën e tij fisnike derisa ajo u zbut, pastaj e vuri atë në gojën e foshnjës dhe foshnja nisi ta lëpinte atë. Pastaj e preku fytyrën e tij me dorën e tij fisnike dhe ia la emrin Abdullah, ndërsa prej pasardhësve të tij ishin dhjetë nga dijetarët më të zgjedhur të Islamit.

* * *

Umu Sulejmi e donte dhe e respektonte Pejgamberin a.s. deri në atë masë sa që ajo e bëri që të bashkojë mishin dhe ashtin dhe t'i vendoste në brendi të zemrës.

Për respektin e madh që ajo kishte ndaj Pejgamberit a.s. flet i biri i saj Enesi: Në shtëpinë tonë fjeti një ditë Pejgamberi a.s. dhe bënte vapë e madhe. Djersët kishin filluar të pikin prej ballit të tij, ndërsa nëna mori një enë dhe filloi t'i mblidhte në të djersët. Ndërkohë Pejgamberi a.s. u zgjua dhe tha:

"Çka po bën kështu o Umu Sulejm?!"

Ajo iu përgjigj: Djersët e tua po i vë në aromën tonë, sepse atëherë po bëhet aroma më e mirë.

* * *

Dëshmitë e respektit të saj të madh ndaj Pejgamberit a.s. janë të shumta. I biri i saj, Enesi, kishte në pjesën e përparme të kokës flokë të gjatë, të cilët ia zinin ballin dhe burri i saj dëshiroi që t'ia priste pasi

që i ishin zgjatur shumë. Mirëpo, Umu Sulejmi e kundërshtoi ta bënte një gjë të tillë me arsyetimin se Pejgamberi a.s., sa herë që e takonte Enesin, ia prekte kokën me dorën e tij dhe ia lëmonte kaçurrelat e flokëve që ia mbulonin ballin e tij.

* * *

Umu Sulejmi nuk cilësohej vetëm si besimtare e fortë, e urtë e mendjehollë, bashkëshorte dhe nënë e klasës së parë…

Por, mbi të gjitha ajo ishte luftëtare në rrugën e Allahut.

Sa shumë herë ishin mbushur mushkëritë e saja me pluhurin e betejave të përzier me aromat e xhenetit!!

Gishtat e saj kishin ndërruar ngjyrën e tyre nga plagët e muxhahidinëve, duke i fshirë ajo me duart e saja duke ua shtrënguar lidhëset.

Sa herë që ajo ia kishte shuar etjen atyre, të cilëve e dhuronin jetën e tyre për hir të Allahut.

Ajo ua bartte ushqimin dhe ua rregullonte shigjetat.

* * *

Umu Sulejm mori pjesë në betejën e Uhudit së bashku me burrin e saj Ebu Talha dhe Pejgamberin a.s. Ajo së bashku me Ajshen, Zoti qoftë i kënaqur me të dyja, i bartën calikët e ujit në krahët e tyre dhe i zbrazën ata në gojët e luftëtarëve të etur.

Umu Sulejmi po ashtu mori pjesë edhe në betejën e Hunejnit. Në atë betejë ajo e kishte marrë në dorë një thikë dhe kur e pa ashtu burri i saj, Ebu Talha, tha: O i Dërguari i Allahut! Ja kjo është Umu Sulejmi, ka marrë në dorë një thikë.

Pejgamberi a.s. atëherë e pyeti:

"Ç'është kjo, o Umu Sulejm?!"

Ajo iu përgjigj: Kjo është thikë, e kam marrë që, nëse më ofrohet ndonjë jobesimtar, t'ia çaj barkun me të.

Atëherë, Pejgamberi a.s. filloi të qeshte i gëzuar me atë që e tha Umu Sulejmi.

* * *

A mund të ketë në tërë rruzullin tokësor ndonjë grua më të lumtur se Umu Sulejmi, pasi që për të Pejgamberi a.s. kishte thënë:

“Hyra në xhenet dhe aty dëgjova një lëvizje hapash”.

Atëherë pyeta: Kush është?!

Më thanë: Kjo është El-Gumejda bintu Milhan, nëna e Enes ibnu Malikut.

Dr. Abdurrahman Rafet el-Basha

EL-GUMEJDAU BINTU MILHAN
Umm Sulaym

(Summary)

“We have never yet heard of a mahr that was more valuable and precious than that of Umm Sulaym for she made Islam her mahr."

When Islam illuminated the world with its light, El-Gumejdau bintu Milhan, was in her forties. Her husband, Malik ibn an-Nadr, showed special attention towards her due to the intelligence, wisdom, vision and manners that characterized her (making her life happy).

د. عبدالرحمن رأفت الباشا

الغميضاء بنت ملحان
المكناة بأم سليم

(خلاصة البحث)

"ما سمعنا بامرأة كانت أكرم مهرا من أم سليم اذ كان مهرها الاسلام" (أهل المدينة)

كانت الغميضاء بنت ملحان حين أهل الاسلام بنوره على الأرض نصفا تخطو نحو الأربعين من عمرها و كان زوجها مالك بن النضر يسبغ عليها من وارف حبه وظليل وداده ما ملأ حياتها نضرة ورغدا و كان أهل يثرب يغبطون الزوج السعيد على ما تتحلى به عقيلته من رجاحة العقل وبعد النظر و حسن التبعل.

*A. K. M. Mohiuddin**

ÇKA I OFRON ISLAMI NJERËZIMIT

Islami e fton njeriun në të vërtetën dhe suksesin. I ofron njeriut daljen nga errësira në dritë dhe i tregon mënyrën më të mirë për të jetuar. I tregon njeriut se jeta e jetuar në përputhje me të vërtetën është e vetmja që mund t'i sigurojë suksesin e vërtetë. I ofron njeriut bazat e qëndrueshme mbi të cilat mund të ndërtojë jetën e qetësisë dhe paqes, dhe i tregon se si ta bëjë atë.

Me njohurinë e eksperiencën e tij të kufizuar dhe paragjykimet e tij subjektive, njeriu kurrë nuk mund vetë ta kuptojë të vërtetën për ekzistencën e tij apo

të përcaktojë drejtimin e duhur për jetën e tij. Ai kurrë nuk mund të dijë origjinën dhe kuptimin e jetës së tij dhe Universin e gjerë, në të cilin gjendet. Kurrë nuk mund të zbulojë identitetin e tij të vërtetë, pozitën e funksionin e tij në Univers dhe destinacionin e tij. Ai mund të pyes për këto gjëra, por kurrë nuk do të marrë përgjigje të kënaqshme. Madje, nuk mund të kuptojë veten mirë dhe të mbetet kështu një i huaj për veten e tij.

Pa përgjigje të qarta, gjithëpërfshirëse dhe konsistente në këto pyetje, jeta e njeriut mbetet e errët, e zbrazët dhe pa kuptim, një mister i pazgjidhshëm dhe një barrë e padurueshme. Ai kërkon nga gafa në gafë, dëshpërim pas dëshpërimi, dhe kurrë nuk gjen paqe, shpresë dhe qetësi në zemrën e tij - një gjendje e dëshpërimit të papërshkrueshëm.

Për të dalë nga ky hutim dhe nga kjo agoni, njeriu mund të ndihmohet nga dikush që është i lirë nga të gjitha kufizimet, i cili është perfekt në njohuri dhe kuptim, dhe gjithashtu perfekt në aftësi dhe i cili është i vëmendshëm e i mirë me njeriun. A ekziston ndonjë ndihmë e tillë që është në dispozicion për njeriun? A ka ndonjë shpresë për njeriun për t'i dhënë jetës një kuptim dhe qëllim?

Islami e ofron këtë ndihmë dhe shpresë

Së pari, Islami ofron shpjegim të qartë, konsistent dhe gjithëpërfshirës për Universin dhe gjithçka që ekziston në të, duke përfshirë edhe jetën e njeriut. Ai i tregon njeriut për ekzistimin e Krijuesit dhe Zotit të Universit, i cili është mbi çdo kufizim. Ai është i përsosur në fuqi, dituri dhe urtësi. Ai është i përjetshëm. Ai nuk ka shok, dhe askush nuk është i njëjtë me të. Ai është unik, ndryshe nga çdo gjë apo çdokush që njohim. Krijuesi dhe Sunduesi i gjithë kësaj është All-llahu (i lartësuar në lavd dhe pushtet). Islami jo vetëm që thotë se Ai ekziston, por gjithashtu ofron arsyetim të mjaftueshëm për njeriun për të pranuar këtë të vërtetë.

All-llahu i Lartësuar mund të krijojë çka të dojë nga asgjëja dhe të përcaktojë funksionin e tij. Universi dhe rregullimi i tij është rezultat i dëshirës së Tij dhe do të ekzistojë vetëm sa të dëshirojë Ai. Ekzistojnë

vetëm dy aspekte të skemës së Tij për gjërat, Krijuesi i Vetëm dhe krijesat e Tij. Të dyja janë të dallueshme. Krijimi është i varur nga Ai, por Ai nuk është i varur nga askush apo asgjë, dhe pasi Ai është i përjetshëm, krijimi është vetëm i përkohshëm. Një ditë Ai do t'i japë fund këtij rregullimi të krijimit. Nuk ka fuqi që mund të shmangë, shpejtojë apo të shtyjë këtë që do të vijë. Nuk ka asnjë fuqi të aftë për ndalimin e dëshirës së Tij. Vetëm All-llahu xh.sh. është i vetmi i vërtetë dhe realitet i përjetshëm, dhe vetëm krijimi ka ekzistencë të shkurtër.

All-llahu xh.sh. ka krijuar gjithçka me një qëllim. Asgjë nuk është e rastit apo aksidentale. Gjithçka që është krijuar i është përcaktuar një funksion dhe destinim. All-llahu është i Zgjuar dhe është i njohur për gjithçka. Asgjë nuk mund t'i ikë shikimit apo dëgjimit të Tij. Asgjë nuk është sekret për Të.

Kjo është e vërteta më fondamentale për të cilën Islami fton njeriun. Kjo është zemra e Islamit apo themeli mbi të cilin qëndron Islami. Kjo është e vërteta e shprehur nga konceptet islame të Tavhidit (Njëshmërisë së All-llaut). Çdo gjë tjetër në Islam pason këtë të vërtetë të vetme.

Vetëm e vërteta mund të shpëtojë njeriun. Në mungesë të së vërtetës, ekziston vetëm një errësirë e pakalueshme dhe gënjeshtër që e vë në kurth dhe e shkatërron njeriun. Por, njeriu nuk mund të krijojë të vërtetën. Ai mund vetëm të spekulojë, hamendësojë dhe krijojë thjesht iluzione që plasin si flluska. Më së shumti që mund të bëjë është të jetë i etur për të vërtetën, ta njohë dhe ta pranojë atë kurdo që shfaqet dhe pastaj të përpiqet t'i bashkohet asaj.

Njeriu nuk mund të krijojë as kuptimin e vlerën. Që çdo gjë të ketë ndonjë kuptim në të, universi duhet të ketë një kuptim. Mund të mos ketë asnjë kuptim për njeriun, nëse Universi në të cilin jeton nuk ka asnjë kuptim; atëherë do të ketë vetëm konfuzion dhe çrregullim të verbër. Nuk mund të ketë asnjë vlerë në Univers pa kuptim. Kuptimi dhe vlera nuk mund të lindin apo krijohen nga njeriu prej boshllëkut. Që të dyja procedohen nga Krijuesi dhe Sunduesi i Universit dhe Dizajnuesi i destinimit të tij. Vetëm Ai mund t'i japë kuptim dhe vlerë

çdo gjëje që dëshiron. Vetëm ajo që Ai i jep kuptim është kuptimplotë, vetëm asaj që i jep vlerë është me vlerë. Ata nuk kanë ekzistencë të pavarur nga Ai, si asgjë tjetër që nuk ka në Univers.

Vetëm pasi njeriu ka kuptuar të vërtetën e tevhidit, ai e ka gjetur spirancën e jetës së tij, e cila mund ta shpëtojë nga lëvizja pa asnjë qëllim në baticat e ndryshueshme të kësaj bote, duke ngecur në shkëmbinjtë e konfuzionit dhe iluzionit. Me këtë njohuri të Zotit të Universit, njeriu e kupton tani se jeton në një Univers kuptimplotë dhe se jeta e tij ka një kuptim dhe qëllim. Vetëm mbi këtë bazë të qëndrueshme, njeriu mund të ndërtojë jetën e tij pa asnjë frikë nga shkatërrimi, një jetë të lirë nga fragmentimi i dhimbshëm dhe kontradiktat e papajtueshme.

Së dyti, Islami i tregon njeriut se kush është, cili është pozicioni dhe funksioni i tij në Univers dhe se nga po shkon. Njeriu është qenie e krijuar që jeton në një univers të krijuar. Ai i përket Krijuesit dhe Sunduesit të tij. Ai është një rob i All-llahut xh.sh., sikur gjithçka tjetër në Univers. Por, Krijuesi dhe Sunduesi i tij i kanë dhënë kësaj krijese të vogël në këtë Univers të madh një pozitë të veçantë, pozitën e khalifas apo trashëgimtarit në tokë. Edhe si çdo rob besnik që i bindet zotërisë të tij dhe i kryen detyrat që i janë caktuar atij, njeriu si rob i All-llahut xh.sh. duhet t'i bindet Atij dhe t'i kryejë detyrat që i janë caktuar. Sikur çdo njeri i ndershëm dhe i sinqertë, njeriut duhet të përmbushë me besnikëri besimin e tij. Ky është adhurimi. Shkalla e besimit është e gjerë sa edhe vetë jeta. Asnjë pjesë e jetës së njeriut nuk është jashtë domenit të tij.

Megjithatë, njeriut i është dhënë liria për t'iu bindur Zotit të tij dhe të përmbushë besimin e tij apo jo. Në këtë, njeriu dallon nga krijesat tjera. Çdo krijesë tjetër i bindet All-llahut dhe kurrë nuk devijon nga kursi që i është përcaktuar. Njeriut i është dhënë zgjidhja, zgjidhja që t'i bindet Zotit të tij apo të jetë i pabindur. Gjithashtu, njeriut i është treguar se liria e tij ka implikime të jashtëzakonshme për të. Jeta e tij në këtë botë është një test. Zoti i tij dëshiron të shohë nëse njeriu zgjedh të jetojë një jetë të bindjes apo të rebelimit dhe një ditë Ai do të gjykojë njeriun për zgjedhjen e tij.

Për të vendosur bazën për këtë ngjarje unike, Zoti i Universit ka caktuar një ditë për t'i dhënë fund këtij rregulli të Universit. Ai do t'i mbledhë të gjithë në një asamble të madhe të gjithë njerëzit që kanë jetuar në këtë botë. Asnjë njeri nuk mund të shmangë apo të shtyjë ardhjen e kësaj dite historike.

Vdekja nuk sjell fundin e jetës së njeriut. Ajo vetëm është portë për një jetë tjetër në botën tjetër me një rend të ndryshëm, ku do të jetë përballë me Zotin e tij. Në atë botë të re, liria e vogël e njeriut që ka gëzuar në këtë jetë do t'i merret. Ai do të jetë plotësisht në duart e Zotit të tij. Pastaj njeriu do të japë përgjegjësi për përdorimin e jetës së tij dhe për dhuratat e mirësitë e kësaj bote që i kishte në dispozicion nga Zoti i tij. Llogaridhënia do të jetë absolutisht e plotë. Asgjë që ky njeri e ka ndjerë, menduar apo vepruar nuk do të mbetet jashtë. Nuk do ketë mungesë të provave për të dëshmuar për apo kundër tij. Askush nuk do të ketë kapacitetin për të mohuar, shtrembëruar apo për të falsifikuar provat. Ky do të jetë një gjykim i paprecedent mbi një shkallë të paprecedent. Kjo do të jetë një ditë e zymtë për njeriun. Çdonjëri do të shpërblehet apo do të ndëshkohet nga Zoti i tij në bazë të përdorimit të lirisë së tij në këtë jetë - qoftë nëse ka zgjedhur të jetë i bindur ndaj Zotit apo i pabindur. Që të dyja, shpërblimi dhe ndëshkimi do të jenë të mëdha, mbi çdo gjë që njeriu mund të imagjinojë. Pastaj, ai do të gjejë shtëpinë e tij finale, xhenetin apo xhehenemin, cilado që e meriton, për të jetuar përgjithmonë.

Kjo do të jetë dita më e madhe e së vërtetës dhe realitet për njeriun. Kjo do të jetë dita e zgjimit të tij të plotë. Ai do të kuptojë dyshimin apo konfuzionin më të vogël se çka ishte në të vërtetë, se cili është suksesi real dhe gëzimi i vërtetë, dhe çka është dështimi real dhe mjerimi i vërtetë. Ai do të kuptojë se cila e vërtetë është reale dhe çka është e rremë e iluzore. Ai do të shohë se çka ndërtuar për veten gjatë gjithë jetës së tij, si vendbanim të tij final, një lumturi e përhershme apo mjerim. Ai do të kuptojë sesi gjatë jetës së tij ka qenë i angazhuar në krijimin e fatit të vet që tani e ka gjetur.

Sigurisht, është e vërtetë se All-llahu xh.sh. është i mëshirshëm dhe mund të falë çdokënd. Por, kjo është e drejtë e Tij. Ai do të falë kë të dojë. Askush nuk e di se cilët do të jenë këta fatlumë.

Nuk ka asgjë të pabesueshme në gjithë këtë. Ai që ka krijuar njeriun dhe këtë Univers mund të bëjë çdo gjë. Ai mund të krijojë dhe rikrijojë çdo gjë në çdo kohë e në çdo formë apo mënyrë. Ai vetëm duhet ta dëshirojë këtë.

Ky është ahireti në Islam. Ai i jep sens dhe kuptim jetës së njeriut. Ai e sjell njeriun në rrethin e plotë dhe i bën bashkë të gjitha enigmat e jetës së tij. Atëherë, kompletohet fotoja.

Gjatë gjithë jetës së tij, njeriu me mjaft dëshpërim përpiqet për qëndrueshmëri, përpiqet për diçka që e do, dhe është i gëzuar të qëndrojë me të. Por, në vend të kësaj e gjen se gjithçka ka kaluar; koha përpin çdo gjë. Kjo përpjekje e njeriut për qëndrueshmëri përmbushet tani, përmbushet në një mënyrë që njeriu kurrë nuk e përfytyron. Ai e kupton tani se vështirësitë, privimet, fyerjet dhe poshtërimet që ka përjetuar, sakrificat që ka bërë për të mbetur në rrugën e drejtë, që të gjitha janë ruajtur në mënyrë të mrekullueshme, janë ushqyer dhe në fund janë transformuar për mrekulli nga Zoti i tij për t'i dhënë gëzim dhe kënaqësi. Asgjë nuk ka humbur.

Së treti, Islami i tregon qartë njeriut se ai mund t'i bindet All-llahut dhe të kryejë obligimet e tij si trashëgimtar i Tij. Zoti i tij ka qenë më i mëshirshmi dhe nuk e ka lënë njeriun në errësirë për ta lënë në mëdyshje mbi këto çështje shumë vendimtare. Ai mund të vazhdojë përmes udhëtimit të jetës së tij me besim dhe shpresë. Ai vetëm duhet t'i kthehet Kur'anit, Librit të Udhëzimit nga All-llahu xh.sh. për njeriun dhe Muhamedit a.s., Mesazhit final të All-llahut xh.sh.

Së bashku, Kur'ani dhe Muhamedi a.s. i ofrojnë njeriut një program të detajuar për jetën e tij. Atë që Kur'ani e thotë parimisht apo shkurtimisht e shpjegon Muhamedi a.s. me detaje dhe e vë në praktikë në vetë jetën e tij, duke i ftuar të tjerët ta ndjekin atë. Askush nuk e ka lexuar Kur'anin më mirë se ai, e as nuk do ta arrijë këtë. Askush nuk ka jetuar me udhëzimin e Kur'anit më mirë se ai, e as nuk do ta arrijë

këtë. Ka kaptina në Kur'an që vetëm ai kishte çelësin për t'i hapur. Askush nuk e ka kuptuar vullnetin e All-llahut xh.sh. më mirë se ai.

Kështu, ndjekja e shembujve të Muhamedit a.s. është bindja ndaj vullnetit të All-llahut xh.sh. në mënyrën më të mirë. Zoti i njeriut ishte pafundësisht i mirë në sigurimin e profetit të Tij si një model perfekt për ne për ta pasuar me dashuri dhe mirënjohje, dhe përmes kursit të jetës së tij të përditshme deri në përfundimin e tij, të sigurohemi se ai është rruga e nënshtrimit ndaj Zotit, rruga e dëshiruar nga Ai, dhe vetë suksesi i tij në këtë jetë dhe në jetën e përjetshme.

Programi i jetës që Islami i ofron njeriut është gjithëpërfshirës me ekuilibër dhe harmoni. Ai ka hartuar gjithë udhëtimin e njeriut që nga lindja e deri në vdekje, duke e çuar drejt portës së përjetësisë. Ai merr në konsideratë marrëdhënien e njeriut me Krijuesin e Zotin e tij, marrëdhënien e tij me mësuesin e tij, Profetin e All-llahut xh.sh., me veten e tij dhe me qeniet e tjera njerëzore, dhe me krijesat e tjera të All-llahut xh.sh., të gjalla dhe të pajeta, dhe i tregon mënyrën më praktike e më efikase për të mbikëqyrë këto marrëdhënie. Ai ka hapësirë të mjaftueshme për ushqimin e shpirtit të tij të brendshëm si dhe jetës së tij të jashtme me veprime. Duke ndjekur këtë program, njeriu mund të pastrojë veten nga të gjithë papastërtitë dhe të ngrejë jetën e tij në thelbin ideal. Këto janë mjetet me të cilat mund të ndërtojë jetën e tij të paqes dhe shpresës.

Së katërti, gjithashtu Islami i tregon njeriut për veten e tij. Për të qenë në gjendje të përdorë në mënyrën më të mirë veten dhe të ruhet kundër rreziqeve që e rrethojnë, njeriu duhet të shohë veten tërësisht në një dritë të qartë e të palëkundur. Islami i tregon fuqitë dhe dobësitë e tij. Ai hapet për opinionin e tij për të gjitha anët e fshehta të natyrës së tij. Duke e njohur veten në këtë mënyrë, ai mund të bëhet i vetëdijshëm për mundësitë e rrënjosura në natyrën e tij - për mundësinë e fisnikërimit të tij apo të rrëzimit të tij. Ai i ekspozon kolosët e tmerrshëm që janë brenda tij dhe punojnë vazhdimisht për shkatërrimin e tij. Ai e paralajmëron në mënyrë lajkatuese njeriun për kapacitetin e tij të madh për të mashtruar vetveten - për të vepruar si armiku i vet. Me diturinë dhe kuptimin e tij të kufizuar dhe anësinë

drejt vetes, njeriu kurrë mund të mos e kuptojë veten ashtu siç duhet. Vetëm All-llahu xh.sh. që e ka krijuar dhe e ka dizajnuar njeriun mund ta sigurojë këtë njohuri për njeriun.

Islami nuk i tregon njeriut vetëm atë që është brenda tij, por i tregon në detaje se si të përforcojë fuqitë e tij dhe të ruhet nga këta përbindësh të brendshëm. Programi i jetës që Islami i ofron njeriut është i bazuar në mënyra dhe mjete për të siguruar këto qëllime të dyfishta.

Së pesti, Islami i ekspozon djallin njeriut, si armiku i tij i përbetuar, i cili kërkon të posedojë shpirtin e tij dhe ta shkatërrojë kështu atë. Ai i tregon njeriut se shejtani është i pranishëm kudo, dhe sa dinake e të ndryshme janë mënyrat e tij. Ai punon ditë e natë dhe nuk pushon kurrë. Ai ngre kurthet e tij kudo, duke i bëri të këndshme dhe atraktive të gjitha ato që janë të mallkuara për njeriun. Gënjeshtrat e shejtanit, joshjet, ryshfetet dhe kërcënimet. Ai i di të gjitha artet e bindjes, si dhe të torturës. Ai ka agjentë në mesin e njerëzve. Kundër këtij armiku të fuqishëm, njeriu nuk mund të mbrohet ndryshe vetëm nëse kërkon mbrojtje nga Zoti i Universit, i cili është gjithashtu Krijuesi dhe Zoti i tij. Islami thotë se Zoti i tij tashmë ka armatosur njeriun kundër këtij rreziku. Ai i ka treguar njeriut mënyrën e sigurt për ta njohur shejtanin dhe mënyrat e tij, të luftojë kundër tij dhe të prishë planet e tij.

Së gjashti, Islami i ofron njeriut një kriter të pandryshuar për të dalluar midis të vërtetës dhe gënjeshtrës, të shenjtës dhe profanes, të drejtës dhe të gabuarës. Me këtë kriter në posedim të tij, ai ka një dritë të vërtetë dhe një armë të mprehtë për të prerë xhunglën e kësaj bote dhe të lëvizë para për të arritur shtëpinë e tij finale dhe të fundit, ku Zoti i tij do ta mirëpresë. Ai mund të përballet me të gjitha pasiguritë e jetës dhe të shpëtojë veten nga të qenit i shqyer nga teket dhe furitë e kësaj bote.

Së shtati, Islami ndalon dëshpërimin dhe i ofron njeriut shpresën që është e gatshme dhe e afërt. Sado që të jetë njeriu i dobët, injorant, gabimtar, i kotë, i pabindur dhe i dalldisur, ai nuk duhet të dëshpërohet. Ai kurrë nuk është i braktisur dhe i humbur përgjithmonë. Megjithatë, sado e madhe që të jetë mosbindja ndaj Zotit të tij dhe mëkatet e

tij, ai gjithmonë mund të rikuperojë veten. Ai mund të ketë mëshirën e faljen e All-llahut dhe të shpengojë veten. Kjo është sikur të lindë përsëri pa asnjë njollë apo cen. Zoti i tij ka thënë:

“...Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti. Kthehuni te Zoti juaj dhe nënshtrojuni Atij, para se t’ju vijë dënimi, sepse atëherë nuk do të mund t’ju ndihmojë kush”. *(Zumar: 53-54)*

Qeveritë dhe komunitetet nuk mund të falin çdo shkelje të anëtarëve të tyre për një arsye të thjeshtë se gjithë sistemi njerëzor dhe angazhimet janë me të meta dhe të cenueshme. Vetëm All-llahu xh.sh. mund të falë gjithçka: asgjë nuk e rrezikon apo dëmton Atë.

Së teti, Islami i ofron njeriut ngushëllimin që kërkon. Njeriu e jeton këtë jetë me zemër të plagosur. Pikëllimi, zhgënjimi, humbja dhe padrejtësia e prek çdo ditë. Nganjëherë ato duken aksidentale dhe të pamerituara, dhe prandaj njeriu ndjehet i habitur dhe i dëmtuar. Por, Islami e siguron atë se Zoti i tij është i vetëdijshëm për ndodhjen e gjithë këtyre dhe premton se një ditë do të kompensojë njeriun për të gjitha dhimbjet që ka përjetuar në këtë botë. Të gjitha vuajtjet do të kthehen në gëzim të paimagjinueshëm. Të gjitha plagët në zemrën e njeriut do të shërohen përgjithmonë, duke mos lënë asnjë mbresë; ai nuk do të ketë më ankesa.

Zemra e tij do të mbushet me gëzim të madh dhe kënaqësia kurrë nuk do të humbet më. Vetëm se njeriu duhet të presë me durim me besim dhe të shpresojë për ardhjen e kësaj dite të pasur dhe të gëzuar. Për këtë, Muhamedi a.s. i ka thënë sahabëve të tij se për myslimanin nuk ka humbje: *“E çuditshme është puna e besimtarit. Në fakt, të gjitha punët janë të mira për të. Nëse i ndodh ndonjë e mirë, ai e falënderon All-llahun dhe ajo do të jetë më e mirë për të. Nëse i ndodh ndonjë e keqe, ai tregohet i durueshëm dhe ajo do të jetë më e mirë për të. Dhe kjo i ndodh vetëm besimtarit.”* (Muslimi)

E gjithë kjo është e lehtë për All-llahun xh.sh., Krijuesin e Universit dhe dhënësit të jetës e të mbështetjes së saj. Ai mund të sjellë prapa e të krijojë dhe të rikrijojë çdo gjë dhe të ndryshojë gjendjen e zemrës së njeriut.

Këto janë ofertat që Islami i bën njerëzimit. A ka ndokush që mund të thotë sinqerisht se nuk ka nevojë për to? A mund të gjejë këto oferta diku tjetër? Njeriu nuk guxon t’i marrë të lehta; ai duhet t’i mendojë shumë seriozisht.

Çfarë jete është ajo, nëse njeriu nuk e di kush është, nga vjen, çka bën, pse është këtu, çfarë është kjo botë ku jeton, si duhet të jetojë më së miri, çfarë shprese ka kur humb apo ka mungesë të virtyteve, dhe çfarë ngushëllimi ka në dhimbje? Nuk ka asnjë. Njeriu atëherë duhet të jetë në ankth të pashqiptuar. Njeriu nuk mund të ndërtojë asnjë të vërtetë apo kuptim për jetën e tij, e as nuk mund të krijojë asnjë shpresë apo ngushëllim për veten.

Konstrukti i njeriut nuk duron, ai shkërmoqet para se të përfundojë apo vihet në përdorim. E vërteta që Islami ia zbulon njeriut është e qëndrueshme dhe jetëgjatë, dhe programi i jetës që e skicon për të është brenda kapacitetit të tij për ta ndjekur. Kështu, thirrja e Islamit është thirrje për jetën, jetën e vërtetë dhe ofertat që bën janë oferta për dikë që është në ankth të vërtetë. Për këtë, All-llahu xh.sh., e fton njeriun me këto fjalën: ***”O besimtarë! Binduni All-llahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë...”.*** *(el-Enfal: 24)*

Një pikë të fundit që duhet përmendur. Islami pohon se Kur’ani është shpallja e fundit nga All-llahu xh.sh. për udhëzimin e njeriut dhe se Muhamedi a.s. është i Dërguari i Tij, dhe dy dokumentet bazë mbi të cilat mbështetet Islami, Kur’ani dhe hadithi, janë historikisht autentike. Pohimet mund të verifikohen lehtë. Këto dokumente vazhdojnë të jenë të paprekura, në formën e tyre origjinale dhe në dispozicion për çdokënd. Ato nuk kanë pësuar asnjë ndryshim apo humbje. Çdokush që dëshiron mund t’i ekzaminojë ato dhe të kuptojë të vërtetën.

Përktheu nga anglisht:
Fuad Morina
Marrë nga www.islamcity.com

* A. K. M. Mohiuddin, është profesor në pension i gjuhës angleze, i cili jeton në Bangladesh.

A. K. M. Mohiuddin

WHAT ISLAM OFFERS MANKIND

(Summary)

Islam invites man to truth and success. It offers to guide man out of darkness to light and to show him how best to live. It tells man that a life lived in conformity with truth can alone ensure him true success. It provides man the enduring foundation on which he can build a life of rest and peace, and shows him how to do it.

أ. ك. محي الدين

ماذا يقدم الاسلام للانسانية

(خلاصة البحث)

الاسلام يدعو الانسان الى الحقيقة والنجاح هو يقدم للانسان الخروج من الظلام الى النور و يريه أحسن طريقة للعيش. هو يبرهن للانسان أن العيش مع الحقيقة هو يضمن الطريق الوحيد للنجاح. هو يقدم للانسان الأسس الثابتة التى يمكن ان يبنى عليه حياة هادئة و في سلام و يبرهن له كيف يصل اليه.

RECENSIONE

Nuridin Ahmeti

NJË JETË NË SHËRBIM TË FESË DHE KOMBIT
Resul Rexhepi - Sadik Mehmeti, *"H. Rrystem ef. Shporta-jeta dhe vepra (1864-1937)"*, "Dituria Islame", Prishtinë, 2010, f. 162.

Që nga viti 2003, kur në revistën *"Edukata Islame"*, nr. 70, u botua një vështrim mbi veprën e haxhi Rrystem ef. Shportës, autorët e këtij punimi, R. Rexhepi-S. Mehmeti, me analizën e bërë veprës dhe jetës së haxhi Rrystem ef. Shportës dhe me prezantimin e bërë, u dhanë sinjale lexuesve, por edhe studiuesve, se bëhej fjalë për një njeri që me tërë qenien e tij veproi për të mirën e fesë islame dhe kombit tonë. Edhe pse këto sinjale a shenja qenë të qarta, njerëzve të penës, sikur nuk u bëri "shumë përshtypje" kjo punë, që të hulumtonin më tutje dhe të interesoheshin më tepër që mundi i këtij alimi të kohës të ndriçohej edhe më shumë.

Ky alim, me prejardhje nga rrethina e Prizrenit, i shkolluar në Prizren e Stamboll, me personalitetin, veprat e tij krijuese dhe veprimtarinë e gjerë kombëtare, bën që t'i kalonte kufijtë lokalë dhe të marrë përmasa më të gjera. Personalitete të tilla, e kaluara jonë na mëson se nuk qenë të paktë në shqiptari, sikurse që na mëson se për ta nuk është bërë sa duhet dhe nuk po bëhet aq sa e kanë merituar.

Nga viti 2003 e deri në vitin 2010, kaluan plot 7 vjet, nga kur u botua punimi për Rrystem ef. Shportën e deri në botimin e monografisë së kompletuar për të.

Plot shtatë vjet nga punimi i parë, për autorët e këtij punimi kishin qenë "barrë", - ndonëse për të tjerët ndoshta

ishte harruar ky informacion fare, - dhe autorëve nga dorëshkrimet e Rrystem ef. Shportës që kishin gjetur në Arkivin e Kosovës, u ishte krijuar bindja se puna e bërë me publikimin e shkrimit në vitin 2003, (edhe pse ishte një punë për çdo lëvdatë), krahasuar me mundin dhe veprimtarinë e tij, ishte si një pikë ujë në oqean. Plot shtatë vjet, autorët e këtij punimi emri dhe mbiemri Rrystem ef. Shporta do t'i përcjellë si hije dhe sikur u thoshte: *"Keni ende punë për të bërë"*.

Autorët Rexhepi-Mehmeti asnjëherë nuk u ndalën duke gjurmuar për veprimtarinë e Haxhi Rrystem efendiut, duke kërkuar gjurmë të pasardhësve të tij në Prizren e më gjerë, duke hulumtuar jo vetëm në bibliotekat e vendit, por edhe jashtë, hulumtime këto që autorët i quan deri në Sarajevë, në bibliotekën e famshme të "Gazi Husrev Begut".

Kështu, këmbëngulja e tyre për ta njohur këtë personalitet dhe për t'u ofruar studiuesve sa më shumë materiale për këtë alim, rezultoi me sukses, sepse në bibliotekat e Sarajevës arritën të gjenin materiale, dhe gjithashtu t'u bien në gjurmë edhe disa pasardhësve të Rrystem ef. Shportës, të cilët jetojnë në Prizren.

Si autor i këtyre rreshtave ndoshta flas pak më me këmbëngulje, por mendoj se kam të drejtë, sepse, siç thotë një nga shkrimtarët më të mëdhenj të kohës, latino-amerikani Gabriel Garsia, në një intervistë të tij: "Kurrë nuk i lexoj miqtë e mi, sepse e di çfarë thonë ata, meqë ua njoh pikëpamjet dhe idetë e tyre", për jetën dhe veprën e Rrystem ef. Shportës, autorët Rexhepi - Mehmeti, më kishin folur gjatë, që nga atëherë kur e kishin vetëm si ide, derisa e hartonin dhe e kishin në dorëshkrim këtë monografi e deri në fund kur e botuan më 2010.

Duke lexuar monografinë "H.Rrystem ef. Shporta jeta dhe vepra" del që ky alim ka qenë njëri nga figurat më të njohura në jetën fetare, politike, kulturore të kohës në Prizren dhe më gjerë dhe ka lënë tetë vepra të shkruara në dorëshkrim në gjuhën arabe, ndaj dhe menjëherë shtrohet pyetja logjike dhe e ligjshme: A thua çfarë u bë me këtë njeri që mbeti i harruar për kaq kohë?

Natyrisht të shkruash për një njeri, me përmasa si Rrystem ef. Shporta, dikur është dashur të kesh guxim intelektual dhe kjo ndoshta edhe mund të falet, por që të mos shkruash fare për këtë njeri, i cili tërë jetën e tij e shkriu për të mirën fetare dhe kombëtare, kjo për mendimin tim është e pafalshme.

Jo se në historiografinë tonë nuk do ta gjejmë askund emrin e këtij shërbyesi të fesë e të kombit, por fatkeqësisht, emrin e këtij alimi nuk do ta gjejmë as në disa monografi që janë shkruar për Prizrenin në dy dekadat e fundit.

Libri “H. Rrystem ef. Shporta - jeta dhe vepra (1884-1937)”, ka 162 faqe, katër kapituj dhe është i pajisur me aparaturën e duhur shkencore.

Në *kapitullin e parë* autorët bëjnë jetëshkrimin e Rrystem ef. Shportës, i cili u lind në Prizren, më 26 dhjetor të vitit 1864, pavarësisht se në punim për Rrystem ef. Shportën të botuar më herët na figuron data 1859, kjo assesi nuk e zbeh punën e autorëve, përkundrazi, ofrimi i të dhënave më të sakta për datëlindjen e Rrystem ef. Shportës, është dëshmia më e mirë për këmbëngulësinë e autorëve, për ta zbardhur sa më të argumentuar jetën dhe veprën e këtij alimi që ishte mbuluar nga terri i kohës dhe pluhuri i harresës. Përveç të dhënave të datëlindjes, në këtë kapitull, do të gjejmë të dhëna me interes edhe për prejardhjen e tij që ishte nga fshati Brezne i Opojës që asokohe bënte pjesë në kazanë e Lumës, për arsimimin në mektebin “Sinan Pasha” në Prizren, te myderrizi i njohur (Abdyl) Halim efendiu, myderriz ky i cili jo vetëm që u dëshmua si një njeri i përkushtuar i fesë, por ishte edhe njëri prej aktivistëve të njohur në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, ishte nga anëtarët e Këshillit Qendror të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, përse dhe pas një kohe Rrystem ef. Shporta do të detyrohej t’i ndërpriste studimet, për shkak se mësuesi i tij (Abdyl) Halim efendiu, do të arrestohej nga autoritetet osmane. Këshillat e (Abdyl) Halim efendiut, qofshin ato fetare apo kombëtare, siç do të shohim më vonë në personalitetin e Rr. ef. Shportes, do të lënë gjurmë të thella, ai jo se do t’i harronte këshillat e tij, por e gjithë jeta e këtij personaliteti do të fokusohej në ngritjen e vetëdijes shpirtërore dhe kombëtare të popullit.

Arrestimi i (Abdyl) Halim efendiut, dhe ndërprerja e mësimeve, nga ana e Rr. ef. Shportes, nuk e ligështuan Rr. ef. Shportën, ai me zellin më të madh i vazhdoi mësimet në medresenë e “Mehmet Pashës” në Prizren, te myderrizi Memish efendiu, për t’i vazhduar më vonë specializimet në Stamboll, për t’u rikthyer më pas në Prizren, në medresenë e “Mehmet Pashës” që t’i vazhdojë studimet e mëtejme në shkencat islame, si në Tefsir, hadith etj., me kërkesën e atëhershme të myftiut e myderrizit Hafiz Abdylaziz efendiu(f.22), që pas plot 16 vjet studimi, plot 16 vjet në kërkim të dijes nga Prizreni në Stamboll, duke marrë dije nga shumë hoxhallarë, alimë të kohës, Rr. ef. Shporta, do të pajisej me Ixhazetname/diplomë, nga, Abdylaziz efendiu, më 24 prill të vitit 1896 (f.23), po këtë vit Rr. ef. Shporta, do të udhëtonte për në Haxh, që më vonë me shumë kënaqësi do ta bartë këtë titull dhe kështu do të njihej nga pasardhësit e tij, por edhe nga popullata, që do ta thërrasë me titullin “haxhi”. Autorët vënë në

dukje, se Rr. ef. Shporta, kishte edhe një titull (pseudonim) letrar “*Zihni*”, që do të thotë: i *mprehtë*, *mendjehollë* etj., titull të cilin ia kishin dhënë myderrizët dhe shokët e tij, gjatë studimeve në medresenë e Prizrenit.

Ndonëse paraardhësit e Rr. ef. Shportës, njiheshin si tregtar, si pronar të disa dyqaneve në Prizren, edhe sot e kësaj dite një pjesë e familjes Shporta jeton në këtë lagje, dhe rruga deri vonë është njohur edhe si “ Rruga e shportajve”, pjesë e kësaj veprimtarie familjare ishte edhe Rr. ef. Shporta. Ai jo rrallë kishte marrë rrugën për Stamboll me qëllim tregtimi, meqë kjo familje njihej si familje me një qëndrueshmëri ekonomike stabile në atë kohë, prandaj ai nuk do të kursente që t’iu delte në ndihmë edhe veprimtarëve të kohës të Lëvizjes sonë Kombëtare, e sidomos atyre që vepronin asokohe në Stamboll. Vetë Rr. ef. Shporta, siç e vënë në dukje edhe autorët e kësaj monografie, do të jetë ai që do t’i iniconte këto kontakte, sidomos me Hasan Prishtinën (f. 25), e që më vonë do të shohim se këto lidhje mes Hasan Prishtinës dhe Rr. ef. Shportes çdoherë përforcoheshin e thelloheshin, me ç’rast do të shohim se Rr. ef. Shporta do të jetë njëri nga alimët e kohës, bashkudhëtar në konceptimin e çështjeve në dobi të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, disa herë Hasan Prishtina do jetë mysafir në konakun e shportajve te Rr. ef. Shporta.

Kontakti i Rr. Ef. Shportës me Hasan Prishtinën, për mendimin tim nuk ishte i rastësishëm, sepse;

1. Edhe Hasan Prishtina, njihet si një posedues i shumë dyqaneve tregtare të kohës si në Selanik e Shkup, gjithashtu edhe familja e Rr. ef. Shportës, siç e pamë më lart, njihej si familje tregtare, që posedonin një numër dyqanesh në Prizren, andaj nuk mund të mos mendohet që njëra nga arsyet e kontakteve të tyre do të kishte qenë edhe për marrëdhënie ekonomike.
2. Lëvizja Kombëtare Shqiptare, sidomos në vitet 1910-1912, kishte nevojë për përkrahje materiale, sepse në marrëveshjen e *Taksimit*, më 12 janar 1912, disa nga krerët shqiptarë lidhur me fillimin e kryengritjeve shqiptare, ishin dakorduar që Ismail Qemali, të siguronte mjetet financiare nga Diaspora, kurse Hasan Prishtina të merrej me përgatitjen e popullit për kryengritje, ndihmë e cila nga Ismail Qemali nuk i erdhi Hasan Prishtinës. **(Shih: Tahir Abdyli, *Hasan Prishtina*, GME, Prishtinë, 2003, f.100-106)**. Për këtë arsye, Hasan Prishtinës nuk i mbeti rrugë tjetër veçse t’i shesë magazet në Shkup e Selanik, me qëllim të mbarëvajtjes së kryengritjeve shqiptare: ”*Nuk kisha veç se*

krejt pak të holla e puna qi i pata hy ishte shumë e madhe. M'u lypte me gjetë të holla e me gjetë pa hall! Nuk më pat mbetë veç se nji rrugë: me i shitë magazet qi i kisha në Shkup e me fillue veprimin e kryengritjes me këtë capital. I shita pra magazet e me preteks te zgjedjevet u nisa për Vulcitirn…" **(shih: Hasan Prishitina, *Nji shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqyptare të vjetit 1912*, Rrokullia, Prishtinë, 2009, f. 20)**. Kurse në anën tjetër, Hasan Prishtina, e kishte humbur besimin në bejlerët e Jugut për mbështetje në kryengritje **(shih: Tahir Abdyli, vep. e cit., f.101)** dhe kjo siç duket bëri që ai të ofrohej me bejlerët e Veriut, dhe njëra prej familjeve bejlere të kohës ishte edhe familja e Rr. ef. Shportës, te e cila e pati derën hapur gjithnjë, siç edhe na del nga të dhënat në këtë monografi.

3. Rr. ef. Shporta, si nxënës i (Abdyl) Halim efendiut në mektebin "Sinan pasha" në Prizren, vazhdimisht ishte ushqyer me ndjenja fetare e kombëtare, andaj me sa duket vitet e kryengritjeve shqiptare, kishin qenë momentet e pritura të tij, që këshillat e marra nga alimët e tij në medrese t'i vinte në praktikë. Rr. ef. Shporta, e bëri këtë, nga kjo kohë gjithnjë do ta gjejmë në luftë me dushmanët e Dinit dhe të Vatanit. Ai gjithnjë i përkrahu krerët e Lëvizjes Kombëtare, si materialisht edhe fizikisht, kështu veproi edhe me Hasan Prishtinën.
4. Rr. ef. Shporta, kishte bashkëpunim me kokat më të njohura të penës dhe me njerëzit me më ndikim në jetën politiko-shoqërore, jo vetëm në rajonin e Prizrenit por edhe më gjerë, si Ymer Lutfi Paçarizin, Sheh Hasanin e Prizrenit (Plakun), Hoxhë Mehmetin, Sherif ef. Bujarin, Musa Efendiun, Sali Efendiun, Jahja agë Dodën, Mehmet Emin Efendiun (myfti dhe myderriz në medresenë "Mehmet Pasha", në Prizren), është e natyrshme që afrimi i këtyre dy personaliteteve, të jetë bërë edhe me qëllim që nëpërmjet Rr. ef. Shportës, të afrohej edhe më shumë me personalitetet në fjalë, e që të dhënat e mëvonshme na tregojnë se Hasan Prishitina, do të marrë pjesë në disa beteja së bashku me disa nga emrat e lartpërmendur.

I gatshëm gjithnjë për ta dhënë kontributin e tij, pas gjithë atij rrugëtimi për dije, i erdhi koha që dijen që e kishte marrë ta përcillte te gjeneratat e ardhshme, kështu që nga viti 1917, Rr. ef. Shportën e gjejmë, mësimdhënës në medresenë "Mehmet Pasha", të Prizrenit, në vend të Abdylaziz efendiut (myftiut dhe myderrisit të medresesë "Mehmet Pasha", në Prizren, i cili në këtë kohë kishte ndërruar jetë.

I përkushtuar gjithnjë në punët që ia besonte shoqëria, Rr. ef. Shporta, do të nxjerrë talebet që me punën dhe veprimtarinë e tyre edhe sot e kësaj dite kujtohen si shembull për të mirë, frymëzim për gjenerata vijuese, ndër të cilët po përmendim vetëm këta emra si: Hafiz Abdullah ef. Hizri, hfz. Nysret ef. Galipi, bejtexhiu i njohur Vejsel Xhelaludin Guta, haxhi Rexhep ef. Ismaili, mistiku i njohur nga Rahoveci, Sylejman ef. Kollari etj. Edhe sot e kësaj dite, në odat e regjioneve ku jetuan dhe vepruan këta alima të kohës, përkujtohen me pijetet, si kontribuues të pakursyer, shërbëtor të dijes, fesë dhe kombit.

Se luftërat ballkanike ishin shumë tragjike për popullin shqiptar, këtë e dëshmojnë edhe konsujt, gazetarët, udhëpërshkruesit, studiuesit e huaj, por kohën e fundit me intensitet disi më të shtuar ndriçimin e këtyre ngjarjeve e kanë bërë edhe studiuesit tanë.

Këtyre tragjedive nuk i shpëtuan as popullata e Prizrenit me rrethinë, ku roli i Rr. ef. Shportës, ishte mjaft moralizues për popullatën e asaj ane, sepse u angazhua pakursyeshëm në kryengritjet që u zhvilluan në Lumë gjatë viteve 1912-1913, edhe pse Rr. ef. Shportën e gjejmë mjaft aktiv edhe në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, sidomos duke u dalë në ndihmë popullatës së Plavës dhe Gucisë (f. 31), por edhe në vitet e mëvonshme, duke i ndihmuar në vazhdimësi Lëvizjes Kaçake dhe disa prijësve të kësaj Lëvizjeje që vepronin në rajonin e Prizrenit, si Sali Kabashit etj.

Që nga viti 1880, figurën e Rr. ef. Shportës, do ta hasim pothuajse në vazhdimësi, kundër forcave pushtuese që ishin vendosur në Prizren, forcave serbe e bullgare. Kur në vitin 1920 Prizreni pushtohet nga forcat serbe, Rr. ef. Shportën e gjejmë në pozitën e myftiut në Prizren, si myfti i Prizrenit, ishte kërkuar nga forcat serbe, që ta nënshkruante vendosjen e administratës militare në Prizren, po si gjithnjë i vendosur në parimet fetare dhe kombëtare do të përgjigjej: ”*Unë nuk nënshkruaj një gjë të tillë, sepse lufta s'ka përfunduar ende*" (f. 36), dhe me të vërtetë për Rr. ef. Shportën, lufta me okupatorin serb veç sa kishte filluar, sepse si myfti i Prizrenit i shihte veprimet djallëzore të okupatorëve sidomos në të ashtuquajturin plan urbanistik, prapa të cilit fshihej shkatërrimi i trashëgimisë kulturore historike të Prizrenit dhe një pjesë bukur e mirë e monumenteve. Këtij qëllimi serbët dhe bullgarët ia arritën, p.sh. shkatërruan Konakun e Rrotullajve, disa medrese, shndërrimin e xhuma xhamisë në Kishë, për të cilën Rr. ef. Shporta kishte rezistuar i armatosur për disa ditë, por përballë rrethanave politike - rajonale të cilat po ndodhnin në këto vite, si largimi i P. Osmane nga trojet

tona dhe shkatërrimi i kësaj perandorie më 1924, sigurisht se kishin ndikimin e vet edhe në vendin ku jetoi dhe veproi Rr. ef. Shporta, dhe përballë të gjitha këtyre stuhive të kohës edhe përkundër këmbëngulësisë së tij të vazhdueshme dhe interesimit që gjithnjë ta mbrojë dinin e vatanin, nuk do të dëgjohej larg, okupatorët asnjëherë nuk do ta ndjenin veten rehat në Prizren derisa aty ishte prezent Rr. ef. Shporta.

Ai gjithnjë do të ketë presione nga më të ndryshmet, po asnjëherë nuk ia arritën qëllimit, edhe pse okupatorët prezencën e tij fizike te popullata e Prizrenit do të arrinin ta shmangnin, duke e burgosur dhe duke ia thurur akuzën se gjoja ka përgatitur atentatin, dhe kishte paguar njerëz për vrasjen e inxhinierit beogradas Ivan Vangelov (i cili kishte dashur ta rrënonte xhaminë e “Sinan Pashës”). Në fakt, Rr. ef. Shporta kishte organizuar popullatën e Prizrenit për protestë kundër prishjes së kësaj xhamie dhe falë këtij organizimi të protestës, siç e vënë në dukje edhe vetë autorët e kësaj monografie, xhamia e “Sinan Pashës”, është edhe sot e kësaj dite, edhe pse disa pjesë të kësaj xhamie ishin rrënuar, si p.sh. hajati.

Përkitazi më këtë akuzë Rr. ef. Shporta, do të dënohet me 20 vjet burgim, të cilin e vuajti në Prizren, Shkup, Nish e Zenicë të Bosnjës, do t’i konfiskohej e tërë pasuria edhe shtëpia ku banonin tre djemtë e tij me familjet e tyre. Ishte burgosur më 25 korrik 1925, për t’u kthyer në familjen e tij në Prizren më 1 prill të vitit 1935.

Në burgun e Zenicës, Rr. ef. Shporta, ishte caktuar që të mbante mësim -besim për të burgosurit myslimanë, përkushtimi i tij në burg, sjellja dhe urtësia e tij, bëri që ai të fitonte simpati dhe zëri i tij prej alimi të dëgjohej edhe në mesin e ulemave boshnjakë të kohës.

Nuk duam të thellohemi në respektin që do t’i bëjnë boshnjakët jo vetëm në burg, por edhe me daljen e tij nga burgu, duke i bërë mikpritje bujare, dhe nuk duam që ta përshkruajmë udhëtimin e Rr. ef. Shportës, pasardhësit e tij, mikpritjen në Prizren, sepse këto me fakte e argumente dhe në hollësi i kanë përshkruar autorët e kësaj monografie, duke na afruar të dhëna të bollshme deri me kalimin e tij nga kjo botë, më 5 tetor 1937.

Më mjaft interes kujtoj janë të dhënat që na ofrojnë autorët në nëntitullin **“Boshnjakët për haxhi Rrystem ef. Shportën”**, sepse nga ditët e burgut kur ishin njoftuar më Omer ef. Shestiçin asokohe imam në xhaminë e “Sejmenit“, do të kenë miqësi të sinqertë, duke iu gjendur pranë në ditët më të vështira Rr. ef. Shportës, ndonëse vizitat dhe hyrje-daljet, e Rr. ef. Shportës, ishin mjaft të kontrolluara nga

autoritetet e burgut, këto autoritete asnjëherë nuk mundën ta ndalin frymën e personalitetit të tij që të dalë edhe jashtë portave të burgut, frymë të cilën e shpërndanë shokët e tij, miqtë e tij të burgut. Kjo bëri që zëri i Rr. ef. Shportës, prej alimi të dëgjohej edhe jashtë portave të burgut.

Se dija e këtij alimi kishte mahnitur edhe ulematë boshnjakë, tregon edhe fakti se kur u largua nga kjo botë Rr. ef. Shporta, shtypi islam i kohës, revista “ El-Hidaje” dhe alimi i njohur boshnjak Mehmet Hanaxhiç, në mes tjerash do të shkruante: ”*Më pesë tetor të këtij viti(1937), ka vdekur në Prizren ish- myftiu dhe plaku i respektuar H. Hfz. Rystem Zihni ef. Ramandani..., Rahmetliu ka qenë plak rreth të tetëdhjetave, erudit, i devotshëm dhe shumë i dashur në mesin e myslimanëve..., Vdekja e tij, është një humbje e madhe, por askush në këtë botë nuk ka mbetur i përhershëm, prandaj as Myftiu ynë. Dashtë Zoti që përsëri në mesin e myslimanëve të gjenden njerëz, të cilët, të paktën deri diku, të zëvendësojnë Rrystem efendiun!*” (f. 57-58).

Boshnjakët, siç kanë vënë në dukje edhe autorët në këtë monografi, nuk do të ndalen vetëm me këtë nekrolog, por pikërisht njëri nga pasardhësit e autorit të shkrimit të parë Xhemaludin Shestiçi për Rrystem efendiun, pas 60 vjetëve në “Takvim” të Sarajevës në vitin 2004 do të shkruajë shkrimin tjetër, ”*Një tregim për fatin e një të burgosuri të pafajshëm”*, duke mos i lënë ato kujtime që i kishte mbledhur paraardhësi i tij, për figurën e Rr. ef. Shportës, t’i kaplonte pluhuri i harresës.

Këto të dhëna janë dëshmia më e mirë se sa e çmuan boshnjakët figurën e Rr. ef. Shportës, dhe në anën tjetër këmbëngulësia e autorëve për t’iu rënë në gjurmë këtyre të dhënave tregojnë se deri ku kanë arritur me hulumtimet e tyre dhe sa të vendosur kanë qenë për zbardhjen e kësaj figure.

Në kapitullin e dytë me titull: “*Vepra e Haxhi Rrystem Zihni ef. Shportës*”, autorët prezantojnë në mënyrën më të mirë të mundshme opusin krijues të Rr. ef. Shportës, për aq sa kanë arritur ta sigurojnë.

Shikuar në aspektin kronologjik se si ka ardhur deri te përpilimi i kësaj monografie, mund të thuhet se kanë qenë pikërisht veprat në dorëshkrim të Rr. ef. Shportës, që u gjetën nga autorët në Arkivin e Kosovës, si nxitje për të vazhduar punën më tutje.

Autorët duke hulumtuar jo vetëm në Arkivin e Kosovës, por duke iu rënë në gjurmë edhe pasardhësve të Rr. ef. Shportës, arritën të siguronin jo vetëm informacione të bollshme për biografinë e tij, por edhe disa vepra autoriale të Rr. ef. Shportës, e të cilat informacione dhe materiale padyshim

se e kanë begatuar dhe më shumë këtë monografi.

Kontakti i autorëve edhe me disa vepra të Rr. ef. Shportës, e të cilat në fund ishin të pajisura edhe me disa të dhëna autobiografike nga vetë shkruesi i këtyre veprave - Rr. ef. Shporta, bënë që autorët të japin edhe saktësime, në disa çështje siç është data e lindjes e Rr. ef. Shportës, etj.

Sikurse u tha, Rr. ef. Shporta ishte njohës i mirë i gjuhës perse, turke dhe arabe, njohja e të cilave mahniti edhe alimët boshnjakë të kohës, të cilët nuk hezituan ta quanin ”erudit”, “e fliste jashtëzakonisht mirë gjuhën arabe” (f. 56-57), etj.

Është logjike që për një njeri me këso dije të fesë dhe gjuhës, të mos rrinë duarkryq autorët e kësaj monografie duke hulumtuar rreth veprave të tij dhe duke analizuar në mënyrë të hollësishme, të na informojnë se Rr. ef. Shporta ka shkruar 8 vepra në gjuhën arabe, nga ajo gjuhë të cilën alimët boshnjakë ishin shprehur se “e fliste jashtëzakonisht mirë”, pesë prej këtyre veprave janë shqyrtuar, analizuar nga autorët e kësaj monografie, kurse për tri tjera, autorët e monografisë japin pak të dhëna (f. 69). Veprat e tij Rr. ef. Shporta i quaj1ti “Risala”, e cila shpreh trajtesën, kumtesën etj., (f.69).

Shikuar nga ana përmbajtësore, veprat e H. Rr. ef. Shportës në përgjithësi janë studime nga fusha e islamistikës, si etikë islame (ahlak), studime kuranore rreth Emrave të Allahut (akaid) etj., ku autorët duke u bërë analiza të hollësishme, si ne aspektin përmbajtësor, stilin e shkrimit, matjet e duhura profesionale të dorëshkrimeve, prezantimin e këtyre veprave edhe me faksimile dhe përshkrimin edhe në gjuhën origjinale arabe, sidomos aty ku autori i veprave jep hollësi rreth asaj se kur janë shkruar këto vepra, janë tregues për seriozitetin autorëve të kësaj monografie dhe mundin e dhënë deri në finalizimin e kësaj monografie.

Me interes për lexuesin në këtë kapitull është edhe prezantimi i disa dokumenteve osmane, si fetva, akte kurorëzimi etj., të cilat ishin shkruar nga dora e vet Rr. ef. Shportës që mbajnë edhe vulën e tij, këto dokumente me sa kuptohet janë shkruar në kohën kur Rr. ef. Shporta ishte myfti i Prizrenit (f. 95- 96).

Në kapitullin e tretë me titull: *“Biblioteka e haxhi Rrystem ef Shportës”* autorët ofrojnë të dhëna rreth bibliotekës së Rr. ef. Shportës, fatit të kësaj biblioteke, analiza të dorëshkrimeve që gjenden në këtë bibliotekë etj.

Mund të thuhet se Biblioteka e haxhi Rrystem ef Shportës e pati të njëjtin fat sikurse edhe populli Kosovës, apo thënë ndryshe fati i bibliotekës së RR. ef. Shportës ishte i lidhur edhe

me fatin e jetës së tij, ajo është e shpërndarë në disa vende dhe është shumë vështirë t’i bihet në gjurmë.

Duke i ditur vlerat e këtij alimi, boshnjakët, konkretisht Instituti i Orientalisitkës në Sarajevë, ka qenë i interesuar që bibliotekën Rr. ef. Shportës ta ketë në fondin e bibliotekës së këtij Instituti, për të cilën nuk ishte arritur marrëveshje me familjen e Rr. ef. Shportës, kështu që librat ishin kthyer te pasardhësit e Rr. ef. Shportës. Por sipas një raporti-regjistri nga ish-Enti për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Përmendoreve Kulturore dhe Bukurive Natyrore, të cilit raport-regjistër i referohen edhe autorët e kësaj monografie na rezulton se në Bibliotekën familjare të Rr. ef. Shportës, ruhen 18 vepra në dorëshkrim, të cilat autorët e kësaj monografie na i ofrojnë në këtë monografi.

Por sipas hulumtimeve të autorëve të kësaj monografie në bibliotekën e Rr. ef. Shportës, nga e cila një pjesë ruhet te pasardhësi i tij Mas’har Shporta, kemi 23 dorëshkrime dhe 31 vepra, që u përkasin fushave të ndryshme (f.100).

Dorëshkrimeve të kësaj biblioteke autorët e kësaj monografie, iu bëjnë një analizë gjithëpërfshirëse, duke na ofruar edhe të dhëna me interes, që sigurisht do të jenë një ndihmesë e madhe për ata studiues që dëshirojnë t’i thellojnë njohuritë nga kjo lëmi, qoftë për vendndodhjen e tyre, qoftë për anën përmbajtësore. Gjithashtu autorët na ofrojnë të dhëna edhe për veprat e botuara nga biblioteka e Rr. ef. Shportës, që na rezulton të jenë 31 vepra nga fusha dhe autorë të ndryshëm, duke na ofruar të dhëna si: autorësinë, gjuhën e botimit, vendin dhe vitin.

Përfundim

Nga leximi dhe rileximi i veprës mund të përfundojmë së është bërë një punë, të cilën ia vlen ta marrësh si model.

Personalitetit të Rr. ef. Shportës, të kapluar nga terri i kohës, më në fund iu dha drita nga rrethanat e reja të kohës.

Është për t’u habitur se për një njeri me një veprimtari kaq të bujshme kombëtare dhe me një opus kaq të gjerë krijues të mos dihet asgjë deri tani, të mos përmendet as emri i tij në ndonjërën nga monografitë e shkruara për Prizrenin, e të mos flasim për Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, ku emri i këtij patrioti e alimi të kohës pa mëdyshje duhet ta ketë pasur vendin, të mos figurojë askund. Gjithashtu mendojmë se nuk është vonë edhe sot, duke pasur informacione të bollshme për personalitetin e tij, ndonjë rrugë e Prizrenit të marrë emrin e tij. Kjo njohje dhe ky propozim na erdhi pikërisht nga autorët e kësaj monografie, që me punën e

tyre na bënë me dije, që në Prizren ka jetuar një njeri që me të bëmat e tij, me pushkë e me penë ishte ndër njerëzit më meritorë të asaj ane.

Vepra e ofruar është dëshmia më e mirë dhe e argumentuar se kush ka qenë ky personalitet, po njëkohësisht është obligim i yni që ta bëjmë atë që autorët na porosisin në përfundimin e kësaj monografie, lidhur me opusin krijues të veprës së Rr. ef. Shportës: “Këto vepra duhet të shpallen e të trajtohen si monument i shkruar i kulturës kombëtare” b (f. 151).

Po qe se do të shpreheshim në rastin Rr. ef. Shportës me shprehjen kenediane “Mos pyet se ç’do të bëjë atdheu për ty, por pyet ç‘mund të bësh t’i për të”, pa dyshim se jeta e Rr. ef. Shportës është yrneku më i mirë se çfarë duhet të bëjë një njeri për të mirën e atdheut dhe të fesë së tij. Ai një jetë të tërë e dëshmoi se për atdheun dhe të mirën e ymetit ishte në gjendje të flijohej në çdo kohë derisa u nda nga kjo jetë.

Kjo monografi krahasuar me veprimtarinë e tij, mund të themi se është një shenjë mirënjohjeje për kontributin e tij, po assesi nuk mund të themi se e kemi larë borxhin ndaj këtij personaliteti.

E pakta që ne mund të bëjmë për ketë personalitet, përveç kësaj që është bërë deri më sot, është se kemi ende mundësi, që të mbledhim kujtime nga të moshuarit e Prizrenit për figurën e Rr. ef. Shportës, e që në rastin e ribotimit të kësaj monografie, por pse jo në të ardhmen të bëhet edhe një libër i veçantë me titull: “Figura e haxhi Rrystem ef. Shporëts në kujtesën popullore”.

Edhe pse për një kohë të gjatë nuk u shkrua për figurën e Rr. ef. Shportës, megjithatë kjo monografi e ka përforcuar thënien proverbiale angleze se: ”E vërteta vonon por kurrë nuk humbet”.

RECENSIONE

Prof. dr. Ali Pajaziti

HOMO ALBANICUSI, ALBKULTURA DHE ORIENTI NËN THJERRËZËN E SOC-ANTROPOLOGJISË[1]
Recension: Enis Sulstarova, *Në pasqyrën e Oksidentit: Studime dhe artikuj*, Logos-A, Shkup, 2010.

Orientalizmi është, dhe jo thjesht përfaqëson, një përmasë të madhe të kulturës moderne politike-intelektuale, ndërkohë që si i tillë më pak ka të bëjë me Orientin, sesa ka të bëjë me botën "tonë". Edward Said[2]

"What we want to achieve through this commission is a just memory not one-sided memory"[3] Ahmet Davutogllu

Ex Oriente Lux! "Drita vjen nga Lindja". Një thënie që interpretohet duke u nisur nga fakti se dielli del nga lindja e deri te hermeneutika mistike, e cila rëndë se shprehet me fjalë, meqë në rend të parë i vë "sytë e zemrës", misteriozen, sublimen. Një nga komentet që ndërlidhen me këtë sintagmë është edhe ai se Lindja ka dhënë fetë abrahamike (hebraizmi, krishterimi, islami), qytetërime dhe kultura të mëdha (babilonas, sumer, hitit, egjiptian, hindu, budist) etj. Kjo "Lindje" në kulturën shqiptare ka zënë vendin e vet me peshë, por ka një kohë, kur "pas eskatologjisë marksiste-leniniste pason një eskatologji orientaliste" (Sulstarova, 2010: 49), kur ligjërata dominuese është ajo që përjashton, atakon Lindjen dhe lindoren, gjithnjë duke u nisur nga motoja *West is the best!*, kur kemi lëkundje nga westcentrizmi letrar-scientist-publicist (Kadare, A. Xhaferi) deri te ai patologjik (Myftaraj, Velo). Në këtë periudhë paskomuniste, ringjallet njëfarë historicizmi, në kuadër të të cilit intelektualët shqiptarë e riinterpretojnë historinë shqiptare rrotull një njësie të quajtur "Evropë" apo "Perëndim", që është nyja që përcakton pozitën e shenjuesve të tjerë në ligjërim (Sulstarova, 2010: 398).

Sot, ndër shqiptarë Oksidenti dhe oksidentalizimi, çështja e arratisjes përfundimtare nga Lindja dhe ngjitjes në varganin e botës së parë, në atë që quhet Perëndim janë tema të rrahura me një dozë të subjektivizmit dhe njëanësisë, pra shoqërohen me një eufori të pop-kulturës masive, ku të gjithë vrapojnë që të tregohen sa më westernistë, sa më pro euroatlantikë, duke tentuar që të mbyllin sytë para identitetit shumëpërmasor, që nuk është produkt i hëpërhëshëm dhe as i njëanshëm. Për proksidentalët tanë - që pohojnë se identiteti shqiptar është ndërtuar mbi kundërshtitë dypalëshe Evropa-Azia, civilizimi-barbarizmi, socializmi-reaksionizmi, Perëndimi-Lindja, krishterimi-islami - Orienti është një kategori më pak gjeografike dhe më tepër politiko-ideologjike, një term që përshkruan një pjesë të botës që mendohet të jetë periferike, e prapambetur dhe për të mos e nxirë krejtësisht, edhe ekzotike. Kjo vijë megjithatë kjo pjesë e botës bashkë me kulturat dhe qytetërimet e krijuara ka ndikuar fort edhe në ngjizjen e botëkuptimeve dhe historive të Ballkanit në përgjithësi dhe të shqiptarëve në veçanti. Mund të thuhet se *homo balkanicusi* ka mbetur diku mes Lindjes dhe Perëndimit.

Enis Sulstarova, një studiues i ndikuar nga qasja saidiane[4] në mënyrë analitike dhe kritike, shtron një problematikë me të cilën shqiptarët përballen ndër shekuj, atë të të qenët ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, çështjen e dilemës shumëshekullore, shpesh të banalizuar skajshmërisht sikur këto dy botë të ishin të ndara preras mes vete. Ai i qaset identitetit shqiptar si një identitet shumështresor i mbetur mes ksenofilisë dhe vetëpëlqimit. Filozofia dhe antropologjia kulturore dhe politike që ndjek këtë libër është përpjekje për të lëvizur gurin nga perceptimi mitik të vetes dhe filetizmit ndaj të tjerëve, në një rilexim objektiv të vetes dhe tjetërsisë. Vepra në fjalë zbërthen vetëperceptimin e shqiptarëve, që sillet nga epërsia racore (miti i pellazgëve), të formësuar nga Rilindja Kombëtare Shqiptare, sipas të cilit pellazgët janë nukleusi i qytetërimit evropian, mitin i vetëflijimit për mbrojtjen e qytetërimit evropian nga pushtimi osman e deri te dilemat identitare dhe tendencat për të krijuar tjetrin brenda vetes (kultura muslimane dhe islami, xhamia, mbulesa).

Vepra e Sulstarovës, paraqet një guidë për të rikontekstualizuar veten dhe të tjerët, për të shqyrtuar historinë e afërt dhe të largët duke e nxjerrë atë nga izmat dhe konstruktet ideologjike që e shtrëngojnë të vërtetën dhe i absolutizojnë disa vlera dhe pjesë të historisë sonë dhe nga ana tjetër përbaltëzojnë

figura, epoka të tëra të historisë sonë kombëtare. Ligjërimi i autorit është ligjërim nacionalist, por me sedër shkencore, pa subjektivizmat oportuniste të atavizmave të ndryshëm që nga shkenca krijojnë një masë amorfe.

Sulstarova duke bërë një sociologji dhe filozofi politike kombëtare trajton koncepte si ndërgjegjja kombëtare, ideali i shqiptarisë, përfytyrimet fetare, afritë fetare, sistemet kulturore, besimet fetare, laicizmi, armiku publik (lindja), mënyra e jetesës, shteti islam, ymeti, programi kombëtar, mitizimi i atdheut, bosnizimi, trysnitë kulturore, helenizmi, greqizmi, osmanizmi, turkizmi, neoshqiptarizmi etj. Ai e trajton nga një perspektivë origjinale inxhinierinë politike dhe kulturore të shqiptarisë (Gellner, 2008: 72), duke u munduar t'i identifikojë çalimet konceptuale, që sjellin çalime aksionale.

Libri i Sulstarovës është i ndarë në tre kapituj, “Kombi dhe nacionalizmi shqiptar”, “Ideja e Evropës dhe orientalizmi” dhe “Kultura dhe politika në Shqipërinë komuniste”. Në të parin jepet një pasqyrë e ideve nacionaliste që nga Rilindja (Veqilharxhi, Naimi, Fishta) e deri te kultura postmoderne e OJQ-ve (Vetëvendosje, Albin Kurti) dhe ideja e bashkimit kombëtar ndërmjet vegimit dhe realitetit, duke u shprehur *pro* projektit gjithëshqiptar. Në këtë kontekst shqyrtohet treshi shteti osman, sistemi i miletit dhe nacionalizmi ortodoks grek në raport me shqiptarinë, rëndësia e gjuhës në zgjimin dhe ndriçimin e kombit, besa, barazia politike dhe juridike e shqiptarëve pa marrë parasysh përkatësinë fetare. Ai e thekson edhe rëndësinë e kapacitetit kombëtar për ta bërë dallimin midis miqve dhe armiqve: “atëherë kur ai (kombi, A.P.) nuk e ka më kapacitetin ose vullnetin ta bëjë këtë dallim, ai pushon së ekzistuari politikisht” (Schmitt, 1996: 49). Sulstarova përmes Ukshin Hotit flet për amullinë përcaktimore në të cilën kanë qenë dhe janë sot shqiptarët, flet për absurdin e kosovarizimit si tendencë e panatyrshme kombndërtimi që shkon kundër ideve të bashkimit. Ai flet edhe për paradoksin e kohës: nga një ekstrem në tjetrin (të gjithë i kemi armiq: bile edhe Kinën - të gjithë i kemi miq: bile edhe Serbinë). Nevoja për edukimin e brezit të ri, që të kapërcejë shfaqjet e sotme të inferioritetit kombëtar dhe të ksenofilisë është një segment tjetër i mozaikut të filozofisë sulstaroviane. Kreu i parë ngërthen edhe përpunimin e tezës së Nathalie Clayer për fillet e nacionalizmës shqiptare, për ekuilibrat etniko-fetare, “islamin shqiptar” si tolerant dhe evropian... Paralelja mes Zija Gëkalpit dhe Branko Merxhanit mbi kombin dhe modernizimin është një tjetër faqe e veprës, ku diskutohet evropianizimi, etosi modernizues, turkizmi dhe neoshqiptarizmi, frymëzimi idealist, nacionalizmi si sistem kulturor-normativ,

kombi kulturor etj. Mitizimi e çmitizimi i figurave dhe ngjarjeve historike si procese të vazhdueshëm dhe të bashkëshoqërueshëm në kohën moderne, debatet për mitin e Skënderbeut që po përdoret si një udhëheqës për procesin e integrimit në NATO dhe BE dhe që sipas disave ka përfunduar misionin e vet (F. Lubonja). Sulstarova kritikon elitën intelektuale shqiptare që për të fituar pikë politike kundërshton bashkimin kombëtar:

“... politikanët tanë bëjnë gara se cili do të bërtasë më shumë se të tjerët që nuk e duam “Shqipërinë e Madhe”. Ndërkohë nuk shprehen kundër bashkimit të Gjermanive, njohin vetëm një Kinë dhe një Qipro dhe patjetër që nuk do ta kundërshtojnë bashkimin e Koreve, kur ky të ndodhë”.

Në kapitullin e dytë temë boshte është orientalizmi, i cili i ndërlidhur me kolonializmin, paraqitet si një disiplinë që i ka shërbyer hegjemonisë intelektuale perëndimore, që ka veshur me një mbulesë “shkencore” paragjykimet perëndimore mbi Orientin dhe orientalët. Veprat e Katerina Fleming, Maria Todorovës dhe Norman Cigarit janë ekzemplarë të vështrimit orientalist të botuar shqip. Ndërkohë ballkanizmi paraqitet si stigmë orientaliste në mikroplan për një rajon si Ballkani. Sulstarova analizon edhe ligjëratën e orientalizmit shqiptar të brendshëm. Xheladin Beu, si simbol i erosit oriental si i kundërt nga ai “perëndimor” dhe Ali Pasha, perversi dhe despoti oriental janë dy figura të fantazive, trillimeve dhe paragjykimeve për Orientin. Narracioni orientalist sipas Sulstarovës përveç fushës së akademizmit (Kadare, Plasari) del edhe në atë të gazetarisë: Gazetari Blendi Fevziu në një libër të botuar më 2004 përfshin edhe një ese të titulluar “Haxhi Qamili, Mulla Omari dhe Perëndimi”, ku parashihet një simetri mes një figure historike shqiptare (mit i kundërevropianistit) dhe një “strumbullari” të fundamentalizmit fetar. Të dy janë prolindorë. Gazetari tjetër Baxhaku jeton me superioritetin shqiptar: Shqiptarët e kanë sunduar njëherë Orientin bashkë me turqit dhe tash bashkë me amerikanët. Ai shenjon mitin e bashkësundimtarëve shqiptarë në perandorinë e re amerikane.

Duke kaluar nga vepra paraprake (*Arratisje nga Lindja*, 2006) autori s'e lë pa përmendur qasjen e Kadaresë, i cili shfaqet si “profet i integrimit” dhe zëdhënës i historisë filoevropiane (të shqiptarëve). Në pjesët e tjera trajtohen pasqyrimet e orientalizmit në erosin kadareian, sipas këtyre tematikave: erosi si mjet i arritjes së Perëndimit, gratë shqiptare përballë despotizmit oriental, homoseksualiteti i personazheve negativë orientalë dhe në fund vendi i pedofilisë homoseksuale në shtjellimet e Kadaresë mbi identitetin evropian të shqiptarëve. Në këtë drejtim këndvështrim mbizotërues është ai se Lindja është “një

fatkeqësi, një mynxyrë, kurse Evropa është kontinenti ynë mëmë" (Kadare, 2004). Sulstarova nuk lë pa prekur as tema si kthimi i fesë dhe shoqëria paslaike, rrëfenja lienare, Evropa ekskluzive, vetëvrasja e Evropës, emigrantët, islami shqiptar, islami si pjesë *les banlieues*-ve të varfra të metropoleve evropiane, por edhe si pjesë e gjallë e kulturës së një komuniteti që bashkëjeton me krishterimin (f. 430).

Dhe kapitulli i fundit është një retrospektivë e pushtetit politik të kondensuar me sferën e ligjit dhe të diturisë që gjeneronte mendje të robëruara (Ç. Millosh) dhe që kishte paraparë edhe një kurs stratifikues dhe një rend urbanistik partitocentrist ("blloku") (f. 455), është një trajtesë e iluzionizmit dhe *science fictionism*-it komunist shqiptar, që parashihte një ardhmëri superinteresante, vetëpëlqyese, utopiste të shoqërisë shqiptare të së ardhmes ose siç do ta quante Giddens, "kolonizim të së ardhmes" (f. 466). Aty autori përmes terminologjisë së Sertosë (ekonomia e shkrimit), të Fukosë (burgu si metaforë sociologjike) i qaset ndërgjegjes klasore propagandës dhe "krijimit të njeriut të ri", marksizëm-leninizmit, për të cilën udhëheqësi ishte shprehur se ishte "shkenca e shkencave, revolucionit të vazhdueshëm" dhe "rrethimit imperialist-revizionist", ruajtjes së komponentëve socialë të vjetër (emërtimet Xhamllikeu, Shallvaret, Zogu i Zi, Medreseja), astronautëve shqiptarë, trurit elektronik, vitit 2044 (festimi i njëqindvjetorit të çlirimit dhe vendosjes së regjimit socialist në Shqipëri), "cilatipakëve", (anagramë e fjalës "kapital"), teleologjisë socialiste etj. Autori nuk e lë pa trajtuar edhe periudhën kritike të agonisë dhe rrënimit të regjimit, rolin e Gorbaçovit shqiptar (R. Alia) në periudhën e transformimit radikal etj. (f. 519)

SulStarova shkrimet e veta i begaton me diskursin intelektual të autorëve të famshëm si Castells, Barthes, Gellner, Anderson, Gramsci, Fuko, Habermas, Vattimo, Smith, Popper, Hobsbawm etj., që trajtesës i japin një ngjyrim dhe peshë më të madhe.

Nga e tëra që del si porosi nga vepra në fjalë me rëndësi të madhe është sentenca se "duhet të lindë një elitë morale", që do të bënte balancimin perceptimor dhe mendor si të botës akademike ashtu edhe të grigjës dhe do të ngjallte *elanin vital* (Bergson) të kombit. S'duhet harruar nevojën për *just memory*: historia të mos shikohet vetëm nga një kënd i vështrimit![5] Kanti mes tjerash thekson nevojën për të përjashtuar paragjykimet, shmangiet dhe mashtrimet, me qëllim që të krijohet hapësira e njohjes së të vërtetës si e vërtetë.[6]

Siç shprehet vetë autori në parafjalën e këtij libri studimet në fjalë janë "udhëtime teorike që tani për tani janë ndalur në stacione, por që mund të rinisin sërish në të ardhmen". Të shpresojmë se

si vetë ai ashtu edhe të tjerët do të nisen nga këto stacione për destinacione të reja nga të cilat do të sjellin dimensione studimore të reja për opinionin shkencor shqiptar dhe më gjerë.

Autorit, vepra e të cilit do t'u shërbejë si pedagogëve universitarë ashtu edhe studentëve të sociologjisë, antropologjisë, filozofisë dhe shumë disiplinave të tjera, do t'i kishim sugjeruar që të merrte parasysh edhe orientalizmin e trojeve të tjera shqiptare (Kosovë, Maqedoni e gjetkë), e në veçanti atë xhaferian, gjegjësisht pikëpamjen e ish-politikanit dhe publicistit Arbër Xhaferi për Lindjen dhe shqiptarët, shtetin osman, kulturën osmane, (neo)osmanizmin etj., me ç'gjë mozaiku i trajtimit të temës do të ishte më i plotë. Shpresojmë se ky diskurs mund të jetë gur themeltar i një vështrimi më serioz ndaj Orientit, i cili në kulturën shqiptare është trajtuar vetëm në rrafshin letrar, pa ndonjë përthellim studimor shkencor të disiplinave humane-sociale.

Bibliografia:

AKCAM, Taner, "What Davutoglu Fails to Understand", The Armenian Weekly, 19 maj 2010.

DEBELJAK, Aleš, Suvremeni fundamentalizam i sveti rat, Naklada Jesenski Turk, Zagreb, 2003.

PAJAZITI, Fjalor i sociologjisë, Logos-A & UEJL, Shkup, 2009.

SAID, Edward, Orientalizmi, përkth. Xhevat Lloshi, Logos-A, Shkup, 2009.

SULSTAROVA, Enis, Arratisje nga Lindja: Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja, Botimet Dudaj, Tiranë, 2006.

http://www.wisdomworld.org/additional/ancientlandmarks/ExOrienteLux.html, 2010/11/12/

http://blog.shekulli.com.al/2008/11/18

1 Kumtesë e elaboruar në Panairin e Librit "Tirana 2010" (13 nëntor).

2 Edward Said, *Orientalizmi*, përkth. Xhevat Lloshi, Logos-A, Shkup, 2009.

3 "Ajo që duam të arrijmë përmes këtij komisioni është një kujtesë e drejtë e jo e njëanshme!" (Fjalë të shprehura lidhur me çështjen turko-armene.)

4 Gjatë një kongresi shkencor në Shkup një profesor universitar nga Tirana me të përmendur emrin e autorit menjëherë asocoi në saidianizmin e Sulstarovës, duke tërhequr një paralele mes libanezit të famshëm dhe një studiuesi me perspektivë që mundohet të bëjë rilexim dhe riinterpretim të historisë dhe të *homo albanicus*-it, të bëjë çmitizimin, që sipas tij "i ngjan shprehjes së Niçes "të filozofosh me çekiç", d.m.th. me çekiçin të trokasësh në trupin e idhujve për të treguar se brenda janë të zbrazët" (f. 181).

5 Taner Akcam, "What Davutoglu Fails to Understand", *The Armenian Weekly*, 19 maj 2010.

6 Aleš Debeljak, *Suvremeni fundamentalizam i sveti rat*, Naklada Jesenski Turk, Zagreb, 2003 f. 9.

RECENSIONE

Teuta Shala *(asistente në Institutin e Historisë, Prishtinë)*

NJË VEPËR MONUMENTALE MBI SHEKUJT OSMANË NË HAPËSIRËN SHQIPTARE (Ferit Duka "Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare", Tiranë 2009, f.465.)

Pas një pune studimore të gjatë e të mirëfilltë shkencore, në fushën e studimeve të periudhës osmane, studiuesi Ferit Duka kohë më parë botoi librin: "Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare".

Botimi i këtij libri vjen si rezultat i një hulumtimi disavjeçar në arkivat e Stambollit dhe të Ankarasë, të cilat siç pohon edhe vete autori, në parathënie të librit janë një thesar i jashtëzakonshëm dokumentesh, duke mos lënë anash as Arkivin Qendror Shtetëror të Tiranës, i cili gjithashtu ruan fonde të rëndësishme, sidomos vlerë të veçantë në këtë rast sipas studiuesit Duka, paraqet korpusi dokumentar, i prodhuar nga gjykatat osmane, të cilat për she-

kuj të tërë funksionuan në qytetet kryesore shqiptare.

Libri në fjalë, në fokus të studimit, ka periudhën pesëshekullore të sundimit osman në Shqipëri. Sipas profesorit Duka, dy janë arsyet që i tërheqin studiuesit për t'u marrë me studimin e kësaj periudhe. Së pari, brenda këtyre shekujve janë zhvilluar procese të rëndësishme, të cilat kanë përcaktuar tiparet e mëvonshme të shoqërisë shqiptare, së dyti, pohon ai, njohja e kësaj periudhe lejon që të saktësohet edhe imazhi që ne kemi për të kaluarën mesjetare paraosmane të shqiptarëve.

Libri "Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare", i botuar nga shtëpia botuese UET-Press, trajton në vete probleme të natyrave të ndryshme që lidhen me sundimin osman në Shqipëri. Temat e trajtuara në kuadër të këtij libri ngërthejnë në vete çështje si të natyrës politike, ekonomike, fetare, demografike, social-ekonomike, urbanistike, infrastrukturore etj.

Pjesë të veçanta të këtij libri janë edhe publikimi i faksimileve të shumta të defterëve osmanë të sanxhakut të Delvinës, si dhe të defterit osman të sanxhakut të Vlorës. Duke iu referuar librit në fjalë, të dhënat që hasim në të sa i përket periudhës kohore mund t'i grupojmë në dy grupe, në të dhëna që kanë të bëjnë me periudhën paraosmane dhe me ato që në fokus kanë periudhën osmane në hapësirat shqiptare.

Periudha paraosmane

Në librin "Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare", krahas të dhënave që kanë të bëjnë me periudhën osmane në hapësirën shqiptare, na ofrohen informacione të rëndësishme edhe për periudhën paraosmane. Të kësaj natyre janë të dhënat që kanë të bëjnë me Muzakajt, të cilët autori i paraqet si një lidhëz të fuqishme midis kohëve paraosmane dhe osmane.

Ai vë në dukje se familja e Muzakajve, si përbërëse elitare e bujarisë shqiptare të mesjetës, mbetet gjithnjë një temë e lakmuar për studiuesit. Përveç Gjon Muzakës, studiuesi Duka pohon se të dhëna të çmueshme për këtë familje na ofrojnë edhe një sërë veprash të studiuesve të shumtë, që janë marrë me këtë çështje. Megjithatë, studiuesi në fjalë e sheh si të arsyeshme dhe shumë të domosdoshme thellimin e mëtejshëm të njohurive për këtë familje, e veçanërisht për mënyrën e kalimit dhe integrimit të Muzakajve në sistemin e ri politik dhe ekonomik të vendosur në Shqipëri pas pushtimit osman.

Periudha osmane

Me vendosjen e sundimit osman në hapësirat shqiptare, populli shqiptar u përball me një perandori të fuqishme dhe me një sundim të gjatë, i cili solli ndryshime si në aspektin ekonomik, social, kulturor, fetar. Autori na jep të dhëna interesante për shumë çështje të rëndësime me të cilat u përball shoqëria shqiptare gjatë sundimit osman, duke filluar që nga vitet e para të vendosjes së këtij sundim në trevat shqiptare. Në mesin e çështjeve të shumta studiuesi Duka, një trajtesë të veçantë i bën ndryshimit të strukturës fetare të popullit shqiptar, si rezultat i përhapjes fesë islame.

Duke u bazuar në fakte dhe analiza, autori përqendrohet në shpjegimin e faktorëve që quan në përhapjen e fesë islame te shqiptarët. Në këtë kontekst, ai potencon se përhapja e Islamit në tokat shqiptare u shkaktua nga një numër faktorësh të natyrave të ndryshme si politike, ekonomike, kulturore dhe fetare.

Sa i përket faktorit politik, ai vë në dukje disa aspekte të politikës së shtetit osman, të cilat inkurajuan procesin e përhapjes së fesë islame ndër shqiptarët. Në radhë të parë përmend mekanizmat politikë që u përdorën për tërheqjen e fisnikërisë feudale vendëse në hierarkinë ushtarako-administrative. Faktor tjetër që ndikoi në përhapjen e fesë islame, ishte edhe ai ekonomik, në këtë kuadër braktisja e fesë së krishterë dhe përqafimi i Islamit u stimulua fuqishëm edhe nga detyrimi i popullsisë së krishterë për t'i paguar shtetit osman taksen e xhizjes. Si faktor të tretë dhe mjaft të fuqishëm që ndikoi në nxitjen e procesit të kalimit në Islam, autori radhit faktorin fetar, për faktin se në kohën kur po vendosej sundimi osman në hapësirat shqiptare, ndryshe nga popujt tjerë fqinjë ballkanikë populli shqiptar nuk kishte një kishë të vetme kombëtare.

Në kuadër të këtij libri, studiuesi Ferit Duka na jep të dhëna interesante edhe për qytetet shqiptare gjatë periudhës osmane. Veçanërisht ai përqendrohet në hulumtimin e disa qyteteve, roli dhe rëndësia e të cilave bie në sy gjatë sundimit osman. Si të tillë përmend qytetin e Vlorës, i cili ishte i pari që kaloi nën sundimin osman, duke u bërë kështu pikëmbështetje e rëndësishme për shtrirjen e sundimit osman në viset e tjera shqiptare. Në kuadër të qyteteve shqiptare, studiuesi Duka në këtë libër kujdes dhe vëmendje të veçantë i kushton edhe qytetit të Himarës gjatë sundimit osman duke u ndalur në trajtimin dhe studimin e aspekteve social-ekonomike dhe demografike. Ai nuk lë pa përmendur as rolin dhe rëndësinë e qytetit të Gjirokastrës dhe të Beratit gjatë periudhës osmane, duke vënë në spikamë aspekte të zhvillimit të urbanistikës dhe të arkitekturës së tyre. Në prizmin urbanistik, për qytetin e Beratit, ai pohon se karakteristikë kryesore e këtij qyteti sa i përket strukturës urbane gjatë shekujve XVII-XVIII, janë objektet e kultit islamik si xhamitë, medresetë, teqetë etj.

Një temë tjetër që autori trajton në këtë libër është edhe prania e hebrenjve në Shqipëri. Për autorin e librit, studimi i historisë së Shqipërisë nuk do të ishte i kompletuar pa njohur dhe studiuar edhe historinë e bashkësive joshqiptare, e në rastin konkret të hebrenjve. Duke folur për prezencën e hebrenjve në Shqipëri, si gjatë periudhës paraosmane ashtu edhe gjatë saj, ai flet edhe për integrimin e tyre në jetën shoqërore si dhe për rolin që ata luajtën në proceset dhe zhvillimet ekonomike, duke vënë në dukje se ata u dalluan sidomos në tregti, me ç'rast në vitet e 60 të shek. XVI hebrenjtë e vendosur në Vlorë, kishin në duart e tyre tregtimin e grurit, vajit të ullirit, kafshëve, lëkurave të punuara etj.

Në faqet e librit "Shekujt osmanë në hapësirat shqiptare" studiuesi Ferit Duka, një trajtesë të veçantë u bënë edhe përpjekjeve të popullit shqiptar për t'u liruar nga sundimi osman, duke iu bërë një shtjellim të veçantë sfidave me të cilat u përball populli ynë, qoftë si pasojë e luftërave të shumta ashtu edhe si rezultat i përpjekjeve diplomatike për të arritur te momenti më kulmor i këtyre orvatjeve, siç është largimi i osmanëve nga trojet shqiptare dhe shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë.

PËRMBAJTJA

Qemajl Morina
Mehmet Ali Pasha burrështeti 5

Nexhat Ibrahimi
Ibn Rushdi (Averroesi), gjeniu mysliman nga Andaluzia 13

Mr. Ejup Haziri
Legjislacioni islam 33

Refik Vitia
Myderrizi Shehid Ismet ef. Limani.. 57

Prof. dr. Adem Zejnullahu
Poezia e Mulla Vesel Xheldin Gutës 75

Sadik Mehmeti
Jehona e përkthimit të parë komplet të Kur'anit
në shtypin shqiptar... 85

Elez Osmani
Gazali "fliste" shqip para 50 vjetësh -
me pendën e Ahmet Ramos 93

Esilda Luku
Vështrim mbi ndikimin e bashkëjetesës pesëshekullore
shqiptaro-osmane në identitetin kombëtar shqiptar.................. 117

Dr. Naceur Jabnoun
Islami dhe menaxhmenti - (5)... 133

Mr. Qemajl Morina
Nevoja e dialogut ndërfetar e ndërkulturor
për arritjen e stabilitetit në Ballkan 169

Mr.sc. Rrezehana Hysa
Politika arsimore e Kongresit të Elbasanit 177

Naim Berisha
Orientalizmat në leksikun e Gjakovës.. 185

Dr. Abdurrahman Rafet el-Basha
El-Guemejdau Bintu Milhan - e njohur me llagapin Umu Sulejm **195**

A. K. M. Mohiuddin
Çka i ofron islami njerëzimit.. 203

Nuridin Ahmeti
Një jetë në shërbim të fesë dhe kombit.. 215

Prof. dr. Ali Pajaziti
Homo albanicusi, albkultura dhe orienti nën thjerrëzën
e soc-antropologjisë.. 227

Teuta Shala
Një vepër monumentale mbi shekujt osmanë në hapësirën
shqiptare... 233

Përmbajtja 237